



RAPORT AUDITIMI
MBI
(Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë)
në

“BASHKIA CËRRIK”

Tiranë 2023

PËRMBAJTJA

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	11
I. HYRJA	14
1. Objektivat e auditimit.....	14
2. Qëllimi i auditimit	14
3. Identifikimi i çështjes.....	14
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	15
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	15
6. Kriteret e vlerësimit	15
7. Standardet e auditimit	16
8. Metodologjia e auditimit	17
9. Dokumentimi i auditimit	18
II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	18
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	18
2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm	19
2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	29
2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike- Asetet.....	50
2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.	53
2.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.	90
2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.....	112
Treguesit e zhvillimit të propozuar	116
Treguesit e zhvillimit pas rikonstruksionit.....	117
Sipërfaqja e ndërtesës e cila rikonstruktohet (28.15 m X 10.6 m): 291.73m ²	117
Treguesit e Zhvillimit të propozuar:	118
Treguesit e Zhvillimit të propozuar :	120
Nga Bashkia Cërrik u paraqitën observacione mbi Projekt Raportin e auditimit nga <i>Z. F.U me detyre Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit</i> , protokolluar në KLSH me nr.1032/1 datë 17.05.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:	129
Pretendimi i subjektit:	129
2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore.....	133
2.7 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	138

IV GJETJE DHE REKOMANDIME	161
F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL	177
ANEKSET	179
Aneksi nr. 2.3/1 Pronat të cilat janë regjistruar gjatë periudhës 2017-2019 pranë ASHK	192
Pronat të cilat janë regjistruar gjatë periudhës 2020-2022 pranë ASHK.	193

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi mbuloi çështjet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë Cërrik si: menaxhimi financiar dhe kontrolli, auditimi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, të ardhurat, vlerësimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit publik, zbatimi i kontratave të punimeve në investimet publike, administrimi i aseteve, shfrytëzimi për veprimtari ekonomike i fondit pyjor si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm. Për analizimin dhe vlerësimin e aktivitetit të subjektit sipas pikave të planifikuara në programin e auditimit, grupi i auditimit vlerësoi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe analizoi të gjitha evidencat e grumbulluara gjatë kryerjes së auditimit në terren sipas çështjeve përkatëse.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit ka mbajtur dhe protokolluar në Bashkinë Cërrik 15 akt konstatime dhe 2 akt verifikim. Mbi akt konstatimet dhe akt verifikimet e mbajtura nga grupi i auditimit si dhe mbi Projekt Raportin e Auditimit janë paraqitur observacione nga Bashkia Cërrik të cilat janë trajtuar në përputhjeve me përcaktimet e Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH-së. Gjithashtu, në ambientet e KLSH-së më datë 13.01.2023 me përfaqësuesit e Bashkisë Cërrik nuk u zhvillua takimi ballafaqes për çështjet e trajtuara në raportin përfundimtar të auditimit.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjeve	Rën dësia	Rekomandimi
1	Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim Asfaltim rruga Kamunah”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 33,820,544 lekë me TVSH, fituar nga OE “V.H” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 102,316 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1343 prot datë 15.04.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE “V.H” SHPK	E lartë	Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 102,316 lekë pa tvsh nga BOE “V.H” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1343 prot datë 15.04.2021, me objekt “Sistemim Asfaltim rruga Kamunah”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
2	Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugës Qyrkan”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 26,092,473.6 lekë, fituar nga OE “V.H” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 271,632 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1834 prot datë 14.07.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE “V.H” SHPK.	E lartë	Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 271,632 lekë pa tvsh nga OE “V.H” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1834 prot datë 14.07.2020, me objekt “Rikonstruksion i rrugës Qyrkan”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
3	Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitimi i kanaleve vaditës”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 40,786,652.4 lekë, fituar nga BOE “M.” SHPK & “Sh.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 104,610 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve	E lartë	Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 104,610 lekë pa tvsh nga BOE “M.” SHPK & “Sh.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2661 prot datë 08.10.2020, me objekt “Rehabilitimi i kanaleve vaditës”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj

	nr. 2661 prot datë 08.10.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe BOE "M." SHPK & "Sh." SHPK.		buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
4	Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rikonstruksion rruga e Liçaj", Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 23,934,289 lekë, fituar nga OE "A." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 129,152 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3720 prot datë 31.12.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE "A." SHPK.	E lartë	Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 129,152 lekë pa tvsh nga OE "A." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3720 prot datë 31.12.2020, me objekt "Rikonstruksion rruga e Liçaj", Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
5	Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Sistemim asfaltim i tre rrugëve", Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 29,637,769 lekë, fituar nga BOE "G.T" SHPK & "E.A" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 369,779 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1390 prot datë 20.04.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe BOE "G.T" SHPK & "E.A" SHPK.	E lartë	Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 369,779 lekë pa tvsh nga BOE "G.T" SHPK & "E.A" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1390 prot datë 20.04.2021, me objekt "Sistemim asfaltim i tre rrugëve", Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
6	Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rikonstruksion objekti 2k dhe ndryshim destinacioni nga magazinë në banesa sociale", Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 13,634,256 lekë, fituar nga OE "Z." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 113,360 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2416 prot datë 16.09.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE "Z." SHPK.	E lartë	Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 113,360 lekë pa tvsh nga OE "Z." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2416 prot datë 16.09.2020, me objekt "Rikonstruksion objekti 2k dhe ndryshim destinacioni nga magazinë në banesa sociale", Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
7	Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar, NjA Mollas", Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 337,342,218 lekë, fituar nga BOE "V.K" SHPK & "F." SHPK & "E.A" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 369,280 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2816 prot datë 21.10.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe BOE "V.K" SHPK & "F." SHPK & "E.A" SHPK.	E lartë	Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 369,280 lekë pa tvsh nga BOE "V.K" SHPK & "F." SHPK & "E.A" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2816 prot datë 21.10.2020, me objekt "Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar, NjA Mollas", Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
8	Gjetje nga auditimi: Detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore që taksapaguesit kanë ndaj Bashkisë Cërrik në datën 31.12.2022 janë në vlerën 39,724 mijë lekë, nga e cila: subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore në vlerë 7,936 mijë lekë për 142 subjekte	E lartë	Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore Bashkia Cërrik, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/tarifatat

	<p>dhe abonentë familjarë në vlerë 31,798 mijë lekë për 3,441 abonent, <i>vlerë kjo e cila perbën detyrim të pa arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Cërrik</i>. Rezulton se vetëm në vitin 2022 borxhi tatimor i krijuar është në vlerën totale 20,584 mijë lekë, i përbërë nga 5,892 mijë lekë për 130 subjekte private dhe 14,692 lekë nga taksapaguesit familjarë. Bashkia Cërrik nuk ka aplikuar masat e duhura ligjore për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. DTTV për vitin 2022 ka dërguar në Drejtorinë e Financës informacion lidhur me debitorët progresiv.</p>	<p>vendore në fund të vitit 2022 në vlerën 39,724 mijë lekë, si më poshtë vijon:</p> <p><i>a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.</i></p> <p><i>b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).</i></p> <p><i>c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.</i></p> <p><i>d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë Tatim Taksave dhe Drejtorisë Juridike, të marren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</i></p> <p><i>e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Cërrik për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.</i></p> <p><i>f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.</i></p>
9	<p>Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e licencave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Cërrik dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrojnë aktivitetin 15 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, sipas aneksit 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 2 subjekte janë pajisur me autorizim 5 vjecar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 dhe kanë paguar detyrimet në vlerë 2,000,000 lekë si dhe janë pajisur me autorizim 1 dhe 2 vjecar 13 subjekte të cilët kanë paguar detyrimet në vlerë 6,040,000 lekë. Sa më sipër rezulton së Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore ka vepruar në kundërshtim me Kreun II pika 11 e VKB nr. 83 datë 28.12.2021 “Mbi miratimin e paketës fiskale për vitin 2022” si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të</p>	<p>E lartë</p> <p>Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së patakshuar prej 5,460,000 lekë sipas pasqyrës Aneks nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.</p>

	<p>kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15.</p> <p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se subjektet e pajisura me autorizim 1 vjecar ka berë likuidimin e detyrimeve sipa autorizimit. Referuar lishensave perkatse subjektet janë debitorë në vlerën 5,460,000 lekë vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë Cërrrik. <i>Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me Kreun II pika 11 e VKB nr. 83 datë 28.12.2021 “Mbi miratimin e paketës fiskale për vitin 2022” si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15.</i></p>		
10	<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në 5 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në pajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht si vijon:</p> <p>1- Në procedurën e prokurimit me objekt “Sistemim Asfaltim i tre rrugëve”, me vlerë të fondit limit 24,835,898 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues BOE “G.T” SHPK & “E.A” SHPK, me ofertë 24,698,141 lekë pa TVSH, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.</p> <p>2- Në procedurën e prokurimit me objekt “Sistemim Asfaltim i rrugës Kamunah”, Bashkia Cërrrik, me vlerë të fondit limit 28,333,333 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021”, është shpallur fitues operatori ekonomik OE “V.H” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 28,183,787 lekë pa TVSh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.</p> <p>3- Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar, NjA Mollas”, Bashkia Cërrrik, me vlerë të fondit limit 283,457,911 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “V.K” SHPK & “F.” SHPK & “E-A” SHPK me ofertë 281,115,515 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.</p> <p>4- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rehabilitim/Perforcim banesash ekzistuese”, Bashkia Cërrrik, me vlerë të fondit limit 26,920,399</p>	E lartë	<p>Rekomandim: Titullari i AK Bashkia Cërrrik, të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.</p>

	<p>lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “Z” ShPK, me ofertë 26,920,399 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.</p> <p>5- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës së Capallarëve dhe vreshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, Fshati Licaj, Nj.A. Shalës”, Bashkia Cërrik, me vlerë të fondit limit 49,091,672 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “Z” SHPK, me ofertë 49,052,481.5 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: neni 24 “Anullimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, germa (ç), neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, germa (a) dhe Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 92, pika 3.</p>		
11	<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në procedurat e prokurimit me objekt: “Sistemim Asfaltim i tre rrugëve”, “Sistemim Asfaltim i rrugës Kamunah”, “Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Desar”, “Rehabilitim/Perforcim banesash ekzistuese”, “Rikonstruksion i rrugës së Capallarëve dhe vreshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, Fshati Licaj, Nj.A. Shalës”, zhvilluar në periudhën 2020-2022, janë vendosur kriteret të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik. Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme në hartimin e kriterëve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5, nenit 27, neni 61 pika 2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, me pikën 4 të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar</p>	E lartë	<p>Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Cërrik të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kriteret e veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.</p>
12	<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për periudhën objekt auditimi janë certifikuar në total 7 prona sipas tabelës së sipërcituar si dhe përpara vitit 2020 janë certifikuar 65 prona objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të administruara llog.(212) pasuri e paluajtshme (sasi e vlerë) pjesa e konsiderueshme e tyre prej 4403 prona (trajtuar analitikisht) nuk janë të regjistruara në kontabilitet dhe</p>	E lartë	<p>Rekomandimi: - Drejtoria e Financës në cilësinë e Nënpunësit Zbatues, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin 38 prona të certifikuara në ASHK Elbasan, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia</p>

	<p>pasqyrat financiare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Nga 65 prona të cilat janë certifikuar 34 prona janë prona të transferuara nga Ish komunat sot njësitë Administrative dhe 31 prona janë prona të cilat janë certifikuar për periudhën 2017-2019 dhe 7 prona janë certifikuar për periudhën 2020-2022 sipas aneksit nr. 1 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Konstatohet se sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga sektori i aseteve, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Cërrik në Drejtorinë rajoneve të ASHK Elbasan, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 38 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Cërrik. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. <i>Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16).</i></p>		<p>Cërrik sipas aneksit nr. 1 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.</p>
13	<p>Gjetje nga auditimi: Konstatohet se: struktura e DAV Bashkia Cërrik ka probleme dhe nuk është në funksion të realizmit e të ardhurave, pasi evidentohet mos krijimi i Sektorit të Masave Shtrenguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në DAV Bashkia Cërrik, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të paarkëtuara (debitor), për 3,583 subjekte familjar dhe biznesi në vlerën 39,724 mijë lekë, nga e cila: subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore në vlerë 7,936 mijë lekë për 142 subjekte dhe abonentë familjarë në vlerë 31,798 mijë lekë për 3,441 abonent. Alternim i këtij sektori në përbërje të Sektorit të Kontrollit Terren është i papërshtatshëm, kjo nisur nga fakti se kanë natyra të ndryshme pune dhe se arkëtimi i debitorëve është procedurë më vetë dhe afate të përcaktuara. Gjithashtu konstatohet se për periudhën objekt auditimi 2022 Drejtoria e të Ardhurave Vendore ka funksionuar pa Drejtor çka sjell mos arkëtimin e të ardhurave, kjo për mungesë stafi, në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me shkresën nr. 168/1 prot datë 29.04.2022.</p>	E lartë	<p>Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Cërrik me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.</p>

14	<p>Gjetje nga auditimi: Bashkia Cërrik në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 181,333,663 mijë lekë (nga kjo 36,236,536 leke, detyrime të FSHZH), Detyrimi i Bashkisë është 145,097,127 leke e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti vlera 71,072,877 mijë lekë, nga e cila është likuiduar vlera 84,750,410 mijë lekë, ose 119.24% e vlerës së planifikuar. Po për efekte të shtimit të detyrimeve gjate vitit 2022 , kjo ulje e detyrimeve nga pagesat nuk reflektohet në gjendjen e detyrimeve në datën 31.12.2022 .Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022), është ulur (145,097,127-121,557,012), me 23,540,115 lekë, ose në masën prej 16.23%. Në mënyrë të detajuar lista analitike e detyrimeve të prapambetura paraqitet në aneksin nr. 5 pika 2.4 bashkëlidhur raportit të auditimit. Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2022.</p>	E lartë	<p>Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura si dhe të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.</p>
15	<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nuk është hartuar “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, përveç trajnimeve që kryhen nga ASPA. - Në informacionin e sjellë nga Burimet Njerëzore në vitin 2022 janë kryer 56 trajnime për 11 punonjës të Bashkisë Cërrik. - Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut. - Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n). - Bashkia Cërrik nuk ka miratuar “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”, e cila duhet të përditësohet rregullisht (çdo 3 vite), në zbatim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e 	E lartë	<p>Rekomandimi: Bashkia Cërrik me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të hartojë planin e trajnimeve; - Të organizojë trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; - Të aplikojë programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar; - Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin; - Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”;

<p>kordinatorit të MFK- së dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”, pikën 5.3.</p> <p>- Procesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse në mos zbatim të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të MFK dhe kordinatorit të riskut njësitë publike”.</p> <p>- Në mbështetje të Ligjit nr. 10296 dt. 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 27, në zbatim të Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK në Njësitë Publike” pika 2/2,4, nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Bashkia Cërrik nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.</p> <p>- Në Bashkinë Cërrik, drejtorja e financave përdor programin excel. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave dhe kjo kryhet nga drejtorja e financave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.</p> <p>- Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm.</p> <p>- Bashkia Cërrik nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.</p>	<p>- Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”;</p>
--	--

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Opinioni i auditimit:

I. Opinion mbi Pasqyrat Financiare

Pasqyrat financiare për vitin 2022, bazuar në Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, mbyllet në datën 31.03.2023. Për arsye se auditimi ka përfunduar në datën 03.03.2023 dhe brenda kësaj date nuk janë hartuar pasqyrat financiare, vlerësimi për pasqyrat financiare të viti 2022 nuk është bërë. Në këtë proces auditimi nuk është dhënë opinion për pasqyrat financiare, i cili do të bëhet në auditimin e radhës.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Cërrik, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor

dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar (kualifikuar) të përputhshmërisë.

Baza për dhënien e opinionit

- Bashkia Cërrrik nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

-Investimet nga të ardhurat e veta kanë një nivel të ulët të realizimit krahasuar me planifikimin. Për vitin 2022 investimet janë planifikuar në vlerën 225,658 mijë lekë, realizuar **193,024** mijë lekë, ose në masën 85.54 %.

-Nuk janë marrë masa të plota për uljen e detyrimeve të prapambetura. Edhe pse janë likuiduar gjatë vitit buxhetor detyrime të prapambetura, nga ana tjetër edhe gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura, duke çuar në 31.12.2022 vlerën e tyre, me burim financimi të ardhurat e veta në 121,557 mijë lekë.

-Janë konstatuar anomali në hartimin e kriterëve të veçanta të DST në procedurat e prokurimit publik, pasi janë vendosur kriterë të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën dhe madhësinë e kontratës.

- Në 5 raste dhe konkretisht në procedurat e prokurimit për objektet “Sistemim Asfaltim i tre rrugëve”, “Sistemim Asfaltim i rrugës Kamunah”, “Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar”, “Rehabilitim/Perforcim banesash ekzistuese”, “Rikonstruksion i rrugës së Capallarëve dhe vreshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, Fshati Licaj, Nj.A. Shalës”, zhvilluar në periudhën 2020 - 2022, janë vendosur kriterë të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

- Në 5 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën totale 413,169,591 lekë, konkretisht si vijon:

1-Në procedurën e prokurimit me objekt “Sistemim Asfaltim i tre rrugëve”, me vlerë të fondit limit 24,835,898 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues BOE “G.T” SHPK & “E.A” SHPK, me ofertë 24,698,141 lekë pa TVSH, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

2- Në procedurën e prokurimit me objekt “Sistemim Asfaltim i rrugës Kamunah”, Bashkia Cërrrik, me vlerë të fondit limit 28,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2021”, është shpallur fitues operatori ekonomik OE “V.H” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 28,183,787 lekë pa TVSH, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

3- Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar, NjA Mollas”, Bashkia Cërrrik, me vlerë të fondit limit 283,457,911 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “V.K” SHPK & “F.” SHPK & “E.A” SHPK me ofertë 281,115,515 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

4- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rehabilitim/Perforcim banesash ekzistuese”, Bashkia Cërrrik, me vlerë të fondit limit 26,920,399 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “Z.” ShPK, me ofertë 26,920,399 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

5- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës së Capallarëve dhe vreshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, Fshati Licaj, Nj.A. Shalës”, Bashkia Cërrrik, me vlerë të fondit limit 49,091,672 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE

“Z.” ShPK, me ofertë 49,052,481.5 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

-Për vitin 2022 nga Bashkia Cërrik për zbatimin e vendimeve gjyqësore pavarësisht objektit të dëmshpërblimit, është shpenzuar vlera **426,000** lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet, për të cilat nuk është kryer analizë dhe nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative nga Titullari.

- Për taksën e ndikimit në infrastrukturë, është konstatuar një vlerë e pa arkëtuar prej 15,537 mijë lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Cërrik.

- Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2022 rezulton një vlerë e pa arkëtuar prej 39,724 mijë lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Cërrik, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Cërrik:

Drejtimi i njësive vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Cërrik.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kriterëve të DST, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të jap opinion për këtë.

I. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1174/1 Prot, datë 09.01.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 09.01.2023 deri në datën 03.03.2023, në subjektin Bashkia Cërrik u krye “Auditimi Financiar për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 dhe Auditimi i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022”. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1.A.Z–P/G

2.H.I–A.

3.E.V–A.

4.L.B–A.

Titulli: Auditim financiar dhe përputhshmërie.

Marrësi: Raporti i Auditimit i drejtohet subjektit të audituar Bashkia Cërrik.

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Cërrik kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuarra dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)¹;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objekivi i auditimit financiar në Bashkinë Cërrik është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Cërrik dhe përgjegjësisë, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin

¹Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2022.
4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2021-31.12.2022.
5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV-së.
7. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Cërrrik, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Cërrrik është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Cërrrik. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- “VKM nr. 187, datë 8.3.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar.
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”;
- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 “Për përgatitjen e PBA vendor 2021-2023”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ”Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.
- Etj.
-

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Cërrik grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik“;
- ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”.
- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Cërrrik me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale².

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

² ISSAI 1315

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtuar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH³ aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Auditimi në subjektin “Bashkia Cërrik”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të

³ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave.

Bashkia Cërrrik është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”.

Profili i Bashkisë Cërrrik

Bashkia Cërrrik kufizohet në veri me bashkitë Elbasan dhe Peqin, në jug-lindje me bashkinë Gramsh, në jug me bashkinë Kuçovë dhe në perëndim me bashkinë Belsh. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Cërrrikut. Bashkia Cërrrik përbëhet nga 5 njësi administrative që janë, Cërrrik, Shalës, Mollas, Gostimë dhe Klos. Burimet e financimit në Bashkinë Cërrrik përbëhen nga, të ardhura nga burime të veta vendore; transfertat e pakushtëzuar; taksa të ndara; transfertat të kushtëzuara.

Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 27,445 banorë me densitet prej 144.71 banorë për km², ndërsa që sipas Regjistrat Civil numëron një popullsi prej 46,652 vetë, me dendësi prej 189.65 banorë për km². Bashkia Cërrrik ka një sipërfaqe prej 189.65 km².

Bashkia e Cërrrikut shtrihet në një zonë fushore dhe kodrinore në përgjithësi mes dy lumenjve, Shkumbin dhe Devoll dhe ka si qendër qytetin e Cërrrikut, një ish qytezë industriale, i shpallur si qytet më 1952 me ndërtimin e Uzinës së Përpunimit të Naftës dhe një termocentrali, të cilat iu shtuan qendrës së shërbimeve për bujqësinë.

Në vitet 1990 rafineria e naftës pushoi së ekzistuari duke sjellë largimin e pjesës më të madhe të rinisë nga ky qytet ndërsa pjesa e mbetur e popullsisë ka burime shumë të pakta ekonomike nga pensionet, ndihma ekonomike dhe remitancat.

REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:

2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-s

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe si ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mjedisi i kontrollit

Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues.

Bashkia Cërrrik funksionon në përputhje me Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Cërrrik.

Rregullorja e brendshme e Bashkisë Cërrrik për vitin 2022, është miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 168/1 datë 29.04.2022 dhe Kodi i Etikës është miratuar me nr. 168/2 datë 29.04.2022.

Politika menaxheriale dhe stili i punës.

Pasqyrimi i emërimeve dhe largimeve në Bashkinë Cërrrik për vitin 2022 është si më poshtë:

	2022	
	<i>Emërimet</i>	<i>Largimet</i>
<i>Nr. i punonjësve</i>	40	21

<i>Emërtimi</i>	<i>Viti</i>	<i>Plan</i>	<i>Fakt</i>
<i>Aparati Bashkia Cërrrik</i>	2022	277	287

Për vitin 2022 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 85, datë 28.12.2021, i ndryshuar “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Cërrrik dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2022”.

Bashkia Cërrrik në strukturën e saj për vitin 2022 ka në total 287 punonjës, dhe 6 pozicione të lira sipas drejtorive apo institucioneve të varësisë.

Numri i punonjësve në Bashkinë Cërrrik është rritur në muajin tetor me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.85 datë 26.10.2022 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me Aktin nr. 1273/1 prot., datë 11.11.2022 nga 277 punonjës në 293 punonjës. Pikërisht për këtë arsye në tabelën plan dhe fakt nuk ka rakordim të numrit të punonjësve të miratuar dhe atij aktual deri në datën 31.12.2022.

Nga ana e drejtorisë së burimeve njerëzore nuk na u paraqitën argumente përse ka ndodhur ky shtim i numrit të punonjësve dhe cili është përfitimi që ka bashkia nga ky ndryshim në numër punonjësish, por vetëm fakti se kjo gjë është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak të konfirmuar më pas nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Aftësitë profesionale të punonjësve.

Emërimet janë kryer në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenet 22 dhe 25 si dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, kreu II, III dhe VII.

Nuk është hartuar “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, përveç trajnimeve që kryhen nga ASPA.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Por nga Bashkia Cërrrik është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve dhe kjo tabelë i është dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Në informacionin e sjellë nga burimet njerëzore në vitin 2022 janë kryer 56 trajnime për 11 punonjës të Bashkisë Cërrrik.

Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-së në fushën e Menaxhimit të Riskut.

Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).

2. Menaxhimi i Riskut.

Në këtë proces identifikohen situatat e mundshme që mund të kenë efekt të dëmshëm në veprimtarinë e institucionit, të cilat mund të jenë risqe të brendshme apo të jashtme.

Bashkia Cërrrik nuk ka miratuar “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”, e cila duhet të përditësohet rregullisht (çdo 3 vite), në zbatim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinitorit të MFK-së dhe koordinitorit të riskut në njësitë publike” pikën 5.3.

Nga Bashkia Cërrik janë ndjekur pjesërisht hapat për implementimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, duke u bazuar edhe në UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”. Koordinator i riskut duhet të jetë Nëpunësi Autorizues (ose kjo detyrë të delegohet), në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 11, “Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë”, pika 2, në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III, pika 2.5.2 “Menaxhimi i riskut”, si dhe neni 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010.

Në Bashkinë Cërrik, për vitin 2022 koordinatori i riskut është Z.F.D, me detyrë Sekretar i përgjithshëm, me Urdhër të brendshëm nr. 11/1 datë 13.01.2022.

Koordinatori i riskut është përgjegjës për një sërë aktivitete: bashkërendon veprimtaritë që lidhen me identifikimin e risqeve, vlerësimin e tyre si dhe menaxhimin në mënyrën më të mirë të mundshme për të mos vënë në rrezik arritjen e objektivave, përgatit dhe paraqet monitorimin e kontrollit të risqeve në Bashkinë Cërrik te titullari i bashkisë dhe realizon monitorimin e kontrollit të risqeve të cilat vënë në rrezik objektivat e Bashkisë Cërrik.

Grupit të auditimit ju vunë në dispozicion shkresat për caktimin e Nëpunësit të Autorizuar dhe Nëpunësit zbatues, të cilat janë si më poshtë:

Nëpunës Autorizues (NA), Z.A.S, konfirmim i NA nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Menaxhimit dhe Harmonizimit Financiar, për dijëni të Degës së Thesarit Elbasan, datë 15.08.2019, me nr. 14905/1 prot. Nëpunës Zbatues (NZ), Z.H.K, konfirmim i NZ nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Menaxhimit dhe Harmonizimit Financiar, për dijëni të Degës së Thesarit Elbasan, datë 09.06.2016, me nr. 7962/1 prot.

Procesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse në mos zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, Kreu III dhe neni 10, Kreu II, ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”. Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS), për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe programit buxhetor afatmesëm. Bashkia Cërrik ka miratuar Plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet excel-it apo word-it. Në Bashkinë Cërrik, drejtoria e financave përdor programin excel. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave dhe kjo kryhet nga drejtoria e financave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.

3. Aktivitetet e kontrollit.

Referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, politikat dhe procedurat që vendosen, si parandaluese apo zbuluese në adresimin e risqeve sjellin arritjen e objektivave të institucionit. Bashkia Cërrik ka në strukturën e saj Auditin e Brendshëm, por ky sektor nuk është i plotë pasi funksionon me 2 auditues dhe nuk ka përgjegjës sektori. Nuk kemi ngritje të drejtorisë së auditit të brendshëm. Në Bashkinë Cërrik nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13. Si rrjedhojë, nuk ka takime të dokumentuara midis Komitetit të

Auditimit dhe drejtuesve të NJAB-së, në kundërshtim me kërkesat ligjore të cilat kanë si detyrim mbledhjen minimalisht 4 herë në vit.

4. Informimi dhe komunikimi.

Bashkia Cërrrik disponon faqen e saj zyrtare në Web, ku pasqyrohet aktiviteti i saj. Komunikimi realizohet elektronikisht, verbalisht dhe në formë shkresore. Me subjektet komunikimi kryhet nëpërmjet telefonit, postës zyrtare apo elektronike. Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Në Bashkinë Cërrrik punonjësit punojnë me këto sisteme informatike Word, Excel, HRMIS. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë elektronike.

5. Monitorimi.

Bashkia Cërrrik duhet t'i dërgojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për periudhat janar – prill, janar – gusht dhe janar – dhjetor, në total 3 raporte vjetore për ecurinë dhe realizimin e produkteve, masën e realizimit të shpenzimeve.

Ky raportim monitorimi për vitin 2022 është bërë 3 (tre) herë. Është miratuar në Këshillin Bashkiak dhe është dërguar në Ministrinë e Financave. Konkretisht për vitin 2022 është hartuar raporti i monitorimit dhe i performancës për vitin 2021 dhe është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresë nr. 1113 datë 30.03.2022. Është hartuar raporti i monitorimit për 4-mujorin e parë 2022 dhe me shkresë nr. 1669 datë 18.05.2022 është dërguar Ministrisë së Financave. Eshte hartuar raporti i monitorimit te 8-mujorit 2022 dhe me shkresë nr. 2712 datë 21.09.2022 është dërguar Ministrisë së Financave. Gjate vitit 2022 është raportuar në Ministrinë e Financave çdo 3-muaj për detyrimet e prapambetura. Për vitin 2022 është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, me urdhrin nr. 113/3 datë 12.01.2022 me përbërje si më poshtë vijon:

Nr	Emer Mbiemer	Pozicioni ne GMS	Funksioni ne Bashki
1	A.S	Kryetar	Kryetar i Bashkisë
2	F.D	N/Kryetar	Sekretar i Përgjithshëm
3	T.Z	N/Kryetar	Nënkryetar i Bashkisë
4	A.B	Koordinatorë	Dr. Kabineti
5	H.K	Sekretar	Dr. Financës e Pronave
6	M.Xh	Antare	Dr. Burimeve njerëzore
7	K.B	Antare	P. Tatim Taksave
8	F.U	Antare	Dr. Urbanistikës
9	Ç.SH	Antare	Dr. Bujqësisë
10	E.C	Antare	Dr. Sociale e Projekteve
11	O.B	Antare	P. Agjensisë Projekteve
12	F.A	Antare	P.Arsimit rinisë dhe sporteve
13	G.K	Antare	Administrator Nj.Gostim
14	A.G	Antare	Administrator Nj.Klos
15	E.XH	Antare	Administrator Nj.Mollas
16	B.K	Antare	Administrator Nj.Shalës
17	I.A	Antare	P. Sektorit Social
18	S.F	Antare	P. Sektorit Strehimit
19	A.N	Antare (Pa të drejtë vendimarrje)	Përgjegjëse për Auditin

Deklaratat për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe Pyetësori i vetëvlerësimit për vitin 2022 nuk janë dërguar akoma shkresat duke qenë se nëpunësi i parë autorizues përgatit dhe depoziton te Ministri i Financave raportin vjetor të konsoliduar jo më vonë se fundi i muajit maj, referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i unifikuar, nenit 18.

Konkluzion:

Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

Njësia vendore ka hartuar rregulloren e brendshme, ku janë përcaktuar në mënyrë të detajuar detyrat e secilit punonjës. Janë përcaktuar rregulla për rekrutimin e punonjëseve, por nuk u konstatuan rregulla të shkruara për veprimet që kryhen nga punonjësi dhe strukturat përgjegjëse. Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin, aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës. Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

- Nuk është evidentuar puna e anëtarëve GMS, duke u dokumentuar takimet dhe mbledhjet të për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

- Nuk ka vendosur rregulla të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar.

Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. Politika dhe praktika e burimeve njerëzore nuk garanton ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit, pasi nuk ka programe trajnimi për punonjësit, për të ngritur në vazhdimësi nivelin e tyre profesional.

“Menaxhimi i Riskut”

Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar. Në Bashkinë Çërrik nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut.

Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në bashki në të gjitha nivelet e saj, pra mungon regjistri i riskut. Është ngritur grupi i menaxhimit të riskut por nuk janë hartuar planet e veprimit për menaxhimin e riskut. Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.

-Nuk është bërë vlerësimi i riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up)

- Bashkia Çërrik nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të

ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka rregulla të shkruara për ruajtjen e aktiveve.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet përveç komunikimit verbal e shkresor kryhet nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale.

“Monitorimi”

Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Në Bashkinë Cërrik mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit.

Titullari i këtij institucioni për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Titulli i gjetjes 1: *Zbatim jo i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.*

Situata: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

- Nuk është hartuar “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, përveç trajnimeve që kryhen nga ASPA

- Në informacionin e sjellë nga Burimet Njerëzore në vitin 2022 janë kryer 56 trajnime për 11 punonjës të Bashkisë Cërrik.

- Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut.

- Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).

- Bashkia Cërrik nuk ka miratuar “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”, e cila duhet të përditësohet rregullisht (çdo 3 vite), në zbatim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të MFK- së dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”, pikën 5.3.

- Procesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse në mos zbatim të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të MFK dhe kordinatorit të riskut njësitë publike”.

- Në mbështetje të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 27, në zbatim të Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK në Njësitë Publike” pika 2/2,4, nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Bashkia Cërrik nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.

- Në Bashkinë Cërrik, drejtorja e financave përdor programin excel. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave dhe kjo kryhet nga drejtorja e financave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.

- Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm.

- Bashkia Cërrik nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016

Ndikimi: Zbatimi jo i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka sjellë mungesë të kontrollit të brendshëm.

Mos ndjekjen e trajnimeve cenon cilësinë e zhvillimit profesional të punonjësve.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor për MFK.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Bashkia Cërrik me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:

- Të hartojë planin e trajnimeve;
- Të organizojë trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
- Të aplikojë programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar;
- Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”;
- Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”;

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi, Z. A.S, Kryetar i Bashkisë Cërrik, nëpunës autorizues; Z. H.K, Drejtor i Financës, nëpunës zbatues dhe Znj. M.XH, Drejtor i Burimeve Njerëzore.

2. Vlerësim mbi veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm.

Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Cërrik, rezultoi se për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, bazuar në VKM nr. 83, datë 03.0.2016, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e NJAB në sektori publik”, Bashkia Cërrik nuk e ka të ngritur Njësien e Auditit të Brendshëm.

Në vitin 2022, struktura organizative nuk ka patur drejtor, vetëm 2 punonjës si inspektorë auditit të brendshëm në strukturë, në kundërshtim me kërkesa e ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, neni 11 dhe të VKM nr. 83 datë 03/02/2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, për “*Miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik*” pika 3 -*Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.*

Struktura e Auditit të Brendshëm në bashkinë Cërrik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Arsimi	Vjetërsi Audit	Çertifikatë si auditues
1	D.M	Specialiste auditit	Ekonomiste Plani	5	Certifikuar korrik i vitit 2019
2	A.H	Specialiste auditit	Ekonomiste Biznesi	1	Pa certifikim

Për vitin 2022 është miratuar plani vjetor dhe ai strategjik për vitet 2022-2024 të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm dhe me shkresën nr. 4342 datë 19.10.2021 i është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Për vitin 2022 janë planifikuar dhe realizuar këto auditime si më poshtë vijon:

- 1-“Sektori i financës”.
- 2-“Sektori i Tatim Taksave”.
- 3-“Sektori i financës dhe buxhetit (detyrimet e prapambetura)”;
- 4-“Ndërmarrja e Ujësjetllës-Kanalizime sh.a.”;
- 5-“Financa Menaxhimi Aktiveve”
- 6-“Kontrolle të iniciuara (nga Kryetari ose nëpunësi autorizues, nëse do ketë)”.

Nga verifikimi rezulton se janë realizuar auditimet e planifikuara dhe nga shqyrtimi i disa dosjeve të auditit të brendshëm për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 u konstatuan si më poshtë vijon:

Viti 2022

Nga auditimi i dosjeve të vitit 2022 konstatuam :

***Dosje auditimi: Drejtoria e tatim-taksave, Njësia Administrative Cërrik;**

*Njoftim për fillimin e angazhimit: Nr. 2093 Prot, datë 01.07.2022;

*Program Auditimi: Nr.2093 Prot., datë 04.07.2022

*Periudha e auditimit: 01.01.2020 – 31.12.2021;

*Auditët: Znj. D.M dhe Znj. A.H;

*Periudha e angazhimit: 01.07.2022 – 20.07.2022

*Lloji i auditimit : Përputhshmërie dhe financiar

*Raporti final: Nr. 2093/2 Prot., datë 20.08.2022

*Numri i rekomandimeve: 4 të dhëna dhe 4 të pranuar

Viti 2022

***Dosje auditimi: Drejtoria e financës, Bashkia Cërrik;**

*Njoftim për fillimin e angazhimit: Nr. 1422 Prot, datë 26.04.2022;

*Program Auditimi: Nr.1468 Prot., datë 06.05.2022

*Periudha e auditimit: 01.01.2020 – 31.12.2021;

*Auditët: Znj. D.M dhe Znj. A.H;

*Periudha e angazhimit: 05.05.2022 – 20.05.2022

*Lloji i auditimit : Përputhshmërie dhe financiar

*Raporti final: Nr. 1468/2 Prot., datë 25.06.2022

*Numri i rekomandimeve: 9 të dhëna dhe 9 të pranuar

Viti 2022

***Dosje auditimi: Drejtoria e financës, sistemi i pagave Bashkia Cërrik (iniciuar nga Kryetari i Bashkisë Cërrik);**

*Njoftim për fillimin e angazhimit: Nr. 72 Prot, datë 03.01.2022;

*Program Auditimi: Nr.84 Prot., datë 12.01.2022

*Periudha e auditimit: 01.01.2020 – 31.12.2021;

*Auditët: Znj. D.M dhe Znj. A.H;

*Periudha e angazhimit: 15.01.2022 – 31.01.2022

*Lloji i auditimit : Përputhshmërie dhe financiar

*Raporti final: Nr. 84/2 Prot., datë 28.02.2022

*Numri i rekomandimeve: 3 të dhëna dhe 3 të pranuar

Konkluzion.

➤ Komiteti i Auditit të Brendshëm: Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”, i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm”:

- a) Duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;
- b) Duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;
- c) Duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
- d) Duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;
- e) Duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna;
- f) Duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.

Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

➤ Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, lejet e ndërtimit, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Kryetarit të Bashkisë për arritjen e objektivave, pasi nuk janë kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

➤ Nga shqyrtimi i dosjeve të auditimeve të periudhës 01.01.2022-31.12.2022 u konstatua se në mungesë të strukturës, nuk është bërë kontrolli i cilësisë së auditimit të kryer, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, Kap. II, pika 10.

➤ Nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim).

Nga ana e Njesisë së Auditimit Bashkia Cërrik për periudhën e auditimit nuk është kryer verifikimi i zbatimit të rekomandimeve me program tematik të veçantë, por është bërë verifikimi i rekomandimeve në auditimin e rradhës, gjë që vjen në kundërshtim me Manualin e auditimit të

miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, pikën 4.1.13.2, Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve, ku përcaktohet se: “Kur nuk është planifikuar angazhim auditimi në vitin në vazhdim, audituesit duhet t’i mundësojnë një raport të shkurtër titullarit të njësisë, për progresin e bërë në zbatimin e rekomandimeve të rëna dakord më parë. Në këto raste rishikimi i zbatimit të rekomandimeve mund të realizohet në auditimin e radhës në subjektin publik si pikë e veçantë e programit të auditimit”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi, Z. A.S, Kryetar i Bashkisë Cërrik; znj. D.M dhe znj. A.H, me detyrë specialiste në njësinë e auditit të brendshëm.

Titulli i Gjetjes 2: Mungesë e strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm

Situata: Njësia e Auditit të Brendshëm për vitin 2022 nuk ka patur drejtor, vetëm 2 punonjës si inspektorë auditimi të brendshëm në strukturë, në kundërshtim me kërkesa e ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, neni 11 dhe të VKM nr. 83 datë 03/02/2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, për “Miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik” pika 3. Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”.

Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, lejet e ndërtimit, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Kryetarit të Bashkisë për arritjen e objektivave, pasi nuk janë kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Nga ana e Njësisë së Auditimit Bashkia Cërrik për periudhën e auditimit nuk është kryer verifikimi i zbatimit të rekomandimeve me program tematik të veçantë, por është bërë verifikimi i rekomandimeve në auditimin e radhës, gjë që vjen në kundërshtim me Manualin e auditimit të miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, pikën 4.1.13.2, Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manuali i Auditit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Vendimin Nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Ndikimi: Mungesa e ngritjes së strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm nuk sjell një veprimtari të pavarur që jep siguri objektive dhe këshillim për të përmirësuar performancën e institucionit

Shkaku: Mos ngritje të Njësisë së Auditit të Brendshëm

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Bashkia Cërrik të marrë masa për plotësimin e strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm, dhe të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, duke i dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike.

2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

I. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022;

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallë e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i taveve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Me Urdhrin nr.113/3, datë 12.01.2022, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022- 2024.

Planifikimi i programit buxhetor afatmesëm 2022- 2024 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me nr. 85 , datë 28.12.2021.

PBA (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimet:

a-PBA 2022-2024 miratuar respektivisht me VKB nr.25. , datë 26/03/2021. me VKB nr.85 , datë 28/12/2021.

Miratimi i taveve të buxhetit afatmesëm 2022-2024 Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 25, datë 26.03.2021 konfirmuar me shkresën nr. 484/1 datë 7.04.2021, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 85, datë 28.12.2021, “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Çërrik për vitet 2022-2024”, jo më vonë se 31 Janar, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Për vitin 2022, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr.85 .datë .28/12/2021, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Elbasan me shkresën nr.1461/1,date 10/01/2022.

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2022 kanë vlerën 409,440,700 lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 148,346,356 lekë, transfertat specifike ka vlerën 106,085,427 lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën 409,440,700lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 409,440,700lekë.

Gjatë vitit 2022, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2021). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB nr.11, datë 24/02/2022 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Çërrik për miratimin e buxhetit shtese për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2021, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 55,708,069 lekë.

Në total buxheti i cili me pas është dërguar për çelje, pranë

Buxheti i miratuar për vitin 2022 është 465,148,769 lekë me burime financimi si me poshte:

1- Të ardhurat e veta 210,716,986 lekë (45.3%) të totalit të burimeve

2- Transfertë e pakushtëzuar 148,346,356 lekë (31.9%) të totalit

3- Transfertë specifike 106,085,427 lekë (22.8%) të totalit

Të marra së bashku transfertat nga qeveria qendrore janë 254,431,783 lekë dhe zënë 54.7% të totalit të burimeve financiare.

Buxheti i miratuar është dërguar në Degën e Thesarit brenda afatit ligjor .

Më të detajuar burimet dhe shpenzimet e planifikuara paraqiten në tabelën si vijon:

në lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2022 ne leke	
		Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara viti 2021/2022	31,643,105	
2	Plani i të ardhurave viti 2021	145,720,000	
3	Trashëguar nga transfertat viti 2021	33,353,881	
4	Transfertë e pakushtëzuar viti 2022	148,346,356	
5	Transfertë e specifike viti 2022	106,085,427	
1	Paga (600)		161,079,126
2	Sigurime shoqërore (601)		27,563,562
3	Shpenzime operative (602)		116,437,984
4	Transfertat (603+604+605+606+609)		13,616,347
5	Investime (230 +231) nga buxheti i Bashkisë		146,451,755
	Totali i buxhetit	465,148,769	465,148,774

Burimi: Drejtoria e financës

Po të krahasojmë buxhetin 2022 me atë të 2021, do shikojmë se rritja prej 33,829,663 lekë është planifikuar të përdoret për shpenzimet operative dhe transfertat. Në këtë zë shpenzimet janë rritur për shkak të shpenzimeve të shtuara për mbetjet urbane.

në lekë

Nr.	Emertimi	Buxheti 2021	Buxhei 2022	Diferenca +
1	Shpenzime personeli (600,601)	183,982,954	188,642,688	4,659,734
2	Shpenzime korrente (602,604,609)	110,260,087	130,054,331	19,794,244
3	Shpenzime investimi (230/231)	137,076,066	146,451,755	9,375,689
	Totalgjithsej :	431,319,107	465,148,770	33,829,663

Burimi: Drejtoria e financës

Në formë tabelle paraqitet planifikimi bazë i buxhetit për vitin 2022 dhe ndryshimet në tabelën vijuese:

në lekë

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2021	Faza e I PBA 2022	Faza e II PBA 2022	Projekt Buxhet 2022
600	Paga	155,444,871	161,079,000	161,079,126	161,079,126
601	Sigurime Shoqërore	25,304,386	27,339,000	27,563,562	27,563,562
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	91,196,814	94,442,560	107,767,655	107,767,655
604	Transferta Korente	100,000	1,000,000	1,000,000	1,000,000
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	4,301,060	13,000,000	7,050,000	7,050,000
609			3,500,000	3,500,000	3,500,000
I	Shpenzime Korrente	276,347,131	300,360,560	307,960,343	307,960,343
230	Kapitale të Trupëzuara	61,135,206	94,991,995	94,991,995	94,991,995
231	Kapitale të pa Trupëzuara	3,297,197	6,488,362	6,488,362	6,488,362
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	64,432,403	101,480,357	101,480,357	101,480,357
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	-	-
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	-	-	-	-
II	Shpenzime Kapitale	64,432,403	101,480,357	101,480,357	101,480,357
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti	11,739,185			
	I+II +III Totali I Shpenzimeve	352,518,719	401,840,917	409,440,700	409,440,700

Burimi: Drejtoria e financës

Gjate vitit 2022 është bërë Analiza dhe monitorimi i buxhetit çdo 4-mujore, Raportet e monitorimit janë diskutuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak dhe janë dërguar në ministrin e financave brenda afateve ligjore. Ky raportim monitorimi për vitin 2022 është bërë 3 (tre) herë është miratuar në Këshillin Bashkiak dhe është dërguar në Ministrin e Financave. Konkretisht për vitin 2022 është hartuar raporti i monitorimit dhe i performances për vitin 2021 dhe është dërguar në ministrin e Financave me shkresë nr.1113, date 30/03/2022. Është hartuar raporti i monitorimit për 4-mujorin e parë 2022 dhe me shkresë nr.1669, datë 18,05,2022 është dërguar Ministrisë së Financave. Është hartuar raporti i monitorimit të 8-mujorit 2022 dhe me shkresë nr. 2712, datë 21,09,2022 është dërguar Ministrisë së Financave. Nga analizat e bëra është dale në konkluzione dhe është bërë rishikimi i buxhetit me vendime të Këshillit Bashkiak në muajin Shtator 2022 (5 vendime)

Lista e investimeve të reja parashikuar në buxhetin vjetor të vitit 2022 nga të ardhurat e veta dhe granti.

në lekë

Nr	Emërtimi i investimit	Nr dhe data e VKB	Burimi financimit	Vlera e miratuar në VKB	Vlera e realizuar e investimit (me TVSh)
1	Rikonstruksion i Shkolles Selit	VKB nr.85, datë 28/12/2021	Të ardhurat e veta	10652000	4726000
2	Rikualifikim urban rruge te brendeshme	VKB nr.85, datë 28/12/2021	Të ardhurat e veta	9200000	4599558
3	Sistemim Asfaltim Rruges Lushallijve	VKB nr.85, datë 28/12/2021	Të ardhurat e veta	7034194	7034194
4	Blerje Mjeti per Bashkin Cërrrik		Të ardhurat e veta	946900	946900
5	Blerje Paisje Elektronike	VKB nr.85, datë 28/12/2021	Të ardhurat e veta	1500000	1068000
6	Blerje paisje te tjera	VKB nr.85, datë 28/12/2021	Të ardhurat e veta	700000	120720
7	Projekte per realizimin e veprave Inxhinjerike	VKB nr.85, datë 28/12/2021	Të ardhurat e veta	927506	894000
8	Riparim Banesa familje ne nevoj	VKB nr.85, datë 28/12/2021	Të ardhurat e veta	1126800	1126800
9	Ndertim ura kanalesh	VKB nr.11, dt.24/02/2022	Të ardhurat e veta	3672854	3672854
	Total të ardhurat e veta		Të ardhurat e veta	35760254	24189026
			Granti (FZHR...specifiko)		
1	Permirsim Kushte Banimi		Finistria e Financave	13464143	13464143
2	Ujesjelles Mollas		Ministria e infrastruktures	69600751	69600751
	Total nga granti			83064894	83064894

Burimi: Drejtoria e financës

Në aneksin nr. 1 bashkëlidhur raportit të auditimit janë pasqyruar përmbledhësja për planifikimin e buxhetit për vitin 2022 sipas VKB përkatëse.

2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

-Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e më poshtme:

Nr.	Emërtimi	Plan përfundim 2022	Sipas PBA 2022-2024	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakush e spec)	188,642,688	188,642,688	-
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	130,054,327	119,317,655	10,736,672
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	146,451,755	101,480,357	44,971,398
4	Investime nga FZSH			-
	Total I planit fillestar	465,148,770	409,440,700	55,708,070
	Shtesat nga Pushteti Qendror	424,890,203	467,516,000	(42,625,797)
5	Shpenzime për pagat (600+601)	3,515,000	3,700,000	(185,000)
6	Shpenzime (602.604.609)	338,310,309	324,630,000	13,680,309
7	Grant i kushtëzuar (230-231)	83,064,894	139,186,000	(56,121,106)
	Gjithsej	890,038,973	876,956,700	13,082,273

Burimi: Nga përpunimi i të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti.

Nga auditimi konstatohet se ndryshimet midis planit buxhetor vjetor 2022 dhe planit vjetor 2022 në PBA vijnë si rezultat i shtimit të fondeve të trashëguara nga viti 2021. Shtesa e fondeve është përdorur për Investime në proces dhe likuidimin e detyrimeve të prapambetura për mallra e shërbime paraqitet në aneksin nr. 2 pika 2.2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë viteve janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/ pakësime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018”Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” pika 100 germa “b” dhe “c” ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë

periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Gjithashtu janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla. Ndryshimet buxhetore janë paraqitur në aneksin nr. 3 pika 2.2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik.

Konstatohet se plani i buxhetit i gjeneruar nga thesari ka vlerën **873,450 mijë lekë** i barabartë me vlerën e planit të buxhetit të miratuar nga këshilli bashkiak që ka vlerën **873,450 mijë lekë**.

Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transferta e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën **448,560 mijë lekë**, ndërsa realizimi **411,298 mijë lekë**, ose në masën 91.69%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën **156,579 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **155,982 mijë lekë**, ose në masën 99.62%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 99.2%.

Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën **113,029 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **110,544 mijë lekë**, ose në masën 97.8%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën **225,658 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **193,024 mijë lekë**, ose në masën 85.54 %.

Titulli gjetjes 3: *Krijimi i diferencave të dukshme me vlerën e planifikuar dhe realizuar, i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 me të ardhurat e veta (pa transfertën e palushtëzuar).*

Situata: Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën **130,495 mijë lekë**, ndërsa realizimi **125,230 mijë lekë**, ose në masën 95.96%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën **225,658 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **193,024 mijë lekë**, ose në masën 85.54 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Cërrik në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe ngarkojnë me përgjegjësi kryetaren e Bashkisë Cërrik Z.A.S, si dhe Z.H.K, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.

Gjithashtu rezulton se gjatë vitit 2022 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2022. Veprimet e mësipërme janë në përputhje me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.

Kriteri: Pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”

Shkaku: Lidhja e kontratave në fund të vitit, si dhe për vlerën e plotë të projektit dhe jo për nivelin e fondeve të buxhetuara për vitin përkatës.

Efekti: Mos realizim i investimeve të planifikuara.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

3. Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë

Konstatohet se për vitin 2022 vlerat e llogaritura për këtë qëllim janë Kontigjencë 2,000,000 lekë, Rezerve 3,500,000 lekë dhe Emergjencë 4,000,000 lekë, mënyrën e llogaritjes të kësaj vlere, bazën ligjore për këtë; Fondi i emergjencës është llogaritur në vlerën 1.7% të buxhetit të vitit 2022 (Në mbështetje të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”)

Vlera e përdorur në fakte nga Bashkia Çërrik, Fondit Emergjencave dhe ai i kontigjencës janë përdorur gjatë vitit 2022, ndërsa fondi Rezerve është përdorur 80% .

4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizimit të të ardhurave (faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE) Në mënyrë të përmbledhur paraqitet fondet e trashëguara për vitin 2022.

Fondet e trashëguara në 31.12.2021 për përdorim në vitin 2022 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)	Fondet e trashëguara në 31.12.2022 për përdorim në vitin 2023 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)
64,996,986	40,753,067

Detyrimet e prapambetura viti 2022

Në lekë

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emerimi i detyrimit te prapambetur	Deyrimi i prapambetur progresiv deri në datën e miratimit të buxhetit vjetor 2022	Planifikimi për likujdim në planin e buxhetit 2022 i vlerës së detyrimit të prapambetur	Pagesa në fakt gjatë vitit 2022 e detyrimit të prapambetur të planifikuar në planin e buxhetit	VKB nr.85.dat ë,28/12/2021
4864100	Detyrime të .p. per vend.gjyqesore	426,000	426,000	4,260,000	
4864200	D.P.per sherbime	5,521,053	5,000,000	5,167,653	
4864300	D.P.per mirembajtje	806,696	400,000	388,760	
4864400	D.P.per investime	135553984	65000000	73962603	

4864400	D.P.per investime nga Ministrite e Linjes (specifiko FZHR etj...)	36236536	0	0	
4865600	D.P per mallra	2789394	246877	971394	
4864900	D.P.te tjera	0		0	
	Totali	181333663	71072877	84750410	

Burimi: Bashkia Cërrrik

Vlera e raportuar nga Bashkia Cërrrik në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2022 është **121,557,012 lekë**, konfirmuar me shkresën nr. 309 datë 26.01.2023 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore. Stoku i detyrimit të mbetur rakordoon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	121,557,012		24.56%
a	Shpenzime korrente	5,439,436		
a,1	Mallra dhe shërbime	5,439,436		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale	116,117,576		
b,1	Insitucione buxhetore			
b,2	Subjekte private	116,117,576		
c	Vendime gjyqësore	0		
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	121,557,012	494,848,086	24.56%

Burimi: Bashkia Cërrrik

Titulli i gjetjes 4: *Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura dhe raportimi i tij në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë si dhe marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur faonde në dispozicion.*

Situata: Bashkia Cërrrik në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 181,333,663 mijë lekë (nga kjo 36,236,536 leke, detyrime të FSHZH), Detyrimi i Bashkisë është 145,097,127 leke e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti vlera 71,072,877 mijë lekë, nga e cila është likuiduar vlera 84,750,410 mijë lekë, ose 119.24% e vlerës së planifikuar. Po për efekte të shtimit të detyrimeve gjate vitit 2022 , kjo ulje e detyrimeve nga pagesat nuk reflektohet në gjendjen e detyrimeve në datën 31.12.2022. Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022), është ulur (145,097,127-121,557,012), me 23,540,115 lekë, ose në masën prej 16.23%. Në mënyrë të detajuar lista analitike e detyrimeve të prapambetura paraqitet në

aneksin nr. 5 pika 2.4 bashkëlidhur raportit të auditimit. Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2022, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Çërrik Z.A.S, si dhe Z.H.K, me detyrë Drejtor Financës.

Kriteri: Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Efkti: Mospasqyrimi real i stokut të detyrimeve të prapambetura.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Çërrik dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

Titulli i gjetjes 5: Efektet negative në buxhet si rezultat i likuidimit të vendimeve gjyqësore.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Çërrik për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën **426,000 lekë** për 1 rast, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, efciencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Në funde të vitit 2022 ka një vendim për dëmshpërblim page në vlerën 2,232,378 leke, i cili është planifikuar në buxhetin e vitit 2023.

Gjithashtu konstatohet se në 1 rastë në vlerën **426,000 lekë** për likuidimet e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullari i institucionit, por nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Kriteri: Nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës.

Efekti: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Cërrrik.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrrik të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR)

Njësitë vendore përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit nëpërmjet Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR). Ky fond përfitohet për financimin e projekteve për të cilat aplikojnë njësitë e qeverisjes vendore në fushat e infrastrukturës rrugore, arsimit, shëndetësisë etj.

Fondi total i pa alokuar, deri më 31.12.2022 për investimet, kap vlerën 36,236,536 lekë dhe i përket periudhës së investimeve të kontraktuara në vitin 2013.

Të detajuara, investimet e financuara nga FZHR nga viti 2015, të cilat nuk janë likuiduar deri më datën 31.12.2022 jepen në tabelat në vijim:

Investimet e financuara nga FZHR

Nr.	Data/ Afati Kontratës	Emri i kontratës	Shuma e kontratës bazë	Situacion përfundimtar	Likuidim total		Total vlera e pa likuiduar	
					FZHR	Bashki	FZHR	Bashki
1	05/07/2013-5/12/2014	Pyllëzim me fidana shege ne ekonomine Pyjore Mollas	48,934,419	48,934,419	12,697,883	0	36,236,536	0
		Shuma investime	48,934,419	48,934,419	12,697,883	0	36,236,536	0

Vlera 36,236,536 lekë është detyrim nga FZHR, vlerë e përfshirë në Pasqyrat Financiare, megjithatë vazhdon që nga viti 2014 të mos likuidohet.

Në dosje gjenden:

- urdhër prokurimi nr. 3, datë 16.05.2013, miratim procedure dhe shpallje fituesi në datën 04.07.2013, kontrata e lidhur në datën 05.07.2013, akt- kolaudimi për punimet e kryera, situacioni përfundimtar. Nga subjekti janë paraqitur si më poshtë:

- fatura tatimore nr. 21, datë 11.02.2014, Pyllëzim me fidan shege në ekonominë pyjore Mollas, me vlerë 22,239,427 lekë (me TVSh) e firmosur nga subjekti “E.” Shpk dhe Komuna Mollas

- fatura tatimore nr. 35, datë 30.12.2014, Pyllëzim me fidan shege në ekonominë pyjore Mollas, me vlerë 13,997,109 lekë (me TVSh) e firmosur nga subjekti “E.” Shpk dhe Komuna Mollas.

6. *Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.*

➤ **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

Për vitin 2022 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 85, datë 28.12.2021, i ndryshuar “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Cërrrik dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2022”, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë

së Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas strukturës është e përbërë nga sektorë dhe në total ka 21 punonjës konkretisht: 1 drejtor, 2 përgjegjës sektori 12 specialistë të vlerësimit të taksave dhe tarifave të biznesit dhe familjar, 5 Agjent Terreni për pronat me qera, tregjeve, transportit e të tjera tatime si dhe 1 kujdestar tregu Cërrik. Struktura e Drejtorisë të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022 është paraqitur në aneksin nr. 1 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit

Titulli gjetjes 6: *Mangësitë e konstatuara në plotësimin e strukturës për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.*

Situata: Konstatohet se: struktura e DAV Bashkia Cërrik ka probleme dhe nuk është në funksion të realizimit e të ardhurave, pasi evidentohet mos krijimi i Sektorit të Masave Shtrënguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në DAV Bashkia Cërrik, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të paarkëtuara (debitor), për 3,583 subjekte familjar dhe biznesi në vlerën **39,724 mijë lekë**, nga e cila: subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore në vlerë 7,936 mijë lekë për 142 subjekte dhe abonentë familjarë në vlerë 31,798 mijë lekë për 3,441 abonent. Alternim i këtij sektori në përbërje të Sektorit të Kontrollit Terren është i papërshtatshëm, kjo nisur nga fakti se kanë natyra të ndryshme pune dhe se arkëtimi i debitorëve është procedurë më vetë dhe afate të përcaktuara.

- Gjithashtu konstatohet se për periudhën objekt auditimi 2022 Drejtoria e të Ardhurave Vendore ka funksionuar pa Drejtor çka sjell mos arkëtimin e të ardhurave, kjo për mungesë stafi, në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me shkresën nr. 168/1 prot datë 29.04.2022. Veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi nëpunsin Autorizues si dhe Drejtoresha e Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore e Informimin me Publikun.

Kriteri: Në përputhje me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime.

Ndikimi: Mungesa e stafit dhe mos përshtatja e strukturës më natyrën e menaxhimit të të ardhurave, çojnë në mos realizim të të ardhurave dhe mungesë të tyre në buxheti e Bashkisë Cërrik.

Shkaku: Mos njohja e kuadrit ligjorë për ,menaxhimit e të ardhurave nga instancat drejtues Bashkia Cërrik.

Rëndësia: i lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Cërrik me specialist të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

➤ **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

Titulli i gjetjes 7: *Performancë e dobët në planifikimin dhe realizimin e disa zërave të të ardhurave për periudhën objekt auditimi.*

Situata: Për vitin 2022: Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 83 datë 28.12.2021, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan. Nga të dhënat e **pasqyrës aneks nr. 2** më poshtë, shihet se për vitin 2022 planifikimi i të ardhurave është në vlerën. **142,720 mijë lekë** dhe realizuar në fakt në vlerën **102,440 mijë lekë** e detajuar sipas pasqyrës aneks nr. 2 pika 2.6 bashkëlidhur raportit.

Tejkalimet dhe mosrealizimet janë argumentuar si më poshtë:

Të ardhurat tatimore dhe argumentet e dhëna nga sektori i taksave dhe tatimeve për tejkalimet dhe mosrealizimet, paraqiten si më poshtë:

- Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin, është në masën 34%, pasi kjo është e ardhur që vjen nga DRT Elbasan, ndërsa planifikimi është bërë duke u nisur nga realizimi i një viti më parë.
- Taksa mbi pasurinë e paluajtshme (ndërtese, tokë, truall), është në masën 49%. Ky mosrealizim ka ardhur si rezultat i pagesës së ulet të taksapaguesve familjarë, pasi nuk ka pasur një regjistër të taksapaguesve apo adresa për t'i njoftuar, si dhe mungesë e dokumentacionit të pronësisë mbi ndërtesën dhe truallin.
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, është në masën 49%, pasi planifikimi është bërë duke u nisur nga të ardhurat e realizuara të një viti më parë, të cilat kanë qënë të konsiderueshme, por edhe nga mungesa e legalizimeve nga ana e ASHK-së.
- Taksa e mjeteve të përdorura është në masën 104%, ku ka ndikuar edhe kërkesa e Bashkisë për rakordime mujore me DRSHTRR Elbasan.
- Të ardhura nga taksa e rentës minerare, është në masën 133%, për arsye të dërgimit nga qeverisja qendrore në muajin dhjetor 2022.
- Taksa e tabelës dhe reklamës, është në masën 28%, për shkak të çmimit shumë të lartë për m²
- Të ardhurat Jotatimore, paraqiten si më poshtë:
- Të ardhurat nga tarifat vendore, është në masën 89%, për shkak të mos likuidimit nga ana e familjarëve.
- Të ardhurat nga tarifat e ndriçim, janë në masën 64% kryesisht për shkak të mos likuidimit nga ana e familjarëve.
- Të ardhurat nga tarifat e gjelbërimit, janë në masën 82% kryesisht për shkak të mos likuidimit nga ana e familjarëve.
- Të ardhurat nga tarifa dhe menaxhimi i mbetjeve janë në masën 98%.
- Tarifa për shërbimet Administrative të bashkisë është në masën 74% ku mos realizim vjenë si rezultat i mos basjes së një baze të saktë të planifikimit.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Cërrik, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale, për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj, në dëm të interesave të publikut.

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64, "Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë"; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar, neni 5, "Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore", neni 42, "Administrimi i mjeteve monetare", pika 1, 2 dhe 4; neni 54, "Raportimi financiar" nënpika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave" pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Z.K.B me detyrë Përgjegjës Sektori në DTTV.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64, "Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë"; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "Për Financat e

Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 42, “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, “Raportimi financiar” nënpika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ndikimi: Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave shkakton mangësi dhe probleme në likuidimin e shpenzimeve të kryera nga institucioni, si dhe është shkak kryesor për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Shkaku: Mos njohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Cërrik, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

➤ Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:

Titulli gjetjes 8: Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin mbi aktivitetin e Agjentëve Tatimorë.

Situata: Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimit nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta. Të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore, në lidhje me TFFH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Cërrik, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të bashkisë Cërrik dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Elbasan. Për detyrimet e familjarëve, u konstatua se shoqëria Ujësjetës-Kanalizime Cërrik Sh.A., nuk është caktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.

- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.

- Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare”

Konstatohet se sipas DTV Bashkia Cërrik, mos arkëtimet nga ana e Drejtoria Rajonale Vendore ASHK Elbasan, janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Cërrik është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të

mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektësh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër, Bashkia Cërrik duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare”

Ndikimi: Mos njohja e situatës, çon në mungesë të ardhura për Bashkinë Cërrik.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit dhe mos zbatimit të kuadrit ligjorë.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Cërrik, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga Agjentët Tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj si dhe të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mbledhen nga Agjentët Tatimore, të kryqëzojë informacionet me institucionin e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

- Bashkia Cërrik, të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Cërrik Sh.a, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

Titulli gjetjes 9: *KLSH-ja konstatoj se nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Cërrik, nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara (borxhi), dhe për të gjithë subjektet.*

Situata: Sipas të dhënave për strukturën organike të Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Cërrik, konstatohet se nuk ka një të ngritur një strukturë përgjegjëse për menaxhimin e borxhit (debitorëve nga taksat/ tarifatat vendore).

Referuar të dhënave të paraqitura nga kjo drejtori, detyrimet për taksat e tarifatat vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjare paraqitet si vijon:

➤ **Detyrimet e familjarëve:**

- *Mënyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve*

Tarifa e pastrimit parashikohet në bazë të numrit të familjeve rezidente aktive të bashkisë.

Taksa e ndërtesës parashikohet në bazë të regjistrimit të taksës që kanë njësitë, të përditësuar me numër njësi pronësie të reja, saktësim dhe shtim sipërfaqesh.

Nga auditimi u konstatua se bashkia Cërrik nuk ka përcaktuar mënyra efektive për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. Edhe pse është aksionare e vetme e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Cërrik ShA dhe bazuar në pikën (ii), neni 5 të ligjit 9642 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ka të drejtën dhe detyrimin e përcaktimit të mënyrës së mbledhjes së taksës dhe zgjedhjen e agjentit fiskal, nuk ka realizuar përfshirjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore familjare në faturën mujore të ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat vendore.

- *Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese*

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifatat vendore.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë për abonentët familjar në vlerën **31,798,332 lekë**. Vlerë e cila përbën Detyrim të pa arkëtuar për buxhetin e bashkisë Cërrik, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjar deri në datën 31.12.2022. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar. Në mënyrë të përmbledhur debitorët familjar paraqiten në aneksin 3 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

➤ **Taksa e tokës:**

Për vitin 2022 taksa mbi tokën bujqësore është realizuar në nivelin 75% (planifikuar 14,000 mijë lekë dhe realizuar 10,465 mijë lekë). Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore rezulton se Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 , pika 1 “Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetë deklaratim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka”, aneksi 2 dhe të VKB-ve për vitin 2022⁴ dhe është e ndarë në 10 kategori që kanë nivele të ndryshme takse për ha/vit.

Sipas Aneksit 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, Bashkia Cërrik klasifikohet në nivelin e dytë ku çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore është si në tabelën më poshtë:

Vlera e taksës së tokës së tokës bujqësore në lekë/hektar/vit

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-ve (lekë/ha/vit)
I	4,200
II	3,500
III	2,800
IV	2,300
V	1,900
VI	1,600
VII-X	1,400

Sipas përcaktimeve të VKB-së nr. 83, datë 28.12.2021 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore administrimi i tyre në Bashkinë Cërrik për vitin 2022”, struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së tokës bujqësore është Drejtoria e Bujqësisë, për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme ia përcjell këtë informacion Drejtorisë së tatimeve e të ardhurave për llogaritjen e detyrimit sipas njësive administrative dhe sipërfaqen e tokës së marrë me AMTP të cilat paraqiten në tabelë dhe të dhëna nga DTTV mbi sipërfaqen e tokës bujqësore që tatohet nga kjo drejtori të paraqitura në tabelën si vijon:

Sipërfaqja e tokës me AMTP nga familjet në Bashkinë Cërrik sipas të dhënave të DTTV

⁴ VKB nr. 83, datë 28.12.2021 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore administrimi i tyre në Bashkinë Cërrik për vitin 2022”.

Nr.	Njësia Administrative	Nr. i familjeve gjithsej që kanë tokë me AMTP	Tokë e marrë me AMTP (ha)
1	NjA Cërrik	1,320	941
2	NjA Shalës	832	2,430
3	NjA Mollas	1,051	1,928
4	NjA Gostimë	2,273	2,628
5	NjA Klos	653	864
Shuma		6,129	8,792

Burimi: Bashkia Cërrik

Sipërfaqja e tokës që tatóhet nga Drejtoria e Tatim Taksave

Kategoritë	Nr. Familjeve	Sipërfaqja (ha)	Çmimi sipas paketës fiskale lekë/ha	Detyrim vjetor/lekë
II	2,682	1,081	3,500	3,783,500
III	3,384	2,361	2,800	6,610,800
IV	2,692	907	2,300	2,086,100
V	3,447	682	1,900	1,295,800
VI	1,236	667	1,600	1,067,200
VII	2,439	1,051	1,400	1,471,400
TOTALI	15,880	6,749		16,314,800

Burimi: Bashkia Cërrik, Drejtoria e Tatim Taksave

Numri i familjeve që tatóhen për taksën e tokës bujqësore nuk është 14,000 familje sepse në tabelën më sipër të dhënat janë grupuar sipas kategorisë së tokës dhe një familje zotëron sipërfaqe tokë në terrene të ndryshme kështu që taksohet në kategori të ndryshme.

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelat e mësipërme, rezulton se nga Drejtoria e Bujqësisë disponohen të dhëna për **8,792** ha tokë të dhënë me AMTP, ndërsa planifikimi i bërë nga DTTV është për **6,749** ha në vlerën e pritshme të arkëtimit **16,314,800** lekë. Diferenca është 2,043 ha tokë që nuk është e regjistruar nga DTTV për llogaritjen e taksës së tokës. Grupi i auditimit nuk mund të llogarisë vlerën në lekë për diferencën prej 2,043 ha sepse çmimi për ha ndryshon nga njëra njësi administrative në tjetrën si dhe brenda njësive administrative në varësi të karakteristikave të terrenit fushor apo kodrinor. Kjo llogaritje bëhet vetëm nga DTTV pasi ka identifikuar koordinatat e parcelave për çdo familje. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, aneksi 2. VKB nr. 83, datë 28.12.2021 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore administrimi i tyre në Bashkinë Cërrik për vitin 2022”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi, Z.Ç.SH me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave, dhe Z.K.B me detyrë Përgjegjës Sektori në DTTV.

➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Administrimi i taksave vendore bëhet me program, ku janë të pasqyruara regjistrat, sipas aktiviteteve, njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që kërkohen për auditim, konstatohet që programi është i saktë, pasi në informacionet që kërkohen të dhënat dalin të analizuar për çdo zë tatimor që DAV Bashkia Cërrik aplikon. Pasqyrimi i të dhënave fillon me çelje si debitor. Kamatëvonesat rigjenerohen nga sistemi në fund të çdo periudhe. Referuar të dhënave të marra nga DAV Bashkia Cërrik, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja në fund te vitit
1	Biznesi Vogel	2022	614	25	42	595
2	Biznesi Madh	2022	95	22	8	109
(1+2)	Gjithsej	2022	709	47	50	704

Burimi: Bashkia Cërrik

➤ **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifave vendore.**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën **7,936,647 lekë, vlerë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar për buxhetin e Bashkisë Cërrik.**

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet si vijon:

Njesite	Detyrimi 31.12.2021		Paguat viti 2022		Mbetje deri 2021		Detyrimi viti 2022		Detyrimi deri 31.12.2022	
	Nr.	Detyrimi	Nr.	Detyrimi	Nr.	Detyrimi	Nr.	Detyrimi	Nr.	Detyrimi
Administrative										
Njesia Shales	4	105,070	0	0	4	105,070	11	288,990	11	394,060
Njesia Cërrik	36	1,610,831	17	651,914	19	958,917	65	3,481,060	69	4,439,977
Njesia Mollas	9	193,742	4	80,140	5	113,602	19	993,058	22	1,106,660
Njesia Gostime	24	1,034,850	7	317,460	17	717,390	28	871,945	31	1,589,335
Njesia Klos	5	413,785	1	16,000	4	397,785	7	257,820	9	406,615
TOTALI	78	3,358,278	29	1,065,514	49	2,292,764	130	5,892,873	142	7,936,647

Burimi: Bashkia Cërrik

Sa me sipër ariet në konkluzionin se nga strukturat tatimore të Bashkisë Cërrik, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, **pasi** janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar **kallëzim penal** bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se:

“Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., ku përcaktohet se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.”

Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

➤ **Hartim i akt marrëveshjeve për pagesën e detyrimeve tatimore ndaj bashkisë në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.**

Nga auditimi i dokumentacionit dhe i akt marrëveshjeve për likuidimin e detyrimeve vendore me këste, rezulton se ato janë lidhur totalisht në kundërshtim me përcaktimet ligjore për lidhjen e marrëveshjeve për pagesat me këste, përkatësisht:

- Në asnjë rast nuk kemi kërkesë me shkrim nga ana e tatimpaguesit për të hyrë më marrëveshje për pagesë me këste referuar ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, pika 2 “Tatimpaguesi paraqet një kërkesë me shkrim, për të hyrë në një marrëveshje pagese me këste. Kërkesa duhet t’i drejtohet drejtorit të

drejtorisë rajonale apo drejtuesit të njësisë të ngjashme me të dhe duhet të parashtrijë arsyet, që e pengojnë tatimpaguesin për të paguar detyrimet tatimore”;

- Akt marrëveshjet nuk kanë formën dhe përmbajtjen e një dokumenti zyrtar dhe nuk janë të firmosura nga ana e drejtuesit të DTTV, referuar ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, pika 3 “Marrëveshja e pagesës me këste bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga drejtori i drejtorisë rajonale apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të dhe tatimpaguesi”;

- Nuk rezulton që nga DTTV të jetë kërkuar garanci bankare përpara se të pranohet një marrëveshja për pagesat me këste, referuar ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, pika 5 “Administrata tatimore mund ta refuzojë kërkesën për një marrëveshje pagese me këste ose të kërkojë garanci bankare, para se të hyjë në një marrëveshje të tillë”, ligji nr. 112/2016, neni 30 “.....në të njëjtën kohë tatimpaguesi duhet të vërtetojë që është në kushtet e pamundësisë financiare për të paguar të plotë detyrimin tatimor, si dhe të tregojë që pavarësisht nga rrethana financiare, ai është në gjendje të përmbushë marrëveshjen”;

- Nuk janë përcaktuar afatet e likuidimit të detyrimeve sipas kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, pika 4, Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, pika 77.4 “Marrëveshja e pagesës me këste nuk mund të zgjasë më tepër se fundi i vitit kalendarik pasardhës pas momentit të hartimit të marrëveshjes”.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi, Z.K.B me detyrë Përgjegjës Sektori në DTTV.

Kriteri: Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve⁵.

Ndikimi: Mos ndjekja e plotë e procedura për arkëtimin e detyrimeve, rrit nivelin e detyrimeve të paarkëtuara në fund të periudhave ushtrimore, si një e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë, ku në fund të vitit 2022 ka një vlerë afërsisht sa plani vjetore i të ardhurave të Bashkisë Çërrik.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi, si dhe mungesa e një strukturë organizative të përshtatshme.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi: Bashkia Çërrik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pavjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të pa arkëtuara (debitor), në vlerën **39,724 mijë lekë**, nga e cila: subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore në vlerë 7,936 mijë lekë për 142 subjekte dhe abonentë familjarë në vlerë 31,798 mijë lekë për 3,441 abonent.

Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” i ndryshuar.

⁵ Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithëse mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Cërrik, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, “Mospagimi i taksave dhe tatimeve

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitoare nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Cërrik në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Cërrik janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Cërrik.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.12.2022, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **15,537,274 lekë** për 360 persona e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar për buxhetin e Bashkisë Cërrik (sipas listës të administruar në CD).

Natyra e debitorëve	Detyrime gjithsej 2017-2021		Detyrime gjithsej 2022		Debitorë me 31.12.2022	
	Pers on	Lekë	Per son	Lekë	Person	Lekë
Taksa infrastrukture (legalizim)	263	9,964,539	97	5,572,735	360	15,537,274

Burimi: Bashkia Cërrik

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Cërrik nuk ka të evidentuar subjektet të cilat janë pajisur me leje legalizimi nga aluizni përpara vitit 2017 si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Cërrik jetë drejtuar ASHK Dega Elbasan, për vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,,,”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 2/1 dhe ngarkohen me përgjegjësi Drejtorinë e PZHT dhe DAV Bashkia Cërrik.

Kriteri: Ligji nr. 9482 datë 03.04.2006, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; VKB Cërrik “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Cërrik”,

Ndikimi: Mos arkëtimi i detyrimeve taksës së ndikimit në infrastrukturës nga ndërtimet pa leje, ka çuar në mungesë të ardhurash në vlerën **15,537,274 lekë**, për buxhetin e Bashkisë

Shkaku: Mos kryerja e akt-rakordimeve nga Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore dhe ASHK-në Cërrik

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje për vitin 2022 në vlerën

5,572,735 lekë ndaj **97** personave dhe përpara vitit 2021 në vlerën **9,964,539 lekë** për 263 persona si dhe t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Elbasan, vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

- Drejtoria e të Ardhurave të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse në shumën **15,537,274 lekë**, nga të gjithë individët e listuar si debitorë bazuar në legjislacionin tatimor.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Titulli gjetjes 10: *Lejimi i subjekteve që tregtojnë hidrokarbure me Licencë të bashkisë dhe papaguar tarifën në zbatim të VKM nr. 344, datë 19.04.2017.*

Situata: Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e licencave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Cërrik dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrojnë aktivitetin 15 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, sipas aneksit 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 2 subjekte janë pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 dhe kanë paguar detyrimet në vlerë 2,000,000 lekë si dhe janë pajisur me autorizim 1 dhe 2 vjeçar 13 subjekte të cilët kanë paguar detyrimet në vlerë 6,040,000 lekë. Sa më sipër rezultojnë së Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore ka vepruar në kundërshtim me Kreun II pika 11 e VKB nr. 83 datë 28.12.2021 “Mbi miratimin e paketës fiskale për vitin 2022” si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15

Në lidhje me auditimin e pagesave të kryera sipas autorizimeve të lëshuar nga Bashkia Cërrik dhe sipas lishencës të mara nga subjektet për ushtrimin e aktivitetit..

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se subjektet e pajisura me autorizim 1 vjeçar ka bërë likuidimin e detyrimeve sipas autorizimit. Referuar licensave përkatëse subjektet janë debitorë në vlerën **5,460,000 lekë** vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë Cërrik. *Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me Kreun II pika 11 e VKB nr. 83 datë 28.12.2021 “Mbi miratimin e paketës fiskale për vitin 2022” si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15*

Kriteri: Në kundërshtim me nenin 35 të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4. e VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar si dhe kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15 të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar.

Ndikimi: Mos ndjekja e procedurës për dhënien e Licensës së tregtimit të karburanteve, çon në mungesë të ardhura për Bashkinë Cërrik me vlerë **5,460,000 lekë**.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit dhe mos ndjekja e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për mos lejimin e ushtrimit të aktivitet pa dokumentacion të rregullt.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së pataksuar prej **5,460,000 lekë** sipas pasqyrës Aneks nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

➤ Mbi pagesën e detyrimeve vendore nga subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Cërrik.

Titulli i gjetjes 11: Mos pagesa e detyrimeve vendore nga subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Cërrik.

Situata: Lidhur me subjektet që janë shpallur fitues nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duke fituar të drejtën të kryejnë punime në territorin e Bashkisë Cërrik grupi i auditimit, auditori dokumentacionin mbi pagesën e detyrimeve të këtyre subjekteve për taksat dhe tarifave vendore për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Për periudhën nën auditim janë identifikuar 4 operatorë ekonomikë që kanë fituar të drejtën për të kryer punime të ndryshme në territorin e Bashkisë Cërrik, dhe nuk kanë paguar detyrimet vendore sikurse paraqitet në tabelën në vijim.

Subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Cërrik 2022 dhe rezultojnë debitorë për taksat dhe tarifave vendore.

Nr.	Subjekti	NIPT	Vl.kont. (pa tvsh)	Afati i i kontratës	Lloji i taksave dhe tarifave vendore					Paguar	Debitor
					Tarifë Pastr.	Tarifë Ndrifç.	Tarifë Gjelb.	Gjob KV	Arsim		
1	I. & S.-A.2016	J....R & L...V	9228338	6 muaj	10,000	620	620	0	2,000		13,240
2	G.T dhe V. K	L....I & K....L	22361041	60 ditë	13,330	830	830	0	2,000	16,990	0
3	E.	K....P	5250841	35 ditë	7,780	500	500	0	1,000	9,780	0
4	Z.	J.....K	49052481.5	120 ditë	26,670	1680	1,680	0	2,000		32,030
	Totali				57,780	3,630	3,630	0	7000	26,770	45,270

Burimi i të dhënave: Bashkia Cërrik, përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi rezultoi se, janë 2 operatorë ekonomik që nuk kanë paguar detyrimet vendore që lindin ndaj Bashkisë Cërrik për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki, duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë në vlerën 45,270 lekë.**

Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore nuk ka dërguar informacion periodik në DTTV lidhur me operatorët e shpallur fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bënte ngarkesën përkatëse të tyre për periudhën e kontratës.

Mos pagesa e detyrimeve vendore nga operatorët ekonomik të listuar në tabelën e mësipërme është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 12, pika 6 “Taksapaguesi regjistron çdo vendndodhje të biznesit pranë bashkisë ose komunës përkatëse. Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhje”, VKB nr. 338/1, datë 20.12.2019 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrik, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative, për vitin 2020”. VKB nr. 118, datë 24.12.2020 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore administrimi i tyre në Bashkinë Cërrik për vitin 2022”.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi, Znj. M.XH me detyrë Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe Z.K.B me detyrë Përgjegjës Sektori në DTTV.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 12, pika 6. VKB nr. 118, datë 24.12.2020 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe administrimin e tyre për vitin 2022”.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Cërrik në vlerën **45,270 lekë**.

Shkaku: Mos ndjekja e hapave ligjore për subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Cërrik.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Drejtorinë e Tatim Taksave Vendore lidhur me operatorët ekonomikë që shpallen fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bëjë llogaritjen e detyrimeve që lindin për periudhën e ushtrimit të aktivitetit. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore të marrë të gjitha masat për pagesën e rregullt të taksave dhe tarifave nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Cërrik.

Auditim mbi shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për dhënien me qira të aseteve të Bashkisë apo Njësisë Administrative. Lidhja e kontratave. Arkëtimi i të ardhurave nga qiraja dhe përdorimi i tyre.

Titulli i gjetjes 12: *Të ardhura të munguara nga mos pagesa e qirave të kontratave të aseteve.*

Situata: Në kuadër të auditimit të të ardhurave të Bashkisë Cërrik u auditua realizimi i të ardhurave nga asetet e bashkisë të dhëna me qira. Në këtë aspekt u auditua vetëm zbatimi i kushteve të kontratave lidhur me pagesat në afat të detyrimeve të qirasë vjetore për sipërfaqen e marrë me qira dhe jo kushtet e hartimit të kontratave.

Bashkia Cërrik në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi⁶ për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre gjatë periudhës 2019-2022 janë lidhur 71 kontrata për dhënien me qira të aseteve në Fond Pyjor që ka në pronësi. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 9-10 vjet. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, për aktivitet agropylltari etj.

Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirave rezulton se nga 71 subjekte në vlerën 3,580,038 lekë, kanë paraqitur kërkesë për prishje të kontratës 3 subjekte dhe heqjen nga fondi pyjor 2 subjekte në vlerën 358,505 lekë duke ushtruar aktivitet 66 subjekte në vlerën 2,916,271 lekë të cilët kanë paguar detyrimin sipas kontratës.

Nga 3 subjektet që kanë paraqitur kërkesë për prishje të kontratës rezulton se 2 subjekte nuk kanë paguar detyrimet kontraktuale për vitin 2022 në vlerën 55,050 lekë, **vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Cërrik.**

Kontrata të tjera të lidhura nga Bashkia Cërrik

Titulli i gjetjes 12: *Mbi kontratat e lidhura nga ish komunitat.*

Situata: Nga auditimi i dosjeve dhe dokumentacionit lidhur me asetet e dhëna me qira nga bashkia rezulton se, Bashkia Cërrik (ish komunitat) ka lidhur ndër vite kontrata për toka bujqësore të pa ndara dhe të abandonuara referuar kuadrit ligjor për tokat bujqësore si, ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826 deri 841 të tij, ligjin nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen

⁶ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

e tokës bujqësore” dhe VKM nr. 531, datë 21.08.1998 "Për tokat bujqësore të pandara”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore. Referuar bazës së të dhënave të paraqitur grupit të auditimit u konstatua se në total janë lidhur 597 kontrata nga njësitë administrative Mollas, Shalës dhe Klos (ish komunat). Lidhur me zbatimin e detyrimeve të kontratave për pagesën e qirasë vjetore u konstatua se janë 170 qiramarrës që nuk kanë paguar detyrimet vjetore të qirasë ndër vite që arrijnë në vlerën 15,640,768 lekë.

Nga strukturat e bashkisë lidhur me këto kontrata janë bërë verifikime referuar dhe ankesave të qiramarrësve dhe rezultojnë se këto kontrata janë lidhur edhe për toka që i takojnë fondit pyjor dhe kullor apo për të njëjtën sipërfaqe është lidhur më shumë se një kontratë. Në vijimësi i janë drejtuar bashkisë për prishje të kontratës 35 qiramarrës të cilët nuk kanë paguar detyrimet e qirasë. Bashkia nga ana e saj edhe pse ka marrë këto kërkesa si dhe ka konstatuar problematika lidhur me hartimin e një pjese të kontratave ende nuk ka gjetur një zgjidhje të kësaj problematike.

Nga auditimi rezultojnë me probleme në pagesën e qirasë 170 kontrata të tjera të lidhura nga ish komunat në vlerë totale të detyrimit 15,640,768 lekë si rezultat i kërkesave për ndërprerje nga ana e qiramarrëse apo konstatimeve të strukturave të bashkisë që sipërfaqe të dhëna me qira si tokë bujqësore i takojnë fondit pyjor dhe kullor apo për të njëjtën sipërfaqe është lidhur më shumë se një kontratë.

Kriteri: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840.

Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36.

VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar.

VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Cërrik nga mos arkëtimi i detyrimeve nga qiramarrësit.

Shkaku: Strukturat e Bashkisë Cërrik nuk kanë qenë efektive në mbledhjen e detyrimeve të qirave nga subjektet qiramarrëse.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Cërrik të marrë masa që të ngrejë një komision për të verifikuar ligjshmërinë dhe zbatimin e të gjitha kontratave që janë lidhur nga ish komunat (sot njësitë administrative) me qëllim zgjidhjen përfundimtare të problemeve që janë konstatuar në vijimësi nga këto kontrata.

2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike- Asetet.

Titulli gjetjes 13: *Mungesa e regjistrimit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Cërrik*

Bashkisa Cërrik, me VKM nr.573 datë 28.05.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Cërrik, të Qarkut Elbasan”, është miratuar lista e inventarit me në total 1979 prona. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultojnë se me VKM nr. 573 datë 28/05/2009, lista e pronave përfundon me nr. rendor 1979 (Njëmijë e nëntëqind shtatëdhjetë e nëntë) dhe ka 261 (dyqind e gjashtëdhjetë e një) flete.

Ish Komunat sot Njësia Administrative Mollas Bashkia Cërrik me VKM nr. 275 dt. 18.03.2009”

Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Mollas i është miratuar lista me 79 (shtatëdhjetë e nëntë) fletë dhe përfundon me nr. rendor 529(pesëqind e njëzetë e nëntë). Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultojnë se

Komuna Gostim sot Njësia Administrative Gostim Bashkia Cërrik me VKM nr. 298 dt. 12.03.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Gostim i është miratuar lista që përfundon me nr. 1034 (Një mijë e tridhjetë e katër) dhe ka 146 (njëqind e dyzetë e gjashtë) fletë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me vendim Këshilli Bashkiak nr. 298 dt. 21/05/2018 ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Gostim, Bashkia Cërrik konfirmuat nga prefekti i qarkut Elbasan me shkresën nr. 1000/1 port datë 06.06.2018.

Komuna Klos sot Njësia Administrative Klos Bashkia Cërrik me VKM nr. 238 dt. 25.04.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Klos i është miratuar lista që përfundon me nr. 569 (Pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) dhe ka 84 (tetëdhjetë e katër) fletë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me vendim Këshilli Bashkiak nr. 78 dt 26/10/2022 ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Klos, Bashkia Cërrik konfirmuat nga prefekti i qarkut Elbasan me shkresën nr.1260/1 port datë 02.11.2022.

Komuna Shalës sot Njësia Administrative Shales Bashkia Cërrik me VKM nr. 1527 dt. 19.16.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Shales i është miratuar lista që përfundon me nr. 364 (Treqind e gjashtëdhjetë e katër) dhe ka 55(pesëdhjetë e pese) fletë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me vendim Këshilli Bashkiak nr. 371 dt. 21/12/2018 ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Shalës, Bashkia Cërrik konfirmuat nga prefekti i qarkut Elbasan me shkresën nr. 2267/1 port datë 03.01.2019 dhe me shkresën nr. 120 datë 15.01.2019 i është drejtuar Ministrisë së Brendshme për “Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Cërrik. Me vendim Këshilli Bashkiak nr. 21 dt. 22/10/2019 ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Shalës, Bashkia Cërrik konfirmuar nga prefekti i qarkut Elbasan me shkresën nr. 1496/1 port datë 31.10.2019 dhe me shkresën nr. 4013 prot i është drejtuar Ministrisë së Brendshme për “Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Cërrik e përberë nga 110 (Njëqind e dhjetë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 266 (Dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) prona sipas lidhëzës nr. 1.

Përsa i përket pronave të Kaluara me VKM në Njësitë Administrative nuk është bërë pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet; nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) Elbasan; nuk ka rakordim me ZVRPP (ASHK) Elbasan, për asetet pronë e Komunës, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve pronë e Komunës; nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuar dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje; nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të aseteve, si dhe nuk është aplikuar në ZVRPP për regjistrimin e tyre. Mosveprimet e mësipërme janë në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe UMF-së nr. 30, datë **27.12.2011** “**Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik**”, kap. III, pika 30 ku citohet: “*Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.*” dhe pika 35/a ku citohet: “*Dokumentet vërtetues-*

vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet mandate arkëtimet, mandate pagesat, procesverbalet dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.” si dhe neni 37 i ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. H.K me detyrë Drejtor i Financës për periudhën e auditimit. 01.01.2020-31.12.2022

Në mënyrë të përmbledhur pronat e kaluara me VKM dhe të regjistruara në ASHK paraqiten si më poshtë:

Nr.	Bashkia/ Njësitë	Nr. Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2020	Nr. Praktikave të Certifikuara 2021	Prona të pa Regjistruara
1	Bashkia/Cërrik	1979	38	7	1931
2	Njësia Mollas	529	16		513
3	Njësia Gostim	1034	7		1027
4	Njësia Klos	569			569
5	Njësia Shalës	364	4		360
	Shuma	4475	65	7	4403

Burimi: Bashkia Cërrik

Pronat e kaluara me VKM të pyjet dhe kullotat publike sipas listës së inventarit

Në zbatim të VKM Nr. 433 datë 08.06.2016 është transferuar në pronësi të Bashkisë Cërrik, pyjet dhe kullotat publike sipas listës së inventarit, që transferohen në pronësi të Bashkisë sipas shtojcës 14 bashkëlidhur këtij vendimi, e cila përmban listën e inventarit që fillon me numrin rendor 1 (një) deri 186 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) rezulton se nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave nuk ka kryer asnjë veprim për regjistrimin ZVRPP (ASHK) Elbasan dhe inventarizimin e tyre, veprime në kundërshtim me nenet 5, 6 dhe 15 pika 2, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, dhe me Manualin e Mbarështimit të Pyjeve.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z.Ç.SH. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave për periudhën e auditimit. 01.01.2020-31.12.2022

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, si dhe të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

Ndikimi: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar.

Shkaku: Mungesa e regjistrimit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Cërrik.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, regjistrimin e pronave në pronësi të vet si dhe për krijimin e regjistrimit të pronave, në zbatim të kërkesave të UMF.

Titulli gjetjes 14: *Mos kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale të cilat janë certifikuar në ASHK nga sektori i menaxhimit të aseteve në Bashkinë Cërrik.*

Situata: Nga auditimi rezultoi se, për periudhën objekt auditimi janë certifikuar në total 7 prona sipas tabelës së sipërcituar si dhe përpara vitit 2020 janë certifikuar 65 prona objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të administruara llog.(212) pasuri e paluajtshme (*sasi e vlerë*) pjesa e konsiderueshme e tyre prej 4403 prona (*trajtuar analitikisht*) nuk janë të regjistruara në kontabilitet dhe pasqyrat financiare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Nga 65 prona të cilat janë certifikuar 34 prona janë prona të transferuara nga Ish komonat sot njësitë Administrative dhe 31 prona janë prona të cilat janë certifikuar për periudhën 2017-2019 dhe 7 prona janë certifikuar për periudhën 2020-2022 sipas aneksit nr. 1 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Konstatohet se sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga sektori i aseteve, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Cërrik në Drejtorinë rajoneve të ASHK Elbasan, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 38 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Cërrik. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. *Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. H.K. me detyrë Drejtoresh e Financës për periudhën e auditimit. 01.01.2020-31.12.2022

Kriteri: VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16).

Ndikimi: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar.

Shkaku: Mos rakordimi ndërmjet Sektorit të Financës dhe Sektorit të Menaxhimit të Aseteve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin 38 prona të certifikuara në ASHK Elbasan, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Cërrik sipas aneksit nr. 1 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrimit të prokurimeve

Në dosjet e prokurimit nuk administrohen dokumente që të vërtetojnë që nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për vitet ushtrimore. Programi i nevojave nuk është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, por në dosje administrohen listat prioritare për investime, të cilat janë miratuar me Vendim të KB vitit 2020, 2021 dhe 2022 bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Cërrik (regjistrat e parashikimit dhe realizimit), për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Lloji i procedurës	Nr. Proc	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh
Viti 2020				
<i>Procedurë e hapur;</i>	5	387,238,335	364,147,405	23,090,930
<i>Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;</i>	2	5,500,000	5,428,400	71,600
<i>Kërkesë për propozime;</i>	12	69,929,316	59,137,240	10,792,076
<i>Prokurim me vlerë të vogël.</i>	26	16,930,000	12463731.7	4,466,268
SHUMA	43	479,597,651	441,176,776	38,420,874
Viti 2021				
Lloji i procedurës	Nr.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh
<i>Procedurë e hapur;</i>	7	206,005,290	202,509,056	3,496,234
<i>Kërkesë për propozime;</i>	9	42,675,732	31,534,867	11,140,865
<i>Prokurim me vlerë të vogël.</i>	20	15,379,775	11,556,410	3,823,365
SHUMA	36	264,060,797	245,600,333	18,460,464
Viti 2022				
Lloji i procedurës	Nr.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh
<i>Procedurë e hapur;</i>	4	117,951,358	115,081,921	2,869,437
<i>Kërkesë për propozime;</i>	6	37,900,980	37,224,680	676,300
<i>Prokurim me vlerë të vogël.</i>	25	22,637,286	17,985,807	4,651,478
SHUMA	35	178,489,624	170,292,408	4,651,478

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, Janë audituar procedura e prokurimit si më poshtë:

Nr.	Objekti	Fondi limit	Operatori fitues	Shënime
1	Sistemim Asfaltim i tre rrugëve	24,835,898	BOE "G.T" SHPK & "E-A" ShPK	Me shkelje
2	Sistemim Asfaltim i rrugës Kamunah	28,333,333	"V.H" SHPK	Me shkelje
3	Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Desar	283,457,911	BOE "V.K" SHPK & "F." SHPK & "E-A" SHPK	Me shkelje
4	Rehabilitim/Perforcim banesash ekzistuese	27,450,777	"Z" SHPK	Me shkelje
5	Rikonstruksion i rrugës së Capallarëve dhe vreshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, Fshati Licaj, Nj.A. Shalës	49,091,672	"Z"	Pa shkelje

1. Procedura e prokurimit me objekt “Sistemim Asfaltim i tre rrugëve”, Bashkia Cërrik

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim Asfaltim i tre rrugëve”, Nr. REF-88255, datë 02-24-2021.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 25, datë 22.02.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 24, datë 22.02.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 25, datë 22.02.2021
2. Lloji i Procedurës – “E hapur”	Njësia e Prokurimit D.L, Jurist I.Ç, Ekonomist (Personi përgjegjës) A.D, Inxhinier gjeoteknik	1. H.K, Kryetar 2. R.J 3. M.XH
5. Fondi Limit (pa TVSh) 24,835,898 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE “G.T” SHPK & “E.A” ShPK me ofertë 24,698,141 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 1390 prot, dt. 21.04.2021 me afat 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 137,757 lekë ose 0.55 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 05.04.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Cërrik	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) S’kualifikuar 1 BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë. Ka tërheqje nga tenderi	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Cërrik
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E Hapur”, me vlerë 24,835,898 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë Cërrik, me afat trevjeçar: 20% në vitin 2021, 30% në vitin 2022 dhe 50% në vitin 2023.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për inicimin e kryerjes së këtij investimi.

Mbi projekt preventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Zhvillimit dhe Aplikimit të Projekteve në Shkurt 2021 dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Cërrik, Z.A.S. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 30 ditë nga lidhja e kontratës.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike**, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Cërrik, Z.A.S.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, datë 22.02.2021, i cili ka ndryshuar me shtojcën e modifikimeve të hedhur në SPE.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr. prot, datë 22.02.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës “*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura (edhe në shtojcën nr. 1), u konstatua se:

1- Në pikën 2.Licënsa profesionale e shoqërisë e vlefshme, është kërkuar në kundërshtim me VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, në të cilën për N.S - 19 Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë përcaktohet “*Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën me origjinë rrugore, hekurudhore, të barrierave metalike betonarme, dru xham, ose material plastik transparent, të mureve dopio, të mureve poroze ose të tullave poroze, gjithashtu edhe të veshjeve izoluese të pareteve të terrenit ose të tuneleve”.*

2- Është kërkuar që OE ofertues të disponojë licencë QKL III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane”, e cila nuk është e argumentuar teknikisht.

3- Është kërkuar që ofertuesi duhet të ketë jo me pak se 90 punonjës për periudhën Gusht 2020 - Janar 2021. Konstatohet që gjatë llogaritjes së orëve të punës janë marrë gabim orët e punës së transportit. Nga rillogaritja e bërë për orët e punës sipas preventivit prej 18692, reduktohen në 14000 orë pune, për të cilat duhen 58 punonjës.

4- Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 4 inxhinierë të ndryshëm të jenë në licencë dhe të punësuar për periudhën Gusht 2020 - Janar 2021, si dhe staf mbështetës 2 inxhinierë të tjerë, 6 teknikë të tjerë të ndryshëm, 2 specialistë montues tubash HDPE, 2 buldozëristë, një auditues energjie, 2 specialistë zjarrfikës, 2 inspektorë cilësie me background inxhinierik. Këto kriterë janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

5- Certifikata e kërkuara **PASS 99**, nuk është në përpjesëtim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

6- Është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me Kontrate pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, diploma, licencë ushtrimi profesioni. Ky kriter është i paargumentuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

7- Janë kërkuar makineri për skarifikim asfalti, 3 pompa suvatimi, 500 m² skela dhe rrjeta mbrojtëse, vinç karekë, termometër për matje tokëzimi, të cilat, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kanë **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi në cilësinë e specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit, Z. A.D Inxhinier.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Zhvillimit dhe Aplikimit të Projekteve në muajin Shkurt 2021. Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 05.04.2021. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE “B-N” SHPK & “B.B” SHPK	21,103,584
2	BOE “G.T” SHPK & “E.A” SHPK	24,698,141

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave pa nr. prot, datë 05.04.2021.

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën pa nr. prot, datë 19.04.2021, i cili NUK është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor Z.A.S. Në dosje administrohet një vendim i personit të autorizuar nga Titullari i AK, Z.T.Z për miratimin e klasifikimit përfundimtar të ofertave. Në bazë të këtij vendimi, është hartuar njoftimi i fituesit, i cili është hedhur në sistemin e APP-së.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se BOE “B-N” SHPK & “B.B” SHPK ka paraqitur një kërkesë për tërheqje me nr. 1281 prot, datë 08.04.2021, ose 3 ditë pas hapjes së ofertave dhe për këtë arsye është skualifikuar. Arsyeja e skualifikimit nuk përputhet me përcaktimet e bëra në Nenin 45 “Kriteret e skualifikimit të kandidatëve ose ofertuesve” të Ligjit 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në Nenin 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. KVO-ja duhet të kishte bërë vlerësimin e ofertës dhe nëse i plotësonte kriteret e kualifikimit sipas DT, të bënte kualifikimin e këtij OE dhe ta ftonte për lidhjen e kontratës. Nëse ky ofertues do të nuk do të bënte lidhjen e kontratës, duke u tërhequr, në zbatim të Nenit 49 të Ligjit 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, “Sigurimi i ofertës”, pika 1.b/i, **AK duhet të kishte bërë konfiskimin e sigurimit të ofertës në vlerën 496,718 lekë.** Lidhja e kontratës me BOE “G.T” SHPK & “E.A” SHPK, i renditur i dyti, është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 58, pika 5, sipas të cilit “...*Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “çmimi më i ulët” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë do të jetë jo më e madhe se 2 për qind e fondit limit...*”. Në këtë rast, diferenca ndërmjet ofertës ekonomike të tërhequr dhe asaj të shpallur fituese është 14.5% dhe KVO nuk duhet të kishte propozuar shpalljen fituese të BOE “G.T” SHPK & “E.A” SHPK.

Sa sipër, skualifikimi i BOE “B.N” SHPK & “B.B” SHPK është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “*Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit*”.

-Gjithashtu, nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të BOE fitues “G.T” SHPK & “E.A” SHPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

1 - “G.T” Shpk:

- nuk plotëson numrin mesatar të punonjësve të kërkuar në DT (14%, sipas marrëveshjes noteriale të bashkëpunimit x 90 = 12,6 punonjës);

- Bilanci i vitit 2019 (i vetmi bilanc) është i pakonfirmuar nga autoritetet përkatëse dhe i pa shoqëruar nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabël i autorizuar;

- nuk plotëson pjesën takuese të xhiros vjetore sipas DT, pasi në vitin 2019 (i vetmi vit) ka patur xhiro vjetore 97,500 lekë, e cila është më e vogël se 14% e fondit limit;

- në eksperiencën e ngjashme të paraqitur “Ndërtim i rrugës Kantier – Shkumbin”, me investitor “B” SHPK (punë jopublike), nuk ka paraqitur lejen e ndërtimit, siç e kërkojnë DT.

2- “E.A” Shpk

-Mungon vërtetim i pagesës së taksave vendore në Bashkinë Sarandë, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në sistem, ka realizuar në këtë bashki objektin “Riparim dhe riveshje e rrugës nga Tirana Bank – Kopshti Kështjella në Ksamil”.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “*Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit*”.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 29,637,769 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së H.K, Kryetar, R.J dhe M.XH.

Ndikimi: Vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Cërrik, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

2. Procedura e prokurimit me objekt “Sistemim Asfaltim i rrugës Komunah”, Bashkia Cërrik

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemin Asfaltim i rrugës Komunah”, Nr. REF-85705 datë 02-02-2021 dhe REF-85705-02-02-2021		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 13/2, datë 02.02.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 13/1, datë 02.02.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 13/3, datë 02.02.2021 H.K, Kryetar R.J M.XH
2. Lloji i Procedurës – “E hapur”	Njësia e Prokurimit 1. D.L, Jurist 2. I.Ç, Ekonomist (Personi përgjegjës) 3. A.D, Inxhinier gjeoteknik	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 28,333,333 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “V.H” SHPK me ofertë 28,183,787 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 1343 prot, dt. 15.04.2021 me afat 20 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 149,546 lekë ose 0.53 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 10.03.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Cërrik	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) S’kualifikuar 2 BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë. Ka një tërheqje nga tenderi	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Cërrik
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E hapur”, me vlerë 28,333,333 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë Cërrik, me afat trevjeçar: 20% në vitin 2021, 30% në vitin 2022 dhe 50% në vitin 2023.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet VKB nr. 64, datë 28.05.2020 për miratimin e listës prioritare për investime, ky objekt figuron me vlerë të projektit 191,139,377 lekë.

Mbi projekt preventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria “Z & C” ShPK dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Cërrik, Z.A. S në vitin 2020. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 30 ditë nga fillimi i punimeve. Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Cërrik, Z. A.S.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, datë 02.02.2021, i cili ka ndryshuar me shtojcën e modifikimeve të hedhur në SPE në datën 04.03.2021 si më poshtë:

Pas monitorimit të APP-së, me Procesverbalin e datës 26.03.2021 (të hedhura si shtojcë në SPE), kriteret e kualifikimit kanë ndryshuar si më poshtë:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr. prot, datë 02.02.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës “*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit*”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura (edhe në shtojcën nr. 1), u konstatua se:

- 1- Është kërkuar që OE ofertues të disponojë licencë QKL III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeje Urbane”, e cila nuk është e argumentuar teknikisht.
- 2- Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 3 inxhinierë të ndryshëm të jenë në licencë dhe të punësuar për periudhën Korrik 2020 - Janar 2021, si dhe staf mbështetës 2 teknikë të tjerë ndërtimi,. Ky kriterë është i paargumentuar teknikisht, pasi, nuk është në përpjesëtim me volumin e punimeve në objektin që prokurohet.
- 3- Është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me Kontrate pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, diploma, licencë ushtrimi profesioni. Ky kriter është i paargumentuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.
- 4- Janë kërkuar pajisje/makineri si Kontenier Stacioner (zyrë në objekt), e cila, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjesëtim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.
- 5- Është kërkuar Fabrikë asfaltbetoni, me distancë jo më shumë se 60 km nga objekti që prokurohet në zbatim të VKM nr. 628 datë 15.07.2015, ose Fabrike mobile të lëvizshme, e cila nuk është e argumentuar teknikisht.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kanë **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar**. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi në cilësinë e specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit, Z.A.D Inxhinier.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Zhvillimit dhe Aplikimit të Projekteve në muajin Shkurt 2021. Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 10.03.2021. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE "B-N" ShPK	21,526,599
2	OE "B B" ShPK	26,923,125
2	OE "V H" ShPK	28,183,787

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se OE "B-N" SHPK, për shkak të personelit të reduktuar si pasojë e pandemisë, ka paraqitur një kërkesë për tërheqje nga oferta me nr. 1024 prot, datë 19.03.2021, ose 9 ditë pas hapjes së ofertave dhe për këtë arsye, sipas procesverbalit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave datë 25.02.2021, është skualifikuar nga KVO-ja. Arsyeja e skualifikimit nuk përputhet me përcaktimet e bëra në Nenin 45 "Kriteret e skualifikimit të kandidatëve ose ofertuesve" të Ligjit 9643, datë 20.11.2016 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe në Nenin 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. KVO-ja duhet të kishte bërë vlerësimin e ofertës dhe nëse i plotësonte kriteret e kualifikimit sipas DT, të bënte kualifikimin e këtij OE dhe ta ffonte për lidhjen e kontratës. Nëse ky ofertues do të nuk do të bënte lidhjen e kontratës, duke u tërhequr, në zbatim të Nenit 49 të Ligjit 9643, datë 20.11.2016 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, "Sigurimi i ofertës", pika 1.b/i, AK duhet të kishte bërë konfiskimin e sigurimit të ofertës.

KVO, pas skualifikimit të OE "B N", ka vazhduar vlerësimin e ofertuesve të mbetur në këtë procedurë:

Nga auditimi rezulton se është skualifikuar OE "B B" SHPK, me ofertë ekonomike 26,923,125 lekë për arsyet si më poshtë:

Boshnjaku B

1. OE nuk ka plotësuar kriterin për pagesën e të gjitha detyrimeve të energjisë elektrike ku kërkohej: e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Nga verifikimi i Ekstraktit të QKB konstatohet se ndër të tjera OE kryen aktivitetet ne: Shijak, Vore për të cilat nuk ka sjelle vërtetim për shlyerjen e energjisë edhe pse i ka ato të regjistruara si seli dytësore sipas QKB. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike lëshon vërtetimet e debisë, bazuar në deklaratimet vullnetare të subjekteve kërkues të kontratave të energjisë elektrike. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike evidenton saktësinë e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë: 1. Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara). 2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuar si private. 3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përveç rasteve kur ato janë ambiente të marra me qira. Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familjare, OSHEE i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së çmimit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Në QKB konstatohen selite dytësore në objekte ndërtimore në proces pa informuar në këtë rast nëse ai furnizohet apo jo me energji në këto ndërtesa apo është në kushtet e shmangies së lidhjes së kontratës apo është me qera dhe qiradhënësi paguan si familjar. Përsa me lart konstatohet se OE nuk ka paraqitur vërtetim të plote të pagesës së detyrimeve të OSHEE.

2. OE nuk ka plotësuar kriterin: Sipas kërkesës Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitet 2018, 2019.... OE nga verifikimi i deklaratës mbi punët në proces konstatohet se nuk ka seli dytësore në: Himarë

Referuar ligjit Nr. 8/2015 Nenit 2 pika 16: "Veprimtari është veprimtaria e pavarur ekonomike, profesionale apo tregtare, e ushtruar në mënyrë të vazhdueshme nga subjektet. Gjithashtu referuar ligjit 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, "Për procedurat tatimore pika 1/1 ku citohet:

“Ne përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, te ndryshme nga selia ne çdo rast behet përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikate me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikate lëshohet për të identifikuar vendodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia. Për këtë rast OE duhet të ishte pajisur me certifikate dhe të regjistrohej në QKB e për pasojë i është shmangur detyrimeve tatimore vendore në bashkitë e mësipërme. Persa me lart OE nuk e ka plotësuar detyrimin për shlyerjen e taksave vendore.

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar me kohë të plotë minimalisht 65 (gjashtëdhjetë e pese) punonjës për periudhën Korrik 2020 – Janar 2021, të vërtetuar me:

a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj të periudhës së mësipërme.

b. Listë pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit e përcaktimeve që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për secilin muaj të periudhës së mësipërme.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij 2 (dy) punonjës të pajisur me certifikatë për dhënien e ndihmës së parë, të siguruar sipas listë pagesës **së paku për muajin e fundit** dhe shoqëruar me kontratë pune dhe certifikatën përkatëse, lëshuar nga organe kompetente publike ose private.

1.1 (një) hidraulik, shoqëruar me kontratë individuale pune, dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës), si dhe me certifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose nga një organ i akredituar certifikues.

2.2 (dy) Asfaltoshtrues, shoqëruar me kontratë individuale pune, dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës), si dhe me certifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose nga një organ i akredituar certifikues.

3.2 (dy) pllakashtrues, shoqëruar me kontratë individuale pune, dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës), si dhe me certifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose nga një organ i akredituar certifikues.

4.2 (dy) betonues, shoqëruar me kontratë individuale pune, dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës), si dhe me certifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose nga një organ i akredituar certifikues

5.3 (tre) shoferë, shoqëruar me kontratë individuale pune, leje drejtimi dhe CAP.

6. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë ;

a.1 (një) punonjës, që përmbush kriteret për të qenë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve ,i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

b. 1 (një) punonjës _ Çertifikuar si Përgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve ne mjedis, ne përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Diplomë/certifikate
- Deklaratë nga administratori

Te jene ne liste pagesat e shoqërisë se paku ne muajin e fundit

7.A.Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL), Kodi III.2.B “Grumbullim, Transportime mbetjeve, jo te rrezikshme).

8.Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e punimeve objekt kontrate. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik (shtojca 10), si më poshtë:

Nr	Lloji i Mjeteve/Makinerive	Statusi	Sasia
6	Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	cope 1
8	Buldozer	në pronësi ose me qira	Cope 1
10	Motogjenerator / Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Sharrë asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kullë ndriçimi - minimumi 1 copë

9.Operatori nga dita e shpalljes se procedurës deri ne momentin e hapjes se ofertave duhet te paraqesë mostra për artikujt e mëposhtëm:

- 1 ndriçues smart VP CL CR M-S 250ë GG FAE 44004 me llampe 250 ë 230 ë.
- Pllake betoni për trotuar t=6 cm

Nga verifikimi në SEP të dokumentacionit të OE “B B” Shpk, rezultoi se:

- Së pari, përsa i përket faturave të shlyerjes së energjisë, ne DT nuk përcaktohet në asnjë pikë të DT, që shoqëritë janë të detyruara që të marrin vërtetim nga OSHEE në vendet ku nuk kanë selinë qendrore, pasi kjo është e detyrueshme vetëm për hapjen e NIPT sekondar.

- Motogjeneratori, sharra e asfaltit, numri i punonjësve, koordinatori për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit (ing. G.P), janë plotësuar nga OE “B” SHPK.

Sa sipër, ky OE është skualifikuar me të drejtë, por jo për të gjitha arsyet e cituara në procesverbalin e vlerësimit të ofertave.

-Gjithashtu, nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të OE fitues “V.H” ShPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

1- Për bashkitë e deklaruara në Shtojcën nr. 11 “Deklaratë mbi kontratat e lidhura ose në Proces”, si Korçë, Librazhd, Laç, Shijak, Berat, Pogradec, referuar ligjit 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, “Për procedurat tatimore”, pika 1/1 ku citohet: *“Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve te tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhet përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë,*

kur është e ndryshme nga selia”, OE duhet të ishte pajisur me certifikatë dhe të regjistrohej në QKB e për pasojë i është shmangur detyrimeve tatimore vendore në bashkitë e mësipërme. Përsa me lart, OE nuk e ka plotësuar detyrimin për shlyerjen e taksave vendore. Edhe OE “B.B” SHPK është skualifikuar nga KVO, duke iu evidentuar si një nga mangësitë, kjo shmangie ligjore për Bashkinë Himarë.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.”.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 33,820,544 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së H.K, Kryetar, R.J dhe M.XH.

Ndikimi: Vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Cërrik, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

3. Procedura e prokurimit me objekt “Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar, NjA Mollas”, Bashkia Cërrik

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar, NjA Mollas”, Nr. REF-85705 datë 02-02-2021 dhe REF-68802-08-16-2020		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 186/3, datë 14.08.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 186/2, datë 14.08.2020	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 186/4, datë 14.08.2020 H.K, Kryetar F.U M.XH
2. Lloji i Procedurës – “E hapur”	Njësia e Prokurimit 1. D.L, Jurist 2. I.Ç, Ekonomist (Personi përgjegjës) 3. A.D, Inxhinier gjeoteknik	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 283,457,911 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE “V.K” SHPK & “F.” SHPK & “E.A” SHPK me ofertë 281,115,515 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 2816 prot, dt. 21.10.2020 me afat 1(një) vit nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 2,342,396 lekë ose 0.82 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 23.09.2020	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) S’kualifikuar 1 BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE

11. Ankimime për DT; datë 28.08.2020. Ankimim për vlerësimin, nuk ka	12. Përgjigje Ankesës 28.08.2020	13. Përgjigje Ankesës
--	----------------------------------	-----------------------

Burimi i të dhënave: Bashkia Cërrik
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E hapur”, me vlerë 283,457,911 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit, me afat katërvjeçar: 20% në vitin 2020, 25% në vitin 2021, 25% në vitin 2022 dhe 30% në vitin 2023.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet shkresa me nr. 1873 prot., datë 23.07.2020 e MIE “Detajimi i Aktit Normativ nr. 28, datë 02.07.2020, për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për programin “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, në të cilën është përcaktuar edhe fondi për realizimin e këtij objekti, me vlerë të projektit 342,162,759 lekë, si dhe VKB nr. 64, datë 28.05.2020 për miratimin e listës prioritare për investime.

Mbi projekt preventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga JV “Z & C” SHPK & “Z” SHPK dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Cërrik, Z.A.S në vitin 2020. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 365 ditë nga fillimi i punimeve.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Cërrik, Z.A.S.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, datë 02.02.2021, i cili ka ndryshuar me shtojcën e modifikimeve të hedhur në SPE në datën 04.03.2021.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 14.08.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës “*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit*”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura (edhe në shtojcën nr. 1), u konstatua se:

1- Është kërkuar që OE ofertues të disponojë në licencën profesionale klasifikimet e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licensat e mëposhtme:**

1. N.P. 1 – D Punime gjermimi në tokë.
- 1.N.P. 4 – C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- 2.N.P. 5 – C Punime nëntoksore, ura e vepra arti.
- 3.N.P. 9 – D Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.
- 4.N.P. 10 – B Ndertimi i impianteve per prodhimin e energjise elektrike.
- 5.N.P. 11 - C Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformatorëve, etj.
- 6.N.P. 12 – E Punime të inxhinierisë së mjedisit.

• **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

- N.S. 1 – B Punime për prishjen e ndërtimeve.
- N.S. 4 - D Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me infrastrukture druri, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndertuese.
- N.S. 8 – D Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
- N.S. 9 – D Punime strukturorë speciale.
- N.S. 10 – E Shtresa dhe mbistruktura speciale.
- N.S. 19 – C Sistemet kundra zhurmës për infrastrukture.

Këto klasifikime të licencës profesionale, pas verifikimit të preventivit të punimeve të objektit, rezultojnë të mos jenë në përpjesëtim me volumin e punimeve ose me natyrën e punimeve, në objektin që prokurohet.

2- Në pikën 2.3.4 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 14 inxhinierë të ndryshëm të jenë në licencë dhe të punësuar për periudhën Korrik 2020 - Janar 2021, si dhe staf mbështetës 6 inxhinierë të tjerë dhe 6 teknikë të tjerë të ndryshëm. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nuk është në përpjesëtim me volumin e punimeve në objektin që prokurohet Kërkesa për arkitekt, 2 inxhinierë hidroteknikë, inxhinier strukturist, gjeoteknike, elektronik, 2 inxhinierë topograf, 2 inxhinierë mjedisi në licencë, si dhe inxhinier Hidroteknik 1 (një), Inxhinier Ndërtimi profili Transport 1 (një), Inxhinier Ndërtimi 2 (dy), Inxhinier Topograf 1 (një), Inxhinier Pyjesh 1 (një), 1 (një) Restaurator i pajisur me licencë profesionale personale lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit, si staf mbështetës, nuk kanë asnjë argumentim teknik.

Janë kërkuar gjithashtu, një inxhinier me certifikatën e audituesit të energjisë “Eficenca e energjisë në ndërtesa”, Një inxhinier ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe një inxhinier me certifikatën e trajnimit *”Përgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve në mjedis”*. *Kjo kërkesë është gjithashtu e paargumentuar teknikisht*

3- Është kërkuar qe operatori ekonomik të ketë të punësuar “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me Kontrate pune te vlefshme brenda periudhës se realizimit te kontratës, diploma, licencë ushtrim profesioni. Ky kriter është i paargumentuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

4-Janë kërkuar licenca nga QKL me kode III.2.A (Ndikimi në mjedis), III.2.B (Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane), Leje mjedisore e tipit “C” për “Magazinin dhe/ose trajtim i mbetjeve te tjera te ujerave te zeza urbane”, kodi III.1.A, kodi III.7.B; Liçencë për “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe/ose kullotat”, të cila nuk është e argumentuar teknikisht dhe nuk janë në përpjesëtim me natyrën e objektit që prokurohet.

5- Është kërkuar autorizim për “Për përdorim civil të lëndëve plasëse” dhe 2 punonjës zjarrmëtar, pa patur në preventiv gjermim me lëndë plasëse.

6- Janë kërkuar pa argumentim teknik certifikatat e mëposhtme:

- BS PAS 99 (Sistemi i menaxhimit të integruar).
- ISO 50001 (Sistemi i menaxhimit të energjisë).

- SA 8000 (Sistemi i menaxhimit të përgjegjësishë shoqërore).
- ISO IEC 27001 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit).
- ISO 28001 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë për zinxhirin e furnizimit).
- DS CEN 15128 (Sistemi i standardeve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit).
- BS EN 13331-1 2002 (Sistemet për veshjen e kanaleve).
- ISO 3744:2010 (Sistemet për nivelin e garantuar të fuqisë së zërit).

7-Janë kërkuar pajisje/makineri si Kontenier Stacioner (zyrë në objekt), 2 pompa suvatimi, 2 sharra asfalti, eskavator/vinç me krahë mbi 30 m dhe aftësi mbajtëse mbi 40 ton, 500 copë kokore për 200 punonjës, etj., të cilat, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjesëtim me natyrën e punimeve ose me volumin e punimeve në objektin që prokurohet.

8- Është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë nga administratori i shoqërisë, që merr përsipër me shpenzimet e veta dhe është dakord që të paraqesë pranë AK mjetet dhe pajisjet e kërkuara më sipër, në rast se do të lindi nevoja për verifikimin e tyre, përpara shpalljes së klasifikimit. Kjo kërkesë nuk është e argumentuar ligjërisht, pasi AK mund të verifikojë mjetet në kantierin që paraqet OE në deklaratën mbi disponueshmërinë e mjeteve, sipas Shtojcës Nr.10.

9- Është përcaktuar që do të organizohet një vizitë në kantier në datë 14.09.2020 në orën 10:00 pranë Autoritetit Kontraktor për të paraqitur mostrat e tubacioneve Tubo HDPE, PE100, me raport testimet përkatëse, si dhe shoqëruar me Certifikatat ISO të prodhimit. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime ku dhe do të pajisen me vërtetim nga institucioni (**mosparaqitja është kusht skualifikimi**). Ky kriter është i paargumentuar ligjërisht, pasi cilësia e materialeve kontrollohet dhe garantohet në fazën e zbatimit. Gjithashtu vendosja si kusht skualifikues mosparaqitjen në këtë vizitë, është e pabazuar, pasi informacionet shtesë dhe shpjegimet nuk jepen nëpër vizita, por përcaktohen në dokumentet e tenderit dhe hidhen në sistemin e prokurimit.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kanë **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar**. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit dhe në cilësinë e specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit, z. A.D Inxhinier.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga shoqëria projektuese. Nga verifikimi i disa zërave të preventivit të ofertës (me vlerë më të madhe), rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 10.03.2021. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE “E.V” SHPK	Pa oferte
2	BOE “V K” SHPK & “F” SHPK & “E-A” SHPK	281,115,515

Burimi i të dhënave: SPE

Nga auditimi rezulton se nga KVO është mbajtur procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave me datë 23.09.2020 dhe më pas është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën pa nr. prot, datë 02.10.2020, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor Z.A.S me vendim me nr. 2578 prot, datë 02.10.2020 “Për miratimin e klasifikimit përfundimtar të ofertave”. Në bazë të këtij vendimi, është hartuar njoftimi i fituesit, i cili është hedhur në sistemin e APP-së.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se OE “E-V” SHPK, rezulton se ky OE ka hedhur në sistem vetëm formularin e ofertës bosh, pa vlerë ekonomike. Për këtë arsye, ky OE është skualifikuar me të drejtë.

-Gjithashtu, nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të BOE fitues “V.K” SHPK & “F” SHPK & “E-A” SHPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

1- OE “V.K” SHPK, për bashkitë e deklaruara në Shtojcën nr. 11 “Deklaratë mbi kontratat e lidhura ose në Proces”, si Shijak, Vlorë, Durrës, Lushnjë, Konispol, Berat, Vorë, Cërrik, Elbasan, referuar ligjit 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, “Për procedurat tatimore”, pika 1/1 ku citohet: *“Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selise dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhet përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia”,* OE duhet të ishte pajisur me certifikate dhe të regjistrohej në QKB e për pasojë i është shmangur detyrimeve tatimore vendore në bashkitë e më sipërme. Përsa me lart OE nuk e ka plotësuar detyrimin për shlyerjen e taksave vendore.

2- Po kështu edhe OE “E-A” SHPK për bashkitë Berat, Lushnjë, Konispol, Sarandë, Gramsh, Durrës, Maliq, Shijak nuk ka bërë regjistrimin në QKB dhe nuk ka paguar taksat në Bashkitë e mësipërme.

3- Nga verifikimi në SPE u konstatua gjithashtu, se objektet e paraqitura në SPE si eksperiencë e ngjashme nga shoqëria “E.A” SHPK, nuk plotësojnë kriterin e vendosur në DT për eksperiencat e ngjashme.

Sa sipër, kualifikimi i këtij BOE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit *“Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.”*

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 337,342,218 lekë me TVSH me një BOE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së H.K, Kryetar, F.U dhe M.XH.

Ndikimi: Vendosja e kriteve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Cërrik, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

4. Procedura e prokurimit me objekt “Rehabilitim/Perforcim banesash ekzistuese”, Bashkia Cërrik

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitim/Perforcim banesash ekzistuese”, Nr. REF-67965-08-06-2020.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 183, datë 06.08.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 182, datë 06.08.2020	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 184, datë 06.08.2020 1. H.K, Kryetar 2. F.U 3. M.XH
2. Lloji i Procedurës – “E hapur”	Njësia e Prokurimit D.L, Jurist I.Ç, Ekonomist (Personi përgjegjës) A.D, Inxhinier gjeoteknik	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 27,450,777 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “Z” SHPK me ofertë 26,920,399 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 2544 prot, dt. 29.09.2020 me afat 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 530,378 lekë ose 1.9 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 14.09.2020	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Cërrik	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) S’kualifikuar 2 BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë. Ka tërheqje nga tenderi	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Cërrik
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E Hapur”, me vlerë 27,450,777 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë Cërrik, me afat trevjeçar: 30% në vitin 2020, 30% në vitin 2021 dhe 40% në vitin 2022.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet VKM nr. 71, datë 26.06.2020, për adaptimin e magazinës në banesë sociale me qira dhe rishikimin e vlerës së projektit.

Mbi projekt preventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria “A. MK” SHPK dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Cërrik, z. A.S në vitin Prill 2020. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Cërrik, Z.A.S.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, datë 06.08.2020, i cili ka ndryshuar me shtojcën e modifikimeve të hedhur në SPE.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 06.08.2020, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës “*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura (edhe në shtojcën nr. 1), u konstatua se:

1- Është kërkuar që OE ofertues të disponojë licencë QKL III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane”, e cila nuk është e argumentuar teknikisht.

2- Është kërkuar që ofertuesi duhet të ketë jo me pak se 80 punonjës për periudhën Shkurt 2020 – Korrik 2020. Konstatohet që gjatë llogaritjes së orëve të punës janë marrë gabim orët e punës së transportit. Nga rilogaritja e bërë për orët e punës sipas preventivit prej 35780 op gjithsej, duhen 75 punonjës.

3- Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 4 inxhinierë të ndryshëm të jenë në licencë dhe të punësuar për muajin e fundit, si dhe staf mbështetës 1 inxhinier + 1 arkitekt, 3 teknikë të tjerë të ndryshëm dhe 3 inxhinierë me certifikata të ndryshme. Këto kriterë janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjesëtim me volumin e punimeve në objektin që prokurohet.

4- Certifikata e kërkuara ISO 1452-1:2009, UNI EN ISO 3834-2:2006, ISO/IEC 27001:2013 dhe PASS 99, nuk janë në përpjesëtim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet. Gjithashtu, kërkesa që në rast BOE të gjithë anëtarët duhet të kenë certifikatat ISO, nuk është e argumentuar juridikisht.

5- Është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me Kontratë pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, diploma, licencë ushtrimi profesioni. Ky kriter është i paargumentuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

6- Janë kërkuar makineri për realizimin e objektit si 3 fadroma skrep, 2 ekskavatorë me goma, kokë tërheqëse, 3 autobote uji, Impiant inertesh, linjë prodhimi për pllaka e bordura, linjë prodhimi elementë netoni, me QKL, Fabrikë betoni, 2 copë autobetonierë, fabrikë për prodhimin e dymëve dhe dritareve PVC dhe duralumin, etj., të cilat, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

7. Është kërkuar “*Rastet e detyrimeve të mëparshme kundrejt Bashkisë Cërrrik si : gjoba, debi të ndryshme, moszbatim në kohë dhe sipas kushteve përkatëse të kontratave të mëparshme, të dokumentuara me njoftime, procesverbale etj, do të përbëjnë kusht për s’kualifikim të operatorit/operatoreve ekonomike përkatës” dhe është hequr në shtojcë, pa asnjë argumentim teknik dhe ligjor.*

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kanë **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar**. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi në cilësinë e specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit, Z.A.D Inxhinier.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga shoqëria “A.MK” në muajin Prill 2021.

Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 05.04.2021. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE “E.VL”	Pa ofertë
2	OE “B. B” SHPK	25,085,242
3	OE “Z” SHPK	26,920,399

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Është mbajtur procesverbali i hapjes të ofertave pa nr. prot, datë 14.09.2020 dhe proces verbali i vlerësimit të ofertave pa nr. Prot, datë 16.09.2020.

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën pa nr. prot, datë 24.09.2020 Në dosje administrohet një vendim i Titullari të AK, Z.A.S për miratimin e klasifikimit përfundimtar të ofertave. Në bazë të këtij vendimi, është hartuar njoftimi i fituesit, i cili është hedhur në sistemin e APP-së.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se janë skualifikuar OE pjesëmarrës, si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE “E. VL”	Pa ofertë
2	OE “B.B” SHPK	25,085,242

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

1. OE “E.VL” SHPK ka paraqitur vetëm shtojcën 1 të pa plotësuar dhe është skualifikuar me të drejtë nga KVO-ja.

2. OE “B.B” SHPK është skualifikuar për mosplotësimin e shtojcës 1, konform DT (preventivi në paragrafin “E” pa njësi); Nuk plotëson numrin e punonjësve; stafin inxhiniero teknik; makineritë/pajisjet. Nga verifikimi në sistem, rezultoi se ky OE nuk plotëson numrin e punonjësve, stafin inxhinierik, ka plotësuar gabim Shtojcën nr. 1, etj., sipas kriterëve të vendosura ne KVK dhe është skualifikuar me të drejtë nga KVO-ja.

Është kualifikuar dhe shpallur fitues, OE si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE "Z" SHPK	26,920,399

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

- Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të OE fitues "Z" SHPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:
- nisur nga eksperiencia e ngjashme e paraqitur në sistem "Rehabilitimi i çarjeve në shkollën e mesme D.N" Qukës, e cila është realizuar në vitin 2018, konstatohet se nga ana e OE "Z" SHPK nuk është paraqitur vërtetimi për shlyerjen e taksave vendore në Bashkinë Prrrenjas. Gjithashtu, referuar ligjit 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, "Për procedurat tatimore", pika 1/1 ku citohet: *"Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selise dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhet përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia",* OE duhet të ishte pajisur me certifikatë dhe të regjistrohej në QKB e për pasojë i është shmangur detyrimeve tatimore vendore në bashkinë e mësipërme. Përsa me lart, OE nuk e ka plotësuar detyrimin për shlyerjen e taksave vendore.
- Në vend të inxhinierit topograf, është paraqitur oficer topograf (N.Z).
- Drejtuesja teknike A.C (në licencë personale është A.C(K.)), e cila është zotëruese e licencës profesionale MK Nr. 0685/1, është njëkohësisht edhe Drejtuese Teknike e Shoqërisë Aksionere Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë, me Vendimin Nr.45, datë 13.06.2018 të Komisionit Kombëtar Rregullator, pranë Entit Rregullator të Sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura. Për pasojë edhe ky OE duhet të ishte skualifikuar.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit *"Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit."*

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 32,304,478.8 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së H.K, Kryetar, F.U dhe M.XH.

Ndikimi: Vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Çërrik, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

5. Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës së Capallarëve dhe vreshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, Fshati Licaj, Nj.A. Shalës”, Bashkia Cërrik

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Capallarëve dhe vreshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, Fshati Licaj, Nj.A. Shalës”, Nr. REF-47186, datë 10-23-2022.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 356, datë 08.09.2022	3. Njësia e Prokurimit: Urdhri i prokurimit i ndryshuar nr. 457, datë 20.10.2022, ka ndryshuar Nj.P, nga: D.L Jurist I.Ç Personi përgjegjës D.D në: K.B, K.M, A.D, Inxhinier gjeoteknik	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 356/1, datë 08.09.2022 4. H.K, Kryetar 5. R.J anëtar 6. M.XH anëtar
2. Lloji i Procedurës – “E hapur”	4. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 355, datë 08.09.2022 Grupi i punës K.B, K.M, A.D, Inxhinier gjeoteknik	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 49,091,672 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE “Z” ShPK me ofertë 49,052,481.5 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 3519 prot, dt. 20.12.2022 me afat 120 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 39,190 lekë ose 0.08 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 09.11.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Cërrik	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) S’kualifikuar 0 BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Cërrik
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E Hapur”, me vlerë 49,091,672 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë Cërrik, me afat trevjeçar: 20% në vitin 2022, 30% në vitin 2023 dhe 50% në vitin 2024.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet VKB nr. 62, datë 22.08.2022 “Për miratimin e listës së projekteve prioritare për vitin 2022”.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria “Z.” SHPK dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Cërrik, z. A.S në vitin 2022. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 30 ditë nga nënshkrimi e kontratës. Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet**

publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Cërrrik, Z.A.S.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit – Tipi i kontratës - PUNË, pa nr. prot, datë 24.10.2022, i cili ka ndryshuar me shtojcat e modifikimeve të hedhur në SPE si më poshtë:

Pas asistencës së APP-së ardhur me email datë 31.10.2022, me Procesverbalin e datës 31.10.2022 (të hedhura si shtojcë në SPE), kriteret e kualifikimit kanë ndryshuar si më poshtë:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr. prot, datë 24.10.2022, veprim në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 2, “Dokumentimi i procesit”, pika 2, gërma c, sipas të cilës “2. Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:

...c) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit ”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura (edhe në shtojcën nr. 1), u konstatua se:

1- Është kërkuar që OE ofertues të disponojë licencë QKL III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane”, e cila nuk është e argumentuar teknikisht.

2- Në pikën 2.3.5 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 4 inxhinierë të ndryshëm të jenë në licencë dhe të punësuar për periudhën Gusht - Shtator 2022 (2 ndërtimi, 1 hidro dhe 1 gjeodet), si dhe 3 hidraulikë, 3 karpentierë, 1 mekanik, etj. Ky kriter është i paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

3- Janë kërkuar makineri/pajisje për realizimin e objektit dhe konkretisht 13 kamionë të tonazheve të ndryshëm, 4 kamionçina, 3 kamionë me vinç, rimorkiator, 9 ekskavatorë të ndryshëm, 8 rrula, 3 fadroma, etj., të cilat, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kanë **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar**. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”, duke ngarkuar me përgjegjësi në cilësinë e specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit, z. A.D Inxhinier.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga shoqëria “Z.” SHPK në vitin 2022.

Nga verifikimi i disa zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur punë”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 09.11.2022. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE “Z” SHPK	49,052,481.5

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave pa nr. prot, datë 05.04.2021.

Nga auditimi rezulton se nga KVO është marrë vendim për renditjen përfundimtare dhe i është kërkuar OE të shpallur fitues paraqitjen e dokumenteve provuese me shkresën pa nr. prot, datë 09.11.2022. Pas verifikimit të ofertës së OE “Z” SHPK, është lidhur kontrata me nr. 3519 prot., datë 20.12.2022. Në bazë të këtij vendimi, është hartuar njoftimi i fituesit, i cili është hedhur në sistemin e APP-së.

- Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të OE fitues “Z” SHPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

- Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të OE fitues “Z” SHPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

- nisur nga eksperiencat e ngjashme të paraqitura në sistem: “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme dhe rurale” Bashkia Cërrik, e cila është realizuar në vitin 2019 dhe “Rikonstruksion i rrugës fshati Çekin” Bashkia Gramsh, e cila është realizuar në vitin 2020, konstatohet se nga ana e OE “Z” SHPK nuk është paraqitur vërtetimi për shlyerjen e taksave vendore përkatësisht në Bashkinë Cërrik dhe Bashkinë Gramsh. Gjithashtu, referuar ligjit 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, “Për procedurat tatimore”, pika 1/1 ku citohet: “Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhet përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia”, OE duhet të ishte pajisur me certifikatë dhe të regjistrohej në QKB e për pasojë i është shmangur detyrimeve tatimore vendore në bashkitë e mësipërme. Përsa me lart, OE nuk e ka plotësuar detyrimin për shlyerjen e taksave vendore.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “...Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme..”.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 93, pika 2 “Në rast mungese të sigurimit të konkurrencës, autoriteti/enti kontraktor anulon procedurën, si më poshtë vijon:

a) në procedurat me faza:

i. në fazën e parë nuk është dorëzuar asnjë kërkesë për pjesëmarrje e përshtatshme;

ii. në fazën e dytë nuk është asnjë ofertë e vlefshme.” KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 58,862,977.8 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së H.K, Kryetar, R.J dhe M.XH.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Cërrik, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Lidhur me auditimin në provedurat e prokurimit, me shkresën nr. 1032/1, datë 17.05.2023, e protokolluar në KLSH me nr. 1174/5 prot, datë 23.05.2023, është observuar nga antarët e Njësisë së Prokurimit dhe anëtarët e KVO-së, si më poshtë:

I. Procedura e prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim i tre rrugëve” Bashkia Cërrik

Pretendimi i subjektit:

1 - Nga shqyrtimi i dokumentacionit ne dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për inicimin e kryerjes se këtij investimi.

Sa i përket kësaj pike ju informojmë se dokumenti për inicimin e kryerjes se këtij prokurimi është vendimi nr. 121 date 24.12.2020 i Këshillit Bashkiak Cërrik “Buxheti i Bashkisë Cërrik për vitin 2021”. (do ta gjeni bashkëngjitur observacioneve për Projektraportin e Auditimit)

Opinionit i Grupit të auditimit

Në dosjen e prokurimit dhe bashkëlidhur observacionit, gjendet vendimi i Këshillit Bashkiak Cërrik, i cili nuk ka të përcaktuar asgjë për këtë objekt. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

2. Sa i përket oponencës teknike, ju informojmë se ne baze te ligjit 107/2014 neni 3 pika 20 Ndërtim është çdo objekt që ndërtohet ose instalohet në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme dhe që zhvillohet nën dhe/ose mbi tokë.

Opiniononi i Grupit të auditimit

Në aktkonstatimin nr. 15 dhe në Projektraport është cituar referenca ligjore që citon kryerjen e oponencës teknike për të gjitha objektet publike. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

3. Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

Nga verifikimi i kritereve te vendosura (edhe në shtojcën nr. 1) u konstatua se:

- Në pikën 2. *Licensa profesionale e shoqërisë, e vlefshme është kërkuar në kundërshtim me VKM nr.42 date 116.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” në të cilën për N.S-19 Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë përcaktohet” Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër mirëmbajtja dhe verifikimi akustik I objektit për zhurmën me origjine rrugore, hekurudhore, të barrerave metalike betonarme, dru xham, ose material plastik transparent, të mureve dopio, të mureve poroze ose të tullave poroze, gjithashtu edhe të veshjeve zë izoluese të pareteve të terrenit ose tuneleve.*

- Sa i përket kësaj pike ne procesverbal është bere argumentimi gjithashtu ju informojmë se në preventivin fillestar (bashkëngjitur) ka zera qe i përkasin kësaj kategorie të licences. Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja ne vepër mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën me origjine rrugore, hekurudhore, të barrerave metalike betonarme, dru xham, ose material plastik transparent, të mureve dopio, **të mureve poroze ose të tullave poroze, gjithashtu edhe të veshjeve zeizoluese të pareteve të terrenit** ose tuneleve.

Opiniononi i Grupit të auditimit

Në aktkonstatimin nr. 15 dhe në Projektraport është cituar që ky kriter nuk është në propocion me natyrën e objektit që prokurohet. Edhe në citimin që ju i keni bërë përcaktimit ligjor të NP-19, evidentohet qartë ky zë pune. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

- *Është kërkuar qe OE ofertues të disponoje licencë QKL III.2.B “Grumbullim, Transportim, ruajtjeje, e mbetjeve urbane” e cila nuk është e argumentuar teknikisht.*

- Sa i përket kësaj pike në procesverbal është bërë argumentimi gjithashtu ju informojmë se legjislacioni për prokurimet bashkëvepron dhe zbaton gjithashtu dhe detyrimet e percaktuara në përgjithësi nga legjislacioni shqiptar psh në fushën e sigurimeve shoqërore, tatim taksave etj. Ne rastin konkret operatorët ekonomike janë të detyruar të zbatojnë legjislacionin që rregullon menaxhimin e mbetjeve (në këtë rast ndërtimorë) duke patur parasysh se në preventivin fillestar parashikohen zera prishjeje e transport i tyre. Kështu në baze te ligjit 10463 date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar si dhe VKM nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuara, “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”. Në Vendimin nr.99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, shtojca 1, përfshirë vetëm mbetjet jo të rrezikshme 17 05 04 Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03. 17 09 04 Mbetje të përziera nga ndërtimet dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03. Po këtu , në pikën “e” parashikohet se mbetjet jo të

rrezikshme të grumbullohen, transportohen dhe transferohen në bazë të rregullave të VKM nr. 229, datë 23.4.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit.

Opinion i Grupit të auditimit

Në aktkonstatimin nr. 15 dhe në Projektraport është cituar që ky kriter nuk është i justifikuar teknikisht. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

• *Është kërkuar që ofertuesi duhet të ketë jo me pak se 90 punonjës për periudhën gusht 2020-Janar 2021. Konstatohet se gjatë llogaritjeve të orëve të punës janë marre gabim orët e punës së transportit. Nga rillogaritja e bërë për orët e punës sipas preventivit prej 18692, reduktohen në 14000 ore pune, për të cilat duhen 58 punonjës. Pas observacioneve, grupi i auditimit nuk ka marrë në konsideratë observacionin tonë. Sa i përket kësaj pike ju informojmë se në procesverbalin e argumentimit të kërkesave për kualifikim janë përcaktuar përlllogaritjet për nr. e orëve dhe për rrjedhojë dhe të punonjësve në total dhe në vijim të monitorimit të Agjencisë së Prokurimit Publik për çdo procedure nga ku rezulton seduhën 89.2 punonjë (bashkëlidhur tabela e llogaritjes së punonjësve (4 faqe).*

Opinion i Grupit të auditimit

Në aktkonstatimin nr. 15 është cituar që ky kriter nuk është vendosur në bazë të llogaritjeve të sakta të orëve të punës, pasi grupi i punës ka llogaritur gabim orët e punës së transportit, duke vendosur orët e punës për njësi, sa largësia në km e transportit (transport 3 km, me 3 op/km). Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë

4. Në piken 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 4 inxhinierë të ndryshëm të jenë në licence dhe të punësuar për periudhën Gusht 2020 - Janar 2021, si dhe staf mbështetës 2 inxhinierë të tjerë, 6 teknike të tjerë të ndryshëm, 2 specialiste montues tubash HDPE, 2 buldozërist, një auditues energjie, 2 specialiste zjarrfikës, 2 inspektore cilësie me background inxhinierik. Këto kriterë janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet. Pas observacioneve, grupi i auditimit nuk ka marrë në konsideratë observacionin tonë.

Sa i përket kësaj pike ne ju informojmë se në procesverbalin e argumentimit të kërkesave për kualifikim janë përcaktuar:

Kategoria e kërkuar	Nevoja për kategorinë përkatëse
Inxhinier Ndërtimi 1 (një)	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune të domosdoshme për tu ndjekur nga inxhinieri i ndërtimit përsa i përket volumit të përgjithshëm të parashikuar në preventiv.
Inxhinier elektrik 1 (një)	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete punë të domosdoshme për tu ndjekur nga inxhinieri i ndërtimit përsa i përket volumit të përgjithshëm të parashikuar në preventiv e përkatësisht në zërat V/1 – V16
Inxhinier hidroteknik 1 (një)	Në preventivin fillestar përcaktohen volume punë për tu ndjekur nga inxhinieri topograf e përkatësisht në zërat : IA/13, IB/3, IB/6, IIA/6 etj.
Inxhinier topograf 1 (një)	Në fazën e pare të zbatimit të punimeve Operatori ekonomik fitues bënë piketimin e themelit nëpërmjet zbatimit, verifikimit dhe implementimit të topografisë sipas projektit fillestar dhe konstatimit të faktit. Autoriteti kontraktor është i interesuar në qëllimin e tij final për realizimin me sukses të punimeve objekt prokurimi dhe për këtë arsye kërkesat për kualifikim shërbejnë si një garanci për arritjen e këtij qëllimi.
2 Inxhinier ndërtimi Staf shoqëruar me kontrate pune e Diplome	Afati i punimeve relativisht i shkurtër 30 dite kërkon angazhimin e personelit të kualifikuar e ne disa pika të ndryshme, kjo pasi rrugët janë 3 e jo të gjitha në të njëjtën Njësi Administrative. Të nevojshëm në të gjithë zërat e preventivit.
2 (dy) Inspektor Cilësie me background Inxhinierik me mbi 5 vite eksperience pune si Inspektor Cilësie në përputhje me standartin ISO 9001:2015.	Specifika e objektit në fjale kur kemi të bëjmë jo vetëm me sistemim asfaltim rrugësh por dhe me punime në linjën KUZ dhe dekantojë kërkon një vete administrim të operatorit ekonomik sa i përket cilësisë së punimeve në përputhje me standartin ISO 9001:2015.

2 (dy) specialist ekspert zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin	Në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”. Objektet janë 3 dhe në largësi nga njëra njësi në tjetrën.
1 (një) auditues energjie	Është një detyrim i përcaktuar nga ligji nr. 124/2015 Për eficienten e energjisë
2 (dy) buldozëriste	Ne zërat I/A/2,4 , II/A2,4
2 (dy) specialiste montim tubash hdpe	Ne zërat I/B 6,7
2 Teknike Elektriçist 2 Teknike mekanik 2 Teknik ndërtimi	Për zërat I/B 6,7,8,9,10,11,12,13,14 Për Zërat II/B dhe II/C Për të gjitha zërat e ndërtimit

Opinionit i Grupit të auditimit

Në aktkonstatimin nr. 15 dhe në Projektraport është cituar që ky kriter nuk është i justifikuar teknikisht, pasi numri i stafit është më i madh se ai i duhuri. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

5.Certifikata e kërkuara PASS 99, nuk është në përpjesëtim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

Sa i përket kësaj pike të kërkesave në procesverbalin e miratimit të DST është përcaktuar se **BS PAS 99:2012 Sistemi i Integruar i menaxhimit është**: Përcakton specifikimet e disponueshme publikisht për integrimin e sistemeve të përbashkëta të menaxhimit, të cilat janë dizajnuar për të përmirësuar mënyrën e funksionimit të bizneseve që mund të kenë strukturë të ngjashme. Është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Kjo certifikatë është në tërësinë e saj sistemi a Ai është menduar kryesisht për përdorim nga organizatat që zbatojnë kërkesat e dy ose më shumë standardeve të sistemit të menaxhimit si ISO 9001, ISO 14001, ISO/IEC 27001, ISO 22000, ISO/IEC 20000 dhe ISO 45001.

Opinionit i Grupit të auditimit

Në aktkonstatimin nr. 15 dhe në Projektraport është cituar që ky kriter nuk është i justifikuar teknikisht. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

6.Është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar "Mjekun e shoqërisë", e vertetuar kjo me kontrate pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, diploma, license ushtrim profesioni. Ky kriter është i paargumentuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

Sa i përket kësaj kërkesë në procesverbal është bërë argumentimi gjithashtu ju informojmë se një kërkesë e tillë është vendosur në baze të VKM nr.692, dt.13.12.2001, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë” i ndryshuar me VKM Nr. 742, dt.06.11.2003“Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë” gjithashtu duam tju informojmë se në shtojcën e hartuar nga AK për ndryshimin e kërkesave për kualifikim është vendosur se mund të sigurohej një shërbim i tillë mjekësor ose me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Opinionit i Grupit të auditimit

Në aktkonstatimin nr. 15 dhe në Projektraport është cituar që ky kriter nuk është i justifikuar teknikisht. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

7.Janë kërkuar makineri për skarifikim asfalti, 3 pompa suvatimi, 500 m2 skela dhe rrjeta mbrojtëse, vinc kareke, termometër për matje tokëzimi, të cilat, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

Sa i përket kësaj pike ju informojmë se mjetet e makineritë e mësipërme përdoren sipas zerave të mëposhtëm:

I		A. Punime ne Trupin e Rrugës			Mjete
2	3.110/b	Germim dheu me makineri (95%e sasisë totale	m3	990	<i>makineri për skarifikim asfalti</i>
B. Punime për ndriçimin rrugor					0
8	3.An/53	F.V shtylla metalike për ndriçim, H=7m, d=160mm	cope	14	Termometër për matje tokëzimi
9	3.an /ksh	F.V.krah shtylle metalike KRH-MSI 1500/1500/10	cope	14	Termometër për matje tokëzimi
10	3.An	F.V.Ndriçues Smart VP CL1 CR M-S 250Ë GG FAE 44004 me llampe 50A let	cope	14	Termometër për matje tokëzimi
11	3.an.et	Elektroda tokezimi te zinkuara 50x3L=1.5m	cope	14	Termometër për matje tokëzimi
12	2.481/2	F.V Percjelles PV -500 3x2.5mm	cope	112	Termometër për matje tokëzimi
13	4.133/25+4.149/6	Percjelles 4x6mm per linjen kryesore te energjise elektrikeFV.Kabell J-H(ST)H 4*0.6mm²	ml	380	Termometër për matje tokëzimi
14	2.481/5	Përcjellës Cu 1x10mm për tokëzimin e shtyllës	ml	14	Termometër për matje tokëzimi
15	2.489	Automat 10 A ne shtylle	cope	14	Termometër për matje tokëzimi
II. Rikonstruksioni i rruges "Sinanallareve" fshati Gostime, Bashkia Cërrik					0
A.Punime ne Trupin e Rrugës					0
2	3.110/b	Germim dheu me makineri (95%e sasise totale	m3	600	<i>makineri per skarifikim asfalti</i>
Shuma A					0
B.Punime per linjen KUZ					0
2	3.110/b	Germim dheu me makineri (95%e sasise totale	m3	160	<i>makineri per skarifikim asfalti</i>
4	2.553	F.V tuba betoni Ø 300 mm ne shtrese zhavori 15cm	ml	120	Vinc Karrele, pompa suvatimi, skela suvatimi
5	2.554	F.V tuba betoni Ø 400 mm ne shtrese zhavori 15cm	ml	320	Vinc Karrele, pompa suvatimi, skela suvatimi
6	An1	Puseta me mure betoni e kapak gize 1X1x1	cope	9	Vinc Karrele, pompa suvatimi, skela suvatimi
7	An2	Puse kontrolli 1x1x1.5m me mure betoni kapak betoni	cope	3	Vinc Karrele, pompa suvatimi, skela suvatimi
8	An 3	Puse kontrolli 1x1x2.0m me mure betoni kapak gize(cope	5	Vinc Karrele, pompa suvatimi, skela suvatimi
C.Dekantori me permasa 600mX410m					0
1	3.101/a	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne toke	m³	116	Vinc Karrele, pompa suvatimi, skela suvatimi
2	3.25/b	Germim me krahe seksion detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak.	m³	10	Vinc Karrele, pompa suvatimi, skela suvatimi
3	2.258	Shtrese zhavori t=10cm	m²	5.4	Vinc Karrele, pompa suvatimi, skela suvatimi
4	2.262/4	N/Shtrese betoni C16/20	m3	2.65	Vinc Karrele, pompa suvatimi, skela suvatimi
5	3/An-9	Mbushje me zhavor natyror	m³	37	Vinc Karrele, pompa suvatimi, skela suvatimi
6	3.243	Strukture monolite betoni C16/20 (per dekantuesin)	m3	27.6	Vinc Karrele, pompa suvatimi, skela suvatimi
7	3.287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	kg	1502	Vinc Karrele, pompa suvatimi, skela suvatimi
8	3.288	F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm	ton	36	Vinc Karrele, pompa suvatimi, skela suvatimi
Shuma C					0

Gjithashtu dhe rrjeta mbrojtëse është e nevojshme për të kufizuar punimet në kantier. Përsa me sipër kërkojmë nga ana juaj ndryshimin e gjetjeve në këtë pjesë të akt konstatimit.

Opinionimi i Grupit të auditimit

Opinionimi i Grupit të auditimit

Në aktkonstatimin nr. 15 dhe në Projektraport është cituar që ky kriter nuk është i justifikuar teknikisht, bazuar në preventivin e punimeve, pasi nisur edhe nga tabela e hartuar nga ana juaj për llojet e makineri/pajisjeve për zëra të ndryshëm pune, duket qartë që janë vendosur pajisje jo në propocion me zërat e punës (psh. për “FV shtylla metalike për ndriçim” duhet termometri!!!, për “gërmimet” duhet skarifikuesja e asfaltit, ndërkohë që gërmimet bëhen me ekskavator, pasi hiqen të gjitha shtresat asfaltike, për “hedhjen e shtresës së zhavorrit” duhen vinçi karrelë, pompa suvatimi, skela suvatimi!!!, etj.. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

Mbi vlerësimin e ofertave

1. Për skualifikimin e OE “B.N” & "B.B" SHPK, ju informojmë se ne rastin e skualifikimit të këtij BOE ne gjykojmë se duke qenë se operatori ekonomik ka paraqitur kërkesë tërheqje për arsye të ndryshme siç mund të jetë angazhimi në një procedurë tjetër çka e bën të pamundur realizimin e procedurës ku ka ofertuar për shkak të mungesës së kapacitetit teknik, pranë autoritetit tone kontraktor Bashkia Cërrrik dhe duke qenë se legjislacioni për prokurimin Publik nuk e parashikon tërheqjen nga procedura e prokurimit në fazën e vlerësimit të ofertave kjo situatë rregullohet me ligjin nr. 44/2015 ”Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili në nenin 94 ”Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1, parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”. Komisioni ka gjykuar se, operatori ekonomik është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga procedura objekt vlerësimi duke argumentuar veprimet e kryera për kërkesën në procesverbalin përkatës pjesë e procedurës, që sjell si pasojë shqyrtimin/vlerësimin e ofertes së tij nga AK. Heqja dorë nga pjesëmarrja në procedure nga operatorët ekonomik sjell si rrjedhojë përfundimin e vlerësimit pa një vendim përfundimtar për ofertën e paraqitur në këtë procedure. Gjithashtu theksojmë se komisioni i vlerësimit të ofertave në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga OE sa i përket garancisë së realizimit të objektit shqyrton nëse ky OE ka mjetet apo stafin apo të tjera kapacitete të nevojshme për realizimin e objektit dhe në rastin konkret një dokument me firmë dhe vule nga ana e BOE ku theksohet tërheqja për shkak të angazhimit në kontrata të tjera është një prove shumë bindëse për KVO për të skualifikuar subjektin përkatës.

2. Sa i përket pikës së kualifikimit të BOE fitues "G.T" SHPK & "E-A" SHPK, ju informojmë se:

- OE G.T sipas kërkesave për kualifikim ka detyrimin të plotesoje sipas pikës 2.3.1/a ... kontrata punë të ngjashme sipas përqindjes së pjesëmarrjes në BOE.

- OE ka paraqitur kontratë të realizuar në masën 6,678,480 lekë, pra duke përmbushur xhiron e kërkuar. (vertetur me dokumentacionin bashkëngjitur)

- Sa i përket lejes së ndërtimit në eksperiencën e ngjashme ju informojmë se pas monitorimit të Agjencisë së Prokurimit Publik për këtë procedure ku theksohej se *kërkesa për paraqitjen e Lejes së ndërtimit, janë të panevojshme dhe nuk i shërben AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve* është bërë modifikimi me ane të shtojcës ku pjesa e lejes së ndërtimit nuk ishte me në kërkesat për kualifikim.

- E-A sh.p.k. nuk ka patur nipt sekondar në momentin e konkurimit në këtë procedure prokurimi në Sarandë.

Gjithashtu theksojmë se në baze të nenit 53 Shqyrtimi i ofertave të LPP pika 4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

Në vijim të komenteve tona dhe duke patur bindje në mirëkuptimin tuaj kërkohet ndryshimin e kësaj pjese të gjetjeve të akt konstatimeve të mbajtuara nga Kontrolli i Larte i Shtetit në date 03.03.2023.

Opinionit i Grupit të auditimit

Përsa i përket vlerësimit të ofertave, ju sqarojmë se:

- siç e keni vërtetuar edhe ju me dokumentet shoqëruese të observacionit (vërtetimi i xhiros së tre viteve të fundit, datë 29.03.2021 nga DRT Elbasan), nuk plotësohet kriteri i xhiros mesatare vjetore

- Kundërshtia që keni paraqitur në lidje me lejen e ndërtimit, APP ka argumentuar vetëm për punët publike dhe jo për ato jopublike, siç është rasti i eksperiencës së paraqitur nga OR “G – T”.

- Mungesa e NIPT-it sekondar, nuk e pengon KVO-në që të gjykojë në lidhje me domosdoshmërinë e pajisjes me të, në rast se punohet në një bashki që OE nuk është rezident,

- Devijimet e vogla duhen argumentuar pse quhen të tilla dhe duhen evidentuar në Raportin Përmbledhës të prokurimit.

Sa sipër, pretendimet e ardhura nëpërmjet observacionit, nuk merren në konsideratë.

II. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim i rruges Kamunah”

Pretendimi i subjektit:

2. Sa i përket oponencës teknike, ju informojmë se në baze të ligjit 107/2014 neni 3 pika 20 Ndërtim është çdo objekt që ndërtohet ose instalohet në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme dhe që zhvillohet nën dhe/ose mbi tokë.

Opinionit i Grupit të auditimit

Në aktkonstatimin nr. 15 dhe në Projektraport është cituar referenca ligjore që citon kryerjen e oponencës teknike për të gjitha objektet publike. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

2. Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 3 inxhinierë të ndryshëm të jenë me licence dhe të punësuar për periudhën Korrik 2020 - Janar 2021, si dhe staf mbështetës 2 teknike të tjerë ndërtimi. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi nuk është në përpjesëtim me volumin e punimeve në objektin që prokurohet. Sa i përket kësaj pike në procesverbal është bërë argumentimi gjithashtu ju informojmë si me poshtë:

Kategoria e kërkuar	Nevoja për kategorinë përkatëse
Inxhinier Ndërtimi 1 (një)	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune të domosdoshme për tu ndjekur nga inxhinieri i ndërtimit përsa i përket volumit të përgjithshëm të parashikuar në preventiv.
Inxhinier elektrik 1 (një)	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete punë të domosdoshme për tu ndjekur nga inxhinieri i ndërtimit përsa i përket volumit të përgjithshëm të parashikuar në preventiv e përkatësisht në zërat V/1 – V16

Inxhinier gjeodet/topograf/markshajder 1(një)	Në fazen e pare të zbatimit të punimeve Operatori ekonomik fitues bën piktimin e themelit nëpërmjet zbatimit, verifikimit dhe implementimit të topografisë sipas projektit fillestar dhe konstatimit të faktit. Autoriteti kontraktor është i interesuar në qëllimin e tij final për realizimin me sukses të punimeve objekt prokurimi dhe për këtë arsye kërkesat për kualifikim shërbejnë si një garanci për arritjen e këtij qëllimi.
2 (dy) teknike ndërtimi	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune të domosdoshme për tu ndjekur nga teknikat e ndërtimit përsa i përket volumit të përgjithshëm të parashikuar në preventiv.

1. Është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar "Mjekun e shoqërisë", e vërtetuar kjo me Kontrate pune të vlefshme brenda periudhës se realizimit të kontratës, diploma, licencë ushtrim profesioni. Ky kriter është i paargumentuar, për pasojë nuk duhet vendosur në KVK.

Duke qene se grupi i auditimit nuk e ka marre ne konsiderate argumentimin tone ju infomoje se ky kriter eshte vendosur ne perputhje me ligjin Nr.10 237, datë 18.2.2010 “ PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË”, i ndryshuar e specifikisht nenenin 23 i cili parashikon se : Neni 23 Shërbimi mjekësor i punës 1. Çdo punëdhënës i një subjekti publik apo privat, vendas apo i huaj, është i detyruar të mbulojë me shërbim mjekësor, nëpërmjet mjekut të punës, të përshtatshëm për rreziqet që paraqet vendi i punës. 2. Kontrolli i shëndetit, në varësi të numrit të punëmarrësve dhe të natyrës së punës, është i organizuar në: a) shërbim mjekësor në punë, i vlefshëm për degët/filialet në varësi; b) shërbim mjekësor në punë, ndërsujektor. 15 3. Mënyra e funksionimit të shërbimit mjekësor në punë, përfshirë normat, rregullat dhe procedurat për të siguruar kontrollin mjekësor të pranimit në punë dhe ato periodike për punëmarrësin, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Gjithashtu duam tju informojme se ne shtojcen e hartuar nga AK per ndryshimin e kerkesave per kualifikim është vendosur se mund të sigurohej një shërbim i tillë mjekësor ose me anë te marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

2. Janë kërkuar pajisje/makineri si kontejner Stacioner (zyre në objekt), e cila, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjesëtim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

- Sa i përket kësaj pike ju informojmë se Kontenieri Stacioner (zyre në objekt) është pjese e planit të organizimit të kantierit të ndërtimit i cili për specifikën dhe kërkesat kërkon ndër të tjera dhe zyrën në objekt.

4. Është kërkuar Fabrike asfaltobetonit, me distance jo me shume se 60 km nga objekti që prokurohet në zbatim të VKM nr. 628 date 15.07.2015, ose fabrike mobilje të lëvizshme, e cila nuk është e argumentuar teknikisht.

- Është kërkuar për shkak të kushteve teknike të asfaltobetonit si dhe sasite e medha që kërkohet të asfaltohen e afatin e shkurtër dhe si pjese e zerave të preventivave si me poshtë:

3	3.222/1	Shtrese binderi me granil gur kave,5cm,me makineri	m2	5660.00
4	3.224/1	Shtrese asfaltobetonit me granil guri kave, 3cm, me makineri	m2	5660.00

Opinionimi i Grupit të auditimit

Përsa pretendoni në këtë pikë të observacionit, grupi i auditimit sqaron si më poshtë:

- Kërkesa për dy teknikë ndërtimi pas kërkesës për tre inxhinierë dhe për mjekun, nuk është në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet. Përsa i takon mjekut, këto mund të jenë detyrime ligjore, por nuk janë në përpjestim me natyrën e objektit që prokurohet. Për analogji, subjektet duhet të mbyllin bilancet nga kontabilistë të miratuar. Pse nuk kërkohet në DT që të ketë në staf edhe kontabilistin?!!

- Kërkesa për kontenierin (zyrë) është e pakuptimtë, pasi nuk detyrohet OE të ketë zyrë provizore, pasi për pajisjen me një zyrë të tillë, duhet të kishit kërkuar edhe truallin për vendosjen e tij, si dhe lejen e ndërtimit.

- Për kriterin e distancës së FAB, grupi i auditimit sqaron se hedhja në vepër e asfaltit është pjesë e mbikëqyrjes së punimeve, e cila kontrollon temperaturën e asfaltit para hedhjes në vepër. OE mund të ketë mjete specifike për transportin e asfaltit, që ruajnë temperaturën e tij.

Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

1. Sa i përket skualifikimit të OE "B.N", ju informojmë se ky OE ka paraqitur kërkesë tërheqje për shkak të personelit të reduktuar si pasojë e pandemisë çka e bën të pamundur realizimin e procedurës ku ka ofertuar për shkak të mungesës së kapacitetit teknik, pranë autoritetit tone kontraktor Bashkia Cërrik dhe duke qënë se legjislacioni për prokurimin Publik nuk e parashikon tërheqjen nga procedura e prokurimit në fazën e vlerësimit të ofertave kjo situatë rregullohet me ligjin nr.44/2015 "Kodi i procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i cili në nenin 94 "Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës", pika 1, parashikon se: "Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë". Komisioni ka gjykuar se, operatori ekonomik është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga procedura objekt vlerësimi duke argumentuar veprimet e kryera për kërkesën në procesverbalin përkatës pjesë e procedurës, që sjell si pasojë shqyrtimin/vlerësimin e ofertës së tij nga AK. Heqja dorë nga pjesëmarrja në procedure nga operatorët ekonomik sjell si rrjedhojë përfundimin e vlerësimit pa një vendim përfundimtar për ofertën e paraqitur në këtë procedure. Gjithashtu theksojmë se komisioni i vlerësimit të ofertave në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga OE sa i përket garancisë së realizimit të objektit shqyrton nëse ky OE ka mjetet apo stafin apo të tjera kapacitete të nevojshme për realizimin e objektit dhe në rastin konkret një dokument me firme dhe vule nga ana e BOE ku theksohet tërheqja për shkak të angazhimit në kontrata të tjera është një prove shumë bindëse për KVO për të skualifikuar subjektin përkatës.

Opinionimi i Grupit të auditimit

Përsa pretendoni në këtë pikë të observacionit, grupi i auditimit sqaron si më poshtë:

1. OE "B.N" SHPK nuk duhet të ishte skualifikuar në atë fazë të vlerësimit të ofertave, nëse do të kishte dokumentacionin e rregullt (siç është cituar edhe në Aktkonstatim). Përsa sipër ky pretendim nuk merret në konsideratë.

III. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndertim ujesjellesi per fshatrat Linas, Kamunah mollas dhe Dasar, Nja Mollas, Bashkia Cërrik "

Pretendimi i subjektit:

1. Sa i përket pikës së kriterit për licencën profesionale, ju informojmë se percaktimi i volumeve është bërë për një objekt me volume të larta i cili kërkon operatore ekonomike të kualifikuar për realizimin e objektit sipas kërkesave si me poshtë:

Kategoria e kërkuar	Nevoja për kategorinë përkatëse
N.P. – 1D Punime Germimi në Toke	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete punë për këtë kategori, të tilla si gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.
N.P. 4 – C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune për këtë kategori në sistemimin e shesheve, gjithashtu dhe në mbarevajtjen e punesve në kuader të minimizimit të dëmeve të ndikimit në mjedis gjatë kryerjes së punimeve si lëvizja e makinerive, depozitimi i mbetjeve, mirë përdorimi i materialeve të dëmshme për mjedisin etj.
N.P. 5 – C Punime nëntokësore, ura e vepra arti	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune për këtë kategori e përkatësisht në zërat AI/2, AI/3, AI/4, AI/5, AI/6, AI/7, AI/8, AI/9 etj.
N.P. 9 – D Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.	Në fazën e parë të zbatimit të punimeve Operatori ekonomik fitues bën piketimin e themelit nëpërmjet zbatimit, verifikimit dhe implementimit të topografisë sipas projektit fillestar dhe konstatimit të faktit. Autoriteti kontraktor është i interesuar në qëllimin e tij final për realizimin me sukses të punimeve objekt prokurimi dhe për këtë arsye kërkesat për kualifikim shërbejnë si një garanci për arritjen e këtij qëllimi.
N.P. 10 – B Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune për këtë kategori e përkatësisht në zërat I/c3/1-14, I/c4/1 etj.
N.P. 11 - C Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformatorëve, etj.	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune për këtë kategori e përkatësisht në zërat
N.P. 12 – E Punime të inxhinierisë së mjedisit	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune për këtë kategori e përkatësisht në zërat II/a/1, II/a/2 etj.
N.S. 1 – B Punime për prishjen e ndërtimeve.	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune për këtë kategori e përkatësisht në zërat IV/a/1 IV/a/2, IV/a/3 etj.
N.S. 4 – D Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me infrastrukture druri, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune për këtë kategori e përkatësisht në zërat I/b/4, I/b/10 etj
N.S. 8 – D Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune për këtë kategori e përkatësisht në zërat Ib/8, Ib/9, Iib.5, Iib/7 etj.
N.S. 9 – D Punime strukturorë speciale	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune për këtë kategori e përkatësisht në zërat Ib/2, Iib/5, Iig/3, IV/a/2/5 etj.
N.S. 10 – E Shtresa dhe mbistruktura speciale	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune për këtë kategori e përkatësisht në zërat Ib/3, Ib/7, Ib/18 etj
N.S. 19 – C Sistemet kundër zhurmes për infrastrukture	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune duke përfshirë ndërtimin e depove puseve me materiale sipas kërkesave të kësaj pike

Opinionit i Grupit të auditimit

Përsa pretendoni në këtë pikë të observacionit, grupi i auditimit sqaron si më poshtë:

Në observacion nuk janë vendosur vlerat sipas kategorive të licencës, të cilat nga ana jonë janë llogaritur, duke arritur në konkluzionin e të mosqenit në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e këtij objekti. Përsa sipër, ky observacion nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit

3. Sa i përket pikës për stafin teknik, ju informojmë si më poshtë vijon:

Kategoria e kërkuar	Nevoja për kategorinë përkatëse
inxhinier Ndërtimi	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune të domosdoshme për tu ndjekur nga inxhinieri i ndërtimit përsa i përket volumit të përgjithshëm të parashikuar në preventiv.
1(një) inxhinier mekanik	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune për këtë kategori, për tu ndjekur nga inxhinieri mekanik.
1(një) inxhinier Topograf	Në fazën e parë të zbatimit të punimeve Operatori ekonomik fitues bën piketimin e themelit nëpërmjet zbatimit, verifikimit dhe implementimit të topografisë sipas projektit fillestar dhe konstatimit të faktit. Autoriteti kontraktor është i interesuar në qëllimin e tij final për

Inxhinier Hidroteknik	realizimin me sukses te punimeve objekt prokurimi dhe për këtë arsye kërkesat për kualifikim shërbejnë si një garanci për arritjen e këtij qëllimi. Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune të domosdoshme për tu ndjekur nga inxhinieri hidroteknik përsa i përket volumit të përgjithshëm të parashikuar në preventiv
Inxhinier Ndërtimi, profili Strukturist Inxhinier Elektrik Inxhinier Elektronik Arkitekt Inxhinier HidroGjeolog Inxhinier Mjedis	Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune të domosdoshme për tu ndjekur nga inxhinieri i ndërtimit strukturist përsa i përket volumit të përgjithshëm të parashikuar në preventiv Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune të domosdoshme për tu ndjekur nga inxhinieri elektrik përsa i përket volumit të përgjithshëm të parashikuar në preventiv Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune të domosdoshme për tu ndjekur nga inxhinieri elektronik përsa i përket volumit të përgjithshëm të parashikuar në preventiv. Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune për këtë kategori e përkatësisht në. Në fushën e ndërtimeve civile (si në rastin konkret) roli i arkitektit është gjithnjë e me i rëndësishëm jo vetëm në rolin e projekteve të ndërtimeve civile por sidomos në përpunimin e projekteve të prokuruar dhe ndjekjen e këtyre punimeve në përshtatje të projektit. Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune të domosdoshme për tu ndjekur nga inxhinieri hidrogeologjik përsa i përket volumit të përgjithshëm të parashikuar në preventiv Në preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune të domosdoshme për tu ndjekur nga inxhinieri i mjedisit duke qene se objekti i prokurimit ndodhet mes fshatrash .
<i>Restaurator i pajisur me licence profesionale personale lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit</i>	Zona është nder zonat tradicionale si në pjesën ndërtimore të saj me shtepi guri e rrugica me pllaka guri por dhe një zone me kala të njohur në mesjete. Në rast problematikash OE duhet të marre masa për restaurime të menjëhershme.
<i>një inxhinier me certifikatën e audituesit të energisë "Eficienca e energjisë në ndërtesa"</i>	Në baze të VKM nr. 407 date 19.06.2019 si dhe ligjit 124/2015 "Për evidencën e energjisë"
<i>Një inxhinier ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe një inxhinier me certifikatën e trajnimit "Përgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve në mjedis"</i>	Në baze të ligjit nr.10341 date 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

Opinion i Grupit të auditimit

Përsa pretendoni në këtë pikë të observacionit, grupi i auditimit sqaron si më poshtë:

Këto kriteret janë tërësisht të pabazuara në LPP, pasi nuk janë në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet. Për analogji, pse nuk është kërkuar një restaurator në procedurën e prokurimit me objekt "Sistemim asfaltim i rrugës Kamunah", që ndodhet në të njëjtën zonë?! Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Prendimi i subjektit

3. Është observuar në lidhje me kriteret për mjekun e shoqërisë, Certifikatat ISO, Licencat nga QKL për lejet mjedisore, për mbetjet urbane, ekspertizë për kullotat etj.

Opinion i Grupit të auditimit

Të gjitha këto pretendime nuk merren në konsideratë, pasi nuk është sjellë asnjë argumentim shtesë për kundërshtimin e argumenteve të evidentuar në Projektraport.

Prendimi i subjektit

4. Sa i përket makineri pajisjeve të konsideruara nga ana e grupit të auditimit si të tepërta, ju informojmë si me poshtë vijon

Pompe suvatimi	Kjo pajisje do të shërbejë për suvatimin e pusetave. E konkretisht në zërat I/B/14, I/B/15, I/B/16 etj.
Kontenier për zyra	Realizimi i objektit të prokurimit do të zgjasë 60 dite , kontenier stacioner është i nevojshëm

Sharre asfalti/betoni	Nevojitet për prerjen e asfaltit në ato pjese rruge të mbetura me asfalt si në intersektime në rruge nacionale dhe rurale etj.
Eskavator/Vinc krah gjat mbi 30 m, aftësi mbajtëse mbi 40 ton	Në preventivin fillestar të punimeve që kanë nevojë për prezencën e vincit me krahë të gjatë për gërmimin e kanaleve e përkatësisht në zërat I/b/1, I/b/1 punime rrethimi. Etj. Terreni i ndërtimit të ujësjellësit ka sisteme elektrike e hidrike të cilat në shume raste nuk e lejojnë lëvizshmërinë deri në objekt ndaj një mjeti i tillë është i domosdoshëm.

Opinionit i Grupit të auditimit

Përsa pretendoni në këtë pikë të observacionit, grupi i auditimit sqaron si më poshtë: Komunikimi ndërmjet nesh duhet të mbështet në argumente ligjorë dhe profesionale. Të kundërshtosh gjetjen e grupi të auditimit që 2 pompa suvatimi nuk janë të nevojshme, me pretendimin që këto mjete duhen për të suvatuar pusetat, është absurde dhe aspak profesionale. Përsa sipër dhe për argumentet e dhëna në aktkonstatim, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit

5. Përsa i përket kriterit skualifikues për vizitën në kantier, ju informojmë se zëri Tubo HDPE. PE100 zë një sasi të konsiderueshme në preventivin fillestar të hartuar nga autoriteti kontraktar. Kërkesa për paraqitjen e mostrave në këtë zë nuk ka asnjë pengese ligjore në Kohen kur vlerësohet si një investim strategjik për AK dhe qëllimi i vendosjes së kriterëve është garantimi i realizimit me sukses të procedurës së prokurimit dhe të objektit

Opinionit i Grupit të auditimit

Përsa pretendoni në këtë pikë të observacionit, grupi i auditimit sqaron si më poshtë: Siç shihet edhe nga pretendimi juaj, ka mungesë argumenti, pasi nga ana e grupit të auditimit është konsideruar si i pabazuar cilësimi i kriterit si “skualifikues” dhe informacionet që do të jepen gjatë vizitës në kantier. Vendosja e një kriteri të tillë, dekonspiron pjesëmarrësit në këtë procedurë dhe mbart riskun e marrëveshjeve të fshehta ndërmjet OE të interesuar për pjesëmarrje. Përsa i përket materialeve që do të përdoren, ato mund të kërkohen para lidhjes së kontratës dhe gjatë zbatimit të objektit certifikohen nga Mbikëqyrësi i punimeve, konform specifikimeve teknike të hedhura në SPE. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit

6. Mbi vlerësimin e ofertave

Gjithashtu, nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të BOE fitues "V-K" SHPK & "F." SHPK & "E-A" SHPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

1.OE “V.K" SHPK, për bashkitë e deklaruara në Shtojcën nr. 11 "Deklarate mbi kontratat e lidhura ose në Proces", si Shijak, Vlorë, Durrës, Lushnjë, Konispol, Berat, Vorë, Cërrik, Elbasan, referuar ligjit 9920, date 19.05.2008 i ndryshuar, "Për procedurat tatimore, pika 1/1 ku citohet: "Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, te ndryshme nga selia, në çdo rast bëhet përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikate me numër unik identifikimi të njëjte me atë të regjistrimit, por me numër serial e ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia", OE duhet të ishte pajisur me certifikate dhe të regjistrohej në QKB e për pasojë i është

shmangur detyrimeve tatimore vendore në bashkitë e mësipërme. Përsa me lart OE nuk e ka plotësuar detyrimin për shlyerjen e taksave vendore.

- Sa i përket kësaj pike ju informojmë se OE "V.K" SHPK ka paraqitur vërtetim të taksave vendore për: Bashkinë Gramsh, Bashkinë Vore, Bashkia Tirane, Bashkia Shkodër për rastet e mos regjistrimit në QKB kontratat e deklaruara mund të kene qene në nisje të tyre dhe procedurat e regjistrimit mund të jenë në proces.

2.Po kështu edhe OE "E-A" SHPK për Bashkitë Berat, Lushnjë, Konispol, Sarandë, Gramsh, Durrës, Maliq, Shijak nuk ka bërë regjistrimin në QKB dhe nuk ka paguar taksat në Bashkitë e mësipërme.

- Sa i përket kësaj pike ju informojmë se OE "E-A" SHPK ka paraqitur vërtetim të taksave vendore për: Bashkinë Kamëz, Bashkinë Bulqize, Bashkia Tiranë, Bashkia Durrës, Bashkia Shijak, Bashkia Maliq, Bashkia Vorë, për rastet e mos regjistrimit në QKB kontratat e deklaruara mund të kene qene në nisje të tyre dhe procedurat e regjistrimit mund të jenë në proces.

3.Nga verifikimi në SPE u konstatua gjithashtu, se objektet e paraqitura në SPE si eksperience e ngjashme nga shoqëria "E.A" SHPK, nuk plotësojnë kriterin e vendosur në DT për eksperiencat e ngjashme.

- Sa i përket kësaj pike në baze të Marrëveshjes së bashkimit të Operatoreve ekonomik "E-A" sh.p.k. & V.K sh.p.k. & F. sh.p.k. OE "E-A" sh.p.k. ka marre përsipër 30% të bashkëpunimit në shoqëri duke mos qene OE me përqindjen me të madhe në BOE por OE me i vogël i saj. Në këtë akt marrëveshje përcaktohet gjithashtu punët konkrete për secilin OE. Në rastin konkret për të provuar eksperiencën e ngjashme OE "E-A" sh.p.k. ka paraqitur rreth 17 kontrata të ngjashme në pajtim me punimet që ka marre përsipër në BOE. Kujtojmë se OE minoritare në BOE plotësojnë përqindjen e 50% të punimeve sipas përqindjes së pjesëmarrjes por jo me një kontratë të vetme, pra këta OE nuk e kane detyrimin e OE mazhoritar.

Gjithashtu theksojmë se në bazë të nenit 53 Shqyrtimi i ofertave të LPP pika 4. *Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.*

Opinionit i Grupit të auditimit

Përsa pretendoni në këtë pikë të observacionit, grupi i auditimit sqaron si më poshtë:

- Regjistrimi në QKB për NIPT sekondar bëhen menjëherë me lidhjen e kontratës dhe konkluzioni ynë ka dalë pasi është parë në dokumentet e paraqitura ky fakt.

- Përsa i përket pretendimit tuaj mbi eksperiencën e ngjashme të OE "E.A" SHPK, mjafton të analizojmë Formularin e Vlerësimit nga Drejtorja e Ujitjes dhe Kullimit në Durrës për objektin "Kanali Ujitës Ndroq Çallik", dhe kontratën për këtë objekt (dokumentet shoqëruese të observacionit), ku dallohet qartë që ky OE në lidhjen e kontratës është pjesë e një BOE, ndërsa në formular rezulton që të ketë kryer 100% të punimeve. KVO duhet të kishte ushtruar skepticizmin profesional në lidhje me këtë diskordancë dhe të kishte bërë sqarimin e saj. E njëjta situatë është edhe me dokumentacionin shoqërues të observacionit, në lidhje me objektin "Mbrotje nga lumi Drini i Zi, fshati Brezhdan" dhe objektin "Rindërtim i shkollës 9 vjeçare "Muhamet Dollaku" Shijak.

Përsa sipër, këto pretendime nuk merren në konsideratë.

IV. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitim./perforcim banesash ekzistuese”.

Pretendimi i subjektit

1. Janë sjellë të njëjtat pretendime si në 3 procedurat e mësipërme për licencën QKL III.2. B, numrin e punonjësve dhe stafin, certifikatat ISO, Mjekun e shoqërisë dhe makineritë.

Opinionit i Grupit të auditimit

Përsa pretendohet sa sipër, grupi i auditimit ka bërë sqarimet respektive në aktkonstatim e Projektraport dhe në tre objektet e mësipërme. Sa sipër ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit

2. Në lidhje me kualifikimin e OE fitues "Z." SHPK, ju informojmë se OE ka paraqitur vërtetimet e taksave vendore sipas selisë dhe nipteve sekondare.

Në vend të inxhinierit topograf, është paraqitur oficer topograf (N.Z).

Në lidhje me këtë pike ju informojmë se OS ka paraqitur kontratën noteriale të punës numër repertori 670 date 22.02.2020 e shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Drejtuesja teknike A.C (në licence personale Është A.C (K.), e cila është zotëruese e licencës profesionale MK Nr. 0685/1, është njëkohësisht edhe Drejtuese Teknike e Shoqërisë Aksionere Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë, me Vendimin Nr.45, datë 13.06.2018 të Komisionit Kombëtar Rregullator, pranë Entit Rregullator të Sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura. Për pasojë edhe ky OE duhet të ishte skualifikuar.

Në lidhje me këtë pike ju informojmë se OS ka paraqitur kontratën noteriale të punës numër kol 665 date 10.03.2017 e shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Gjithashtu theksojmë se ne baze të nenit 53 Shqyrtimi i ofertave të LPP pika 4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

Opinionit i Grupit të auditimit

Përsa pretendohet nga observuesit, grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e mësipërm pas verifikimeve në SPE. Bashkëlidhur këtij observacioni, nuk silllet asnjë dokument shtesë për vërtetimin e pagesës së taksave vendore në Bashkinë Prrrenjas.

Dy gjetjet e tjera (oficeri topograf dhe e dy punësuara znj.A.K) nuk janë kundërshtuar nga observuesit me dokumentacion shoqëruar

Për sa sipër, këto pretendime nuk merren në konsideratë.

V. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Capallareve dhe vreshtit, fshati Shalës”

Pretendimi i subjektit

1. Janë sjellë të njëjtat pretendime si në procedurat e mësipërme për licencën QKL III.2. B, numrin e punonjësve dhe stafin dhe makineritë.

Opiniononi i Grupit të auditimit

Përsa pretendohet sa sipër, grupi i auditimit ka bërë sqarimet respektive në aktkonstatim dhe në tre objektet e mësipërme. Sa sipër këto pretendime nuk merren në konsideratë.

Pretendimi i subjektit

Vlerësimi i ofertave

2. Nisur nga eksperiencat e ngjashme të paraqitura në sistem: "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme dhe rurale" Bashkia Cërrik, e cila është realizuar në vitin 2019 dhe "Rikonstruksion i rrugës fshati "Cekin" Bashkia Gramsh, e cila është realizuar në vitin 2020, konstatohet se nga ana e OE "Z." SHPK nuk është paraqitur vërtetimi për shlyerjen e taksave vendore përkatësisht në Bashkinë Cërrik dhe Bashkinë Gramsh. Gjithashtu, referuar ligjit 9920, date 19.05.2008 i ndryshuar, "Për procedurat tatimore", pika 1/1 ku citohet: "Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhet përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikate me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshem. Kjo certifikate leshohet për të identifikuar vendodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia", OE duhet të ishte pajisur me certifikate dhe të regjistrohej në QKB e për pasoje i është shmangur detyrimeve tatimore vendore në bashkitë e mësipërme. Përsa me lart, OE nuk e ka plotësuar detyrimin për shlyerjen e taksave vendore.

- Përsa i përket kësaj pike ju informojmë se OE ka paraqitur shlyerjen e taksave vendore për Shkodër dhe Lushnjë.

Gjithashtu theksojmë se në baze të nenit 53 Shqyrtimi i ofertave të LPP pika 4. *Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.*

Opiniononi i Grupit të auditimit

Përsa sipër, grupi i auditimit sqaron se nga observuesit nuk është kundërshtuar ajo çka është gjetur nga grupi i auditimit. Ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

Në Bashkinë Cërrik, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizua regjistri i investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, është përzgjedhur për auditim në bazë të vlerës së kontratës objekti:

Nr	Objekti	Vlera e kontratës	Kontraktori	Shenime
1	"Sistemim Asfaltim rruga Kamunah	33,820,544.4	OE "V.H" SHPK	Me shkelje
2	"Rikonstruksion i rrugës Qyrkan"	26,092,473.6	OE "V.H" SHPK	Me shkelje
3	Rehabilitimi i kanaleve vaditës	40,786,652.4	BOE "M" SHPK & "Sh." ShPK	Me shkelje
4	Rikonstruksion rruga e Liçaj	23,934,289	OE "A" SHPK	Me shkelje

5	Sistemim asfaltim i tre rrugëve	29,637,769	BOE "G.T" & "E.A" SHPK	Me shkelje
6	Rikonstruksion objekti 2k dhe ndryshim destinacioni nga magazinë në banesa sociale	13,634,256	OE "Z."SHPK	Me shkelje
7	Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar, NjA Mollas	337,342,218	BOE "V.K" SHPK & "F" SHPK & "E.A" SHPK	Me shkelje

1. "Sistemim Asfaltim rruga Kamunah", Bashkia Cërrrik)

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1343 prot datë 15.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrrik, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z.A.S dhe Operatorit Ekonomik "V.H" SHPK me përfaqësues Z.B.H, me licencë profesionale NZ 3938/18. Vlera e kontratës është 33,820,544.4 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 20 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës. Me shkresën e mbikëqyrësit të punimeve, me nr. 3800 prot., datë 31.08.2021 është kërkuar pezullimi i punimeve deri në zgjidhjen e problemeve të dala nga interferimi i punimeve me objektin e furnizimit me ujë. Pas kësaj kërkesë është nxjerrë Urdhri i titullarit të Bashkisë Z.A.S, nr. 1534 prot., datë 06.05.2021, për pezullimin e punimeve. Me Urdhrin nr 9802 prot., datë 31.08 të titullarit të Bashkisë Cërrrik, është urdhëruar rifillimi i punimeve. Pas këtij Urdhri, është hartuar amendamenti i kontratës me nr. 3801 prot, datë 31.08.2021, i cili bën shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve deri në datën 03.09.2021.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1303/1 prot, datë 15.04.2021, është lidhur kontrata me ing. P.M PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0004/1 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 117,600 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas Kontratës me nr. 1157/1 prot., datë 28.04.2021, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi L. PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 00068/3, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 60,000 lekë me TVSH.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në zbatim të Urdhrit të TAK me nr. 4405/2 prot., datë 30.10.2021, nga grupi i punës me përbërje ing. F.U, teknik H.A dhe ing. A.D, është hartuar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 31.10.2021.

Projekt preventivi

- Për këtë objekt, nuk administrohet në dosje Leje Infrastrukurore. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" Neni 39, "Leja e ndërtimit" sipas të cilit "1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.

2.Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqërues të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3.Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat "e" dhe "ë", të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit." dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë Cërrrik Z.A.S, mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Cërrik, Z.A.S.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria “Z&C” SHPK në vitin 2020 dhe është miratuar nga Bashkia Cërrik.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 19.04.2021 dhe kanë përfunduar me datë 03.09.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve pa nr. prot., datë 01.09.2021, sipërmarrësi i punimeve “V.H” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “Z.” SHPK dhe titullari i Bashkisë Cërrik, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 23,908,885 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 23,088,387 lekë pa TVSH, duke përdorur edhe fondin rezervë në vlerën prej 820,887 lekë pa TVSH. Kjo ka ndodhur për shkak të marrjes në konsideratë të mureve ekzistues (mbajtes/pritës) dhe shtresave ekzistuese. Më pas është bërë shtesë prej 600 ml në gjatësinë e rrugës (është realizuar 1900 ml nga 1300 ml sipas projektit bazë), duke bërë edhe ndryshimin e shtresave (zhavorr 15 cm + stabilizant 10 cm me stabilizant 15 cm, binder 5 cm + tapet 3 cm me binder mix 6 cm, stabilizant për bankina 8 cm me stabilizant 6 cm).

Nga auditimi i preventivit të ripunuar, konstatohet se janë shtuar 5 zëra të rinj pune. Në dosjen teknike nuk administrohet asnjë dokument për negociimin e këtyre zërave të rinj pune, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 15.02.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu UU, pika 8.3. Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Mbikëqyrësi i punimeve.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemim Asfaltim rruga Kamunah”, Bashkia Cërrik				
14.Lidhja e kontratës Nr. 1343 prot datë 15.04.2021	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 33,820,544.4 lekë OE fitues “V.H” ShPK		16.Likuiduar deri dt	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 23,934,289 lekë -Vlera pa tvsh 19,945,241 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 20 ditë , Zbatuar 276 ditë. Fillimi punimeve: 21.07.2020 Përfundimi punimeve : 37.03.2021		19. Zgjatja e kontratës Amendamenti nr 3801 prot, datë 31.08.2021, shtyrje deri në datën 03.09.2021	
20. Mbikëqyrësi i punimeve Ing. P. M. PF	Licenca Nr: MK 0004/1	Kontrata me nr 1303/1 prot, datë 15.04.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve Ing. L. K. PF	Licenca Nr: MK 0068/3	Kontrata nr. 1157/1 prot., datë 28.04.2021	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 28.10.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim nr. 1651/4 prot., datë 31.10.2021		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **102,316 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes 39: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Sistemim Asfaltim rruga Kamunah”, Bashkia Cërrik, nga zbatuesi i punimeve BOE “V.H” SHPK, për zërat e punimeve IV.3, dhe VI.1.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “FV bordura betoni 150x 30” dhe “Shtresë stabilizanti t=6 cm”, etj, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1343 prot datë 15.04.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1303/1 prot, datë 15.04.2021.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 1157/1 prot., datë 28.04.2021.

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Cërrik.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

Rëndësia: E ulët

Rekomandime: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 102,316 lekë pa tvsh nga OE “V.H” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1343 prot datë 15.04.2021, me objekt “Sistemim Asfaltim rruga Kamunah”, Bashkia Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera. Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 102,316 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj. P.M me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

2. Znj. L.K me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

2. “Rikonstruksion i rrugës Qyrkan”, Bashkia Cërrik.

Kontratata

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1834 prot datë 14.07.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. A.S dhe Operatorit Ekonomik “V.H” SHPK me përfaqësues Z.B.H, me licencë profesionale NZ 3938/18. Vlera e kontratës është 26,092,473.6 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 30 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës. Me shkresën e mbikëqyrësit të punimeve, pa nr. prot., datë 31.07.2020 është kërkuar pezullimi i punimeve deri

në zgjidhjen e problemeve të dala me banorët e zonës. Pas kësaj kërkesë është nxjerrë Urdhri i titullarit të Bashkisë Z.A.S, nr. 936 prot., datë 31.07.2020, për pezullimin e punimeve. Me Urdhrin nr. 936/1 prot., datë 10.03.2021 të titullarit të Bashkisë Cërrik, është urdhëruar rifillimi i punimeve. Pas këtij Urdhri, është hartuar amendamenti i kontratës pa nr. prot, datë 10.03.2021, i cili bën shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve deri në datën 27.03.2021.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1835 prot, datë 14.07.2020, është lidhur kontrata me OE “Z.” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3360/2 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 382,744.8 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas Kontratës me nr. 1157/1 prot., datë 28.04.2021, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi ing. P.M PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0004/1, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 30,000 lekë me TVSH.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në zbatim të Urdhrit të TAK me nr. 1651/3 prot., datë 12.07.2021, nga grupi i punës me përbërje ing. F.U, teknik H.A dhe teknik SH.L, është hartuar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 13.05.2021.

Projekt preventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje Infrastrukturore me nr. 222, datë 20.07.2020. Ky veprim është në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” Neni 39, “Leja e ndërtimit”.

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik**”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Cërrik, Z.A.S.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria “Z.” SHPK në vitin 2020 dhe është miratuar nga Bashkia Cërrik.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 21.07.2020 dhe kanë përfunduar me datë 27.03.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve pa nr. prot., datë 15.03.2021, sipërmarrësi i punimeve “V.H” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “Z.” SHPK dhe titullari i Bashkisë Cërrik, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 2,201,129 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 2,201,129 lekë pa TVSH. Janë negociuar 4 zëra të rinj pune.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstrukcion i rrugës Qyrkan”, Bashkia Cërrik		
14.Lidhja e kontratës Nr. 1834 prot datë 14.07.2020	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 26,092,473.6 lekë OE fitues “V.H” SHPK	16.Likuiduar deri dt.
17- Situacioni Përfundimtar	18.Afati i kontratës në dite	19. Zgjatja e kontratës

-Vlera me tvsh 23,934,289 lekë -Vlera pa tvsh 19,945,241 lekë	Parashikuar 30 ditë , Zbatuar 276 ditë. Fillimi punimeve: 21.07.2020 Përfundimi punimeve : 37.03.2021	Amendamenti pa nr. prot, datë 10.03.2021, shtyrje deri në datën 27.03.2021		
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “Z.” SHPK	Licenca Nr.: MK 3429	Kontrata me nr. 1835 prot, datë 14.07.2020	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve Ing. P.M PF	Licenca Nr.: MK 0004/1	Kontrata nr. 1157/1 prot., datë 28.04.2021	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 03.05.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim nr. 1651/4 prot., datë 13.05.2021	24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)		

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **271,632 lekë pa tvsh.**

Titulli i Gjetjes 39: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion i rrugës Qyrkan”, Bashkia Cërrrik, nga zbatuesi i punimeve OE “V.H” SHPK, për zërat e punimeve I.A. 7+8, I.B, II.B 6+7+8, II.D.4 dhe III.A.9.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “FV bordura betoni 150x 30”, “Beton C16/20 për fiksimin e bordurave”, “Punime për ndriçimin rrugor”, “Puseta me mure betoni”, “Shtresë binderi 6 cm”, “Beton C16/20 për veshjen e tubave të betoni”, etj, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1834 prot datë 14.07.2020.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1835 prot, datë 14.07.2020.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 1157/1 prot., datë 28.04.2021.

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Cërrrik.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit.

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Nga Bashkia Cërrrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 271,632 lekë pa tvsh nga OE “V.H” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1390 prot datë 20.04.2021, me objekt “Rikonstruksion i rrugës Qyrkan”, Bashkia Cërrrik, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 271,632 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. L.H me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. P.M me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

3. “Rehabilitimi i kanaleve vaditës”, Bashkia Cërrik.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2661 prot datë 08.10.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z.A.S dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “M.” SHPK, me përfaqësues Z.E.B, me licencë profesionale NZ 6803/6 & “SH.” SHPK me përfaqësues Z.Y.B me licencë profesionale NZ 3580/17. Vlera e kontratës është 40,786,652.4 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 30 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës. Në dosjen teknike administrohet një njoftim për rifillim punimesh me datë 09.02.2021, në të cilin citohet që është hartuar një amendament kontrate për shtyrje të afatit të punimeve, i cili nuk administrohet në dosjen teknike.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2664 prot, datë 09.10.2020, është lidhur kontrata me OE “A.MK” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3360/2 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 872,634.4 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi shoqërinë “XH & M” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1322/8, Në dosje nuk administrohet kontrata për shërbimin e kolaudimit.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, nga grupi i punës me përbërje ing. Ç.SH., teknik topograf H.A dhe teknik SH.B, është hartuar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 21.04.2021.

Projekt preventivi

- Për këtë objekt, nuk administrohet në dosje Leje Infrastrukturore. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” Neni 39, “Leja e ndërtimit” sipas të cilit “1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.

2.Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqëruar të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3.Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat “e” dhe “ë”, të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit.” dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë Cërrik Z.A.S, mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga ing.N.M në vitin 2020 dhe nuk rezulton të jetë miratuar nga Bashkia Cërrik. Projekti i zbatimit nuk është i plotë. Në vizatime (Planimetri, prerje tërthore, profil gjatësor) mungojnë referencat (numrat) e kanaleve, duke mbartur riskun për krijimin e vështirësive në zbatimin e projektit. Relacioni teknik është shumë i cunguar, pasi përbëhet nga 32 rreshta narrativ gjithsej, një planimetri jo e plotë e kanaleve dhe një seksion tip të kanalit. Gjendja ekzistuese është përshkruar me 6 rreshta dhe nuk të jep mundësi të gjykosh mbi saktësinë e preventivit të punimeve. Specifikimet teknike kanë vetëm titullin për objektin në auditim dhe duket si set tip, i marrë nga objekte të tjera (rrugë), pasi në to gjenden specifikime për zëra pune si

tombino me D=80 cm, mure pritës drenazhues, kuneta e bordura betoni, mure mbajtës e pritës, zgjerime të urave ekzistuese, etj., të cilat nuk figurojnë në preventivin e punimeve. Nisur edhe nga fakti që ka patur ndryshime në projekt në 37.5% të vlerës totale të objektit, tregon që projekti nuk është hartuar sipas azhurnimit të gjendjes faktike dhe mbart riskun që të manipulohet gjatë zbatimit të punimeve. Për veprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi projektuesi dhe marrësi në dorëzim i projektit.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 09.10.2020 dhe kanë përfunduar me datë 27.02.2021.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve pa nr. prot., datë 11.01.2021, sipërmarrësi i punimeve “M.” SHPK & “SH.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “A.M” SHPK dhe titullari i Bashkisë Cërrik, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 12,753,494 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 11,414,305 lekë pa TVSH, duke përdorur edhe fondin rezervë prej 1,607,028 lekë me TVSH. Është bërë negociimi i tre zërave të rinj pune, me procesverbalin pa datë të nënshkruar nga mbikëqyrësi, sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i Investitorit, të cilat, nga auditimi, rezultojnë të jenë miratuar sipas manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi. Nga verifikimi në terren të objektit, rezultoi se ky objekt, edhe pse i është bërë marrja e përkohshme në dorëzim, nuk ka mirëmbajtjen e duhur. Bimësia në një gjatësi të konsiderueshme kishte bërë bllokimin total të kanalit, duke e nxjerrë jashtë funksionit.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rehabilitimi i kanaleve vaditës”, Bashkia Cërrik				
14.Lidhja e kontratës Nr. 2661 prot datë 08.10.2020	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 40,786,652.4 lekë BOE fitues “M.” SHPK & “SH.” SHPK		16.Likuiduar deri dt	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 23,934,289 lekë -Vlera pa tvsh 19,945,241 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 30 ditë , Zbatuar 30 ditë. Fillimi punimeve: 31.12.2020 Përfundimi punimeve : 30.01.2021		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “A.M” SHPK	Licenca Nr: MK 2892/3	Kontrata me nr 2664 prot, datë 09.10.2020	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve “Xh & M” ShPK	Licenca Nr: MK 1322/8	Kontrata nr. 473/1prot., datë 10.02.2021	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 17.03.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim pa nr prot., datë 21.04.2021		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **104,610 lekë pa tvsh.**

Titulli i Gjetjes 39: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rehabilitimi i kanaleve vaditës”, Bashkia Cërrik, nga zbatuesi i punimeve BOE “M.” SHPK & “SH.” SHPK, për zërat e punimeve K-5.5 dhe K-16.1+3.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Shtresë zhavorr lumi t=10 cm” dhe “Gërmim dhe me ekskavator + transport deri në 5 km”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2661 prot datë 08.10.2020.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2664 prot, datë 09.10.2020.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 473/1prot., datë 10.02.2021.

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Cërrik.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit.

Rëndësia: E ulët

Rekomandime: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 104,610 lekë pa tvsh nga BOE “M.” SHPK & “SH.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2661 prot datë 08.10.2020, me objekt “Rehabilitimi i kanaleve vaditës”, Bashkia Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 104,610 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. E.M me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. XH.D me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

4. “Rikonstruksion rruga e Liçaj”, Bashkia Cërrik.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 3720 prot datë 31.12.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z.A.S dhe Operatorit Ekonomik “A.” SHPK, me përfaqësues Z.S.A., me licencë profesionale NZ 6757/2. Vlera e kontratës është 23,934,289 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 30 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 3722 prot, datë 31.12.2020, është lidhur kontrata me OE “Z.” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3360/2 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 117,600 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas Kontratës me nr. 473/1prot., datë 10.02.2021, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi ing. L.K. PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0068/3, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 30,219 lekë me TVSH.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, nga grupi i punës me përbërje ing. F.U, teknik H.A dhe teknik SH.L, është hartuar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim me nr. 473/2 prot., datë 03.03.2021.

Projekt preventivi

- Për këtë objekt, nuk administrohet në dosje Leje Infrastrukurore. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” Neni 39, “Leja e ndërtimit” sipas të cilit “*1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.*

2.Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqëruar të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3.Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat “e” dhe “ë”, të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit.” dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë Cërrik Z.A.S, mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Cërrik, Z.A.S.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria “Z.” SHPK në vitin 2020 dhe është miratuar nga Bashkia Cërrik.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 31.12.2020 dhe kanë përfunduar me datë 30.01.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve pa nr. prot., datë 11.01.2021, sipërmarrësi i punimeve “A..” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “Z.” SHPK dhe titullari i Bashkisë Cërrik, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 3,742,958 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 3,742,958 lekë pa TVSH. Është bërë negociimi i tre zërave të rinj pune, me procesverbalin pa datë të nënshkruar nga mbikëqyrësi, sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i Investitorit, të cilat, nga auditimi, rezultojnë të jenë miratuar sipas manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,

2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion rruga e Liçaj”, Bashkia Cërrik				
14. Lidhja e kontratës Nr. 3720 prot datë 31.12.2020	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 23,934,289 lekë BOE fitues “A..” SHPK		16. Likuiduar deri dt	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 23,934,289 lekë -Vlera pa tvsh 19,945,241 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 30 ditë , Zbatuar 30 ditë. Fillimi punimeve: 31.12.2020 Përfundimi punimeve : 30.01.2021		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “Z.” SHPK	Licenca Nr: MK 3360/2	Kontrata me nr 3722 prot, datë 31.12.2020	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve Ing. L.K.PF	Licenca Nr: MK 0068/3	Kontrata nr. 473/1prot., datë 10.02.2021	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22. Akt Kolaudimi Datë 01.03.2021	23. Akt i marrjes në dorëzim nr. 473/2 prot., datë 03.03.2021		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **129,152 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes 39: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion rruga e Liçaj”, Bashkia Cërrik, nga zbatuesi i punimeve OE “A.” SHPK, për zërat e punimeve VII 6+7 dhe XII.2+7.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “FV hekur betoni periodik”, “Beton C16/20 për veshjen e kanalit të ujërve të shiut” dhe “Beton C16/20 për veshjen e tubave të betoni”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3720 prot datë 31.12.2020.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3722 prot, datë 31.12.2020.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 473/1prot., datë 10.02.2021.

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Cërrik.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

Rëndësia: E ulët

Rekomandime: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 129,152 lekë pa tvsh nga OE “A..” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3720 prot datë 31.12.2020, me objekt “Rikonstruksion rruga e Liçaj”, *Bashkia Cërrik*, vlerë kjo e cila përfaqëson

një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 129,152 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. L.H me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. L.K me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

5. “Sistemim asfaltim i tre rrugëve”, Bashkia Cërrik.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1390 prot datë 20.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. A.S dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “G.T” SHPK, me përfaqësues Znj.D.Ç, me licencë profesionale NZ 7987 & “E-A” SHPK me përfaqësues Z.B.M, me licencë profesionale NZ 3279/15. Vlera e kontratës është 29,637,769 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 30 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1390/1 prot, datë 20.04.2021, është lidhur kontrata me OE “F.S” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3429 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 117,600 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas Kontratës me nr. 165/2 prot., datë 5.05.2021, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi ing. P.M PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0004/1, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 30,000 lekë me TVSH.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në zbatim të Urdhrit të TAK me nr. 1651/3 prot., datë 12.07.2021, nga grupi i punës me përbërje ing. F.U, teknik H.A dhe teknik SH.L, është hartuar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim me nr. 1651/4 prot., datë 15.07.2021.

Projekt preventivi

- Për këtë objekt, nuk administrohet në dosje Leje Infrastrukturore. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” Neni 39, “Leja e ndërtimit” sipas të cilit “1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.

2.Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqëruar të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3.Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat “e” dhe “ë”, të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit.” dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë Cërrik Z.A.S, mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e

ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Cërrik, Z.A.S.**

- Projekti i zbatimit është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Zhvillimit dhe Aplikimit të Projekteve në Shkurt 2021 dhe është miratuar nga Bashkia Cërrik.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 20.04.2021 dhe kanë përfunduar me datë 20.05.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas verifikimit të objektit, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, sipërmarrësi i punimeve "G.T" SHPK & "E-A" SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "F." SHPK dhe titullari i Bashkisë Cërrik, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 1,188,873 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 470,067 lekë pa TVSH, dhe përdorimin e fondit rezervë prej 718,807 lekë pa tvsh.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Sistemim asfaltim i tre rrugëve", Bashkia Cërrik				
14.Lidhja e kontratës Nr. 1390 prot datë 20.04.2021	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 29,637,769 lekë BOE fitues "G.T" SHPK & "E-A" SHPK		16.Likuiduar deri dt	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 23,934,289 lekë -Vlera pa tvsh 19,945,241 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 30 ditë , Zbatuar 30 ditë. Fillimi punimeve: 31.12.2020 Përfundimi punimeve : 30.01.2021		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "F." SHPK	Licenca Nr: MK 3429	Kontrata me nr 1390/1 prot, datë 20.04.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve Ing. P.M PF	Licenca Nr: MK 0004/1	Kontrata nr. 165/2 prot., datë 25.05.2021	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 28.05.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim nr. 1651/4 prot., datë 15.07.2021		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **369,779 lekë pa tvsh.**

Titulli i Gjetjes 39: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Sistemim asfaltim i tre rrugëve", Bashkia Cërrik, nga zbatuesi i punimeve BOE "GT" SHPK & "E-A" SHPK, për zërat e punimeve I.A. 7, I.B, II.D.4, III.A.9 dhe III.B.6.1.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës "FV bordura betoni 150x 30", "Punime për ndriçimin rrugor", "FV tub metalik 500 mm x 8 mm, çmimi", "Shtresë binderi 6 cm", "Vijëzimi shirita gjatësorë", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfutur padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1390 prot datë 20.04.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1390/1 prot, datë 20.04.2021.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 165/2 prot., datë 25.05.2021.

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Cërrik.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 369,779 lekë pa tvsh nga BOE “GT” SHPK & “E-A” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1390 prot datë 20.04.2021, me objekt “Sistemim asfaltim i tre rrugëve”, *Bashkia Cërrik*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 369,779 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. S.B me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. P.M me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Lidhur me objektin e mësipërm, në dosjen me observacione të përcjella në KLSH me shkresën nr. 1032/1, datë 17.05.2023, protololluar në KLSH me nr.1174/5, datë 23.05.2023, janë paraqitur dokumentet, si më poshtë:

1. Urdhër nr. 158, datë 17.05.2023 “Për ngritje komisioni për verifikim punimesh” e personit të autorizuar nga Kryetari i Bashkisë Z.T.Z;
2. Procesverbal konstatimi për kryerjen e këtyre punimeve, i shoqëruar me foto;
3. Shkresa e Kryetarit të Bashkisë Z.A.S për konfirmimin e punimeve.


Nga analizimi i këtij dokumentacioni, grupi i auditimit merr në konsideratë punimet si vijon:

- “Punime për ndriçimin rrugor” në rrugën “Ali Pashë Tepelena”, e konstatuar në aktkonstatimet e grupit të auditimit dhe të komisionit të Bashkisë Cërrik, në vlerën 601,623 lekë;
- “Shtresë binderi me granil” në “Rrugën e Lumit”, e konstatuar në aktkonstatimin e mbajtur nga komisioni i Bashkisë Cërrik me sipërfaqe totale 1169 m², me vlerë të situacionuar 1,547,700 lekë.

Nga sa sipër, punimet e marra në konsideratë janë në vlerën 2,149,323 lekë, ndërsa dëmi ekonomik, që rezulton nga diferenca e volumeve në zërat e mbetur të pakryera, bëhet 369,779 lekë.









6. “Rikonstruksion objekti 2k dhe ndryshim destinacioni nga magazinë në banesa sociale”, Bashkia Cërrik.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2416 prot datë 16.09.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z.A.S dhe Operatorit Ekonomik “Z.” SHPK, me përfaqësues Z.D.S, me licencë profesionale NZ 5900/5. Vlera e kontratës është 13,634,256 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 45 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës. Në dosje administrohet një kërkesë me dt. 19.09.2020 të mbikëqyrësit të punimeve për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve, për shkak të problemeve të pronësisë në pjesën ballore të objektit. Amendament Kontrate nr. 1612/1, datë 05.10.2020, me shtyrje afatit të përfundimit të punimeve me 63 ditë kalendarike.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2421 prot, datë 16.09.2020, është lidhur kontrata me ing. N.M PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0992/3 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 118,800 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas Kontratës me nr. 220/1 prot., datë 08.01.2021, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria “G.. C” ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2829/9, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 48,000 lekë me TVSH.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në zbatim të Urdhrit të TAK me nr. 21/1, datë 22.02.2021, nga grupi i punës me përbërje ing. F.U, teknik H.A dhe teknik SH.L, është hartuar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr prot., datë 26.02.2021.

Projekt preventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje ndërtimi me nr. 240, datë 20.11.2020, ose 64 ditë më vonë se fillimi i punimeve. Ky veprim është në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” Neni 39, “Leja e ndërtimit”.

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin

e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Cërrik, Z.A.S.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria “A M” SHPK në vitin.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 16.09.2020 dhe kanë përfunduar me datë 01.01.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve, sipërmarrësi i punimeve “Z.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve ing. N.M dhe titullari i Bashkisë Cërrik, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar proceberbalin datë 24.12.2020 për ndryshim volumesh, me punime që shtohen prej 530,450 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 530,450 lekë pa TVSH. Është bërë negociimi i dy zërave të rinj pune, me procesverbalin datë 24.12.2020, të nënshkruar nga mbikëqyrësi, sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i Investitorit, të cilat, nga auditimi, rezultojnë të jenë miratuar sipas manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditari të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion objekti 2k dhe ndryshim destinacioni nga magazinë në banesa sociale”, Bashkia Cërrik				
14.Lidhja e kontratës Nr. 2416 prot datë 16.09.2020	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 13,634,256 lekë OE fitues “Z.” SHPK		16.Likuiduar deri dt	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 13,634,255 lekë -Vlera pa tvsh 11,361,879 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 45 ditë , Zbatuar 106 ditë. Fillimi punimeve: 16.09.2020 Përfundimi punimeve : 01.01.2021		19. Zgjatja e kontratës Amendament nr 1612/1, datë 05.10.2020, me shtyrje 63 ditë	
20. Mbikëqyrësi i punimeve Ing. N. M. PF	Licenca Nr: MK 0992/3	Kontrata me nr 2421 prot, datë 16.09.2020	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve “G. C” ShPK	Licenca Nr: MK 2829/9	Kontrata nr. 220/1 prot., datë 08.01.2021	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 10.02.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim nr. 473/2 prot., datë 26.02.2021		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **113,360 lekë pa tvsh.**

Titulli i Gjetjes 39: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion objekti 2k dhe ndryshim destinacioni nga magazinë në banesa sociale”, Bashkia Cërrik, nga zbatuesi i punimeve OE “Z.” SHPK, për zërat e punimeve VII 6+7 dhe XII.2+7.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “FV hekur betoni periodik”, “Beton C16/20 për veshjen e kanalit të ujërve të shiut” dhe “Beton C16/20 për veshjen e tubave të betoni”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2416 prot datë 16.09.2020.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2421 prot, datë 16.09.2020.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 220/1 prot., datë 08.01.2021.

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Cërrrik.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit.

Rëndësia: E ulët

Rekomandime: Nga Bashkia Cërrrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 113,360 lekë pa tvsh nga OE “Z.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3720 prot datë 31.12.2020, me objekt “Rikonstruksion objekti 2k dhe ndryshim destinacioni nga magazinë në banesa sociale”, Bashkia Cërrrik, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 113,360 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj. N.M. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

2. Z. L.H me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

7. “Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar, NjA Mollas”, Bashkia Cërrrik.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2816 prot datë 21.10.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrrik, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z.A.S dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “V.K” SHPK, me përfaqësues Z.Gj.B, me licencë profesionale NZ 4933/11 & “F.” SHPK me përfaqësues Z.SH.F me licencë profesionale NZ 1163/15, & “E-A” SHPK me përfaqësues Z.B.M, me licencë profesionale NZ 3279/15. Vlera e kontratës është 337,342,218 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 365 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2750 prot, datë 15.10.2020, është lidhur kontrata me OE “Z & C” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1208/13 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 3,479,978.4 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas Kontratës me nr. 2146 prot., datë 08.07.2022, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi shoqërinë “F.” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3429/1, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 636,307 lekë me TVSH.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, nga grupi i punës me përbërje ing. F.U, teknik topograf H.A dhe E.B, është hartuar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 04.08.2022.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, nuk administrohet në dosje Leje Infrastrukurore. Në dosje administrohet vetëm leja e zhvillimit me nr. 238, datë 18.11.2020, ose rreth 1 muaj pas fillimit të punimeve, Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” Neni 39, “Leja e ndërtimit” sipas të cilit “1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.

2.Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqëruar të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3.Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat “e” dhe “ë”, të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit.” dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë Cërrrik Z.A.S, mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria “Z & C” në vitin 2020.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 09.10.2020 dhe kanë përfunduar me datë 27.02.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve, sipërmarrësi i punimeve “V.K” SHPK & “F.” SHPK & “E.A” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “Z & C” SHPK dhe titullari i Bashkisë Cërrrik, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 62,010,637 lekë me TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 46,137,765 lekë me TVSH, duke përdorur edhe fondin rezervë prej 13,195,228 lekë me TVSH.

Me shkresën nr. 4121 prot, datë 29.09.2021 është njoftuar nga mbikëqyrësi për pezullimin e punimeve për shkak të problemeve me kuotat e projektit, linjën e energjisë nga OSHEE, intersektimet me rrugën, etj. Kjo kërkesë është miratuar nga Investitori dhe është materializuar me Amendamentin nr. 1, datë 30.09.2021, sipas të cilit punimet do të rifillojnë në datën 16.05.2022 dhe do të përfundojnë në datën 06.06.2022.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rehabilitimi i kanaleve vaditës”, Bashkia Cërrrik		
14.Lidhja e kontratës Nr. 2816 prot datë 21.10.2020	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 40,786,652.4 lekë BOE fitues “V. K” SHPK & “F.” SHPK & “E A” SHPK	16.Likuiduar deri dt
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 23,934,289 lekë -Vlera pa tvsh 19,945,241 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 30 ditë , Zbatuar 30 ditë. Fillimi punimeve: 31.12.2020 Përfundimi punimeve : 30.01.2021	19. Zgjatja e kontratës Amendament nr. 1, datë 30.09.2021, zgjatja e afatit deri në dt. 06.06.2022

20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “Z & C” SHPK	Licenca Nr: MK 1208/13	Kontrata me nr 2750 prot, datë 15.10.2020	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve “F.” ShPK	Licenca Nr: MK 3429/1	Kontrata nr. 2146 prot., datë 08.07.2022	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 12.07.2022	23.Akt i marrjes në dorëzim pa nr prot., datë 04.08.2022		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **369,280 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes 39: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar, NjA Mollas”, Bashkia Cërrik, nga zbatuesi i punimeve BOE “V.K” SHPK & “F.” SHPK & “E.A” SHPK, për zërat e punimeve III.a.2 dhe III.b.2..

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Gërmim dheu me ekskavator në kanale me gjerësi deri në 2 m, tokë e zakonshme me shkarkim në tokë” dhe “FV tuba çeliku DN 200 mm, t=7.04 mm”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2816 prot datë 21.10.2020.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2750 prot, datë 15.10.2020.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 2146 prot., datë 08.07.2022.

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Cërrik.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit.

Rëndësia: E ulët

Rekomandime: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 369,280 lekë pa tvsh nga BOE “V.K” SHPK & “F.” ShPK & “E.A” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2816 prot datë 21.10.2020, me objekt “Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar, NjA Mollas”, Bashkia Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 369,280 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. A.P me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. S.B me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Këshilli Kombëtar i Territorit në përputhje me ligjin nr. 107/2017, datë 31.07.2014 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Bashkia Cërrik me Vendim të Këshillit të Bashkisë me Vendim nr.150, datë 29.12.2016 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT-së). Ky Plan mbulon Territorin e Bashkisë Cërrik me sipërfaqe 19.48km², ku përfshihen pesë Njësi Administrative. Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë së bashku me tarifatat që aplikohen në aplikimet që kryhen në sistemin e-leje, janë të përcaktuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, në paketën fiskale vjetore, përkatësisht: **-VKB Nr.338/1 datë 20/12/2019 për vitin 2020 dhe VKB Nr. 83 datë 28.12.2021 për vitin 2021.**

Zyra e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Cërrik ka ushtruar funksionet dhe detyrat e saj bazuar në ligjin Nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar si dhe V.K.M.-së Nr.408, Datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me V.K.M.-në Nr.271 Datë 06.04.2016 “Për një ndryshim në V.K.M.-në Nr. 408 Datë 13.05.2015”.

Nga auditimi u konstatua se, gjatë viteve 2020-2022 në Bashkinë Cërrik nuk është miratuar Leje Ndërtimi për subjekte private në pronë shtetërore. Të gjitha Lejet e miratuara kanë qënë në truall privat të personave apo subjekteve që kanë aplikuar dhe janë pajisur me leje ndërtimi.

Bazuar në sa më sipër, gjatë vitit 2020 janë miratuar **18** Vendime për Leje Ndërtimi, gjatë vitit 2021 deri më 31.12.2021 janë miratuar **17** Vendime për Leje Ndërtimi, gjatë vitit 2022 deri më 31.12.2022 janë miratuar **16** Vendime për Leje Ndërtimi sipas sistemit të e-leje, të cilat janë paraqitur në aneksin nr. 1 pika 5 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Leje të ndërtimit për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2 për vitin 2020-31.12.2022

Nga dokumentacioni i sipër cituar rezulton se për periudhën objekt auditimi Janar 2020 – Dhjetor 2022 janë miratuar gjithsej **9** (nëntë) leje e ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se >250 m2, të cilat u audituan të teta, nga ku rezultuan me probleme disa leje të ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se >250 m2, paraqiten në aneksin nr. 1 pika 5 bashkëlidhur raportit të auditimit, i Leje të ndërtimit për ndërtim të ri, me sipërfaqe me të mashe se 250 m2 për vitin 2020-2022. Në mënyrë të detajuar paraqiten lejet si vijon:

VITI 2020

1) Aplikimi me nr.211 prot. datë 21.04.2020, sipas aplikimit në sistemin e leje.

Objekti: “Shtesë kati, objekt banimi dhe shërbimesh 2 kat + podrum” Rruga “Rinia” Lagja nr. 2 Cërrik

Leje Zhvillimi: Bazuar në V. K. M. 408 datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 9 pika 5, ku thuhet “Leje zhvillimit nuk është e nevojshme për pajisje me leje ndërtimi punime sipas shkronjave b, c dhe ç të nenit 11” Nuk ka leje zhvillimi pasi ka objekt ekzistues .

Leje ndërtimi : Vendim Nr. 211, datë 08.06.2020 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik

Me zhvillues: SH.K si përfaqësues i familjes

Të dhëna për pasurinë:

Me nr. pasurie 322/3/1, ZK 2281, me sipërfaqe e parcelës pronë 4500 m², sipërfaqja e tokës që zhvillohet 1020 m², sipërfaqja e tokës e zënë nga struktura prej 218 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 530 m² në pronësi të z. SH.R.K.

Treguesit e zhvillimit të propozuar:

Njësia Strukturore: 1/216

Sipërfaqja e parcelës pronë sipas certifikatës së pronësisë: 4 500m²

Sipërfaqja e tokës që zhvillohet: 1 020m²

Sipërfaqja e podrumit ekzistues: 180m²

Sipërfaqe e katit përdhe: 218m²

Sipërfaqja e katit të parë: 132m²

Sipërfaqja totale e ndërtimit: 530m²

Lartësia mesatare e xokolit: 1m

Lartësia e objektit: 6m

Lartësia maksimale e çatisë në kulm: 6.65m

Lartësia maksimale e ndërtimit nga niveli i kuotës së sistemimit: 10.65m

Numri i kateve mbi tokë: 2 (dy) kate

Numri i kateve nën tokë: 1 (një) kat

Koeficienti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim: 34.31%

Intensiteti i ndërtimit: 0.3431.

Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar”, dhe sipas V.K.B nr. 338/1, date 20.12.2019 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre në bashkinë Cërrik si dhe penalitetet për shkeljet apo kundravajtjet administrative, për vitin 2020”.

Llogaritjes së kostos së ndërtimit të banesave nga Enti kombëtar i banesave:

Kosto mesatare e ndërtimit/m²: 32 331 leke/m²

Sipërfaqe e ndërtimit 350 m² x 32 331 Lekë x 3 % = **339 476 Lekë**

Shuma totale për t'u paguar për sipërfaqen e re të ndërtimit është: **339 476 Lekë**

Njoftim për fillimin e punimeve:

Njoftimi i fillimit të punimeve është bërë në dt. 18.12.2021, i cili është i pa plotë dhe ka kaluar afati prej një vit. Njoftimi është bërë me kontratën e mbikëqyrjes nr. 3930 Rep., 1771 Kol., datë 17.12.2021

2) Aplikimi me nr.225 prot. datë 24.07.2020, sipas aplikimit në sistemin e leje.

Objekti: “Ndërtim thertore për bagëti” fsh. Gosmim, Nj. Adm. Gostim, B. Cërrik

Leje Zhvillimi

Leje ndërtimi : Vendim Nr. 225, datë 04.08.2020 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik

Me zhvillues: F.B dhe pa dhe H.M

Të dhëna për pasurinë:

Pasuria me nr. 85/24/2, Z.K. 1820, me sipërfaqe e parcelës pronë 1900 m², sipërfaqe e tokës e zënë nga struktura prej 756.23 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 756.23 m² në pronësi të Z.F.B.

Treguesit e zhvillimit të propozuar:

Njësia Strukturore 2/239

Sipërfaqja e parcelës pronë sipas certifikatës së pronësisë: 1 900m²

Sipërfaqja e tokës së zënë nga struktura: 756.23m²

Sipërfaqja e thertoresh (objekti 1): 575.62m²

Sipërfaqe e stallës së bagëtive (objekti 2): 100.11m²
 Sipërfaqja e impiantit të pastrimit të ujërave dhe gjakut (objekti 3): 68.25m²
 Sipërfaqe e vendrojes (objekti 4):12.25m²
 Sipërfaqja totale e ndërtimit:756.23m²
 Lartësia maksimale e thertoresh nga niveli i tokës:8.8m
 Lartësia maksimale e stallës nga niveli i tokës:3.15m
 Lartësia maksimale e impiantit të pastrimit nga niveli i tokës:3m
 Lartësia maksimale e vendrojes nga niveli i tokës:3.9m
 Numri i kateve mbi tokë (objekti 1,2 dhe 4):1 (një) kat
 Numri i kateve nën tokë (objekti 3): 1 (një) kat
 Numri i vendparkimeve të automjeteve:10 (dhjetë) vende
 Koeficienti i shfrytëzimit të territorit: 39.8%
 Koeficienti i shfrytëzimit të gjelbërimit:11.23%
 Koeficienti i shfrytëzimit të rrugëve brenda pronës: 48.97%
 Intensiteti i ndërtimit:0.398

Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar”, dhe sipas V.K.B Nr.338/1, date 20.12.2019 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrik si dhe penalitetet për shkeljet apo kundravajtjet administrative, për vitin 2020”

Llogaritjes se kostos së ndërtimit të banesave sipas V. K. B.:

Vlera llogaritet 3 % e preventivit

Preventivi 27 839 221 lekë x 3 % =**835176.63 lekë**

Shuma totale për t’u paguar për sipërfaqen e re të ndërtimit është: **835176.63 Lekë**

Njoftim për fillimin e punimeve:

Nuk ka aplikuar

3) Aplikimi me Nr. 2326 Prot. Datë 04.06.2020, sipas aplikimit në sistemin e_Leje.

Objekti: "Fabrikë Prodhim Vaji Ulliri" në fshatin Çartaloz, Nj.Administrative. Gostime, Bashkia Cërrik.

Leje Zhvillimi: Vendim Nr.243, Dt.14.12.2020 i Kryetarit të Bashkisë Cërrik me zhvillues “M.” Shpk., Nr. pasurie 366/1/1, Zk.1357, me sipërfaqe 4041m² tokë bujqësore Arë, prej të cilës 1733m² sipërfaqja e parcelës që zhvillohet dhe sipërfaqja e gjurmës së ndërtesës 365.76m², mbi pronën me Nr. pasurie 366/1/1, ZK 1357, me sipërfaqe 4041 m² arë në pronësi të Shoqëria M. shpk.

Leje ndërtimi : Vendim Nr.243, Dt.14.12.2020 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik.

Me zhvillues: Shoqëria “M.” Shpk

Të dhëna për pasurinë: Pasuria Nr. 366/1/1, ZK 1357, me sipërfaqe 4041 m² Arë në pronësi të Shoqëria “M.” shpk.

Të dhëna mbi objektin e miratuar

Njësia Strukturore: **KODI 2/34, PERDORIMI 1B**

Përcaktimet sipas.	Projekt –propozimi
Madhësia min. e parcelës 4041 m ²	1733 m ² truall + 2308m ² arë
Përdorimi i lejuar : Kategoria 1B	Fabrikë vaj ulliri
Sipërfaqja maksimale për ndërtim : Shërbime	365.76 m ² (pa ballkone)
K.sh.t max = 10%	21.10 %
Imax = 0.4	0.21

H max = 8 m	1 kate/ 4.5 m ²
-------------	----------------------------

• **Lartësia e objektit.**

Objekti është i organizuar ne 1(një) kat mbi tokë, me lartësi objekti 4.5m²; lartësi maksimale e strukturës nga toka natyrale gjithashtu 4.5m², si dhe lartësia e Xokolit 0.2m² kurse nëntoka 0 (zero) shfrytëzim dhe numri i vend parkimeve për automjet 6 (gjashtë) vende. Ndërsa koeficienti i shfrytëzimit të territorit (365.76m² / 1733m²) = 21.10%; koeficienti i shfrytëzimit të rrugëve + trotuar + parkim (796m² / 1733m²) = 44.37m²% si dhe koeficienti i shfrytëzimit të sipërfaqes së mbjellë me ullinj (598.24m²) = 34.53m²%.

• **Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.**

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit Nr. 3, Date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar”, dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.338/1 Date 20.12.2019 “Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020”.

Llogaritjes së kostos së ndërtimit të banesave nga Enti kombëtar i banesave për vitin 2020:

Kosto mesatare e ndërtimit: 32 331 leke/m²

Sipërfaqe e ndërtimit kati nën tokë: 0 (zero) m²

Sipërfaqe e ndërtimit kati përdhe: 365.76 m²

Sipërfaqe totale e ndërtimit: 1645.92 m²

Për objekte shërbimi, banesat kolektive dhe objektet që nuk përfshihen në kategoritë e tjera: niveli i taksës 3%. sipërfaqja totale 365.76 m² x 32331 leke/m²= 11825367 lekë

Vlera e paguar: = 11 825 367 leke x 3% = 354,762.00 leke.

4) Aplikimi me Nr. 3690 Prot., Datë 24.12.2020, sipas aplikimit në sistemin e_Leje.

Objekti: KOMPLEKS AGRO - BUJQËSOR
(MAGAZINIM-FRIGORIFER)

Leje Zhvillimi: Vendim Nr.242 Datë 09.12.2020 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik me zhvillues **G.K.Z** për pasuritë me Nr.29/7/1, në Zk.3294.

Leje ndërtimi : Vendim Nr.256 Datë 02.03.2021 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik.

Me zhvillues: G.K.Z

Të dhëna për pasuritë:

Pasurit me: Nr. 29/7/1, në Zk.3294, në pronësi G.K.Z, me sipërfaqe 9550 m², me adresë në Selite, Njesia Administrative Mollas, Bashkia Cërrik sipas paraqitjes grafike të fragmentit të hartës në gjendjen ekzistuese.

Të dhëna mbi objektin e miratuar

Njësia Strukturore: Kategoria 1B

Përcaktimet sipas. 1B	Projekt –propozimi
Madhësia min. e parcelës 9550 m ²	9550 m ²
Përdorimi i lejuar : Kategoria 1B	BUJQËSORE
Sipërfaqja maksimale për ndërtim : 1337m ²	1384.5
K.sh.t max = 14.49%	15 %
Imax = 0.14	1384.5
H max = 4.5M ²	1 kat

• **Lartësia e objektit.**

Objekti është i organizuar ne 1(një) kat mbi tokë, me lartësi objekti 4.5m²; lartësi maksimale e strukturës nga toka natyrale gjithashtu 4.5m², si dhe lartësia e Xokolit 0.3m² kurse nëntoka 0 (zero) shfrytëzim dhe numri i vend parkimeve për automjet 4 (katër) vende. Ndërsa koeficienti i

shfrytëzimit të territorit (1384.5 / 9550m²) = 14.49% ; koeficienti i shfrytëzimit të rrugëve + trotuar + parkim = 1.38m²% si dhe distanca e strukturës nga trupi i rrugës =89.68m².

• **Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.**

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit Nr. 3, Date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar”, dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 83 datë 28.12.2021 “Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021”.

Llogaritjes se kostos së ndërtimit të banesave nga Enti kombëtar i banesave për vitin 2020:

Kosto mesatare e ndërtimit: 32331Leke/m²

Sipërfaqe e ndërtimit kati nën tokë: 0 (zero) m²

sipërfaqe e ndërtimit kati përdhe: 1384.5 m²

sipërfaqe totale e ndërtimit: 1384.5 m²

Vlera e paguar:34,013,874 lekë x 2% = 680,277 leke

VITI 2021

1) **Aplikimi me nr.1642 prot. datë 19.05.2021**, sipas aplikimit në sistemin e leje.

Objekti: “Banesë 1 kat” fshati Gostim, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrik

Leje Zhvillimi: Nuk ka pasi është Rikonstruksion pa ndryshim funksioni.

Leje ndërtimi : Vendim Nr. 267, datë 08.06.2021 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik

Me zhvillues: A.Q.P

Të dhëna për pasurinë:

Kategoria/të e përdorimit të tokës : Tokë “ Truall ”

Kodi i nën-njësisë strukturore: 2/141Kodi I përdorimit sipas planit :Kategoria bazë e përdorimit të tokës A, A, S-Shërbime etj.

Tregueit e zhvillimit ekzistues:

Sipërfaqja e totale e ndërtesës sipas A.SH.K Elbasan :906m²

Sipërfaqja e ndërtesës (Magazinës) sipas faktit :912.68m²

Sipërfaqja e ndërtesës e cila rikonstruktohet (28.58 m X 10.6 m) :298.39m²Lartësia mesatare e xokolit :0.15m²

Lartësia e magazinës ekzistuese: 3.20m²

Largësia e çatisë ekzistuese:2.45m²

Lartësia max e strukturës nga toka natyrale, kulm çatije: 5.80m

Numri i kateve mbi tokë:1 katë

Numri i kateve nën tokë:0 (zero) kate

Treguesit e zhvillimit të propozuar

Sipërfaqja e ndërtesës e cila rikonstruktohet (28.58 m X 10.6 m) :298.39m²

Sipërfaqja e çatisë që prishet (28.15 m X 10.6 m)325.00m²

Lartësia mesatare e xokolit:0.15m² Lartësia e magazinës ekzistuese :4.00m Lartësia max e strukturës nga toka natyrale, kulm çatie 4.15m

Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar”, dhe sipas V.K.B nr. 118, datë 24.12.2020 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrik si dhe penalitetet për shkeljet apo kundravajtjet administrative, për vitin 2021”

Llogaritjes se kostos së ndërtimit të banesave sipas V. K. B.:

Vlera llogaritet 2% e preventivit

3 641 003 Lekë x 2 % =**72 820 Lekë**

Shuma totale për t’u paguar për sipërfaqen e re të ndërtimit është: **72 820 Lekë**

Njoftim për fillimin e punimeve:

Njoftimi i fillimit të punimeve është bërë në dt. 05.05.2022, i cili është miratuar më 16.05.2022 me nr. 1510/1 prot.

Njoftimi është bërë me kontratën e Sipërmarrjes nr. 1219 Rep., 644 Kol., datë 23.04.2022 me shoqërinë E. SHPK

2) Aplikimi me nr.1728 prot. datë 26.05.2021, sipas aplikimit në sistemin e_leje.

Objekti: “Rikonstruksion i ndërtesës 1 kat” fshati Malasej, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrik.

Leje Zhvillimi: Nuk ka pasi është Rikonstruksion pa ndryshim funksioni.

Leje ndërtimi :Vendim Nr. 269, datë 17.06.2021 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik

Me zhvillues: R.B.J. dhe K.B.J

Të dhëna për pasurinë:

Kategoria/të e përdorimit të tokës :“ Tokë “Truall” Kodi I nën-njesisë strukturore 2 / 390

Kodi i përdorimit sipas planit : Kategoria bazë e përdorimit të tokës A, A2, S-Shërbime etj.

Treguesit e zhvillimit ekzistues:

Sipërfaqja e totale e ndërtesës sipas A.SH.K Elbasan :292.6m²

Sipërfaqja e ndërtesës (Objektit Social-ekonomik) sipas faktit:91.73m²

Sipërfaqja e ndërtesës e cila rikonstruktohet (28.15 m X 10.6 m) :291.73m²

Lartësia mesatare e xokolit : 0.50 1

Lartësia e magazinës ekzistuese : 4.00 1

Lartësia max e strukturës nga toka natyrale, kulm çatije : 4.50 1

Numri i kateve mbi tokë : 1 kate

Numri i kateve nën tokë : 0 (zero) 1

Treguesit e zhvillimit pas rikonstruksionit

Sipërfaqja e ndërtesës e cila rikonstruktohet (28.15 m X 10.6 m): 291.73m²

Lartësia mesatare e xokolit : 0.50 M

Lartësia e magazinës ekzistuese : 4.00 M

Lartësia e parapetit (Veri-Lindje & Lindje) : 0.50 M

Lartësia max e strukturës nga toka natyrale, parapet : 5.00 M

Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar”, dhe sipas V.K.B nr. 118, datë 24.12.2020 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre ne Bashkinë Cërrik dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative, për vitin 2021”

Llogaritjes se kostos së ndërtimit të banesave sipas V. K. B.:

Vlera llogaritet 2% e preventivit

3 198 526 Lekë x 2 % =**63 971 Lekë**

Shuma totale për t’u paguar për sipërfaqen e re të ndërtimit është: **63 971 Lekë.**

Njoftim për fillimin e punimeve:

Njoftimi i fillimit të punimeve është bërë në dt. 15.06.2022, i cili është miratuar më 15.06.2022 me nr. 1911/1 prot.

Njoftimi është bërë me kontratën e Sipërmarrjes nr.1525 Rep., 973 Kol., datë 14.06.2022.

3) Aplikimi me nr.3849 prot. datë 01.09.2021, sipas aplikimit në sistemin e leje.
Objekti: “Magazine për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore” fshati Gjyralë, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrik
Leje Zhvillimi: Vendim Nr. 277, datë 10.08.2021 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik
Leje ndërtimi : Vendim Nr. 291, datë 01.11.2021 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik
Me zhvillues: SH.T.Z

Treguesit e Zhvillimit të propozuar:

<input type="checkbox"/> Sipërfaqja e pronës:	1 184	m ²
<input type="checkbox"/> Sipërfaqja e magazinës (gjurma) :	250	m ²
<input type="checkbox"/>		
<input type="checkbox"/> Sip. e kabinës elektrike (gjurma) :	6	m ²
<input type="checkbox"/> Sip. Totale që ndërtohet :	256	m ²
<input type="checkbox"/> Lartësia mesatare e xokolit :	0.3m	
<input type="checkbox"/> Lartësia e magazinës :	4.3m	
<input type="checkbox"/> Lartësia maksimale e strukturës nga toka natyrale :	4.6m	
<input type="checkbox"/> Numri i kateve mbi tokë :	1 kate	
<input type="checkbox"/> Numri i kateve nën tokë :	0 (zero) kate	
<input type="checkbox"/> Numri i vendparkimeve të automjeteve :	3 (tre) vende	
<input type="checkbox"/> Koeficienti i shfrytëzimit për rrugë e parkim (Sip. 411.5 m ²) :	34.76 %	
<input type="checkbox"/> Koeficienti i shfrytëzimit për gjelbërim e mbjellje (Sip. 516.5 m ²) :	43.62 %	
<input type="checkbox"/> Koeficienti i shfrytëzimit të territorit	21.62 %	
<input type="checkbox"/> Intensiteti i ndërtimit m ² nd / m ² tokë :	0.2162	
<input type="checkbox"/> Intensiteti i ndërtimit (250 X 4.6 + 6 X 2.8) / 1 184 m ³ nd / m ² tokë :	0.9854	

Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar”, dhe sipas V.K.B nr. 118, datë 24.12.2020 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrik si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative, për vitin 2021”.

Llogaritjes se kostos së ndërtimit të banesave sipas V. K. B.:

Vlera llogaritet 2% e preventivit

8 276 736 Lekë x 2 % = **165 535 Lekë**

Shuma totale për t’u paguar për sipërfaqen e re të ndërtimit është: **165 535 Lekë**

Njoftim për fillimin e punimeve:

Njoftimi i fillimit të punimeve është bërë në dt. 02.12.2021, i cili është miratuar më 06.12.2021

Njoftimi është bërë me kontratën e Sipërmarrjes nr. 3441 Rep., 1682 Kol., datë 01.12.2021 me shoqërinë E. SHPK.

VITI 2022

1) Aplikimi me nr.431 prot. datë 08.02.2022, sipas aplikimit në sistemin e leje.
Objekti: “Magazinë e grumbullimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore” fshati Çartaloz, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrik
Leje Zhvillimi: Vendim Nr. 253, datë 12.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik
Leje ndërtimi : Vendim Nr. 311, datë 18.03.2022 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik

Me zhvillues: SH.K.LL

Treguesit e zhvillimit të propozuar:

Kodi i nën njësisë strukturore:2/39 Sipërfaqja e pronës :3 400m² Sipërfaqja e tokës “Arë” e marë në studim: 3 400m² Sipërfaqja e magazinës (gjurma) : 600m² Sipërfaqja e plotë e magazinës: 600 M Lartësia maksimale e strukturës së re nga toka natyrale: 4.00 m Numri i kateve mbi tokë: 1 katë Numri i kateve nën tokë 0 (zero) kate Koeficienti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim: 17% Intensiteti i ndërtimit mbi truallin në zhvillim : 0.17 % Vëllimi I strukturës: 2 400 m³

Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit nr.3, date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar”, dhe sipas V.K.B nr. 83, datë 28.12.2021 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre ne bashkinë Cërrik si dhe penalitetet për shkeljet apo kundravajtjet administrative, për vitin 2022”.

Llogaritjes se kostos së ndërtimit të banesave sipas V. K. B.:

Vlera llogaritet 2% e preventivit

19 640 592 Lekë x 2 % =**392 811.84 Lekë**

Shuma totale për t’u paguar për sipërfaqen e re të ndërtimit është: **392 811.84Lekë**

Njoftim për fillimin e punimeve:

Nuk ka bërë njoftim për fillimin e punimeve

2)Aplikimi me Nr. 4993 Prot., Datë 13.12.2021, sipas aplikimit në sistemin e_leje.

Objekti: “NDERTIM I MAGAZINËS 1 KAT”

Leje Zhvillimi: Vendim Nr.295 Datë 10.12.2021 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik me zhvillues **K.B.H** për pasuritë me Nr.323/25/4, në Zk.2281.

Leje ndërtimi : Vendim Nr.299 Datë 24.12.2021 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik.

Me zhvillues: K.B.H

Të dhëna për pasuritë:

Pasurit me: Nr. 323/25/4, në Zk.2281, në pronësi K.B.H me sipërfaqe 3044m², me adresë Lagja Nr.2, Bashkia Cërrik sipas paraqitjes grafike të fragmentit të hartës në gjendjen ekzistuese.

Të dhëna mbi objektin e miratuar

Njësia Strukturore:1/147 Truall

Përcaktimet sipas. NJESIA STRUK.1/147	Projekt –propozimi
Madhësia min. e parcelës 3044 m ²	3044 m ²
Përdorimi i lejuar: 1/147	Magazinë
Sipërfaqja maksimale për ndërtim : 798m ²	798m ²
K.sh.t max = 50%	27.93%
Imax = 0.5	0.2793
H max = 4.5M2	1 kat

• Lartësia e objektit.

Objekti është i organizuar ne 1(një) kat mbitokë, me lartësi objekti 4.5m 2; lartësi maksimale e strukturës nga toka natyrale gjithashtu 6.224m², si dhe lartësia e Xokolit 0.1m² kurse nëntoka 0 (zero) shfrytëzim dhe numri i vendparkimeve për automjet 10 (dhjete) vende. Ndërsa koeficienti i shfrytëzimit të territorit = 27.93%; koeficienti i shfrytëzimit të rrugëve + parkim = 43.93m²% si dhe koeficienti i shfrytëzimit për gjelbërim =28.14m².

• **Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.**

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit Nr. 3, Date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar”, dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.83, Dt.28.12.2021“Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021”.

Llogaritjes se kostos së ndërtimit të banesave nga Enti kombëtar i banesave për vitin 2021:

Kosto mesatare e ndërtimit: 32331leke/m²

Sipërfaqe e ndërtimit kati nën tokë: 0 (zero) m²

sipërfaqe e ndërtimit kati përdhe: 798 m²

sipërfaqe totale e ndërtimit: 798 m²

Vlera e paguar: 15,060,485 = leke x 2% = 396,970 lekë

3)Aplikimi me nr.1309/1 prot. datë 17.05.2022, sipas aplikimit në sistemin e leje.

Objekti: “Fabrikë për prodhim vaji nga ulliri”

fshati Gjyralë, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrik

Leje Zhvillimi: Vendim Nr. 139, datë 19.04.2022 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik

Leje ndërtimi : Vendim Nr. 1309/3, datë 09.06.2022 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik

Me zhvillues: D.M.R

Treguesit e Zhvillimit të propozuar :

Kategoria/të e përdorimit të tokës :Tokë “ Arë ”

Përdorimi i lejuar :Kategoria 1 B

Kodi i nën njësisë strukturore: 2/75

Sipërfaqja e tokës parcelës pronë : 3 000m²

Sipërfaqja e tokës arë e marë në studim : 1 355m²

Sipërfaqja e fabrikës : 360m²

Sipërfaqja e gropës septike (Dekantori) : 24m²

Sipërfaqja e kabinës elektrike : 6.25m²

Sipërfaqja totale :390.25m²

Lartësia e fabrikës :4.50m

Lartësia mesatare e xokolit :0.3m

Lartësia e çatisë :1.80 m

Lartësia max e magazinës nga toka natyrale 4.80 m

Lartësia max e strukturës nga toka natyrale-Kulm çatie6.6 m

Numri i kateve mbi tokë :1 kat (një)

Numri i kateve nën tokë : 0 kat (zero)

Numri i vendparkimeve të automjeteve :9 vende (Nëntë)

Koefiçienti i shfrytëzimit për rrugë e parkim + trotuar (Sip. 735.8 m²) :24.53%

Koef. i shfrytëzimit për murin mbajtës Sip. (40.9 m²) :1.36 %

Koef. i shfrytëzimit për gjelbërim (1 645 m² ullinj + 188.3 m² shkurre e lule dekorative në territorin e fabrikës) :61.1 %

Koefiçenti i shfrytëzimit të territorit 13%

Intensiteti i ndërtimit (m² ndërtim/m² Tokë) (390.25 / 3 000) :0.130

Intensiteti i ndërtimit (m³ ndërtim/m² Tokë) (360 * 4.5 / 3 000) 0.54

Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit

Kombëtar”, dhe sipas V.K.B nr. 83, datë 28.12.2021 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre ne Bashkinë Cërrrik si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative, për vitin 2022”

Llogaritjes se kostos së ndërtimit të banesave sipas V. K. B.:

Vlera llogaritet 2% e preventivit

17 144 018 Lekë x 2 % = **342 880.36 Lekë**

Shuma totale për t’u paguar për sipërfaqen e re të ndërtimit është: **342 880.36Lekë**

Njoftim për fillimin e punimeve:

Njoftimi i fillimit të punimeve është bërë në dt. 24.06.2022, i cili është miratuar më 24.06.2022 me nr. 1995/1 prot. Njoftimi është bërë me kontratën e Sipërmarrjes nr. 1845 Rep., 988 Kol., datë 16.06.2022 me shoqërinë E. SHPK.

4) Aplikimi me nr.3024 prot. datë 25.10.2022, sipas aplikimit në sistemin e_leje.

Objekti: “Fabrikë për prodhim vaji nga ulliri”

Cërrrik-Fermë, Bashkia Cërrrik

Leje Zhvillimi: Vendim Nr. 2111/2, datë 19.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë Cërrrik

Leje ndërtimi : Vendim Nr. 3024/7, datë 05.01.2023 të Kryetarit të Bashkisë Cërrrik

Me zhvillues: E.O.M

Të dhëna të përgjithshme:

Emërtimi i punimeve: FABRIKË PËR PRODHIMIN E VAJIT NGA ULLIRI

Kategoria e përdorimit të tokës: Tokë Arë

Pasuria: Nr. 243/13, Z.K. 2281 dhe Nr. 243/40, Z.K. 2281

Lloji i Strukturës :Prodhim

Pronari: Z. E.O.M

Zhvilluesi :Z. E.O.M

Adresa: Cërrrik-Fermë , Bashkia Cërrrik

Kodi i Njësisë strukturore: 1/195, Bashkia Cërrrik

Treguesit e zhvillimit të propozuar:

Kategoria/të e përdorimit të tokë “Arë”

Sipërfaqja e tokës parcelës pronë: 7717m²

Sipërfaqja e tokës e marrë në studim:7717m²

Sipërfaqja e fabrikës: 800m²

Sipërfaqja e gropës septike (dekantori):30m²

Sipërfaqja e galinës elektrike: 15m²

Sipërfaqja total:800m²

Lartësia e fabrikës:5.5m

Lartësia mesatare e xokolit :0.10m

Lartësia e çatisë: 1.5m

Lartësia maksimale e magazinës nga toka natyrale:7.1m

Lartësia max e strukturës nga kuota 0.00-Kulm çatie: 7m

Numri i kateve mbi tokë: 1 kat (një)

Numri i kateve nën tokë:0 kat (zero)

Numri i vendparkimeve të automjeteve: 29 (Njëzetë e nëntë)

Koef. i shfryt. për rrugë, parkime dhe trotuare: 35%

Koefiçienti i shfrytëzimit për murin mbajtës:16.01%

Koefiçienti i shfrytëzimit për gjelbërim:38.9%

Koef. i shfrytëzimit të territorit: 10 %

Intensiteti i ndërtimit (m² ndërtim/m² Tokë):0.1

Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar”, dhe sipas V.K.B nr. 83, datë 28.12.2021 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrik si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative, për vitin 2022”.

Llogaritjes se kostos së ndërtimit të banesave sipas V. K. B.:

Vlera llogaritet 2% e preventivit

63 546 299 Lekë x 2 % = **1 270 924.58 Lekë**

Shuma totale për t’u paguar për sipërfaqen e re të ndërtimit është: **1 270 924 lekë**

Njoftim për fillimin e punimeve:

Nuk ka bërë Njoftim për fillimin e punimeve .

Titulli i gjetjes: - “Mos ushtrimi i kontrolleve dhe moszbatimi i procedurës ligjore për dhënie leje ndërtimi”

Situata:

Nga auditimi i zbatimit të procedurave për dhënie të lejeve të ndërtimit u konstatuan mangësi në miratimin e disa lejeve si vijon:

- **Aplikimi me Nr.211 Prot., Datë 21.04.2020**, sipas aplikimit në sistemin e_leje me **objekt: “Shtesë kati, objekt banimi dhe shërbimesh 2 kat + podrum”** Rruga “Rinia” Lagja nr. 2 Cërrik.
- **Aplikimi me Nr.225 Prot., Datë 24.07.2020**, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: **“Ndërtim thertore për bagëti”** fshati Gostim, Nj. Adm. Gostim, B. Cërrik.
- **Aplikimi me Nr.2326 Prot. Datë 04.06.2020**, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: **"Fabrikë Prodhim Vaji Ulliri"**.
- **Aplikimi me Nr.3690 Prot., Datë 24.12.2020**, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: **Kompleks Agro - Bujqësor (magazinim-frigorifer).**
- **Aplikimi me Nr. 4993 Prot., Datë 13.12.2021**, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: **“Ndërtim i magazinës 1 kat”**.
- **Aplikimi me Nr.1642 Prot., Datë 19.05.2021**, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: **“Banesë 1 kat”** fshati Gostim, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrik.
- **Aplikimi me Nr.1728 Prot., Datë 26.05.2021**, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: **“Rikonstruksion i ndërtesës 1 kat”** fshati Malasej, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrik.
- **Aplikimi me Nr.3849 Prot., Datë 01.09.2021**, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: **“Magazine per grumbullimin, ruajtjen dhe perpunimin e produkteve bujqesore”** fshati Gjyralë, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrik.
- **Aplikimi me Nr.431 Prot., Datë 08.02.2022**, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: **“Magazinë e grumbullimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore”** fshati Çartalloz, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrik.
- **Aplikimi me Nr.1309/1 Prot., Datë 17.05.2022**, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: **“Fabrikë për prodhim vaji nga ulliri”** fshati Gjyralë, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrik.
- **Aplikimi me Nr.3024 Prot., Datë 25.10.2022**, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: **“Fabrikë për prodhim vaji nga ulliri”** Cërrik-Fermë, Bashkia Cërrik.

Konstatohet se në gjithë auditimin e kryer në Bashkia Cërrik për lejet e zhvillimit dhe lejet e ndërtimit ka problematika të njëjta në përgjithësi me kuptimin dhe zbatimin e ligjit në kontekst të VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar

dhe me Ligjin Nr.107/2014“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, ku vërehet që bien ndesh me disa nga pikat e bazës ligjore sipërcituar.

Në dosjet e lejeve mungon dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, specifikisht të pesë pikat si më poshtë konstatohet që nuk procedohen në kërkesën për plotësim të tyre nga subjektet përfitues të lejeve dhe miratohen pa to, duke qenë në kundërshtim me nenin 15 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar:

pikën b) *Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta;*

pikën e) *Deklarata e projektuesit të licencuar, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit, nëpërmjet së cilës konfirmohet përputhshmëria e projektit me lejen e zhvillimit, dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit, në fuqi, dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjieno-sanitare;*

pikën ë) *Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit;*

pikën v) *Projektin e eficiencës energjetike, në rastet kur është e detyrueshme me ligj;*

pikën g) *Kopje e policës së sigurimit të projektuesve, për mbulimin e përgjegjësive profesionale; Problematika në punimet e hedhjes së hartave nga sektori i Gis Kadastrës së Bashkisë Cërrik, duke mos përcaktuar qartë kufijtë e pronës objekt zhvillimi, duke mos përcaktuar sakte gjendjen faktike të terrenit me objektet informale si dhe me poseduesit e ligjshëm dhe të paligjshëm mbi pronat objekt zhvillimi e dhënie leje ndërtimi për to, për pasojë duke çuar në moszbatim të kritereve, distancave dhe evidence të pronarëve, të cilat bien në kundërshtim me Nenin 10, pika c) dokument që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim dhe, nëse ka, kopje të marrëveshjeve për pronën; pika ç) planin e rëlevimit të pronës, në shkallë 1:500, nga topograf i licencuar; dhe në kundërshtim me Nenin 16, pika d) të dhënat identifikuese të pronarit të tokës, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, Datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.,*

Referuar sistemit e-Leje rezulton për lejet e sipërcituara, Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe IMTV me përfaqësues Z.F.U, Z. A.D, Znj.S.F në zbatim të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar rezulton që nuk ka mbajtur Akt Kontrolli i Piketimit të Objektivit me subjektin zhvillues, nuk kemi një mbikëqyrës të punimeve inxhinierin përkatës dhe nuk kemi firmë zbatuese të punimeve të ndërtimit.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë:-Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit” dhe VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit, neni 15 (pika b,ë,g,v,e); neni 10 (pika c,c.); neni 16 (pika d).

Impakti:

Mosrespektimi i rregullores së miratuar nga institucioni i cili nuk ka siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit duke mos krijuar kushte të përshtatshme me, të drejta dhe shanse të barabarta për banim. Gjithashtu mosrespektim të ligjit dhe moszbatim të tij në nivel procedural duke sjell parregullsi juridike në çdo akt të prodhuar nga institucioni.

Shkaku:

Mos respektimi i përcaktimeve të Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi

Drejtoria e Punëve Publike, Administrimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratimit të lejeve të ndërtimit të mbahen aktet e kontrollit sipas përcaktimeve ligjore si dhe të zbatohen të gjitha pikat dhe nenet e cituara te VKM Nr.408/2015.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi sipas funksioneve; Z. A. S me detyrë Kryetar i Bashkisë Z.F.U me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Z.A.D, nëpunës dhe Znj. S.F, kontrolluese, Z. F.Q me detyrë Kryeinspektor i IMTV, Z. K.M, Z. S.SH me detyrë Inspektor të IMTV.

Në se për lejet e ndërtimit të dhëna për ndërtimet e reja është paguar taksa e ndikimit në infrastrukturë sipas legjislacionit në fuqi. (neni 46 i ligjit nr.107/2014, dt.01.10.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar me ligjin. 28/2017 dt.23.03.2017 dhe neni 27, i ligjit nr. 9632, dt.30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Taksa e ndikimit në infrastrukturë është aplikuar duke u bazuar në koston e ndërtimit për m² për Bashkinë Cërrik, për vitin 2020-2022 të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave. Ky çmim ka qënë 32,331 lekë/m². Në bazë të nenit 46 të ligjit të sipërpërmendur, për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë është marrë për bazë vlera më e lartë duke e krahasuar llogaritjen e taksës me vlerën e investimit dhe llogaritjen me koston e ndërtimit për m².

Nga auditimi i mandat pagesave që ndodhen në dosjen e çdo objekti, u konstatua se nga ana e bashkisë nuk është llogaritur saktë taksa e ndikimit në infrastrukturë duke krijuar diferenca për 16 subjekte në vlerën 997,803 lekë vlerë e cila përben të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Cërrik. Veprimet dh mosveprimet bien në kundërshtim me VKB Nr. 338/1 datë 20/12/2019 dhe VKB Nr. 83 datë 28.12.2021 “Për nivelin e taksave e tarifave vendore, administrimi i tyre” në Bashkinë Cërrik. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 2 pika 5 bashkëlidhur raportit të auditimit.

(Sa më sipër është trajtuar më gjerësisht në Akt konstatimin nr. 4 datë 03.03.2023).

Nga Bashkia Cërrik nuk u paraqitën observacione mbi akt konstatimin nr. 4 jashtë afatit një javor të përcaktuar në rregulloren e procedurave të auditimit të cilat janë bërë pjesë e Projekt raport, nga Z. F.U i me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Z.A.D, nëpunës dhe Znj.S.F, kontrolluese, protokolluar në KLSH me nr.1021/2 datë 16.01.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Aplikimi me Nr. 2326 Prot. Datë 04.06.2020, sipas aplikimit në sistemin e_Leje.

Objekti: "Fabrikë Prodhim Vaji Ulliri" në fshatin Çartaloz, Nj.Ad., Gostime, Bashkia Cërrik.

Leje Zhvillimi: Vendim Nr.243, Dt.14.12.2020 i Kryetarit të Bashkisë Cërrik me zhvillues “M.” Shpk., Nr. pasurie 366/1/1, Zk.1357, me sipërfaqe 4041m² tokë bujqësore Arë, prej të cilës 1733m² sipërfaqja e parcelës që zhvillohet dhe sipërfaqja e gjurmës së ndërtesës 365.76m², mbi pronën me Nr. pasurie 366/1/1, ZK 1357, me sipërfaqe 4041 m² arë në pronësi te Shoqëria M. shpk.

Leje ndërtimi : Vendim Nr.243, Dt.14.12.2020 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik.

Me zhvillues: Shoqëria “M.” Shpk

Të dhëna për pasurinë: Pasuria Nr. 366/1/1, ZK 1357, me sipërfaqe 4041 m² Arë në pronësi të Shoqëria "M." shpk.

Për Çeshtjet

• **Aplikimi me Nr. 3690 Prot., Datë 24.12.2020**, sipas aplikimit në sistemin e_Leje.

Objekti: KOMPLEKS AGRO – BUJQËSOR (MAGAZINIM-FRIGORIFER)

Leje Zhvillimi: Vendim Nr.242 Datë 09.12.2020 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik me zhvillues

Gentjan Kadri Ziu për pasuritë me Nr.29/7/1, në Zk.3294.

Leje ndërtimi : Vendim Nr.256 Datë 02.03.2021 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik.

Me zhvillues: G.K.Z

Aplikimi me nr.1642 prot. datë 19.05.2021, sipas aplikimit në sistemin e_Leje.

Objekti: "Banesë 1 kat" fshati Gostim, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrik

Leje Zhvillimi: Nuk ka pasi është Rikonstruksion pa ndryshim funksioni.

Leje ndërtimi : Vendim Nr. 267, datë 08.06.2021 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik

Me zhvillues: A.Q.P

Aplikimi me nr.431 prot. datë 08.02.2022, sipas aplikimit në sistemin e_Leje.

Objekti: "Magazinë e grumbullimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore"

fshati Çartaloz, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrik

Leje Zhvillimi: Vendim Nr. 253, datë 12.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik

Leje ndërtimi : Vendim Nr. 311, datë 18.03.2022 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik

Viti 2021

Aplikimi me nr.431 prot. datë 08.02.2022, sipas aplikimit në sistemin e_Leje.

Objekti: "Magazinë e grumbullimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore"

fshati Çartaloz, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrik

Leje Zhvillimi: Vendim Nr. 253, datë 12.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik.

Leje ndërtimi : Vendim Nr. 311, datë 18.03.2022 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik.

Aplikimi me Nr. 4993 Prot., Datë 13.12.2021, sipas aplikimit në sistemin e_Leje.

Objekti: "NDERTIM I MAGAZINËS 1 KAT"

Leje Zhvillimi: Vendim Nr.295 Datë 10.12.2021 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik me zhvillues **K.H** për pasuritë me Nr.323/25/4, në Zk.2281.

Leje ndërtimi : Vendim Nr.299 Datë 24.12.2021 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik.

Me zhvillues: K.B.H

Aplikimi me Nr.1309/1 Prot., Datë 17.05.2022, sipas aplikimit në sistemin e_Leje.

Objekti: "Fabrikë për prodhim vaji nga ulliri" fshati Gjyralë, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrik

Leje Zhvillimi: Vendim Nr. 139, datë 19.04.2022 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik.

Leje ndërtimi : Vendim Nr. 1309/3, datë 09.06.2022 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik.

Me zhvillues: D.M.R.

Aplikimi me Nr.3024 Prot., Datë 25.10.2022, sipas aplikimit në sistemin e_Leje.

Objekti: "Fabrikë për prodhim vaji nga ulliri" Cërrik-Fermë, Bashkia Cërrik.

Leje Zhvillimi: Vendim Nr. 2111/2, datë 19.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik.

Leje ndërtimi : Vendim Nr. 3024/7, datë 05.01.2023 të Kryetarit të Bashkisë Cërrik.

Me zhvillues: E.M

Ne lidhje me konstatimet e cituara me lart po ju paraqesim disa komente dhe shpjegime per gjetjen ne fjale:

Për këto objekte problematikat e konstatuar nga ju janë të njëjta që përmbliohen:

1.Pajisja me certifikatë pasurie te sipërfaqes që zhvillohet duke e ndare këtë nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës prone (kjo para aplikimit për leje),
2. Kantata me sipërmarrësin dhe supervizorin të noterizuar para aplikimit për leje ndërtimi.

3.Certifikat e eficensës së energjisë,

4.Raporti Gjeologjik,

5.Raporti sizmik

6. Akt Kontrollit e Piketimit

7.Giz-Kadastra

8.Gjeneralitete e studios projektues, licensa, nipt, e deklarata profesionale,

9.Taksa e ndikimit ne infrastrukture.

Për sa me sipër po ju shpjegojmë:

1. Në lejet e zhvillimit/ndërtimit të lëshuara nga Bashkia Cërrik dominojnë ato për ndërtim banesa me funksion banimi apo rikonstruksiione banesash, banesa 1 kat deri në 250m2.

• Për lejet për të cilat ju i referohen janë zhvillime në tokë arë në sistemin B_bujqësi me kategori bazë të përdorimit të tokës arë e që lejet janë dhe në përputhje me neni 40 të rregullores së PPV dhe VKM Nr. 283 date 01.04.2015''**Për Përcaktimin e tipeve, Rregullimeve, Kriteret dhe Procedurave Për Ndërtimin e Objekteve për prodhimin, Ruajtjen dhe përpunimin e produkteve Bujqësore dhe Blektorale, në Tokë Bujqësore''**

• Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (D.P.ZH.T) pranë Bashkisë Cërrik nuk e ka kërkuar ndarjen e parcelës që do të zhvillojë nga pjesa tjetër e parcelës pronë e cila nuk do të zhvillohet pasi aplikimi bëhet nga aplikuesi (zhvilluesi) në e –Albania për leje zhvillimi /ndërtimi. Bashkia Cërrik nëpërmjet D.ZH.T duhet që këtë aplikim ta refuzojë dhe zhvilluesi duhet të pajisë parcelën që do të zhvillohet me certifikatë pasurie e ndarë nga parcela që nuk zhvillohet (pra duhet te pajiset me dy certifikata pasurie). Ne rast mos miratimi i lejes së zhvillimit/ndërtimi për mos plotësim kushteve e kriterëve të PPV Cërrik apo nga institucionet shtetërore në të cilat ne e dërgojmë për mendim zhvilluesi duhet të bëjë përsëri bashkimin e këtyre pronave në gjendje fillestare (Bashkimi përsëri në një parcelë të vetme) për ta pasur dokument për aplikimet për subvencione në fushën e bujqësisë etj. Kjo procedurë do të ishte kohë e kosto e shtuar për zhvilluesin dhe do të sillte vonesa në investim si dhe lodhjen e investitorit.

Në raste të tilla ASHK Drejtoria Elbasan në praktikën e saj bën regjistrimin e objektit me certifikatë pronësie në të cilën gjejmë specifikime si më poshtë: Sipërfaqja totale e pasurisë: x(m2) nga kjo tokë, truall y(m2) dhe ndërtesë z.(m2) regjistrimi bëhet sipas koordinatave në KRRGJSH apo Sistemit UTM që ka vënë projektuesi dhe ing topografi në pranëvendosjen pas përfundimit të investimit për objektin ,sipërfaqen në studim si dhe kufijtë e parcelës.

• Bashkangjitur keni edhe Certifikatën tip

2. VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 i ndryshuar neni 15 pika ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjisllacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit;

Siç e theksuam me lart, lejet zhvillimore/ndërtimi të lëshuar nga Bashkia Cërrik janë për ndërtim apo rikonstruksiione për banesa apo objekte me sipërfaqe deri 250m2 dhe duke u nisur nga lart D.P.ZH.T nuk e parë të nevojshme pasi në lejen e ndërtimit që lëshon Bashkia Cërrik është e theksuar dhe është kusht për vazhdimin e zhvillimit se zhvilluesi duhet të aplikojë në e-Albania për (leje ndërtimi “Njoftim për fillim të punimeve) njoftimi të fillimit të punimeve brenda periudhës 1(një) vjeçare nga data e vendimit të lejes së ndërtimit, në rast të mos aplikimit për njoftim të fillimit të punimeve leja është e pavlefshme.

• Në njoftimin e fillimit të punimeve zhvilluesi duhet të paraqesë:

Lejen e zhvillimit/ndërtimi, kontratën me sipërmarrësin dhe mbikëqyrësit të punimeve të noterizuar, procesverbalin e fillimit të punimeve, akt piketimin si dhe çdo dokument tjetër që kërkohet nga portali.

- Drejtorja e Planifikimit nuk e ka parë të nevojshme hartimin e kontratave me sipërmarrësin dhe mbikëqyrësin para miratimit të lejes, pasi kjo do të ishte jo në favor të zhvilluesit pasi mund të kemi ndryshime të çmimeve të ndërtimit sipas preventivit të kontratës (kujtojmë se leja do minimumin 30 ditë të miratohet) çka do të sillte vështirësi për zhvilluesin në lidhje me ofertën (preventivin e projekt-zbatimit) apo prishjen e kontratës ndërsa lidhja e këtyre kontratave të nevojshme pas miratimit të lejes së ndërtimit dhe ngarkimit të tyre në sistemin e-leje “Njoftim për fillimin e Punimeve” do të ishin më të përshtatshme për zhvilluesin.

- Kërkimi i kontratave me sipërmarrësin dhe mbikëqyrësin të noterizuara nuk janë në kushtet e domosdoshme ose plotësuese në sistemin e-Albania (leje ndërtimi)

3. Po ashtu theksojmë se “Certifikimi i performancës së energjisë së ndërtesës” ligji 116/2016 neni 4” pika 3. Ndërtesat e përkohshme me një kohë shfrytëzimi jo më shumë se 2 vjet, kantieret industriale, punishtet dhe ndërtesat jo banimi, që shfrytëzohen për aktivitete bujqësore, me një kërkesë të vogël energjie dhe ndërtesa të tjera bujqësore jo banimi, që janë të rregulluara me akte të veçanta ligjore për sa i përket performancës së energjisë në ndërtesë. Theksojmë se kapanonet apo ndërtesat që shërbejnë për prodhim vaji nga ulliri janë punishte të cilat periudha e punës së tyre është 4 mujore (shtator –dhjetor) për çdo vit.

4. Raporti Gjeologjik

5. Raporti sizmik, duke qënë se kërkesat për leje zhvillimi / ndërtimi janë në përgjithësi për objekte 1 kate (me sipërfaqe më të vogël 250m²) me funksion banese ose social ekonomik D.P.ZH. është mjaftuar me deklaratën e përgjegjësive profesionale të konstruktorit.

6. Drejtorja e planifikimit dhe zhvillimit të territorit mbas çdo procesi për pajisje me leje ndërtimi të aplikantëve që janë personave fizik dhe juridik, nga kjo drejtori është njoftuar me shkresë zyrtare IMTV -pranë Bashkisë Cërrik, shkresës janë bashkangjitur një kopje e gjithë dokumentacionit të miratuar (vendimi i kryetarit, leja e ndërtimit si dhe projektet, grafiku i punimeve, preventive, licenca deklarata etj). IMTV nuk është strukturë në varësi të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit po ashtu është në kompetencë e këtij sektori pjesëmarrja në akt piketimi, akt përfundimi i karabinasë, përfundimi i objektit, pastrimit të territorit rreth objektit etj.

6/1. Për Konstatimin për nuk ka mbajtur Akt Kontrolli i Piketimit të Objektit me subjektin zhvillues G.K.Z; nuk kemi një mbikëqyrës të punimeve inxhinierin përkatës dhe nuk kemi firmë zbatuese të punimeve të ndërtimit për këtë objekt dhënë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi për qëllime bujqësore, për rrjedhojë nuk mund të shprehemi nëse “Piketimi i objektit është., kjo vjen për arsye se zhvilluesi në fjalë nuk ka bërë aplikim për fillim të punimeve në portalin e-leje (njoftim për fillim të punimeve). Shtojmë këtu se kjo leje është e pavlefshme pasi ka mbaruar afati i njoftimit të fillimit të punimeve (nuk është bërë në vitin e parë të lejes)

7. Në Bashkinë Cërrik nuk ka strukture Giz – Kadastra, kjo për mungesë specialistësh.

8. Gjeneralitete e studios projektues, licenca, nipt, deklarata profesionale këto janë në sistemin e-leje por mbase nuk janë në dritaren e specifikuar për këtë qëllim por janë në dritare të tjera brenda aplikimit për shkak se sistemi nuk ngarkonte në dritaren përkatëse.

9. Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Konstatimi i bërë nga ju se :-Nga auditimi i mandat pagesave që ndodhen në dosjen e çdo objekti, u konstatua se nga ana e Bashkisë nuk është llogaritur saktë taksa e ndikimit në infrastrukturë duke krijuar diferenca për 16 subjekte në vlerën 997,803 lekë vlerë e cila përben të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Cërrik. Veprimet dh mosveprimet bien në kundërshtim me VKB Nr. 338/1 datë 20/12/2019 dhe VKB Nr. 83 datë 28.12.2021 “Për nivelin e taksave e tarifave vendore, administrimi i tyre” në Bashkinë Cërrik. Në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:

1.Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit(D.P.T.ZH.) pranë Bashkisë Çërrik ka llogaritur taksën e ndikimit në infrastrukturë për lejen e ndërtimit si vijon :

1/a.Për objektet e reja duke iu referuar Udhëzimit nr.3, datë 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar” në m2 për sipërfaqe ndërtimi si dhe VKB-Bashkia Çërrik sipas viteve 2020,2021,2022.

1/b. Për objektet që janë në rikonstruksion apo ndryshim funksioni(të cilat nuk parashikohen në Udhëzimit nr.3, datë 28.12.2016 të EKB, kjo taksë është llogaritur me preventivin e hartuar nga projektuesi me çmimet sipas VKM 629 date 15.07.2015”Per miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre” si dhe VKB –Bashkia Çërrik sipas viteve 2020,2021,2022.

1/c. Për lejen e ndërtimit me Vendim Nr. 299 datë 24.12.2021 Ndërtim magazinë 1 kate (kapanon metalik) për Vendim Nr.256 datë 02.03.2021- Kompleks agro bujqësor, magazinim-frigorifer taksa e ndikimit në infrastrukturë është llogaritur në bazë të preventivit të hartuar nga projektuesi me çmimet sipas VKM 629 datë 15.07.2015”Per miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike te tyre” si dhe VKB –Bashkia Çërrik sipas viteve 2020,2021,2022 kjo në mbështetje të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave vendore” neni 27 “Taksa e ndikimit ne infrastrukture” pika pika 3.a, Për ndërtimet që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3 për qind e vlerës së investimit , ndryshuar me ligjin **ligjin Nr. 95/2018 neni 9 pika 3,3a**

1/d. Për lejen e ndërtimit me Vendim Nr.211 date 08.06.2020 për objektin “Shtese kati, objekt banimi dhe shërbimesh 2-kate + bodrum” me sipërfaqe totale 530m2 me aplikues firma projektuese “D.” e zhvillues Z.SH.R.K është lapsus i hedhjes së sipërfaqe në tabelë pasi bodrumi është ekzistues dhe ka sipërfaqe 218m2 dhe 530m2-218m2=312m2 sipërfaqja që shtohet mbi bodrumin ekzistues.

1.e.Emërtimet e lejeve të ndërtimit për Ndërtim të ri me sipërfaqe 250m2/ apo mbi 250m2, për rikonstruksione, adaptime objekte ekzistues me ose pa ndryshim funksioni, magazinë (kapanon metalik industrial), kapanone me ose pa konstruksion metalik për fabrika vaji, komplekse agro-bujqësore si dhe sipërfaqet e tyre i gjeni në portalin e-leje Bashkia Çërrik.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Së pari, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (D.P.ZH.T) pranë Bashkisë Çërrik nuk mund të shprehet në këtë formë duke thënë që ka kosto ndarja apo bashkimi i pasurisë dhe se nuk dihet nëse e miratojmë si leje zhvillimi apo ndërtimi. **Bashkia ka një bazë ligjore dhe një draft ligjor ku duhet ti përmbahet plotësisht në procedurë për dhënie leje ndërtimi,** nuk mund të parashikojë institucioni kostot e subjekteve për veprime me pronën, ajo ka detyrimin të kërkoj dokumentacionin në formën e duhur. Pretendimi juaj nuk gjen justifikim pasi Bashkia është për të prodhuar akte të rregullt dhe jo për të parashikuar nëse do ketë të ardhura për të paguar taksën apo për ta ndërtuar atë. Bashkia ka detyrimin e pritjes dhe shqyrtimit të aplikimit të çdo subjekti në mënyrë të paanshme.

Së dyti, referuar VKM Nr.408, Datë 13.5.2015 i ndryshuar neni 15 e saj shpreheni se Drejtoria e Planifikimit nuk e ka parë të nevojshme hartimin e kontratave me sipërmarrësin dhe mbikqyrësin para miratimit të lejes pasi mund te kemi ndryshime në preventive apo ndryshim të kontratës me një sipërmarrës tjetër. Sqarojmë se Bashkia ka të gjitha tagrat ligjor për të përcaktuar një preventive në lejen e ndërtimit sipas kostove aktuale të tregut dhe nuk është detyrimi juaj të mendoni ndryshimet që mund të ndodhin jo për faj tuaj. **Detyrimi juaj është të zbatoni procedurën sipas parashikimeve ligjore** si dhe përta i përket kontratës me sipërmarrësin e njëjta gjë nëse do ketë ndryshime gjatë rrugës ligji parashikon rregullimet e saj me kalim të drejtash etj.

Së treti, pretendimi juaj se kemi të bëjmë me ndërtime me sipërfaqe të vogla apo me ndërtime në zona rurale, bëjmë me dije se ligji nuk parashikon kritere përjashtimore apo lehtësira në këto raste për evitim dokumentacioni si raporte të eficensës, sizmiologjik, arkeologjik, gjeologjik, taksën e police së sigurimit etj.

Së katërti, shpreheni se sektori i Gis-Kadastrës nuk funksionon dhe ka mungesë specialistësh. Kjo është në kundërshtim me rregulloren dhe bazën ligjore si funksionon struktura e Bashkisë e për rrjedhojë duke krijuar problematika në përpunimin dhe trajtimin e pronës sipas Gis-Kadastrës.

Së fundmi, në parashtrim të prapësimeve si më lart si dhe bazuar në VKM Nr.408, Datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar dhe me Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, ku vërehet që bien ndesh me disa nga pikat e bazës ligjore sipërcituar për rrjedhojë observacioni juaj nuk merret parasysh nga Kontrolli i Lartë i Shtetit pasi pretendimet tuaja nuk gjeten vend në bazën ligjore.

Nga Bashkia Cërrik u paraqitën observacione mbi Projekt Raportin e auditimit nga Z. F.U me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, protokolluar në KLSH me nr.1032/1 datë 17.05.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

❖ Në lidhje me pikën b) te konkluzioneve tuaja ne te cilën theksoni "Mungojnë dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta" kjo nuk qendron pasi :

1 .Në çdo aplikim është Certifikata e regjistrimit të pasurisë e vlefshme ose rinovuar kartela e pasurisë brenda 3 muajve te fundit.

2.Pronari/pronaret e parceleva ndërtimore janë edhe zhvilluesi/zhvilluesit .

❖ Në lidhje me pikën e) Deklarata e projektuesit te licencuar, sipas formatit te aplikimit, te përcaktuar ne sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit, nëpërmjet së Cilës konfirmohet përputhshmëria e projektit me lejen e zhvillimit, dokumentet e planifikimit e kontrollit te zhvillimit, ne fuqi, dhe me legjislacionin qe rregullon veprimtarinë e ndërtimit ne Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjieno-sanitare. Ne lidhje me këtë pike ju bëjmë me dije se :

1 Deklaratat e përgjegjësive profesionale të projektueseve janë ne sistemin e-leje.

❖ Në lidhje me ë) Lejet, liçensat, autorizimet apo aktet e miratimit, te nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, ne zbatim te legjislacionit të posaçëm për lejet, liçencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme qe ato të paraqiten përpara marrjes së lejes se ndërtimit.

Ne lidhje me këtë pike ju bëjmë me dije se:

I. Në sistem ndodhen të gjitha dokumentet mbi lejet, liçencat, NIPT-I, etj i studios se projektimit, liçensat dhe autorizimet për hartuesit te MNZ, tw VNM, liçencat e arkitekteve, konstruktorit, ing, elektrik, hidrosanitar si dhe te gjitha liçencat e nevojshme.

❖ Ne lidhje me piken v) Projektin e efciences energjitike, në rastet kur është e detyrueshme me ligj;

Në lidhje me këtë pike ju bëjmë me dije se:

Tipologjia dhe funksioni i objekteve me sipërfaqe me te madhe se 250m2 për të cilat ne kemi dhënë leje ndërtimi janë kapanone metalike me aktivitete bujqësore dhe magazine industrial.

Bazuar ne ligjin 116/2016 pika 4.Perjashtimet: Ky ligj nuk do të zbatohet për kategoritë e mëposhtme të ndërtesave: 3. kantieret industriale, punishtet dhe ndërtesat jobanimi, që shfrytëzohen për aktivitete bujqësore, me një kërkesë të vogël energjie dhe ndërtesa të tjera bujqësore jobanimi.

❖ Në lidhje me piken g) Kopje e polices se sigurimit te projektuesve, për mbulimin e përgjegjësive profesionale;

Ne lidhje me këtë pike ju bëjmë me dije se:

Ne te gjitha çështjet që përmenden me lart ne sistem është polica e sigurimit nga projektuesi.

❖ Ne lidhje me piken i) Problematika në punimet e hedhjes se hartave nga sektori i Giş Kadastres . se Bashkisë Cërrrik, duke mos përcaktuar qarte kufijtë e pronës objekt zhvillimi, duke mos përcaktuar sakte gjendjen faktike te terrenit me objektet informale si dhe me poseduesit e ligjshëm dhe te paligjshem mbi pronat objekt zhvillimi e dhënie leje ndërtimi për to, për pasoje duke çuar ne mozbatim te kriterëve, distancave dhe evidence te pronarëve.

Ne lidhje me këtë pike ju bëjmë me dije se:

1 .Ne sistem ndodhet për secilën leje, plani i rilevimit topografik (azhornimet topografike) i gjendjes se parcelës, pronës me konture, pronës të përcaktuara rigorozisht (edhe me kordinata) para fillimit te projektit tw objektit. Azhornimet topografike janë bere nga ing. gjeodet të licensuar për këtë fushe.

2.Sa për distancat nga kufiri i pronës dhe ndërtesave ekzistuese ato janë në përputhje të plote me ligjet në fushën e planifikimit dhe rregullores se zhvillimit, vkm 283/2015 si dhe rregullores se planit të përgjithshëm rregullues të bashkisë Cërrrik.

3.Ne bashkinë Cërrrik mungon sektori Gis/kadastres dhe nuk është përgjegjësia e drejtorisë se planifikimit.

Dokumentet e mësipërme janë në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 107 date 31.07.2014 si dhe VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”.

4.Për kontratat midis zhvilluesit dhe sipërmarrësit të punime dhe kontrata midis zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve ato janë në sistemin e-leje njoftim për fillimin e punimeve.

5. Për çdo leje ndërtimi apo deklaratë paraprake drejtoria njofton me shkresë zyrtare IVMT si dhe dokumentat shoqërues për çdo leje, aktet e kontrollit nuk janë përgjegjësi e jona.

6.IVMT nuk është sektor në varësi te Drejtorisë së Planifikimit te Territorit dhe Zhvillimit

Ju lutemi në raportin përfundimtar që do të hartohet nga ana juaj na specifikoni se çfarë dokumentash shtesë duhet nga ajo që kërkohet në sistemin e-leje "Dokumenta të detyrueshme" sepse me këtë rast na vini në ndihmë .

Bashkangjitur këtij observacioni keni formularët e aplikimit si dhe kontratat për ato objekte që janë zhvilluar apo janë në zhvillim

Pwrgjigje e grupit tw auditimit

- **Së pari**, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (D.P.ZH.T) pranë Bashkisë Cërrrik nuk mund të shprehet në këtë formë duke thënë që ka kosto ndarja apo bashkimi i pasurisë dhe se nuk dihet nëse e miratojmë si leje zhvillimi apo ndërtimi. **Bashkia ka një bazë ligjore dhe një draft ligjor ku duhet t'i përmbahet plotësisht në procedurë për dhënie leje ndërtimi**, nuk mund të parashikojë insitucioni kostot e subjekteve për veprime me pronën, ajo ka detyrimin të kërkoj dokumentacionin në formën e duhur. Pretendimi juaj nuk gjen justifikim pasi Bashkia është për të prodhuar akte të rregullt dhe jo për të parashikuar nëse do ketë të ardhura për të paguar taksën apo për ta ndërtuar atë. Bashkia ka detyrimin e pritjes dhe shqyrtimit të aplikimit të çdo subjekti në mënyrë të paanshme.

- **Së dyti**, referuar VKM Nr.408, Datë 13.5.2015 i ndryshuar neni 15 e saj shpreheni se Drejtoria e Planifikimit nuk e ka parë të nevojshme hartimin e kontratave me sipërmarrësin dhe mbikëqyrësin para miratimit të lejes pasi mund te kemi ndryshime në preventive apo ndryshim të kontratës me një sipërmarrës tjetër. Sqarojmë se Bashkia ka të gjitha tagrat ligjor për të përcaktuar një preventive në lejen e ndërtimit sipas kostove aktuale të tregut dhe nuk është detyrimi juaj të mendoni ndryshimet që mund të ndodhin jo për faj tuaj. **Detyrimi juaj është të zbatoni**

procedurën sipas parashikimeve ligjore si dhe përsa i përket kontratës me sipërmarrësin e njëjta gjë nëse do ketë ndryshime gjatë rrugës ligji parashikon rregullimet e saj me kalim të drejtash etj.

- **Së treti**, pretendimi juaj se kemi të bëjmë me ndërtime me sipërfaqe të vogla apo me ndërtime në zona rurale, bëjmë me dije se ligji nuk parashikon kritere përjashtimore apo lehtësira në këto raste për evitim dokumentacioni si raporte të eficensës, sizmiologjik, arkeologjik, gjeologjik, etj.. Në lidhje me pretendimin tuaj për ligjin Nr.10440 Datë 07.07.2011“Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, lutemi në vëmendjen tuaj Shtojca II, pika 1/ b dhe d : -*Shtojca II Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis 1. Bujqësia, silvikultura dhe akuakultura. b) Projekte për përdorimin e tokës së pakultivuar ose zonave gjysmë natyrore për qëllime të bujqësisë intensive; d) Instalime për rritjen intensive të kafshëve (projektet që nuk përfshihen në shtojcën I);*

- **Së katërti**, shpreheni se sektori i Gis-Kadastrës nuk funksionon dhe ka mungesë specialistësh. Kjo është në kundërshtim me rregulloren dhe bazën ligjore si funksionon struktura e Bashkisë e për rrjedhojë duke krijuar problematika në përpunimin dhe trajtimin e pronës sipas Gis-Kadastrës. Ky sektor është pjesë e Drejtorisë Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në strukturë, për rrjedhojë drejtori i kësaj drejtorie ka detyrimin e propozimit dhe krijimit të sektorit të Gis Kadastrës pranë Bashkisë duke u miratuar kjo dhe nga Kryetari i Bashkisë.

- **Së pesti**, shpreheni se auditimi mbi këto leje nuk qëndron për faktin se lejet janë të pavlefshme duke qënë se nuk janë aplikuar ne sistemin e leje deklarate për fillim punimesh, sqarojmë që ky pohim ska bazë ligjore. KLSH auditon nëse këto leje janë dhënë nga institucioni në përputhmëri me ligjin (kryesisht vkm 408/2015) dhe proceduralisht të bazuara në ligj, cka presupozon momentin e lëshimit të lejes së zhvillimit/ndërtimit, pra fakti e destinacionit përfundimtar te saj (të cilën skeni detyrimin ta percaktoni dhe ta parashikoni) nuk e zhvesh institucionin tuaj nga përgjegjësia ligjore.

- **Së gjashti**, në kundërshtim me nenin 15, **pikën b)** *Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta;*

-Në kuptim të saj, akt marrëveshje /kontratë sipërmarrje e lidhur midis zhvilluesit, pronarëve të truallit (apo përfaqësuesit të tyre me prokurë) dhe subjektit ndërtues që do të kryej punimet, e cila duhet të jetë e lidhur para noterit/nëpunësit publik. Në lidhje me këtë pikë parashtroni që dokumenti i pronësisë figuron i rifreskuar nga ashk etj, ju orientojmë të lexoni qartazi ligjin pasi vërehet që ka një moskuptim të materies ligjore. Kjo pikë shpreh atë çfarë cituam më lart (kontratë sipërmarrje), ndërsa lidhur me pretendimin tuaj që subjekti aplikues është edhe zhvillues, kjo nuk përbën arsye pasi zhvillues/investitor mund të jesh në pronën tënde por ke detyrimin ligjor të lidhesh kontratën me një shoqëri ndërtuese.

- **Së shtati, pikën e)** *Deklarata e projektuesit të licencuar, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit, nëpërmjet së cilës konfirmohet përputhshmëria e projektit me lejen e zhvillimit, dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit, në fuqi, dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjieno-sanitare; kjo ne referim te VKM Nr.650/2019 “Për sigurimin e ndërtimeve”.*

-Referohemi në pikën sipërcituar në mungesë të raportit gjeo-sizmik në zbatim të VKM Nr.650/2019 “Për sigurimin e ndërtimeve”. Lidhur me pretendimin tuaj mbi pikën 15 të VKM Nr.408/2015 sjellim në vëmendje dispozitat antizismike (duke nëvniëzuar ne akt konstatim, në zbatim te VKM Nr. 650/2019).

- **Së teti, pikën ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit;**

-Në kuptim të saj, licenca e subjektit ndërtues me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Subjekti duhet të jetë i regjistruar në QKR.

- **Së nënti, pikën v) Projektin e eficiencës energjetike, në rastet kur është e detyrueshme me ligj (ligji nr.124/2015 “Per eficensen....”), të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, Datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar . Në procedurën e dhënive të lejes së zhvillimit dhe lejeve të ndërtimit, të rehatojnë sipas rastit mbi rregullat e vecanta dhe hapësirat ligjore/teknike ku bazohen për ndryshim parametrash në kate, volum, lartësi (përsa parashikon dispozita të veçanta PPV për Bashkinë Cërrrik) dhe kohën e përdorimit të ndërtesës (kjo në vëmendje të observacionit nga ana juaj përsa i përket ligjit Nr.116/2016“Për performancën e energjisë në ndërtesa), pasi konstatimet janë kryer bazuar në parashikimet ligjore për secilën njësi nënstrukturore dhe ligjit Nr.124/2015 “Për eficensen”.**

- **Së fundmi, në parashtrim të prapësimeve si më lart si dhe bazuar në VKM Nr.408, Datë 13.05.2015“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar dhe me Ligjin Nr.107/2014“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, ku vërehet që bien ndesh me disa nga pikat e bazës ligjore sipërcituar për rrjedhojë observacioni juaj nuk mund të merret parasysh nga Kontrolli i Lartë i Shtetit por ky i fundit ju orienton drejt interpretimit të ligjit në përpikmëri dhe me përgjegjshmëri të lartë duke rritur profesionalizmit tuaj ligjor dhe teknik nëpërmjet trajnimeve dhe precedenteve të zonave më urbane në Republikën e Shqipërisë.**

✓ **Përgjigja nga KLSH mbi observacionin është e konturuar në disa pika shtjellimi në vija të përgjithshme duke qënë para faktit që të njëjtat pretendime janë nga juaj pothuajse për secilën çështje të trajtuar.**

Auditimi i Lejeve Infrastrukturore dhe lejet e ndërtimit me zhvillues Bashkia Cërrrik:

Nga auditimi i Lejeve Infrastrukturore dhe lejeve ndërtimore me zhvillues bashkia rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë dhënë nga 4 leje infrastrukturore të miratuara nga Kryetari i Bashkisë Cërrrik dhe 4 leje ndërtimi me Zhvillues Bashkia Cërrrik si vijon:

Nr	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Nr. Prot.i aplikimit	Data e aplikimit	leje zhvillimi	Vendimi Leje ndërtimi	Sipërfaqe totale ndërtimi	Preventivi Sipas subjektit
1	Ndertimi i zyrave te Njesise Administrative Klos, Bashkia Cërrrik	214	15.05.2020	Vendimi Nr. 198 date 03.03.2020	Vendimi Nr. 214 date 04.06.2020	164 m2	7,499,914.00
2	Rikonstruksion I rruges Qyrkan	222	06.07.2020	Nuk ka	Vendimi Nr. 222 date 20.07.2020	5870 m2	26,970,393.00
3	Rehabilitimi urban i bllokut Nr. 3, lagja Nr. 2	2449	18.09.2020	Nuk ka	Vendimi Nr. 232 date 28.09.2020	-	14382945
4	Parkim publik, gjelberim dhe ndricim	3069	06.11.2020	Vendim Nr. 226 date 04.08.2020	Vendimi Nr. 239 date 20.11.2020	Sip. Prones qe zhvillohet 1850 m2 sip. Ndert. 14 m2	14,997,853.00
5	Rikonstruksion objekti 2-kate per ndryshim destinacioni, nga magazine ne banesa sociale	3084	09.11.2020	Nuk ka	Vendimi Nr. 240 date 20.11.2020	484 m2	13,634,256.00
6	Rikonstruksion i rruges Lushallive te fshatit Shtermen	40/1	07.01.2022	Nuk ka	Vendimi Nr. 300 date 14.01.2021	3213 m2	23,012,669.85

7	Rikualifikim urban i bllokui Nr. 2, lagja Nr. 1 dhe rikualifikim i bllokut Nr. 2 lagja Nr. 2	556	18.02.2022	Vendim Nr. 303 date 04.03.2022	Vendimi Nr. 308 date 11.03.2022	7421 m2	45,994,110.00
8	Rikonstrukcion i nderteses ekzistuese 2 kate + ndertim palestere me ambiente ndihmese 1 kate dhe ndertim kopshti per femijet ne shkollen Beqir Sade	2401	16.08.2022	Vendimi Nr. 1654/1 date 20.05.2022	Vendimi Nr. 2401/3 date 19.09.2022	485.14	56,000,026.00

Burimi: DPZHT

Nga auditimi i lejeve infrastrukturore dhe lejeve të ndërtimit ku zhvilluesi dhe përfituesi është Bashkia Cërrik rezultuan mospërputhje midis lejeve të miratuara në sistemin e lejeve dhe investimeve të kryera nga vetë bashkia. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar si dhe V.K.M.-së Nr.408, Datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me V.K.M.-në Nr.271 Datë 06.04.2016 “Për një ndryshim në V.K.M.-në Nr. 408 Datë 13.05.2015”.

2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore.

I-Mbi krijimin e organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit.

Struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë Cërrik (IMTV) për vitin 2022 është miratuar me VKB nr. 85, datë 28.12.2021, i ndryshuar “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Cërrik dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara”, ku përfshihet Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor e cila përbehet nga **3** punonjës, nga të cilët **1** kryeinspektor dhe **2** inspektorë në fakt aktualisht në punë janë Kryeinspektori dhe dy Inspektorë.

Spektori i IMT Bashkia Cërrik nuk funksionon në parametrat tekniko-ligjor të duhur duke filluar nga burimet njerëzore rezultojnë në kundërshtim me nenin 11 të ligjit Nr. 9780 Date 16.07.2007 i ndryshuar, Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit ndërtimor e urbanistik - “Kryeinspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik në nivel bashkie/komune/qarku/kombëtar dhe inspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit. Inspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik në nivel bashkie/komune/qarku mund të kenë arsimin e mesëm profesional në fushën e ndërtimit”.

Sa me sipër është konkluduar, pasi **Z. F.Q** me detyrë kryeinspektor pranë Sektorit të IMT, Bashkia Cërrik është i diplomuar në Shkenca Politike, **Z. K.M** me detyrë inspektor pranë Sektorit të IMT, Bashkia Cërrik është i diplomuar në Drejtësi dhe **Z. S.SH** me detyrë inspektor pranë Sektorit të IMT, Bashkia Cërrik i diplomuar në Inxhinieri Elektronike.

II.Përshkrimi i situatës për periudhën 01/01/2020-31/12/2022

Në ushtrimin e detyrave funksionale të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Cërrik për periudhën objekt auditimi, aktiviteti i veprimtarisë së punës në terren i cili është pasqyruar dhe dokumentuar me procesverbale konstatimi dhe për më tej me vendime pezullimi punimesh dhe vendime për prishje objekti të ndërtuar pa leje ndërtimi, në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën në vijim.

Në formë table paraqiten vendimeve të marra nga IMTV për vitin 2022 si vijon:

Nr.	Lloji i aktit	2022
1	PV/Akte kontrolli	0
2	PV/Akte konstatimi	22
3	Vendime gjobe	21
4	Vendime pezullimi	4
5	Vendime prishje	17
6	PV ekzekutimi të prishjeve	0
7	Kallëzime penale	-
8	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	16
9	Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT	4
10	Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori	0
11	Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori	6

Nga auditimi rezultoi se Sektori i IMT, Bashkia Cërrik për periudhën 01.01.2021 deri me 31.12.2022 **nuk ka një plan pune vjetor** për të gjithë harkun kohor të viteve objekt auditimi, vërehet se kane të përcaktuar një plan pune vetëm për muajin Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2022 ndërsa përsa i përket periudhës tjetër para nuk rezulton asnjë shkresë apo memo mbi planin e punës, detyre dhe përgjegjësi kjo e Kryetarit të Bashkisë Cërrik, Z. A.S dhe Z. F.Q me detyre kryeinspektor pranë Sektorit të IMT, Bashkia Cërrik.

III. Burimi i krijimit të të ardhurave, bazuar në kuadrin rregullator ligjor / nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

Titulli i gjetjes: Krijimi i debitorëve nga mos arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) në vlerën **8,880,000** lekë.

Situata: Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Cërrik për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si vijon:

Nr	Viti	Nr Subjek.	Vlera e Gjobës	Arkëtuar				Debitor	% Realizim
				Gjoba	Kamat vonesa	Totali	Nr Pers.		
1	Gjëndje 31.12.2021	24	8.880.000 lekë	0	-	-	-	24	0%
2	31.12.2022	12	4.800.000 lekë	0	-	-	-	12	0%
	SHUMA	21	13.680.000 lekë	0	-	-	-	21	0%

Burim: Bashkia Cërrik

Sa më sipër rezultoi se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Cërrik **nuk është njoftuar zyrës juridike për vazhdimin e procedurave për arkëtimin e gjobave të vendosura.** Nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit (IMT) Bashkia Cërrik për periudhën objekt auditimi janë vendosur 12 gjoba në vlerën **4,800,000 lekë** nga të cilat nuk është arkëtuar asnjë lekë si dhe për periudhën përpara vitit 2022 janë vendosur gjithsej 24 në vlera **8,880,000 lekë**, të cilat nuk janë shpallur titull ekzekutiv, por që nuk ka filluar procesi i kërkimit të tyre duke **sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën prej 13,680,000 lekë.**

Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikat IMT-ja, Drejtoria Juridike nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Cërrik në vlerën prej **13,680,000 lekë**, në kundërshtim me: **a-neni 16**, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime, **përcaktohet se:** -Gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj**. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.

-**Neni 15**-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni 1)(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3);

b-nuk janë nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjobjës) të përcaktuara në nenet, 9,22 dhe 30, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

c-Nga Drejtoria Juridike dhe IMTV, nuk është kërkuar në Gjykatë, shndërrimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar.

d-Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike të Bashkisë Cërrik nuk ka marrë masat dhe nuk ka kërkuar në Gjykatë rivendosjen në afat të 31 vendimeve të gjobave në vlerën **8,880,000 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996, "Kodi i Procedurës Civile në RSH" i ndryshuar, nenet 17 dhe 55- Vënia në ekzekutim, shkronja (ç) **ku përcaktohet se:** Vënia në ekzekutim e urdhrit të ekzekutimi bëhet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kreditorit dhe nenet 151 dhe 152, të "Kodit Procedurës Civile në RSH-se"

Kriteri:

Neni 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime; **Neni 15**-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni 1)(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3); - **Nenet**, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

Shkaku:

Mos vjelja e gjobave të vendosura nga IMT –ja.

Ndikimi/Efekti

Mungesë të ardhurash nga mos arkëtimi i penaliëve dhe prishje të planit urbanistik nga ndërtimet pa leje dhe në kundërshtim me lejet e ndërtimit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar në vlerën 8.880.000 Lekë sipas **aneksit nr. 1 pika 6 bashkëlidhur raportit të auditimit.**

IV.Vendimet e marra nga IMT për prishjen e objekteve pa leje ndërtimi.

Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i vendimeve të mara nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje ndërtimi.

Situata:

Për periudhën objekt auditimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin 9780/2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga

IKMT dhe INUV” i ndryshuar, IMT Bashkia Cërrik, ka marrë **17** (shtatëmbëdhjetë) vendime për prishje objkesh pa leje (sipas tabelës së mëposhtme), vendime të cilat rezultojnë të pa ekzekutuara.

Në **17 (shtatëmbëdhjetë)** raste rezulton se është mbajtur procesverbal konstatimi dhe procesverbal prishje, por nuk është marrë asnjë masë tjetër nga ana e IMT Bashkia Cërrik për prishjen e ndërtimeve dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, për të cilat nga IMT duhej vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar dhe konkretisht neni 10, *veprimi dhe mosveprimi kanë të njëjtën pasojë juridike për rrjedhojë, ngarkojnë me përgjegjësi K/Inspektorin Z.F.Q, inspektorin Z.K.M si dhe inspektorin Z.S.SH.*

Pasqyra mbi vendimet e marra nga IMT për prishjen e objekteve pa leje ndërtimi për periudhën 01/01/2021– 30/09/2022 si vijon:

I. Nr	Emri Subjektit (Shoqëria)	Lloj objektit	Vendimi	
			Nr.	Datë
1	H.Z	Rindërtim objekti 1 kat nga themeli.	0021	29.04.2020
2	G.D	Rindërtim objekti 1 kat nga themeli.	0022	19.06.2021
3	H.B	Rrethim i objektit me mur tulle.	0023	01.09.2021
4	M.M	Rindërtim objekti nga themeli dy kate.	0024	03.09.2021
5	F.M	Ndërtimi në zhvillim i konstruksionit metalik.	0025	08.09.2021
6	R.H	Shtesë objekti në pjesën ballore.	0026	20.10.2021
7	B.C	Ndërtim pa leje, 1 kat.	0027	28.10.2021
8	M.M	Shtesë kati dytë.	0028	29.10.2021
9	B.F	Shtesë kati dytë.	0029	22.11.2021
10	E.SH	Ndarja e mureve me mur tulle, në katin e poshtëm të objektit ekzistues.	0030	22.11.2021
11	A.S	Dy objekte në zhvillim me përmasa (5m me 4m dhe 3m l, 23m me 7m dhe 6.5m l).	0031	07.02.2022
12	H.D	Themelet e përfunduara dhe kollonat e ngritura.	0032	02.03.2022
13	H.M	Kati i dytë+çati.	0033	13.05.2022
14	M.D	Muri rrethues i ndërtuar pa leje në pjesën veri-lindje.	0034	18.05.2022
15	N.P	Ndërtimi i katit të nëndheshëm.	0035	06.06.2022
16	L.G	Rikonstruksion i objektit ekzistues nga fillimi.	0036	20.07.2022
17	A.B	Ndërtimi i murit rrethues.	0037	26.08.2022
18	S.G	Shtesë kati dytë.	0038	27.10.2022
19	F.B	Shtesë anësore në katin e dytë të objektit ekzistues.	0039	12.12.2022

Burimi: Bashkia Cërrik

Kriteri:

Neni 10 i ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “ Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV” i ndryshuar.

Shkaku:

Moszbatimi i procedurave për prishjen e objekteve pa leje.

Ndikimi/Efekti

Mungesa e besueshmërisë në funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti, dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, duke zbatuar vendimin e prishjes së objektit. Në rast kundërshtimi ndajë personave përgjegjës, të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndaj shkelësve.

V. Zbatimi i ligjit dhe procedurës ligjore nga IMTV Bashkia Cërrik si dhe shtrirja e efekteve të saj.

a-Ne kundërshtim me nenin 6 të ligjit Nr. 9780 Datë 16.07.2007 i ndryshuar, Bashkëpunimi dhe delegimi i përgjegjësive dhe detyrave për inspektimin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës, “Bashkia/komuna mund t’i delegojë qarkut, në të cilin ajo është pjesë përbërëse, përgjegjësitet dhe detyrat e parashikuara në nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, sipas një marrëveshjeje të lidhur midis palëve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. **Bashkia/komuna mund t’i ushtrojë përgjegjësitet dhe detyrat e parashikuara në nenet 4 dhe 5, në bashkëpunim me një ose disa njësi vendore, në bazë të një marrëveshjeje ose kontrate, në përputhje me legjislacionin në fuqi.**

Sa me sipër është konkluduar, pasi: - Ndërmjet **Inspektoriatit Mbrojtjes Territorit, Bashkia Cërrik dhe Këshillit të Qarkut, Elbasan** si dhe po ashtu **Inspektoriatit Mbrojtjes Territorit, Bashkia Cërrik dhe Njësi Administrative, Cërrik** nuk ka një marrëveshje të administruar sipas ligjit pranë institucionit mes tyre si më sipër, për delegim dhe ushtrim të përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara.

b-Në kundërshtim me nenin 5 të ligjit Nr. 9780 Date 16.07.2007 i ndryshuar “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës merr masat e mëposhtme”: - **d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;**

Sa me sipër është konkluduar, se nuk është bërë ekzekutimi i vendimeve për prishje të objekteve Dt.01.01.2020 deri ne 31.12.2022 të paligjshme duke u shprehur me shkresë Nr.242 Prot., Dt.23.01.2023 nga IMT, Bashkia Cërrik se jemi në kushtet e mungesës së mjeteve motorike dhe në pritje të sigurimit të mjeteve motorike. **Ndërkohë konstatohet që nuk administrohet një shkresë përcjellëse nga IMT, Bashkia Cërrik drejtuar Kryetarit të Bashkisë Cërrik apo instanca më lart me lëndën për kërkesë për fond publik lidhur me mjetet motorike për blerje në funksion dhe mbarëvajtje të këtij sektori publik.**

c-Ne evidencën e kryer mbi procedurën e ndjekur vërehet se Inspektoriatit Mbrojtjes Territorit, Bashkia Cërrik në asnjë moment nuk ka kryer një korrespondencë me institucione të tjera, ndalemi këtu në korrespondencën e domosdoshme me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, respektivisht Sektori i Legalizimeve pranë kësaj drejtorie për të

kërkuar një shkresë apo konfirmim nëse këta subjekte që i nënshtrohen prishjes, gjobës etj nga IMT, Bashkia Cërrik kanë vetdeklarim për ndërtim pa leje, nëse ky vetdeklarim është në sistemin e tyre, nëse ka raste përjashtimore të vetdeklarimeve duke u bazuar në ortofoton fotografimin ajror në vite në referim të **Ligjit Nr.20/2020** “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe **VKM Nr.1040, Datë 25.11.2020** “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”.

Kriteri:

Neni 5 dhe 6 i ligjit Nr. 9780, Datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 862, Datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV” i ndryshuar.

Shkaku:

Moszbatimi i procedurave për prishjen e objekteve pa leje dhe moszbatim i parashikimeve ligjore.

Ndikimi/Efekti

Mungesa e besueshmërisë dhe profesionalizmit në funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit dhe mungesa e bashkëpunimit me institucionet e tjera në varësi apo jo me qëllim efektivitetin dhe ligjshmërinë në veprime apo mosveprime që parashikon ligji.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Inspektorati i Mbrojtjes Territorit të marrë masa në rekrutimin e burimeve njerëzore duke ngritur profesionalizmin e tyre me qëllim njohjen dhe zbatimin e procedurave ligjore si dhe detyrimin për bashkëpunim me institucionet e tjera.

Për veprime dhe mosveprime ngarkohen me përgjegjësi:

Z. A.S, Kryetar i Bashkisë Cërrik.

Z. F.Q, me detyrë, Kryeinspektor i Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit Vendor Cërrik.

Z. K.M, me detyrë Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit Vendor Cërrik.

Z. S.SH, me detyrë Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit Vendor Cërrik.

2.7 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

Objekti i verifikimit është zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin e auditimit të mëparshëm dërguar në Bashkinë Cërrik me nr. 58/7 prot., datë 16.05.2022.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Cërrik pika 7 e Programit të Auditimit financiar dhe përputhshmërisë” nr. 1174/1 prot., datë 09.01.2023, “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” rezultoi si më poshtë vijon:

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se janë rekomanduar gjithsej:

b. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 15 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 15 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 6 masa, janë në proces zbatimi 7 masa organizative dhe 2 masa nuk janë është zbatuar.(rekomandimi nr. 1 dhe nr. 9)

c. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, janë rekomanduar 6 masa, nga të cilat janë pranuar plotësisht 6 masa, dhe janë në proces zbatimi 6 masa.

d. Masa disiplinore, i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Cërrik t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e

përgjegjesisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse. Ky rekomandim nuk është zbatuar.

DREJTIMIT E AUDITIMIT:

1. Hartimi i programit (Plan veprimi) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

1. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Cërrrik rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 58/7, datë 16.05.2022, ndërsa nga Bashkia Cërrrik për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor.

Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Cërrrik, ishin marrë masat si vijon:

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë janë caktuar personat përgjegjës “Për hartimin e plan veprimi dhe akteve të tjera për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

Zbatuar pjesërisht

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

2. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Cërrrik rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 58/7, datë 16.05.2022, dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 16.11.2022 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA), por nuk është raportuar brenda kësaj date në KLSH.

Pa zbatuar

B. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Cërrrik 15 masa organizative, të cilat janë pranuar prej tyre, janë zbatuar plotësisht 6 masa, janë në proces zbatimi 7 masa dhe 2 masa organizative (rekomandimet nr.1, dhe nr. 9) nuk janë zbatuar. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

- Bashkia Cërrrik nuk ka miratuar Kodin Etik, në kundërshtim me Ligjin nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”, Ligjin nr. 10296, Kreu III, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2/a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit”.

- Nuk është hartuar “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, përveç trajnimeve që kryhen nga ASPA.

Në informacionin e sjellë nga Burimet Njerëzore në vitin 2020 janë kryer vetëm 14 trajnime për 2 punonjës të Bashkisë Cërrrik dhe për vitin 2021 vetëm 70 trajnime për 13 punonjës.

Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-së në fushën e Menaxhimit të Riskut.

Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik.

- Bashkia Cërrrik nuk ka miratuar “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”, e cila duhet të përditësohet rregullisht (çdo 3 vite), në zbatim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK- së dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pikën 5.3.

- Procesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse në mos zbatim të Ligjit 10296 datë 08.07.2010, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut njësitë publike”.

- Në mbështetje të Ligjit nr. 10296 dt 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 27, në zbatim të Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK në Njësitë Publike” pika 2/2,4, nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Bashkia Cërrrik nuk ka miratuar Plan Pune Vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.

- Në Bashkinë Cërrrik, drejtorja e financave përdor programin Excel. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave dhe kjo kryhet nga drejtorja e financave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.

- Për periudhën janar- prill 2020-2021 raportimi monitorimit nuk është dërguar në MFE. Për periudhën janar-gusht nuk është dërguar në MFE raportimi për vitin 2020, ndërsa për vitin 2021 janë bashkëlidhur vetëm detyrimet e prapambetura. Për periudhën janar-dhjetor është dërguar në MFE, për vitin 2020 dhe për vitin 2021, ku janë bashkëlidhur vetëm detyrimet e prapambetura. Përpilimi i tyre nuk është kryer në formatin e duhur si dhe nisja e tyre nuk është kryer brenda afatit të përcaktuar në pikën 48, të urdhrit nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore”, 3.2.

- Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm.

- Bashkia Cërrrik nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 15-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Bashkia Cërrrik me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:

- Të hartojë planin e trajnimeve;
- Të organizojë trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
- Të aplikojë programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar;
- Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”;
- Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”;
- Të raportojë periodikisht lidhur me kryerjen e procesit të monitorimit.

1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrrik, sipas urdhrit nr. 428, datë 06.10.2022, janë ngarkuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Sipas dokumentacionit të paraqitur rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditit të Brendshëm për vitin 2020 dhe 2021 është miratuar në strukturë me 3 punonjës, por në fakt ka funksionuar vetëm me një punonjës në kundërshtim me Vendimin Nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njërive të auditimit të

brendshëm në sektorin publik”, pika 3. Mos plotësimi i kësaj strukture nuk jep siguri në realizimin e misionit të auditimit të brendshëm.

Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”.

Referuar Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” Njësia e Auditit të Brendshëm nuk e ka hartuar dhe miratuar “Kodin e Etikës” në Bashkinë Cërrrik.

Nuk janë hartuar dhe miratuar sipas viteve: për vitin 2020 plani strategjik për vitet 2020 – 2022 dhe për vitin 2021 plani strategjik 2021- 2023 në kundërshtim me përcaktimet e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, Kapitulli 3, pika 3.1.6 dhe 3.1.7.

Auditimet e planifikuara për periudhën e auditimit kanë nivel të ulët realizimi.

Për vitin 2020 realizimi i auditimeve është në masën 30 %, nga 10 auditime të planifikuara janë realizuar 3 auditime të cilat nuk janë planifikuar si auditime.

Për vitin 2021 realizimi i auditimeve është në masën 66 %, nga 6 auditime të planifikuara janë realizuar 4 auditime nga të cilat 3 prej tyre nuk janë planifikuar si auditime. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 15-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Bashkia Cërrrik të marrë masa për plotësimin e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, të miratojë Kodin e Etikës dhe planet strategjike si dhe të ngrijë Komitetin e Auditimit, që të jetë një mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm si një organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë.

2.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrrik, sipas urdhrin nr. 426, datë 06.10.2022, janë ngarkuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Sipas dokumentacionit të paraqitur rezulton se është miratuar Kodi i Etikës dhe planet strategjike por nuk është ngritur Komiteti i Auditimit për shkak se nuk plotësohet numri i punonjësve për Komitetin e Auditimit. Gjithashtu edhe struktura e Auditit të Brendshëm rezulton e paplotësuar për shkak të mungesës së punonjësve të trajnuar për auditues.

Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve rezulton se nuk janë respektuar kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të Manualit të Auditit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, përkatësisht:

- Mungon njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit dhe programi i auditimit, në auditimet e kryera në vitin 2021 në shkolla dhe në Qendrën e Grumbullimit Klos dhe Ujitjen e tokave bujqësore;

- Plan Veprimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit;

- Nuk është dokumentuar nëse Drejtoria e Auditit të Brendshëm pas përfundimit të çdo angazhimi të auditimit të ketë njoftuar zyrtarisht subjektin e audituar, për reagimin ndaj projekt rekomandimeve të adresuara, konform detyrimit të përcaktuar në pikën 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm;

- Për vitet 2020-2021 nga NJAB nuk është realizuar një mision auditimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm;

- Grupet e auditimit në Bashkinë Cërrrik përbëhen vetëm nga një anëtar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 15-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm të marrë masa që në kryerjen e auditimeve të ndjekë të gjithë hapat e duhura të angazhimit të auditimit. Të plotësojë dosjet e auditimit me dokumentacionin përkatës duke filluar që nga njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit dhe në vijim dokumentacionin për të gjithë hapat e tjerë që ndjek një auditim. Të planifikojë dhe të kryejë auditime me qëllim vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

3.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrik, sipas urdhrit nr. 425, datë 06.10.2022, janë ngarkuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Sipas dokumentacionit të paraqitur rezultoi se ky rekomandim është zbatuar vetëm për njoftimin për fillimin e angazhimit të auditimit dhe të programit të auditimit ndërsa pikat e tjera nuk janë zbatuar për shkak se struktura nuk është e plotë.

Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Këshilli Bashkiak Cërrik nuk ka marrë Vendim për Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2020- 2022 dhe 2021- 2023, në kundërshtim me ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33, e specifikuar brenda datës 31 dhjetor.

- Nuk është bërë miratimi i tavanëve të buxhetit afatmesëm 2021-2023 me Vendim të Këshillit Bashkiak, në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.
- Nuk ka Vendim të Këshillit Bashkiak “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Cërrik për vitet 2021-2023”, në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.
- Hartimi i buxhetit nuk është mbështetur si duhet në konsultimin me komunitetin dhe grupet e interesit, pasi u konstatua mungesë dokumentacioni në këtë drejtim.
- Nuk ka mbledhje të dokumentuara të GMS për të diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Nuk dokumentohet mbledhja e njësive vendore dhe institucioneve të varësisë në lidhje me kërkesat e tyre buxhetore. Planifikimi Buxhetor Afatmesëm është kryer duke u mbështetur në PBA- të e viteve të mëparshme dhe jo mbi një analizë të mirëfilltë.
- Ka diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Shpenzimet faktike janë realizuar ndaj planit për vitin 2020 në masën 90.4 %, dhe me të ardhurat e tyre si bashki mbulojnë 12.5 % të shpenzimeve. Për vitin 2021 ka diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Shpenzimet faktike janë realizuar ndaj planit për vitin 2021 në masën 89 %, dhe me të ardhurat e tyre si bashki mbulojnë 11.2 % të shpenzimeve.
- Detyrimet kreditore për fund vitin 2019, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 25,584,390 lekë. Shlyerja e këtyre detyrimeve nuk është programuar si zë më vete i treguesve të buxhetit, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar pika 101. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Bashkia Cërrik të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe të analizohet brenda muajit qershor të çdo viti zbatimi i buxhetit. Të dokumentohet procesi i konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore. Këshilli Bashkiak Cërrik të marrë vendimin për miratimin e kalendarit të përgatitjes së

Programit Buxhetor Afatmesëm brenda afatit si dhe të miratojë tavanet e buxhetit afatmesëm, vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave.

4.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrik, sipas urdhrin nr. 424, datë 06.10.2022, janë ngarkuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Sipas dokumentacionit të paraqitur rezultoi se është miratuar kalendari i miratimit të PBA me shkresën nr.25 e datës 26.03.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan nr. 484/1, datë 07.04.2022.

Zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave nëpërmjet bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30-ditor të paraqitjes dhe miratimit në Degën e Thesarit Elbasan, të faturave për shpenzime/ shërbime/investime të mbërritura në institucion, rezultoi se janë kryer pagesa jashtë afatit 30 ditor, në 29 raste në vlerën 28,808,138 lekë nga e cila: për vitin 2020 janë 11 fatura me vlerë 15,283,956 lekë dhe për vitin 2021 janë 18 fatura me vlerë 13,524,182 lekë. Ky fenomen vjen nga mosrealizimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52.

Gjithashtu, nga Bashkia Cërrik, evidentohen dhe fatura të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre kjo për efekt të mungesës së fondeve nga realizimi i të ardhurave vendore. Kështu për periudhën objekt auditimi 01/01/2020 – 31/12/2021, paraqiten gjithsej 33 fatura me vlerë 191,083,484 lekë, nga e cila: për vitin 2020 janë 25 fatura me vlerë 51,818,149 lekë dhe për vitin 2021 janë 8 fatura me vlerë 139,265,335 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandim: Nëpunësi autorizues dhe zbatues të marrin masa për shlyerjen brenda afatit 30 ditor të të gjitha faturave që kanë si detyrim për likuidim ndaj të tretëve, duke eliminuar në këtë mënyrë krijimin e detyrimeve të prapambetura, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe futjen e institucionit në vështirësi financiare.

5.2 Nga verifikimi rezultoi se: Debia ka qenë në vlerën 181,333,663 lekë, nga e cila vlera prej 36,236,536 lekë janë detyrime të FSHZH dhe vlera prej 145,097,127 lekë janë detyrime të Bashkisë Cërrik. Nga kjo debi janë shlyer gjatë vitit 2022, 78,526,300 lekë, ose 54% e vlerës. Tashmë ka mbetur pa shlyer vlera prej 66,567,767 lekë detyrime të Bashkisë dhe vlera prej 36,236,536 lekë detyrime të FSHZH-se. Vërtetohet me dokumentacionin bashkëlidhur urdhrin për zbatimin e rekomandimeve.

Në proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Raporti i detyrimeve të prapambetura për vitin 2021 nuk i është nisur Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nga Bashkia Cërrik. Sipas raportit të dërguar MFE-së për vitin 2020, detyrimet e prapambetura rezultojnë në vlerën 75,571,176 lekë ndërkohë në Pasqyrat Financiare të mbyllura për vitin 2020 rezultojnë në vlerën 111,807,712 lekë në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me kundër parti llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 111,807,712 lekë, me diferencë në vlerën 36,236,536 lekë më shumë se vlera e raportit dërguar MFE-së. Në Pasqyrat Financiare është bashkangjitur edhe vlera e papaguar e FZHR-së, fatura tatimore të papaguara që nga viti 2014, me vlerë 36,236,536 lekë. Në buxhetin e miratuar 2021 vlera e detyrimeve të prapambetura deri në dhjetor 2020 rezultoi 112,139,112 lekë, e cila nuk përkon as me vlerën e paraqitur në Pasqyrat Financiare për vitin 2020 dhe as me vlerën e nisur me shkresë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Detyrimet nga viti 2020 në vitin 2021 janë shtuar në vlerën 69,525,951 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936,

datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 40 “E drejta për të kryer shpenzime”; UMF nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014; Udhëzimin plotësues nr. 2 të MF, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësitëve të Vetëqeverisjes Vendore”; UMF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësitëve të vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandim: Bashkia Cërrik të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të trashëguara nga vitet e mëparshme, duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.

6.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sipas dokumentacionit të paraqitur rezultoi se me shkresën nr. 460 prot., datë 10.02.2022, i është dërguar Ministrisë së Financave raporti 12 mujor për vlerësimin e situatës financiare për vitin 2021 dhe treguesit fiskal si dhe planin e shlyerjes së stokut të detyrimeve për 3 vitet në vazhdim. Gjithashtu është rishikuar dhe detajuar me vendimin nr. 53, me nr. 2293 prot., datë 01.08.2022 “plani i rehabilitimit për daljen nga situata e veshtirësisë financiare”, të miratuar nga këshilli bashkiak Cërrik dhe konfirmuar me shkresën nr. 912/1 prot., datë 09.08.2022 nga Prefekti i Qarkut Elbasan, është hartuar plani afatshkurtër 2022-2023 për të shmangur krijimin e detyrimeve të reja dhe likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Në proces zbatimi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se strukturat e Bashkisë Cërrik nuk kanë një bashkëpunim efektiv midis tyre lidhur me dërgimin e informacion në Drejtorinë e Tatim Taksave i cili do të përdoret për planifikimin e të ardhurave të bashkisë. Metodologjia e përdorur nga Drejtoria e Tatim Taksave Vendore për planifikimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore nuk është e saktë pasi të dhënat që përdoren nuk janë të plota dhe të përditësuara duke sjellë që niveli i planifikimit të të ardhurave të mos jetë real.

Drejtoria e Tatim Taksave për planifikimin e taksës së tokës bujqësore i referohet të dhënave që ka nga ish komunat lidhur me sipërfaqen e tokës që familjet zotërojnë me AMTP. Këto të dhëna i përkasin vitit 2015 dhe nuk janë përditësuar në vijim.

Për planifikimin taksës mbi ndërtesat, DTTV i referohet të dhënave që disponon si dhe përditësimeve që vijnë si rezultat i finalizimit të procesit të legalizimit, apo verifikimeve në terren nga specialistët e tatim-taksave. Bashkia Cërrik nuk merr informacion dhe të dhëna periodike nga ASHK mbi pronësinë dhe sipërfaqen e ndërtesave të cilat duhen për llogaritjen e taksës së ndërtesës në kundërshtim me VKM-së nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa” neni 2, neni 4, dhe ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” neni 24. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Cërrik të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me ASHK-në degën vendore me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e planifikimit dhe të realizimit.

7.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrik, sipas urdhrit nr. 434, datë 06.10.2022, janë ngarkuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij

rekomandimi. Sipas dokumentacionit të paraqitur rezulton se nga ana e drejtorisë së tatim taksave ka pasur bashkëpunim me strukturat e tjera të bashkisë për realizimin e kësaj mase.

Zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave në Bashkinë Cërrik rezulton se janë në total 8,792 ha tokë dhënë familjeve me AMTP. Drejtoria e Tatim Taksave Vendore për të bërë planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës llogarit të ardhura për sipërfaqen totale prej 6,749 ha në vlerën e pritshme të arkëtimeve 16,314,800 lekë. Diferenca në sipërfaqe e cila nuk tatohet është 2,043 ha tokë. Mos përcaktimi i sipërfaqes në pronësi sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet rast pas rasti është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, aneksi 2, si dhe Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale 2020-2021. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave të dërgojë informacion të plotë dhe të saktë pranë Drejtorisë së Tatim Taksave Vendore mbi sipërfaqen e tokës bujqësore të dhënë më AMTP familjeve në Bashkinë Cërrik si dhe të bashkëpunojë midis tyre me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës së tokës bujqësore për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Cërrik.

8.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrik, sipas urdhrit nr. 436, datë 06.10.2022, janë ngarkuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Sipas dokumentacionit të paraqitur rezulton se nga ana e drejtorisë së pyjeve dhe kullotave ka pasur bashkëpunim me drejtorinë e tatim taksave për realizimin e kësaj mase.

Zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë në Bashkinë Cërrik kryhet në programin Excel. DTTV nuk kryen regjistrim manual të të dhënave dhe çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Cërrik i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; neni 4, zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7, “Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Bashkia Cërrik të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit, ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifave vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.

9.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrik, sipas urdhrit nr. 422, datë 06.10.2022, janë ngarkuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Sipas dokumentacionit të paraqitur rezulton se kjo masë është e pazbatuar për shkak të mosmiratimit në buxhet të fondit për blerjen e programit.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe i akt marrëveshjeve për likuidimin e detyrimeve vendore me këste, rezulton se ato janë lidhur në kundërshtim me përcaktimet ligjore për këtë qëllim, si vijon:

- Në asnjë rast nuk kemi kërkesë me shkrim nga ana e tatimpaguesit për të hyrë në marrëveshje për pagesë me këste referuar ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, pika 2;
- Akt marrëveshjet nuk kanë formën dhe përmbajtjen e një dokumenti zyrtar dhe nuk janë të firmosura nga ana e drejtuesit të DTTV, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, pika 3;
- Nuk rezulton që nga DTTV të jetë kërkuar garanci bankare përpara se të pranohet një marrëveshje për pagesat me këste, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, pika 5;
- Nuk janë përcaktuar afatet e likuidimit të detyrimeve sipas kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, pika 4, Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, pika 77.4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Cërrik gjatë hartimit të akt marrëveshjeve me subjektet debitorë të marrë masat që këto akt marrëveshje të kenë përmbajtjen dhe formën e dokumenteve zyrtare, si dhe të plotësojë dokumentacionin e duhur që justifikon dhe mbështet hyrjen në marrëveshje me subjektet për likuidimin e detyrimit me këste.

10.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrik, sipas urdhrit nr. 437, datë 06.10.2022, janë ngarkuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Sipas dokumentacionit të paraqitur rezulton se gjatë vitit 2022 nuk janë lidhur kontrata nga Drejtoria e tatim taksave.

Zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve dhe dokumentacionit lidhur me asetet e dhëna me qira rezulton se, Bashkia Cërrik (ish komunat) ka lidhur ndër vite kontrata për toka bujqësore të pa ndara dhe të abandonuara referuar kuadrit ligjor për tokat bujqësore si, ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826 deri 841 të tij, ligjin nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” dhe VKM nr. 531, datë 21.08.1998 "Për tokat bujqësore të pandara”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore. Referuar bazës së të dhënave të paraqitur grupit të auditimit u konstatua se, në total janë lidhur 597 kontrata nga njësitë administrative Mollas, Shalës dhe Klos (ish komunat). Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirave rezultojnë se nuk kanë zbatuar kushtet e kontratës lidhur me pagesën e qirasë 170 qiramarrës me vlerë totale të detyrimit 17,694,401 lekë si rezultat i kërkesave për ndërprerje të kontratës nga ana e qiramarrëse apo konstatimeve të strukturave të bashkisë që sipërfaqe të dhëna me qira si tokë bujqësore i takojnë fondit pyjor dhe kullosor apo për të njëjtën sipërfaqe është lidhur më shumë se një kontratë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik të marrë masa që të ngrëjë një komision për të verifikuar ligjshmërinë dhe zbatimin e të gjitha kontratave që janë lidhur nga ish komunat (sot njësitë administrative) me qëllim zgjidhjen përfundimtare të problemeve që janë konstatuar në vijimësi nga këto kontrata.

11.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrrik, sipas urdhrin nr. 420, datë 06.10.2022, janë ngarkuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Sipas dokumentacionit të paraqitur rezultoi se është ngritur komisioni për zbatimin e këtij rekomandimi.

Në proces zbatimi

12. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” si në mbyllje të vitit 2019 dhe në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën neto 1,692,300 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2019 dhe në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 1,692,300 lekë. Për këtë gjendje nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës për vlerën 1,692,300 lekë ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale. Veprime këto në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 53-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrrik të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në Llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Pronave Publike të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite, për të verifikuar saktësisht e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pa saktësisht të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

12.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sipas dokumentacionit të paraqitur rezultoi se është ngritur komisioni për zbatimin e këtij rekomandimi, i përbërë nga Znj. M.LL, Z. SH.L, Z.ZM, Z. E.B dhe Znj.A.LL. Përveç ngritjes së grupit të mësipërm, nuk na u vu në dispozicion asnjë dokument tjetër nëse është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i aktiveve të llogarisë 211.

Në proces zbatimi

13. Gjetje nga auditimi: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale në qarkullim (në vlerën bruto) për vitin 2020 është paraqitur i plotë, por për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Nga verifikimi i përlllogaritjeve të amortizimit të AAGJ materiale në qarkullim, rezultoi se përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit, duke aplikuar normat ligjore të amortizimit. Por konstatohet se, amortizimi është llogaritur për grup aktivesh në total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përlllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Mangësi që bien ndesh me kërkesat e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85. Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 53-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Pronës Publike të hartojë regjistrin e aktiveve me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre e ekzistencës fizike.

13.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sipas dokumentacionit të paraqitur rezultoi se drejtoria e financës dhe pronës publike e ka hartuar regjistrimin e aktiveve me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera në vite sipas rekomandimit të mësipërm. Bashkëlidhur regjistri i aktiveve.

Zbatuar

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, projekti “Rikonstruksion i Rrugës Liçaj” me kosto historike 817,692 lekë, megjithëse është marrë në dorëzim në vitin 2020, nuk është kapitalizuar pasi nuk është paguar për mungesë fondesh. Vlera e kapitalizuar për vitin 2020 është 2,197,533 lekë për kosto historike ndërsa vlera e bërë hyrje është 3,015,225 lekë. Kjo ka bërë të mundur nën vlerësimin e llogarisë 202 Studime dhe Kërkime në vlerën 817,692 lekë për vitin 2020. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 6,9 dhe 10, Urdhrit e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe konkretisht standardin kombëtar të kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” paragrafët 10 deri 19 dhe pikat 46 deri 55 të këtij standardi, UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 53-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Pronës Publike, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e projektme”, në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, investimet e të cilave nuk kanë përfunduar, duke e transferuar në debi të llogarive të aktiveve afatgjata materiale, vlerën 817,692 lekë e cila u përket objekteve të përfunduara në fund të vitit 2018. Të bëhet sistemimi kontabël në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit dhe të paraqiten në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit pasardhës.

14.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sipas dokumentacionit të paraqitur rezultoi se drejtoria e financës dhe pronës publike e ka analizuar në buxhet këtë rekomandim.

Zbatuar

15. Gjetje nga auditimi: KLSH ka dërguar në Bashkinë Cërrik Raportin Përfundimtar të Auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve dhe kërkesën për zbatimin e rekomandimeve të paraqitura ende me shkresën nr. 214/46 Prot, datë 13.04.2021. Në përfundim të auditimit të zbatimit të rekomandimeve nga KLSH janë rekomanduar 2 masa organizative, 8 masa shpërblim dëmi, 4 masa lidhur me të ardhurat e munguara dhe 3 masa administrative. Nga auditimi rezultoi se:

- Nuk është zbatuar 1 masë organizative që lidhet me marrjen e masave të nevojshme për të ndjekur me prioritet procedurat administrative dhe ligjore për të siguruar arkëtimin e shpërblimit të dëmit, masave organizative, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e përcaktuara dhe rikërkua nga KLSH-ja.

- Lidhur me 8 rekomandimet për marrjen e masave për shpërblim dëmi në vlerën 9,778,825 lekë (“Z.” SHPK 1,804,560 lekë, “V. E” SHPK 31,540 lekë, “V.H” SHPK 2,540,095 lekë, “E.” SHPK 993,280 lekë, BOE “B.” SHPK & “S. 2F” SHPK & “A.” SHPK 1,945,471 lekë, “B.” SHPK 1,496,539 lekë, “V.H” SHPK 733,977 lekë dhe “Z.” SHPK 233,363 lekë) si rrjedhojë e pasqyrimit

në situacionin përfundimtar të punimeve të pakryera, krahasuar me volumet e realizuara në objekt, Bashkia Cërrik ka depozituar kërkesë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan sipas shkresave, nr. 351 prot, datë 03.02.2022, nr. 352 prot, datë 03.02.2022, nr. 353 prot, datë 03.02.2022, 3517/2, datë 16.11.2020 dhe nr. 3169/1, datë 16.01.2020, çështjet janë në vazhdim.

- Lidhur me pagesën e gjobës nga 3 mbikëqyrës punimesh (Ing. E.M, Ing. R.T dhe Ing. M.K me vlerë 50,000 lekë secili) për shkeljet e konstatuara në zbatimin e punimeve të ndërtimit, për kontratat për punë publike, Bashkia Cërrik me shkresat nr. 1543-1543/5 Prot, datë 16.02.2021 ka njoftuar mbikëqyrësit e punimeve dhe me shkresat nr. 2447-2447/5 Prot, datë 18.02.2021 është dërguar njoftimi për shpërblim dëmi së bashku me faturat për arkëtim, rezulton se këto detyrime nuk janë paguar nga asnjëri prej mbikëqyrësve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 68-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Bashkia Cërrik të marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për:

- Arkëtimin e vlerës 9,778,825 lekë (“Z.” SHPK 1,804,560 lekë, “V.E” ShPK 31,540 lekë, “V.H” SHPK 2,540,095 lekë, “E.”SHPK 993,280 lekë, BOE “Beladi” ShPK & “Sireta 2F” ShPK & “A.” SHPK 1,945,471 lekë, “B.” SHPK 1,496,539 lekë, “V.H” SHPK 733,977 lekë dhe “Z.” SHPK 233,363 lekë) dhe të ndjekë me vëmendje procesin gjyqësor me qëllim arkëtimin e detyrimit nga operatorët ekonomik apo bashkimi i operatorëve sipas vlerave që ato kanë secili;

-Të marrë masat për pagesën e detyrimit nga 3 mbikëqyrës punimesh, Ing. E.M, Ing. R.T dhe Ing. M.K me vlerë 50,000 lekë secili.

15.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrik, sipas urdhrin nr. 432, datë 06.10.2022, janë ngarkuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Sipas dokumentacionit të paraqitur rezulton se fillimisht i është kërkuar operatorëve ekonomikë dhe mbikëqyrësve të punimeve likuidimi vullnetar i vlerave të mësipërme.

Për arsye të mos likuidimit të detyrimit nga asnjë prej operatorëve ekonomikë, Bashkia Cërrik i është drejtuar me kërkesë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Deri në datën e mbajtjes së këtij akt verifikimi, vetëm mbikëqyrësja Znj. M.K ka paguar ndërsa 2 mbikëqyrësit e tjerë jo.

Në proces zbatimi

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton se:

-Deri më datë 31.12.2019, detyrimi që kanë ndaj Bashkisë Cërrik qytetarët që kanë përfituar legalizimin e ndërtimeve pa leje dhe janë pajisur me certifikatën e pronësisë është në vlerën 2,636,767 lekë për 96 qytetarë;

-Për vitin 2020 janë debitor 116 qytetarë me vlerë detyrimi 3,966,783 lekë;

- Për vitin 2021 janë debitor 57 qytetarë me vlerë detyrimi 3,698,340 lekë.

Referuar korrespondencës shkresore që ASHK ka me Bashkinë Cërrik rezulton se nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë 270 qytetarë që kanë përfituar legalizimin e ndërtimeve të reja me vlerë totale 10,301,890 lekë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Cërrik, veprim në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar për 270 objekte të legalizuara me vlerë 10,301,890 lekë. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Cërrik të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrik, sipas urdhrin nr. 423, datë 06.10.2022, janë ngarkuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Sipas dokumentacionit të paraqitur rezultoi se Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit bashkëpunon periodikisht me strukturat e tjera për zbatimin e këtij rekomandimi. Detyrimi i ngelur është 9,964,539 lekë për 263 persona. Për më shumë është trajtuar hollësisht në akt konstatimin me nr. 5.

Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Detyrimet për taksat dhe tarifave vendore që taksapaguesit kanë ndaj Bashkisë Cërrik në datën 31.12.2021 janë në vlerën 26,143,232 lekë prej të cilave vlera 3,358,268 lekë i përket 78 subjekteve private dhe vlera 22,784,964 lekë i përket kategorisë së taksapaguesve familjarë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Cërrik. Rezultoi se vetëm në vitin 2021 borxhi tatimor i krijuar është në vlerën totale 13,617,398 lekë, i përbërë nga 2,638,432 lekë për 77 subjekte private dhe 10,978,966 lekë nga taksapaguesit familjarë. Bashkia Cërrik nuk ka aplikuar masat e duhura ligjore për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. DTTV për vitin 2021 nuk ka dërguar në Drejtorinë e Financës informacion lidhur me debitorët progresiv. Për vitin 2020 informacioni i dërguar nga DTTV nuk pasqyron saktë numrin e subjekteve debitorë dhe vlerën reale të borxhit tatimor. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimit Taksave Vendore Bashkia Cërrik, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifave vendore në fund të vitit 2021 në vlerën 26,143,232 lekë, si më poshtë vijon:

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatimit Taksave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimit paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë Tatimit Taksave dhe Drejtorisë Juridike, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Cërrik për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

2.2 Nga verifikimi rezultoi se : Detyrimet familjare janë në vlerën 22,784,964 nga të cilat është paguar për vitin 2021 nga 890 subjekte në vlerën 5,795,424 lekë dhe rezultojnë debitorë 1852

familje në vlerën prej 16,989,540 lekë. Detyrimet për bizneset janë në vlerën 3,358,278 lekë për 78 subjekte dhe janë paguar nga 29 subjekte vlera prej 1,065,514 lekë dhe rezultojnë debitorë 49 subjekte në vlerën prej 2,292,764 lekë.

Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Bashkinë Cërrik janë tre subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë të pa pajisur me autorizim/licencë për ushtrimin e aktivitetit, konkretisht subjekti F., për periudhën Korrik - Dhjetor 2021, subjekti D.O, për periudhën Shtator - Dhjetor 2021 dhe subjekti G.O, për adresën në Kamunah për periudhën Dhjetor 2020 - Gusht 2021, për adresën në Gostimë për periudhën Dhjetor 2020 - Dhjetor 2021. Të tre këto subjekte ushtrojnë aktivitet në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 15, neni 20-Autorizimet pika 2, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Cërrik për vitin 2021 në vlerën 3,000,000 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa që subjektet F., D.O dhe G.O që ushtrojnë aktivitet në kundërshtim me dispozitat ligjore të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën 1,000,000 lekë secili ndaj Bashkisë Cërrik.

3.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrik, sipas urdhrin nr. 433, datë 06.10.2022, janë ngarkuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Sipas dokumentacionit të paraqitur rezultoi se:

1-Karburanti F.O sh.p.k

Subjekti F.O me numër nipti L...T, autorizimi mbaruar korrik 2021 dhe nuk ka paguar Autorizim.

2- Karburanti G.O sh.p.k (Kamunah)

G.O Kamunah sh.p.k me numër Nipti L...N, Pagesë autorizim për periudhën dhjetor 2020 - dhjetor 2021, numër mandati 1463, datë 26.07.2022.

Autorizimi dhjetor 2021 - dhjetor 2022 është paguar me numër mandati 1319, datë 11.10.2022.

3- Karburanti G.O sh.p.k (Gostimë)

G.O Gostimë sh.p.k me numër Nipti L...N, pagesë autorizim për periudhën dhjetor 2020 - dhjetor 2021 numër mandati 2325, datë 23.09.2021.

Autorizimi dhjetor 2021 - dhjetor 2022 është paguar me numër mandati 1807, datë 25.10.2022.

4- Karburanti D.O Sh.p.k

D.O sh.p.k me numër Nipti L...O, pagesë autorizim për periudhën shtator 2021 - shtator 2022 numër mandati 1813, datë 23.09.2022. Nuk ka kryer pagesën.

Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Cërrik në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve që ka në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre gjatë periudhës 2018-2021 ka lidhur 47 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi. Këto kontrata janë në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 9-10 vjet, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore apo për aktivitet bujqësor. Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirave rezultoi se 46 subjekte kanë paguar rregullisht detyrimin ndaj bashkisë ndërsa qiramarrësi D.K i cili ka marrë me

qira 1.5 ha tokë për një periudhë 10 vjeçare referuar kontratës me nr. 2453 datë 21.09.2020 me vlerë vjetore të qirasë 15,000 lekë, në kundërshtim me kushtet e kontratës nuk ka paguar detyrimin për vitin 2021 në vlerën 16,500 lekë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Cërrik.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masat që qiramarrësi D.K të paguajë qiranë në vlerën 16,500 lekë si dhe të ndjekë më përpikmëri zbatimin e kushteve të kontratave të qirasë me të gjithë qiramarrësit.

4.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrik, sipas urdhrin nr. 421, datë 06.10.2022, janë ngarkuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Sipas dokumentacionit të paraqitur rezulton se është bërë njoftimi me nr. 106 prot., datë 22.11.2022, njoftim për detyrimet e qerasë për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullosor publik. Pagesa nuk është kryer.

Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi lidhur me pagesën e detyrimeve vendore nga subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Cërrik rezultoi se 10 operatorë ekonomik nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore që lindin ndaj Bashkisë Cërrik për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë në vlerën 195,405 lekë. Mos pagesa e detyrimeve nga operatorët ekonomik është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 12, pika 6, VKB nr. 338/1, datë 20.12.2019 dhe VKB nr. 118, datë 24.12.2020, për nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Cërrik për vitet 2020-2021.

5.1 Rekomandimi: Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Drejtorinë e Tatim Taksave Vendore lidhur me operatorët ekonomikë që shpallen fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bëjë llogaritjen e detyrimeve që lindin për periudhën e ushtrimit të aktivitetit. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore të marrë të gjitha masat për pagesën e rregullt të taksave dhe tarifave nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Cërrik.

5.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrik, sipas urdhrin nr. 438, datë 06.10.2022, janë ngarkuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Sipas dokumentacionit të paraqitur rezulton se janë dërguar në drejtorinë e tatim taksave operatorët ekonomikë të shpallur fitues në procedurat e tenderimit. Gjithashtu, nga verifikimi rezultoi se: gjatë vitit 2022 nga vlera e rekomanduar prej 195,405 lekë, kanë mbetur pa arkëtuar 14,249 lekë.

Në proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2020-2021 Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në Bashkinë Cërrik ka vendosur 11 masa “Dënim me gjobë” për personat që kanë kryer shkelje të legjislacionit për mbrojtjen e territorit në vlerën totale 5,000,000 lekë. Nga auditimi rezultoi se nuk është paguar në mënyrë vullnetare asnjë nga gjobat e vendosura nga IMTV. Për gjobat e vendosura në vitet 2020-2021 dhe që nuk janë paguar brenda afateve ligjore, IMTV vetëm ka njoftuar subjektet kundërvajtës dhe nuk ka ndjekur procedurat e duhura ligjore me qëllim arkëtimin e tyre. Përkatësisht, IMTV nuk ka “dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhrin e Ekzekutimit për secilën gjobë”, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4, rrjedhimisht nuk ka ndjekur as hapat e tjera të parashikuar në ligj si procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit apo vendosje sekuestro mbi

pasurinë. Gjithashtu, rezulton se për gjobat që nuk janë paguar brenda afateve ligjore nuk është llogaritur kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë.

Gjobat e vendosura nga IMTV për periudhën 2020-2021 nuk janë kontabilizuar si detyrime nga Drejtoria e Financës. IMTV nga ana e saj për vitin 2020 nuk ka përcjellë në DF informacion për gjobat e vendosura ndërsa për vitin 2021 ka dërguar informacion me shkresën nr. 5200 Prot, datë 13.12.2021. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, kapitulli 1, pika 2.3. Për sa më sipër rezulton se, për vitet 2020-2021 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 5,000,000 lekë.

6.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën 5,000,000 lekë.

6.2 Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Cërrik me shkresat datë 04.05.2022 ka njoftuar debitorët për shlyerjen e gjobave nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, dhe me shkresën nr. 2852/1 prot., datë 20.10.2022 ka njoftuar Burimet Njerëzore për masat administrative të IMTV Cërrik. Kjo masë rezulton në proces pasi i është kërkuar Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Durrës lëshimin e urdhërit të ekzekutimit. Deri në datën e mbajtjes së këtij akt verifikimi nuk na u vu në dispozicion asnjë vendim i marrë nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Në proces zbatimi

D. MASAT DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Cërrik t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Nga verifikimi rezultoi se: nga ana e Bashkisë Cërrik nuk ju vendos në dispozicion grupit të auditimit ndonjë shkresë me anë të së cilës nga ana e Kryetarit të bashkisë t’i jetë kërkuar Komisionit Disiplinor marrjen e masave për punonjësit për shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së.

Pa zbatuar

Tabela nr.1: “Statusi i Zbatimit të rekomandimeve ”

/000 lekë

Masa	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Organizative	15		15		6				7		2	
Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të	6		6						6			

ardhurave të munguara.												
Disiplinore												
Gjithsej	21		21		6				13		2	

Në përfundim të procesit të auditimit, në Bashkinë Cërrrik, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 58/7 prot, datë 16.05.2022, të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

B. MASAT ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandimi: Bashkia Cërrrik me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:

- Të hartojë planin e trajnimeve;
- Të organizojë trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
- Të aplikojë programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar;
- Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”;
- Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”;
- Të raportojë periodikisht lidhur me kryerjen e procesit të monitorimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1. Rekomandimi: Bashkia Cërrrik të marrë masa për plotësimin e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, të miratojë Kodin e Etikës dhe planet strategjike si dhe të ngrrejë Komitetin e Auditimit, që të jetë një mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm si një organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njesisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1 Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm të marrë masa që në kryerjen e auditimeve të ndjekë të gjithë hapat e duhura të angazhimit të auditimit. Të plotësojë dosjet e auditimit me dokumentacionin përkatës duke filluar që nga njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit dhe në vijim dokumentacionin për të gjithë hapat e tjerë që ndjek një auditim. Të planifikojë dhe të kryejë auditime me qëllim vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Brenda vitit 2023

5.1 Rekomandim: Nëpunësi autorizues dhe zbatues të marrin masa për shlyerjen brenda afatit 30 ditor të të gjitha faturave që kanë si detyrim për likuidim ndaj të tretëve, duke eliminuar në këtë mënyrë krijimin e detyrimeve të prapambetura, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe futjen e institucionit në vështirësi financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1 Rekomandim: Bashkia Cërrrik të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të trashëguara nga vitet e mëparshme, duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.

9.1 Rekomandimi: Bashkia Cërrik të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit, ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifave vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.

Brenda vitit 2023

11.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik të marrë masa që të ngrejë një komision për të verifikuar ligjshmërinë dhe zbatimin e të gjitha kontratave që janë lidhur nga ish komunat (sot njësitë administrative) me qëllim zgjidhjen përfundimtare të problemeve që janë konstatuar në vijimësi nga këto kontrata.

Menjëherë

12.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në Llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Pronave Publike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite, për të verifikuar saktësuat e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pa saktësisë të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2022

15.1 Rekomandimi: Bashkia Cërrik të marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për:
- Arkëtimin e vlerës **9,778,825 lekë** (“Z.” SHPK **1,804,560 lekë**, “V.E” SHPK **31,540 lekë**, “V.H” SHPK **2,540,095 lekë**, “E.” SHPK **993,280 lekë**, BOE “B.” SHPK & “S. 2F” SHPK & “A.” SHPK **1,945,471 lekë**, “B.” SHPK **1,496,539 lekë**, “V.H” SHPK **733,977 lekë** dhe “Z.” SHPK **233,363 lekë**) dhe të ndjekë me vëmendje procesin gjyqësor me qëllim arkëtimin e detyrimit nga operatorët ekonomik apo bashkimi i operatorëve sipas vlerave që ato kanë secili;
-Të marrë masat për pagesën e detyrimit nga 3 mbikëqyrës punimesh, Ing. E.M, Ing. R.T dhe Ing. M.K me vlerë 50,000 lekë secili.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar për **270 objekte** të legalizuara me vlerë **10,301,890 lekë**. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Cërrik të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënie e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimit Taksave Vendore Bashkia Cërrik, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin

e detyrimeve për taksat/ tarifave vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **26,143,232 lekë**, si më poshtë vijon:

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë Tatim Taksave dhe Drejtorisë Juridike, të marren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Cërrik për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa që subjektet F., D.O dhe G.O që ushtrojnë aktivitet në kundërshtim me dispozitat ligjore të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën 1,000,000 lekë secili ndaj Bashkisë Cërrik.

Menjëherë

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masat që qiramarrësi D.K të paguajë qiranë në vlerën **16,500 lekë** si dhe të ndjekë më përpikmëri zbatimin e kushteve të kontratave të qirasë me të gjithë qiramarrësit.

Menjëherë

5.1 Rekomandimi: Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Drejtorinë e Tatim Taksave Vendore lidhur me operatorët ekonomikë që shpallen fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bëjë llogaritjen e detyrimeve që lindin për periudhën e ushtrimit të aktivitetit. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore të marrë të gjitha masat për pagesën e rregullt të taksave dhe tarifave nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Cërrik.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtime të pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën 5,000,000 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASAT DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Cërrik t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit,**

që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Menjëherë

Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Objekti i verifikimit është zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin e auditimit të mëparshëm dërguar në Bashkinë Cërrik me nr. 568/38 prot., datë 27.07.2022.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Cërrik pika 7 e Programit të Auditimit financiar dhe përputhshmërisë” nr. 1174/1 prot., datë 09.01.2023, “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” rezultoi si më poshtë vijon:

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se janë rekomanduar gjithsej:

b . Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar gjithsej 3 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 3 masa, dhe 3 masat janë konsideruar në proces zbatimi pasi gjatë periudhës së auditimit nuk ishte mbyllur viti ushtrimor 2022.

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

1. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Cërrik rekomandimet e auditimit me shpresën e saj nr. 568/38, datë 27.07.2022, ndërsa nga Bashkia Cërrik për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor.

Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Cërrik, ishin marrë masat si vijon:

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë janë caktuar personat përgjegjës “Për hartimin e plan veprimit dhe akteve të tjera për zbatimin e rekomandimeve të KLSH;

Zbatuar pjesërisht

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Cërrik rekomandimet e auditimit me shpresën e saj nr. 568/38, datë 27.07.2022, dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 27.01.2023 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA), por nuk është raportuar brenda kësaj date në KLSH.

Pa zbatuar

B. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Cërrik 3 masa organizative, të cilat janë pranuar prej tyre, dhe janë në proces zbatimi 3 masa. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

Në përfundim të procesit të auditimit, në Bashkinë Cërrik, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 568/38 prot, datë 27.07.2022, për rekomandimet e mëposhtme të cilat janë në proces zbatimi (por që nuk janë zbatuar plotësisht për shkak se nga ana e Drejtorisë së Financës është bërë mbyllja e llogarive, por Pasqyrat financiare nuk janë dërguar akoma për rakordim në Degën e Thesarit Elbasan), **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,655,845 lekë, i pandryshuar. Për këtë gjendje llogarie të palëvizshme nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale.

Gjendja e llog. 211 “Pyje, Plantacione”, paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,692,300 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 1,692,300 lekë. Për këtë gjendje nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale.

Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.2.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 12-31 të Raport Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit e aktiveve në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe llog. 211 “Pyje, Plantacione”, ku nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Pronave Publike të kryejë zbatimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite, për të verifikuar saktësisht e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësisht të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

1.2 Nga verifikimi rezultoi se: nga Bashkia Cërrik në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, me urdhër nr. 259, datë 01/09/2022 dhe urdhër nr.485, datë 2/11/2022 ka ngritur komision për verifikimin dhe vlerësimin e llogarive 210 “Toka, Troje, Terrene”. Ky komision ka analizuar llogarinë dhe ka rritur vlerën e llogarisë 210 me 37,844,407 lekë. Po kështu gjatë vitit 2022 është bërë analiza e llogarisë 211 “Pyje, Platacione” dhe është rritur vlera e kësaj llogarie me 9,477,613 lekë. Nga ana e Drejtorisë së Financës është bërë mbyllja e llogarive, por Pasqyrat financiare nuk janë dërguar akoma për rakordim në Degën e Thesarit Elbasan.

Llogaria	EMËRTIMI	Gjendja 31/12/2021	Shtesa 2022	Gjendja 31/12/2022
210	TOKA, TROJE E TERRENE	5655845	37844407	43500252
2101000	Troje	2737436	6876	2744312
2102000	Tokë bujqësore	0	14011324	14011324
2103000	Terrene të shtresave	300000	0	300000
2104000	Sistemime dhe rregullime të tokave	0	0	0

2105000	Të tjera	1748940	0	1748940
2106000	Troje sheshe Mollas	300000	0	300000
2107000	Troje Qendra e Grumbullimit	569469	0	569469
2108000	Toka inproduktive	0	23826207	23826207
	PYJET, KULLOTA, PLANTACIONET	1692300	9477613	11169913
2111000	Pyje	405500	220426	625926
2112000	Kullota	296200	4642061	4938261
2113000	Plantacione	931800	3570979	4502779
2114000	Pyllzim fidana mollas	58800	0	58800
2115000	livadhe	0	290059	290059
2111600	Ledhe	0	754088	754088

Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale në qarkullim (në vlerën bruto) për vitin 2021 është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktivi. Inventari kontabël i aktiveve materiale në qarkullim gjendje në fund të vitit 2021 janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Nga verifikimi i përlllogaritjeve të amortizimit të AAGJ materiale në qarkullim, rezulton se përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje te periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit, duke aplikuar normat ligjore të amortizimit. Por konstatohet se amortizimi është llogaritur për grup aktivesh në total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përlllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Në mungesë të regjistrimit të aktiveve me të dhënat si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur për çdo aktiv u bë e pamundur sondazhi i përlllogaritjes së amortizimit për aktive të veçanta në llogari të ndryshme si dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit të aktiveve për të bërë diferencën. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85. Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.2.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Pronës Publike Bashkia Cërrik, të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre e ekzistencës fizike.

2.2 Nga verifikimi rezultoi se: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale në qarkullim (në vlerën bruto) për vitin 2022 është në proces, pasi afati i mbylljes së tyre është data 31 mars 2023. Nga ana e Drejtorisë së Financës është bërë mbyllja e llogarive, por Pasqyrat financiare nuk janë dërguar akoma për rakordim në Degën e Thesarit Elbasan.

Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale në qarkullim (në vlerën bruto) për vitin 2022 është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktivi. Inventari kontabël i aktiveve materiale në qarkullim gjendje në fund të vitit 2022 janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit, janë ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Për këto aktive janë kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Nga verifikimi i përllogaritjeve të amortizimit të AAGJ materiale në qarkullim, rezulton se përllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje te periudhës ushtrimore për çdo aktiv dhe grup aktivesh sipas klasifikimit, duke aplikuar normat ligjore të amortizimit. Amortizimi është llogaritur për çdo aktiv si dhe në total, duke përllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Regjistri i Aktiveve është në formë elektronike me të dhënat si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur për çdo aktiv.

Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditim: Nga verifikimi i analitikëve, konstatohet se për vitin 2021, duke identifikuar dhe fletë hyrjet dhe fletë daljet e magazinës për projektet e studim kërkimit, rezulton se 7 projekte me kosto historike 9,287,169 lekë, të bëra hyrje në vitin 2019, 2020 dhe 2021, të cilat janë kapitalizuar në bilancin 2021 me kosto historike 3,297,197 lekë. Nuk është njohur në bilancin kontabël të vitit 2021 vlera 5,989,972 lekë dhe kjo ka ndodhur pasi projekti për ndërtimin e ujësjellësit të fshatrave Klos, Selvias nuk është likuajduar gjatë vitit 2021, në fakt është marrë në dorëzim dhe duhet të ishin kapitalizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit. Kjo ka sjellë nënvlerësimin e llogarive të aktiveve afatgjata materiale në vlerën totale 5,989,972 lekë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 6,9 dhe 10, Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe konkretisht standartin kombëtar të kontabilitetit nr.5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” paragrafët 10 deri 19 dhe pikat 46 deri 55 të këtij standarti, UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Cërrik, të marrë masa për sistemimin e llog. 202 “Studime e projekteve”, në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, investimet e të cilave nuk kanë përfunduar, duke e transferuar në debi të llogarive të aktiveve afatgjata materiale vlerën 5,989,972 lekë për vitin 2021 e cila u përket objekteve të përfunduara para mbylljes së vitit ushtrimor 2021 dhe 5,989,972 lekë, si dhe të bëhet sistemimi kontabël në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit.

3.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës gjatë vitit 2022 ka sistemuar llogarinë 202 “Studime e projekteve”. Në këtë llogari paraqitet vetëm vlera e projekteve për investimet e pa përfunduara.

Nga verifikimi i analitikëve, konstatohet se për vitin 2022, duke identifikuar dhe fletë hyrjet dhe fletë daljet e magazinës për projektet e studim kërkimit, rezulton se 4 projekte me kosto historike 6.228.000 lekë, të bëra hyrje në vitin 2022, janë kapitalizuar në bilancin 2022 me kosto historike 6.228.000 lekë. Nga ana e Drejtorisë së Financës është bërë mbyllja e llogarive, por Pasqyrat financiare nuk janë dërguar akoma për rakordim në Degën e Thesarit Elbasan.

Në proces zbatimi

IV GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së konstatohet se:

- Nuk është hartuar “*Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*”, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, përveç trajnimeve që kryhen nga ASPA.

- Në informacionin e sjellë nga Burimet Njerëzore në vitin 2022 janë kryer 56 trajnime për 11 punonjës të Bashkisë Cërrik.

- Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut.

- Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).

- Bashkia Cërrik nuk ka miratuar “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”, e cila duhet të përditësohet rregullisht (çdo 3 vite), në zbatim të Udhëzimit nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të MFK- së dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”, pikën 5.3.

- Procesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse në mos zbatim të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të MFK dhe kordinatorit të riskut njësitë publike”.

- Në mbështetje të Ligjit nr. 10296 dt. 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 27, në zbatim të Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK në Njësitë Publike” pika 2/2,4, nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Bashkia Cërrik nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.

- Në Bashkinë Cërrik, drejtorja e financave përdor programin excel. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave dhe kjo kryhet nga drejtorja e financave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.

- Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm.

- Bashkia Cërrik nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1 faqe 19-28 të Raportit të Auditimit*).

1.1.Rekomandimi: Bashkia Cërrik me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:

- Të hartojë planin e trajnimeve për punonjësit, duke përcaktuar nevojat konkrete për to;

- Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS), për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”;
- Të miratojë “*Strategjinë e Menaxhimit të Riskut*”.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditit të Brendshëm për vitin 2022 nuk ka patur përgjegjës, por vetëm 2 punonjës si inspektorë auditit të brendshëm në strukturë, në kundërshtim me kërkesa e ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik*”, neni 11 dhe të VKM nr. 83 datë 03/02/2016 “*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*”, për “*Miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik*” pika 3.

Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” neni 13 “*Komitetit të Auditimit të Brendshëm*”.

Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, lejet e ndërtimit, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Kryetarit të Bashkisë për arritjen e objektivave, pasi nuk janë kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*”, i ndryshuar, nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”.

Nga ana e Njesisë së Auditimit Bashkia Çërrik për periudhën e auditimit nuk është kryer verifikimi i zbatimit të rekomandimeve me program tematik të veçantë, por është bërë verifikimi i rekomandimeve në auditimin e radhës, gjë që vjen në kundërshtim me Manualin e auditimit të miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*”, pikën 4.1.13.2, Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2 faqe 19-28 të Raportit të Auditimit*).

2.1.Rekomandimi: Bashkia Çërrik të marrë masa për plotësimin e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, dhe të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, duke i dhënë mbështetje titullarit të njesisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njesisë publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën **130,495 mijë lekë**, ndërsa realizimi **125,230 mijë lekë**, ose në masën 95.96%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën **225,658 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **193,024 mijë lekë**, ose në masën 85,54 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Çërrik në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”. Gjithashtu rezultojnë se gjatë vitit 2022 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2022. Veprimet e mësipërme janë në përputhje me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr.

68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2 faqe 19-28 të Raportit të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtorja e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korrigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Bashkia Cërrik në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 181,333,663 mijë lekë (nga kjo 36,236,536 leke, detyrime të FSHZH). Detyrimi i Bashkisë është 145,097,127 leke e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti vlera 71,072,877 mijë lekë, nga e cila është likuiduar vlera 84,750,410 mijë lekë, ose 119.24% e vlerës së planifikuar. Po për efekte të shtimit të detyrimeve gjatë vitit 2022, kjo ulje e detyrimeve nga pagesat nuk reflektohet në gjendjen e detyrimeve në datën 31.12.2022 .Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022), është ulur, me 23,540,115 lekë, ose në masën prej 16.23%. Në mënyrë të detajuar lista analitike e detyrimeve të prapambetura paraqitet në aneksin nr.5,pika 2.4 bashkëlidhur raportit të auditimit. Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr.5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 38-50 të Raportit të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik dhe Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura si dhe të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Konstatohet Drejtorja e të Ardhurave Vendore nuk ka në përbërje të saj Sektorin e Masave Shtrenguese si një strukturë e rëndësishme në Bashkinë Cërrik, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të pa arkëtuar debitor, për 3,583 subjekte familjar dhe biznesi në vlerën **39,724 mijë lekë**, nga e cila: subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërorë në vlerë 7,936 mijë lekë për 142 subjekte dhe abonentë familjarë në vlerë 31,798 mijë lekë për 3,441 abonent. Alternim i këtij sektori në përbërje të Sektorit të Kontrollit Terren është i papërshtatshëm, kjo nisur nga fakti se kanë natyra të ndryshme pune dhe se arkëtimi i debitorëve është procedurë më vetë dhe afate të përcaktuara. Gjithashtu konstatohet se për periudhën objekt auditimi 2022 Drejtorja e të Ardhurave Vendore ka funksionuar pa Drejtor çka sjell mos arkëtimin e të ardhurave, kjo për mungesë stafi, në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor

të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me shkresën nr. 168/1 prot datë 29.04.2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 38-50 të Raportit të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Cërrik me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta. Të ardhurat nga agjentët tatimorë (*Drejtoria Rajonale Tatimore, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Cërrik, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura*), derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Cërrik dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Elbasan. Për detyrimet e familjarëve, u konstatua se shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Cërrik Sh.A., nuk është caktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.

- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.

- Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr.26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 38-50 të Raportit të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Cërrik, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga Agjentët Tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj si dhe të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mblidhen nga Agjentët Tatimore, të kryqëzojë informacionet me institucionin e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

6.2.Rekomandimi: Bashkia Cërrik, të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Cërrik Sh.a, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjisllacionit në fuqi, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

Në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë certifikuar në total 7 prona sipas tabelës aneks si dhe përpara vitit 2020 janë certifikuar 65 prona objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të administruara llog.(212) pasuri e paluajtshme (*sasi e vlerë*) pjesa e konsiderueshme e tyre prej 4403 prona (*trajtuar analitikisht*), nuk janë të regjistruara në kontabilitet dhe pasqyrat financiare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Nga 65 prona të

cilat janë certifikuar 34 prona janë prona të transferuara nga Ish komunitat sot njësitë Administrative dhe 31 prona janë prona të cilat janë certifikuar për periudhën 2017-2019 dhe 7 prona janë certifikuar për periudhën 2020-2022 sipas aneksit nr. 1 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Konstatohet se sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga sektori i aseteve, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Cërrik në Drejtorinë rajoneve të ASHK Elbasan, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 38 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Cërrik. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16). (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1 faqe 50-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: - Drejtoria e Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin 38 prona të certifikuara në ASHK Elbasan, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Cërrik sipas aneksit nr. 1 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në procedurat e prokurimit me objekt: “Sistemim Asfaltim i tre rrugëve”, “Sistemim Asfaltim i 1 rrugës Kamunah”, “Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Desar”, “Rehabilitim/Perforcim banesash ekzistuese”, “Rikonstruksion i rrugës së Capallarëve dhe vreshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, Fshati Licaj, Nj.A. Shalës”, zhvilluar në periudhën 2020-2022, janë vendosur kriteret të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme në hartimin e kriterëve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5, nenit 27, neni 61 pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, me pikën 4 të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4.1, faqe 54-113 të Raportit të Auditimit).

8.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Cërrik të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kriteret të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në 5 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht si vijon:

1-Në procedurën e prokurimit me objekt “Sistemim Asfaltim i tre rrugëve”, me vlerë të fondit limit 24,835,898 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues BOE “G.T” SHPK & “E-A” SHPK, me ofertë 24,698,141 lekë pa TVSH, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

2- Në procedurën e prokurimit me objekt “Sistemim Asfaltim i rrugës Kamunah”, Bashkia Cërrik, me vlerë të fondit limit 28,333,333 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021”, është shpallur fitues

operatori ekonomik OE "V.H" SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 28,183,787 lekë pa TVSh , i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

3- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Komunah, Mollas dhe Dasar, NjA Mollas*", Bashkia Cërrrik, me vlerë të fondit limit 283,457,911 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "V.K" SHPK & "F." SHPK & "E-A" SHPK me ofertë 281,115,515 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

4- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rehabilitim/Përforcim banesash ekzistuese*", Bashkia Cërrrik, me vlerë të fondit limit 26,920,399 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "Z." SHPK, me ofertë 26,920,399 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

5- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i rrugës së Capallarëve dhe vreshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, Fshati Licaj, Nj.A. Shalës*", Bashkia Cërrrik, me vlerë të fondit limit 49,091,672 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "Z." SHPK, me ofertë 49,052,481.5 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: neni 24 "*Anulimi i një procedure prokurimi*", pika nr.1, germa (ç), neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1, neni 53 "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3 dhe pika 5, neni 55, "*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*", pika 1, germa (a) dhe Ligji Nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", neni 92, pika 3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4.1, faqe 54-113 të Raportit të Auditimit*).

9.1.Rekomandim: Titullari i AK Bashkia Cërrrik, të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave për dhënie të lejeve të ndërtimit u konstatuan mangësi në miratimin e disa lejeve si vijon:

- Çështja me Nr.211 Prot., Datë 21.04.2020, sipas aplikimit në sistemin e leje me objekt: "*Shtesë kati, objekt banimi dhe shërbimesh 2 kat + podrum*" Rruga "*Rinia*" Lagja nr. 2 Cërrrik.

- Çështja me Nr.225 Prot., Datë 24.07.2020, sipas aplikimit në sistemin e leje me objekt: "*Ndërtim thertore për bagëti*" fsh. Gosmim, Nj. Adm. Gostim, B. Cërrrik.

- Çështja me Nr.2326 Prot. Datë 04.06.2020, sipas aplikimit në sistemin e leje me objekt: "*Fabrikë Prodhim Vaji Ulliri*".

- Çështja me Nr.3690 Prot., Datë 24.12.2020, sipas aplikimit në sistemin e leje me objekt: "*Kompleks Agro - Bujqësor (magazinim-frigorifer)*".

- Çështja me Nr. 4993 Prot., Datë 13.12.2021, sipas aplikimit në sistemin e leje me objekt: "*Ndërtim i magazinës 1 kat*".

- Çështja me Nr.1642 Prot., Datë 19.05.2021, sipas aplikimit në sistemin e leje me objekt: "*Banesë 1 kat*" fshati Gostim, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrrik.

- Çështja me Nr.1728 Prot., Datë 26.05.2021, sipas aplikimit në sistemin e leje me objekt: "*Rikonstruksion i ndërtesës 1 kat*" fshati Malasej, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrrik.

- Çështja me Nr.3849 Prot., Datë 01.09.2021, sipas aplikimit në sistemin e leje me objekt: "*Magazine për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore*" fshati Gjyralë, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrrik.

- Çështja me Nr.431 Prot., Datë 08.02.2022, sipas aplikimit në sistemin e leje me objekt: "*Magazinë e grumbullimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore*" fshati Çartaloz, Nj. Admin.

Gostim, Bashkia Cërrik.

- Çështja me Nr.1309/1 Prot., Datë 17.05.2022, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: “Fabrikë për prodhim vaji nga ulliri” fshati Gjyralë, Nj. Admin. Gostim, Bashkia Cërrik.

- Çështja me Nr.3024 Prot., Datë 25.10.2022, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: “Fabrikë për prodhim vaji nga ulliri” Cërrik-Fermë, Bashkia Cërrik.

Sa më sipër rezultoi se në dosjet e lejeve mungon dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, specifikisht të pesë pikat si më poshtë konstatohet që nuk procedohen në kërkesën për plotësim të tyre nga subjektet përfitues të lejeve janë konstatuar mangësi në **pikën b) Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta; pikën e) Deklarata e projektuesit të licencuar, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit, nëpërmjet së cilës konfirmohet përputhshmëria e projektit me lejen e zhvillimit, dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit, në fuqi, dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjiëno-sanitare; pikën ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit; pikën v) Projektin e eficiencës energjetike, në rastet kur është e detyrueshme me ligj; pikën g) Kopje e policës së sigurimit të projektuesve, për mbulimin e përgjegjësive profesionale; pikën i) Problematika në punimet e hedhjes së hartave nga sektori i Gis Kadastres së Bashkisë Cërrik, duke mos përcaktuar qartë kufijtë e pronës objekt zhvillimi, duke mos përcaktuar sakte gjendjen faktike të terrenit me objektet informale si dhe me poseduesit e ligjshëm dhe të paligjshëm mbi pronat objekt zhvillimi e dhënie leje ndërtimi për to, për pasojë duke çuar në mozbatim të kriterëve, distancave dhe evidence të pronarëve, të cilat bien në kundërshtim me **Nenin 10, pika c) dokument që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim dhe, nëse ka, kopje të marrëveshjeve për pronën; pika ç) planin e rievimit të pronës, në shkallë 1:500, nga topograf i licencuar; dhe në kundërshtim me Nenin 16, pika d) të dhënat identifikuese të pronarit të tokës, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, Datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; pika i) Referuar sistemit e-Leje rezultoi për lejet e sipërcituara, Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe IMTV me përfaqësues Z. F.U, Z.A.D, Znj.S.F në zbatim të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar rezultoi se nuk janë mbajtur Akt Kontrollit e Piketimit të Objekteve me subjektet zhvillues, nuk ka mbikëqyrës të punimeve, inxhinierin përkatëse dhe nuk ka firma zbatuese të punimeve të ndërtimit.****

Veprimet dhe mosveprimet e sipërcituar janë në kundërshtim me Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, i cili nuk ka siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit duke mos krijuar kushte të përshtatshme, të drejta dhe shanse të barabarta për banim. Gjithashtu mosrespektim të ligjit dhe moszbatim të tij në nivel procedural duke sjell parregullsi juridike në çdo akt të prodhuar nga institucioni. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5. faqe 131 135 të Raportit të Auditimit).

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Punëve Publike, Administrimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratimit të lejeve të ndërtimit të mbahen aktet e kontrollit sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se IMTV Bashkia Cërrik janë konstatuar mangësi konkretisht: - Nuk ka një plan pune vjetor për të gjithë harkun kohor të viteve objekt auditimi, vërehet se kane të përcaktuar një plan pune vetëm për muajin gusht, shtator, tetor nëntor dhe

dhjetor të vitit 2022, ndërsa persa i përket periudhës tjetër para kësaj periudhe, nuk rezultojnë asnjë shkresë apo memo mbi planin e punës - Në asnjë moment nuk ka kryer një korrespondencë me institucione të tjera, ndalemi këtu në korrespondencën e domosdoshme me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, respektivisht Sektori i Legalizimeve pranë kësaj drejtorie për të kërkuar një shkresë apo konfirmim nëse këta subjekte që i nënshtrohen prishjes, gjohës etj nga IMT, Bashkia Cërrik kanë vetdeklarim për ndërtim pa leje, nëse ky vetdeklarim është në sistemin e tyre, nëse ka raste përjashtimore të vetdeklarimeve duke u bazuar në ortofoton fotografimin ajror në vite në referim të **Ligjit Nr.20/2020** “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe **VKM Nr.1040, Datë 25.11.2020** “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimit të modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”. Sektori i IMTV Bashkia Cërrik nuk funksionon në parametrat tekniko-ligjor të duhur duke filluar nga burimet njerëzore rezultojnë në kundërshtim me nenin 11 të ligjit Nr. 9780 Date 16.07.2007 i ndryshuar, Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit ndërtimor e urbanistik- “Kryeinspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik në nivel bashkie/komune /qarku/ kombëtar dhe inspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit. Inspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik në nivel bashkie/komune/qarku mund të kenë arsimin e mesëm profesional në fushën e ndërtimit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6. faqe 135-159 të Raportit të Auditimit).

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve njerëzore të marrë masa për plotësimin e strukturës së IMT, Bashkia Cërrik, sipas përcaktimeve ligjore.

11.2.Rekomandimi: Sektori i IMT, Bashkia Cërrik, të marrë masa për organizimin dhe efektivitetin e punës duke ndjekur një procedurë pune të inventarizuar dhe arshivuar, ku përcakton ndarjen e punës dhe zhvillimin e saj gjatë vitit kohor hedhur në një plan të miratuar nga përgjegjës sektori dhe titullari i Bashkisë si dhe të marrë masa që në zbatim të procedurave ligjore të zhvilloj dhe dokumentoj korrespondencë me institucione e tjera.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV” i ndryshuar, IMT Bashkia Cërrik, ka marrë **17** (shtatëmbëdhjetë) vendime për prishje objektësh pa leje (sipas tabelës së mëposhtme), vendime të cilat rezultojnë të pa ekzekutuara.

Në **17** (shtatëmbëdhjetë) raste rezultojnë se është mbajtur procesverbal konstatimi dhe procesverbal prishje, por nuk është marrë asnjë masë tjetër nga ana e IMT Bashkia Cërrik për prishjen e ndërtimeve dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, për të cilat nga IMT duhej vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6. faqe 135-159 të Raportit të Auditimit).

12.1.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, të zbatoj vendimin e prishjes së objektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i fundit i kryer në Bashkinë Cërrik, nga KLSH janë rekomanduar masa për përmirësimin e gjendjes, të cilat janë dërguar në subjekt me shkresën nr.

58/7 prot., datë 16.05.2022. Nga auditimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për zbatimin e tyre, si vijon:

- Janë rekomanduar 15 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 6 prej tyre, 7 masa janë në proces zbatimi dhe 2 masa organizative nuk janë zbatuar.
- Janë rekomanduar 6 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, dhe janë në proces zbatimi 6 masa.
- Masa disiplinore, i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Cërrik t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse, rekomandim i cili nuk është zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 159-175 të Raportit të Auditimit).*

13.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Cërrik të marrë të gjitha masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, dhe përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve në proces zbatimi të lëna nga KLSH në raportin e auditimit të fundit, sipas shkresës nr. nr. 58/7 prot., datë 16.05.2022, të përshkruara në mënyrë të detajuar në këtë raport auditimi, pika “Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në auditimin e fundit” si vijon:

Për 2 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

1.1.Rekomandimi: Bashkia Cërrik me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:

- Të hartojë planin e trajnimeve;
- Të organizojë trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
- Të aplikojë programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar;
- Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”;
- Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”;
- Të raportojë periodikisht lidhur me kryerjen e procesit të monitorimit.

9.1 Rekomandimi: Bashkia Cërrik të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit, ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifave vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.

Menjëherë

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i fundit i kryer në Bashkinë Cërrik, nga KLSH janë rekomanduar masa për përmirësimin e gjendjes, të cilat janë dërguar në subjekt me shkresën nr. 568/38 prot., datë 27.07.2022. Nga auditimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për zbatimin e tyre, si vijon:

- Janë rekomanduar 3 masa organizative për të cilat drejtoria e financës ka kryer veprime për zbatimin e rekomandimeve, por duke qene se nuk janë mbyllur pasqyrat financiare të vitit 2022, janë konsideruara të pa zbatuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 159-175 të Raportit të Auditimit).*

14.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Cërrik të marrë të gjitha masat për zbatimin e plotë të rekomandimeve të cilat janë në proces zbatimi, të lëna nga KLSH në raportin e auditimit të fundit, sipas shkresës nr. 568/38 prot., datë 27.07.2022, të përshkruara në mënyrë të detajuar në këtë raport

auditimi, pika “Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në auditimin e fundit”.

Për 3 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit e aktiveve në llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” dhe llog. 211 “*Pyje, Plantacione*”, ku nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Pronave Publike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite, për të verifikuar saktësuat e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Pronës Publike Bashkia Cërrik, të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre e ekzistencës fizike.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Cërrik, të marrë masa për sistemimin e llog. 202 “*Studime e projekteve*”, në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, investimet e të cilave nuk kanë përfunduar, duke e transferuar në debi të llogarive të aktiveve afatgjata materiale vlerën 5,989,972 lekë për vitin 2021 e cila u përket objekteve të përfunduara para mbylljes së vitit ushtrimor 2021 dhe 5,989,972 lekë, si dhe të bëhet sistemi kontabël në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,460,129 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Sistemim Asfaltim rruga Kamunah*”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 33,820,544 lekë me TVSH, fituar nga OE “V.H” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 102,316 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1343 prot datë 15.04.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE “V.H” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 113-130 të Raportit të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **102,316 lekë pa TVSh** nga BOE “V.H” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1343 prot datë 15.04.2021, me objekt “*Sistemim Asfaltim rruga Kamunah*”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt

“Rikonstruksion i rrugës Qyrkan”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 26,092,473.6 lekë, fituar nga OE “V.H” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 271,632 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1834 prot datë 14.07.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE “V.H” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 113-130 të Raportit të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **271,632 lekë pa tvsh** nga OE “V.H” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1834 prot datë 14.07.2020, me objekt “Rikonstruksion i rrugës Qyrkan”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitimi i kanaleve vaditës”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 40,786,652 lekë, fituar nga BOE “M.” SHPK & “SH.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 104,610 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2661 prot datë 08.10.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe BOE “M.” SHPK & “SH.” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 113-130 të Raportit të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **104,610 lekë pa tvsh** nga BOE “M.” SHPK & “SH.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2661 prot datë 08.10.2020, me objekt “Rehabilitimi i kanaleve vaditës”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion rruga e Liçaj”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 23,934,289 lekë, fituar nga OE “A.....” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 129,152 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3720 prot datë 31.12.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE “A..” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 113-130 të Raportit të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **129,152 lekë pa tvsh** nga OE “A..” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3720 prot datë 31.12.2020, me objekt “Rikonstruksion rruga e Liçaj”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim i tre rrugëve”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 29,637,769 lekë, fituar nga BOE “G.T” SHPK & “E-A” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 369,779 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1390 prot datë 20.04.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe BOE “G.T” SHPK & “E-A” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 113-130 të Raportit të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **369,779 lekë pa tvsh** nga BOE “G.T” SHPK & “E-A” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1390 prot datë 20.04.2021, me objekt “Sistemim asfaltim i tre rrugëve”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion objekti 2k dhe ndryshim destinacioni nga magazinë në banesa sociale”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 13,634,256 lekë, fituar nga OE “Z.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 113,360 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2416 prot datë 16.09.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE “Z.” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 113-130 të Raportit të Auditimit).

6.1 Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **113,360 lekë pa tvsh** nga OE “Z.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2416 prot datë 16.09.2020, me objekt “Rikonstruksion objekti 2k dhe ndryshim destinacioni nga magazinë në banesa sociale”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar, NjA Mollas”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 337,342,218 lekë, fituar nga BOE “V.K” SHPK & “F.” SHPK & “E.A” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 369,280 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2816 prot datë 21.10.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe BOE “V.K” SHPK & “F.” SHPK & “E-A” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 113-130 të Raportit të Auditimit).

7.1 Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **369,280 lekë pa tvsh** nga BOE “V.K” SHPK & “F.” SHPK & “E-A” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2816 prot datë 21.10.2020, me objekt “Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar, NjA Mollas”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

C/1. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Cërrik për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën **426,000 lekë** për 1 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Në funde të vitit 2022 ka një vendim për dëmshpërblim page në vlerën 2,232,378 leke, i cili është planifikuar në buxhetin e vitit 2023. Gjithashtu konstatohet se në 1 rastë në vlerën **426,000 lekë** për likuidimet e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullari i institucionit, por nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 28-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrrik të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Detyrimet për taksat dhe tarifave vendore që taksapaguesit kanë ndaj Bashkisë Cërrrik në datën 31.12.2022 janë në vlerën **39,724 mijë lekë**, nga e cila: subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore në vlerë **7,936 mijë lekë** për 142 subjekte dhe abonentë familjarë në vlerë **31,798 mijë lekë** për 3,441 abonent, **vlerë kjo e cila përbën detyrim të pa arkëtuar nga debitorët, në buxhetin e Bashkisë Cërrrik**. Rezulton se vetëm në vitin 2022 borxhi tatimor i krijuar është në vlerën totale 20,584 mijë lekë, i përbërë nga 5,892 mijë lekë për 130 subjekte private dhe 14,692 lekë nga taksapaguesit familjarë. Bashkia Cërrrik nuk ka aplikuar masat e duhura ligjore për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. DTTV për vitin 2022 ka dërguar në Drejtorinë e Financës informacion lidhur me debitorët progresiv. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 38-50 të Raportit të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore Bashkia Cërrrik, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifave vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **39,724 mijë lekë**, si më poshtë vijon:

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë Tatim Taksave dhe Drejtorisë Juridike, të marren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Cërrrik për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Cërrrik në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Cërrrik janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Cërrrik.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.12.2022, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **15,537,274 lekë** për 360 persona e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar për buxhetin e Bashkisë Cërrrik (sipas listës

të administruar në CD). Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Cërrik nuk ka të evidentuar subjektet të cilat janë pajisur me leje legalizimi nga ALUIZNI përpara vitit 2017, si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Cërrik jetë drejtuar ASHK Dega Elbasan, për vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,,,”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastructure (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 38-50 të Raportit të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje për vitin 2022 në vlerën **5,572,735 lekë** ndaj **97** personave dhe përpara vitit 2021 në vlerën **9,964,539 lekë** për 263 persona.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e licencave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Cërrik dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrojnë aktivitetin 15 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, sipas aneksit 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 2 subjekte janë pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 dhe kanë paguar detyrimet në vlerë 2,000,000 lekë si dhe janë pajisur me autorizim 1 dhe 2 vjeçar 13 subjekte të cilët kanë paguar detyrimet në vlerë 6,040,000 lekë. Sa më sipër rezulton së Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore ka vepruar në kundërshtim me Kreun II pika 11 e VKB nr. 83 datë 28.12.2021 “Mbi miratimin e paketës fiskale për vitin 2022” si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se subjektet e pajisura me autorizim 1 vjeçar kanë bërë likuidimin e detyrimeve sipas autorizimit. Referuar licencave përkatëse subjektet janë debitorë në vlerën **5,460,000 lekë**, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë Cërrik. Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me Kreun II pika 11 e VKB nr. 83 datë 28.12.2021 “Mbi miratimin e paketës fiskale për vitin 2022” si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 38-50 të Raportit të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së patakuar prej **5,460,000 lekë** sipas pasqyrës Aneks nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: linden ndaj Bashkisë Cërrik për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë në vlerën **45,270 lekë**.

Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore nuk ka dërguar informacion periodik në DTTV lidhur me operatorët e shpallur fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bënte ngarkesën përkatëse të tyre për periudhën e kontratës.

Mos pagesa e detyrimeve vendore nga operatorët ekonomik të listuar në tabelën e mësipërme është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 12, pika 6 “Taksapaguesi regjistron çdo vendndodhje të biznesit pranë bashkisë ose komunës përkatëse. Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhje”, VKB nr. 338/1, datë 20.12.2019 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Çërrik, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative, për vitin 2020”. VKB nr. 118, datë 24.12.2020 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore administrimi i tyre në Bashkinë Çërrik për vitin 2022”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 38-50 të Raportit të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Drejtorinë e Tatim Taksave Vendore lidhur me operatorët ekonomikë që shpallen fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bëjë llogaritjen e detyrimeve që lindin për periudhën e ushtrimit të aktivitetit. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore të marrë të gjitha masat për pagesën e rregullt të taksave dhe tarifave nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Çërrik.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Në kuadër të auditimit të të ardhurave të Bashkisë Çërrik u auditua realizimi i të ardhurave nga asetet e bashkisë të dhëna me qira. Në këtë aspekt u auditua vetëm zbatimi i kushteve të kontratave lidhur me pagesat në afat të detyrimeve të qirasë vjetore për sipërfaqen e marrë me qira dhe jo kushtet e hartimit të kontratave.

Bashkia Çërrik në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre gjatë periudhës 2019-2022 janë lidhur 71 kontrata për dhënien me qira të aseteve në Fond Pyjor që ka në pronësi. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 9-10 vjet. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, për aktivitet agropylltari etj.

Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirave rezulton se nga 71 subjekte në vlerën 3,580,038 lekë, kanë paraqitur kërkes për prishje të kontratës 3 subjekte dhe heqen nga fondi pyjor 2 subjekte në vlerën 358,505 lekë duke ushtruar aktivitet 66 subjekte në vlerën 2,916,271 lekë të cilët kanë paguar detyrimin sipas kontratës.

Nga 3 subjektet që kanë paraqitur kërkes për prishje të kontratës rezulton se 2 subjekte nuk kanë paguar detyrimet kontraktuale për vitin 2022 në vlerën 55,050 lekë, **vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Çërrik.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 38-50 të Raportit të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Drejtorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së pataksuar prej 55,050 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve dhe dokumentacionit lidhur me asetet e dhëna me qira, rezulton se Bashkia Çërrik (ish komunat) ka lidhur ndër vite kontrata për toka bujqësore të pa ndara dhe të abandonuara referuar kuadrit ligjor për tokat bujqësore si, ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826 deri 841 të tij, ligjin nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” dhe VKM nr. 531, datë 21.08.1998 "Për tokat bujqësore të pandara”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore. Referuar bazës së të dhënave të paraqitur grupit të auditimit u konstatua se në total janë lidhur 597 kontrata nga njësitë administrative Mollas, Shalës dhe Klos (ish komunat). Lidhur me zbatimin e detyrimeve të kontratave për pagesën e qirasë vjetore u konstatua se janë 170 qiramarrës që nuk kanë paguar detyrimet vjetore të qirasë ndër vite që arrijnë në vlerën 15,640,768 lekë.

Nga strukturat e bashkisë lidhur me këto kontrata janë bërë verifikime referuar dhe ankesave të qiramarrësve dhe rezultojnë se këto kontrata janë lidhur edhe për toka që i takojnë fondit pyjor dhe kullor apo për të njëjtën sipërfaqe është lidhur më shumë se një kontratë. Në vijimësi i janë drejtuar bashkisë për prishje të kontratës 35 qiramarrës të cilët nuk kanë paguar detyrimet e qirasë. Bashkia nga ana e saj edhe pse ka marrë këto kërkesa si dhe ka konstatuar problematika lidhur me hartimin e një pjese të kontratave ende nuk ka gjetur një zgjidhje të kësaj problematike.

Nga auditimi rezultojnë me probleme në pagesën e qirasë 170 kontrata të tjera të lidhura nga ish komunitat në vlerë totale të detyrimit **15,640,768 lekë** si rezultat i kërkesave për ndërprerje nga ana e qiramarrëse apo konstatimeve të strukturave të bashkisë që sipërfaqe të dhëna me qira si tokë bujqësore i takojnë fondit pyjor dhe kullor apo për të njëjtën sipërfaqe është lidhur më shumë se një kontratë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 38-50 të Raportit të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrrik të marrë masa që të ngrejë një komision për të verifikuar ligjshmërinë dhe zbatimin e të gjitha kontratave që janë lidhur nga ish komunitat (sot njësitë administrative) me qëllim zgjidhjen përfundimtare të problemeve që janë konstatuar në vijimësi nga këto kontrata.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Rezultojnë se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Cërrrik nuk është njoftuar zyrës juridike për vazhdimin e procedurave për arkëtimin e gjobave të vendosura. Nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit (IMT) Bashkia Cërrrik për periudhën objekt auditimi janë vendosur 12 gjopa në vlerën **4,800,000 lekë** nga të cilat nuk është arkëtuar asnjë lekë si dhe për periudhën përpara vitit 2022 janë vendosur gjithsej 24 në vlera **8,880,000 lekë**, të cilat nuk janë shpallur titull ekzekutiv, por që nuk ka filluar procesi i kërkimit të tyre duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën prej **13,680,000 lekë**.

Rezultojnë se për të gjitha praktikat IMT-ja, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës, nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Cërrrik në vlerën prej **13,680,000 lekë**, në kundërshtim me neni 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime; neni 15-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni 1)(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10324, datë 23.9.2010, neni 3); - nenet, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 130-135 të Raportit të Auditimit).*

8.1.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar në vlerën **13,680,000 lekë** sipas aneksit nr. 1 pika 6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të nenit 58, "llojet e masave disiplinore" të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i

rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Cërrrik, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit, si më poshtë:

1. **Znj. D.L** me detyrë Specialiste në Drejtorin Juridike, Burimeve Njerëzore e informimit me Publikun
2. **Znj. I.Ç** me detyrë Përgjegjëse Sektori në Drejtorin Juridike, Burimeve Njerëzore e informimit me Publikun
3. **Z. A.D** me detyrë Specialist në Drejtorin e Planifikimit e Zhvillimit.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, apo shërbejnë edhe si pengesë për konkurrencën e hapur, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 “*Kualifikimi ofertuesve*” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar; neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, neni 26 “*Kontrata për punë publike*”, pika (5); neni 61 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*”, pika (2), paragrafi (2).

4. **Z. H.K** me detyrë Drejtor në Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike.
5. **Znj. M.XH** me detyrë Drejtor në Drejtorin Juridike, Burimeve Njerëzore e informimit me Publikun.
6. **Znj. R.J** me detyrë Specialiste në Drejtorin Juridike, Burimeve Njerëzore e informimit me Publikun.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në vlerësimin dhe shpallje fituese të ofertës e cila për devijime të vogla nuk plotësojnë kriteret në kërkesat kualifikuese, ndërsa duhej të ishin skualifikuar dhe KVO duhej ti kishte rekomanduar titullarit anulimin e procedurave të prokurimit, për arsye se asnjë nga operatorët ekonomik pjesëmarrës nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) “*Anulimi një procedure prokurimi*”, pika (1), germa (ç); neni (46) “*Kualifikimi i ofertuesve*”, pika (1); neni (53) “*Shqyrtimi ofertave*”, pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*”, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe neni (66) “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, pika (3); neni (67) “*Klasifikimi ofertave*; neni (68) “*Raporti përmbledhës*”; Kreu (VIII) “*Kushte të përgjithshme për zbatim*”; neni (73) “*Mungesa e konkurrencës*”, pika (1) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Patos pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

ANEKSET

Aneksi nr. 2.2/1 Pasqyra përmbledhëse për planifikimin e buxhetit për vitin 2022 sipas VKB përkatëse

në lekë

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2022				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr.85 datë 28/12/2021	Buxheti shtesë miratuar me VKB nr.11,dt.24/02/2022	Vleranë 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr.85, datë 28/12/2021	Buxheti shtesë miratuar me VKB nr. 11,dt.24/02/2022	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	1	2	1+2		3	4	3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022	145,720,000	0	145,720,000	Art. 600 Paga	161,079,126		161,079,126
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe te planifikuara për shpenzim për vitin 2022	0	30,562,772	30,562,772	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	27,563,562		27,563,562
Total të ardhurat e veta	145,720,000	30,562,772	176,282,772	Art.602 Shpenzime operative	107,767,655	8,670,328	116,437,983
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	9,288,917	24,064,964	33,353,881	Art.604 Transferime korrente të brendshme	1,000,000	966,343	1,966,343
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike	0	0	0	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	7,050,000	1,100,000	8,150,000
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2022	148,346,356	0	148,346,356	Art. 230-231 Investime	101,480,357	44,971,398	146,451,755
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2022	106,085,427	0	106,085,427	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	3,500,000		3,500,000
Te ardhurat jashte limitit te trasheguara		1,080,332	1,080,332				0.00
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit te shtetit	26,3720,700	25,145,297	288,865,997				0.00
TOTALI TE ARDHURAVE	409,440,700	55,708,069	465,148,769	TOTALI SHPENZIMEVE	409,440,700	5,5708,069	465,148,769

Burimi: Bashkia Cërrik

Plani i investimeve për vitin buxhetor rregjistrohet në thesar me kod projekti nga ministria e financave .

Nr	Emërtimi i investimit	Nr dhe data e VKB	Burimi financimit	Vlera e miratuar në VKB	Vlera e realizuar e investimit (me TVSh)
1	Rikonstruksion I Shkolles Selit	VKB nr.85, datë 28/12/2021	Të ardhurat e veta	10,652,000	4,726,000
2	Rikualifikim urban rruge te brendeshme	VKB nr.85, datë 28/12/2021	Të ardhurat e veta	9,200,000	4,599,558
3	Sistemim Asfaltim Rruges Lushallijve	VKB nr.85, datë 28/12/2021	Të ardhurat e veta	7,034,194	7,034,194
4	Blerje Mjeti per Bashkin Cërrrik		Të ardhurat e veta	946,900	946,900
5	Blerje Paisje Elektronike	VKB nr.85, datë 28/12/2021	Të ardhurat e veta	1,500,000	1,068,000
6	Blerje paisje te tjera	VKB nr.85, datë 28/12/2021	Të ardhurat e veta	700,000	120,720
7	Projekte per realizimin e veprave Inxhinjerike	VKB nr.85, datë 28/12/2021	Të ardhurat e veta	927,506	894,000
8	Riparim Banesa familje ne nevoj	VKB nr.85, datë 28/12/2021	Të ardhurat e veta	1,126,800	1,126,800
9	Ndertim ura kanalesh	VKB nr. 11, dt.24/02/2022	Të ardhurat e veta	3,672,854	3,672,854
	Total të ardhurat e veta		Të ardhurat e veta	35,760,254	24,189,026
			Granti (FZHR..specifiko)		
1	Permirsim Kushte Banimi		Finistria e Financave	13,464,143	13,464,143
2	Ujesjelles Mollas		Ministria e infrastruktures	69,600,751	69,600,751
	Total nga granti			83,064,894	83,064,894

Burimi: Bashkia Cërrrik

në lekë

Nr.	Kodi Projektit	Objekti i Prokurimit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Data e lidhjes se kontrates	Planifikimi i likudimit të vlerës së kontratës			Likuiduar për vitin
						2022	2023	2024	
1	1100126	Projekt Reabilitim Kanale Uites	1272000	D. - E SHPK	10.05.2022	894000	486000	486000	894,000
2	1100214	Projekt Ujesjelles klos	8911952	Z. & C. SHPK	11.08.2020	2500000	2911952	1000000	2,500,000
3	1100128	Projekt Rruge Te brendshme Qyrkan	723000			723000			
4	1100128	Projekt Rruge Te brendshme	163856			163856			

5	1100133	P.rikonstruksion e sist. asfaltim rruge	2000000	Z. & C. SHPK	15.05.2012	2054000		2000000	2,054,000
6	1100229	Hartim Plan Vendorsje	780000	M.. SHPK	12.07.2021	780000			780,000
7	1100134	Projekt rikualifikim urban	927506			927506			
XX		Shuma Projekte				8042362	3397952	3486000	6,228,000
1	1100202	Supervizim punimesh komuna Klos	60000	T. D.	30.12.2021	60000	0		
2	1100201	Kolaudim punimesh goina Klos	20000			20000	0		
3	1100136	Paisje elektronike	3500000	Z. SHPK	19.04.2022	800000	1000000	1000000	500,000
4	1100137	Paisje te tjera	2000000	“Z.” SHPK, D. &C.	13/01/2022,19,4/2022	753100	700000	600000	700,000
5	1100037	Blerje makine per bashkin				946900			946,900
6	1100201	kolaudim punimesh Tregu Cërrik	25000			45000	0		
7	1100220	Supervizion rik. te zyrave te Komunes Mollas	368400			368400	0	0	
8	1100180	Blerje Paisje Zjarrfikse	3000000			1000000	1000000	1000000	
9	1100141	Reabilitim Kanale Uites,Stac. P.htepanje	26044470	E. SHPK	19.11.2018	4557762	1000000	3000000	4,557,762
10	1100143	Reabilitim I kanaleve ujitese sekondare shtes kontrate	5590000	B. SHPK	27.02.2015	5590000			5,590,000
11	1100241	Ndertim urash ne kanale	3672854	F. C. SHPK	30.12.2021	3672854			3,672,853
12	1100220	Mbikqyerje kanale Uites	872534			620534			
13	1100164	Rikonstruksion rruge rurale (zdrava)	88150224	Z. SHPK	19.10.2020	12501077	11491138	20663412	12,501,077
14	1100202	Supervizim rruge rurale	1500000	L. K.	07.03.2018	300000	500000	500000	340600
15	1100201	Kolaudimrruge rurale	480000	L. K.	07.03.2018	120000	180000	180000	110000
16	1100203	Rikonstruksion rruge Qyrkan	26092474	V.H	14.07.2020	6524146	6500000	8000000	6,524,146
17	1100202	Supervizim rruga qyrkan	382745			382745			
18	1100209	Rikonstruksion rruge Kamunah	33820544	V.H	15.04.2021	4833468	8173902	8398803	4,833,467
19	1100210	Rikonstruksion rruge Lican Shales	23934289	A... SHPK	31.12.2020	7930525	8934289	4000230	7,852,045
20	1100215	Rikonstruksion 3 rrugeve (lagjia nr.3)	29637769	G.T SHPK	24.02.2021	12380734	10637829	8000000	12,380,734
21	1100164	Rikonstruksion rruga Çamria	36651254	SH. 07 SHPK	10.06.2019	3219583	7000000	7689060	3,219,583
22	1100224	Rikonstruksion rruga Lushsllijve	21151306	B. N SHPK	13.01.2022	7034194	6460520	7065786	7,034,194
23	1100204	Rikualifikim Urb.blloku 3 lagj. 2 Cërrik Greint	14174623	G.T SHPK	25.08.2020	3155035.2			3,154,158
24	1100202	Supervizim Kolaudim	90000	I. SHPK	02.07.2020	90000			88448
25	1100218	Rikualifikim Urbane blloku 1 lagjia 1	46000000	A. SHPK	06.04.2022	9200000	10400000	7400000	4,599,558
26	1100202	Kolaudim rikualifikim urban blloku II lagj.1	360000			120000	120000	120000	

27	1100230	mbikqyerje rikualifikim urban blloku II lagj.1	120000	R. 95 SHPK	28.12.2018	40000	40000	40000	
28	1100144	Rikualifikim Urban L.2,Mollas (Boshnjaku)	28391885	B.	28.12.2018	7651790			7,651,790
29	1100148	TERMINAL AOTOBUS	14346385	F. C. SHPK	02.05.2019	3000000	5237368	223213	2,000,000
30	1100149	Ndricim Rrugeve te brendeshme sh-07	9323042	SH. 07 SHPK	26.12.2018	2000042			2,000,042
31	1100220	Supervizim ndricim rrugor	60000			60000			
32	1100243	Ndertim KUZ dhe Rikonst. I rruges				5625000			
33	1100244	Rikonst. I rruges Fshati Dasar				7858618			
34	1100245	Rikon. I rruges se Delijve&Xhamise				6138100			
35	1100246	Rikon. Rruges Cërrik&Malasej				11999469			
36	1100247	Rikon. I rruges se Çapallareve&Vreshtit				11800000			
37	1100248	Rikonst. Rruges ne NJA Gostime(Viti				8139733			
38		Rimburim giz tvsh				219131			
39	M100397	Reabilitim Banesa Shpia Pionerit	2390110	Z. SHPK	01.04.2021	2390110			2,390,110
40		mbikqyrje punimesh	565608	A. M. SHPK	20.09.2019	565608			565608
41	1100234	mbikqyrje punimesh	556017			556017			
42		kolaudim banesa	100000			100000			
43		Mbikqyrje banesa	98000			98000			
44	1100166	KUZ 2020AL-MEX	7779868	A. W.	01.10.2020	2479868			2,320,329
45	1100196	Riparim Stacioni Pompave Shelg	9427326	E. SHPK	28.06.2019	6800000			3,198,800
46	1100152	Supervizim kuz (Detyrim)	90000	TH. D.	01.10.2020	90000			90,000
47	1100063	Supervizim punimesh KUZ banje	26400			26400			
48	1100062	Supervizion objektit pyllezim me fidane shege ne ekonomin pyjore Molas	474000			474000			
49	1100140	Sistemim tregu I lire Gostim	534672			534672			
50	1100165	Pik Lidhje Energjie	600000	F.		200000	200000	200000	182,491
51	1100162	Arredim e foni per kinemn	9069910			18061	1981860		
52	1100238	Rikonstruksione Shkolla Selit	53257606	E. SHPK	04.02.2022	10652000	7348300	9904755	4,726,000
53	1100220	Mbikqyrje punimesh shkolla	60000			60000			
54	1100221	Kolaudim punimesh ambjente skollore	30000			30000			
55	1100170	Rikonstruksione Ambjente Sportive	5227000			716738			
56	1100170	Kend Loj.Palestre kap.6	143520						

		SHUMA TE VETAT			176,549,414.2	88,905,206	87,985,259	103,730,695
1	M100399	Permirsim kushte banimi		Z. shpk	13,464,143			13,464,143
2	19AF801	Ujesjelles Mollas		V. shpk	68,016,769			68,016,769
3	19AF802	Supevizim Ujesjelles Mollas			1,583,982			1,583,982
		Te deleguara			83,064,894			83,064,894
		TOTALI 2022			267,656,670	92,303,158	91,471,259	193,023,589

Burimi: Bashkia Cërrik

Aneksi nr. 2.2/2 Tabela e ndryshimeve në buxhet për vitin 2022.

në lekë

Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
Nr/ datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull (me emër)			
				SHTESA art.	shuma	PAKSIME art.	shuma
Vkb nr.85,date 28/12/2021	409,440,700	Nr.11,date 24/02/2022	55,708,070	602- 609ShP. te tjera	10,736,671.85		
				230+231 (Investime)	44,971,398.12		
		Nr.59, dt. 22.08.2022	1500000	606, Nd.Ekonomike 6%	1500000	609, F.Rezerve	1500000
		Nr.65, dt. 15.09.2022	2200000	600,Paga dhe Sigurime	2200000	602 Shpenzime	2200000
		Nr.65, dt. 15.09.2022	1010518	Paga dhe Sigurime	1010518	0	0
		Nr.70, dt. 23.09.2020	2400000	231 Investime	2400000	606, FE	2400000
		Nr.72, dt. 23.09.2022	4600000	231 Investime	4600000	602 Shpenzime	4600000
		Nr.73, dt. 23.09.2022	3000000	602, ShP. Operative	3000000	600 Paga	1000000
Nr.92, dt. 15.12.2022	27890000	602, ShP. operative	5751590				
				231, investime	20,584,410		

Burimi: Bashkia Cërrik

Shënim: Ndryshimet e tjera në buxhetin e Bashkisë Cërrik për vitin 2022 janë kryer brenda programeve buxhetore ,midis artikujve , dhe nuk ka qene nevoja për vendim këshilli Bashkiak kjo në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018”Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” pika 100 germa “b” dhe “c” ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, Pra shtesat dhe pakësimet janë bërë me urdhër të nëpunësit Autorizues dhe janë miratuar në Degën e Thesarit Elbasan.

Aneksi nr. pika 2.2/4 Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2022, referuar akt-rakordimet me thesarin.

Në lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Cërrik, për vitin 2022. Në lekë										
Nr.	Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Burimi i financimit të shpenzimit					
					Nga të ardhurat e veta	% e realizimit nga të ardhurat	Nga Granti Qeveritar			Nga transferta e kushtëzuar
							Nga transferta e pakushtëzuar	Nga transferta e kushtëzuar specifike	Nga transferta e kushtëzuar	

									për funksionet e deleguara	për investimet
1	Paga 600	156,579,126	155,982,331	100	22,603,210	97	63,899,995	69,479,126	-	-
2	Sigurime shoqërore 601	26,789,650	26,575,535	99	757,455	78	14,095,750	11,722,330	-	-
3	ShP. Operat602+ F. Rezervë	113,029,123	110,544,326	98	58,868,319	99	26,255,776	25,420,231	-	-
4	Subvencion Ujësjiellësi, etj. 603	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	K. Q Emergj Civile 604	7,900,816	7,900,362	-	2,122,520	100	-	-	5,777,842	-
6	Nd/Ekonom invalid 606	343,493,357	338,923,226	99	5,385,955	92	4,363,969	-	329,173,302	-
7	Mjete ne ruajtje 466	-	2,335,611	-	2,335,611	-	-	-	-	-
8	Investime 230-231	225,658,099	193,023,589	86	33,156,960	86	76,801,735	-	-	83,064,894
9	Shpenzime 605									
10	Interesa kredia 166									
11	Principali 651									
12									
13	Shto, pakso sipas faktit në B.Cërrik									
	Totali	873,450,171	835,284,980	96	125,230,030		185,417,225	106,621,687	334,951,144	83,064,894

Burimi: Bashkia Cërrik

Aneksi nr. 2.2/5 Lista analitike e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022.

Emerimi i detyrimit te prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2021	Vlera e paguar gjatë vitit 2022 për detyrimin e prapambetur(vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2022 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2022)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2022 (situata më 31.12.2022)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur pa më 31.12.2022
2	3	4	5=3-4	6	7=5+6
Sistemim tregu i lire	534,672		534,672		534,672
Supervizim kuz	90,000		90,000		90,000
Reabilitim i kanaleve ujtesse sekondare shtes kontrate	5,590,480	5590000			0
Hartim e projektme rikonstruksion e sistemimin asfaltim rruge Komuna Mollas	15,554,000	2054000	13,500,000		13,500,000
Supervizion objektit pyllezim me fidane shege ne Molas	474,000		474,000		474,000
Supervizion rikonstruksioni te zyrave te Komunes Mollas	368350		368,350		368,350
Supervizion objektit pyllezim me fidane shege ne ekonomin pyjore Molas	105,600		105,600		105,600
Gjob nga ISHSH	426,000	426000	0		0

MIRMBAJTEJE SHKOLLAT	300,000		300,000		300,000
Ndertim ujesjellesi Selite	354,166		354,166		354,166
Plera dhe Mirmbajtje Fushes	388,760	388760	0		0
Materiale Te tjera	1,786,800		1,786,800		1,786,800
Kolaudim rruga rinia Tregu	25,000		25,000		25,000
Zhavorime	117,936		117,936		117,936
Kendi i Lojrave	1,650,075		1,650,075		1,650,075
Reabilitim stacion Pompash Shtepanje	-		0		0
Arredim e sistemi i kondicionimit te Kinemas	10,061		10,061		10,061
asfalt per shtrim rruge	3,000,000		3,000,000		3,000,000
Trasport Sportist	-		0		0
Riparim i Stacionit te pompave ne Shelg	4,400,000	3198800	1,201,200		1,201,200
Mbikqyrje Mirmb.Ob.Shkolllore	60,000		60,000		60,000
Reabilitim stacion Pompash Shtepanje	9,557,762	4557742	5,000,000		5,000,000
Ndricim i rrugeve B.Cërrik	2,000,042	2000042	0		0
Ruga Camria	20,994,523	3219583	17,774,940		17,774,940
Arredim Kinema	4,080,960		4,080,960		4,080,960
Sherbim Interneti	1,060,200	1060200	0		0
Shpenzime Uji	138,528	138528	0		0
Lidhje kontrate	25,000		25,000		25,000
Matesa Uji	31,200		31,200		31,200
Kolaudim rikualifikim urban	88,448	88448	0		0
Rikualifikim Urban	7,651,790	7651790	0		0
Adaptim dy godina	4,481,175	0	4,481,175		4,481,175
Rikonstruksion rruge	24,000,000	20774400	3,225,060		3,225,060
Sherbim Interneti	176,700	176,700	0		0
Mbikqyrje punimes rikualifik urban	117,600	117,600	0		0
Fishek Zjarre	378,000	378,000	0		0
Sherbim Interneti	176,700	176,700	0		0
Sherbim Interneti	176,700	176,700	0		0
Sherbime Postare	208,776	208,776	0		0
Sherbim Interneti	176,700	176,700	0		0
MbikqyrjeAdaptim 2 godinat	565,608	565,608	0		0
TONERA	593,394	593,394	0		0
Sherbime Postare	128,003	128,003	0		0
Sherbim Interneti	176,700	176,700	0		0
Mbikqyrje Punimesh	620,534		620,534		620,534
Sherbim Interneti	176,700		176,680		176,680
Sherbime Postare	126,967	126967	0		0
Sherbim Interneti	176,700	176700	0		0
Mbikqyrje PUNIMESH	556,017		556,017		556,017

SHPENZIME UJI	1,157,288	1157288	0		0
Sherbime Postare	145815	145815	0		0
Sherbim Interneti	176700	176700	0		0
Sherbime Postare	154347	154347	0		0
Sherbim Interneti	176700	176700	0		0
Sherbim Interneti4 muaj	176,700	176700	0		0
Mbikqyrje punimesh	382,745		382,745		382,745
Rikonstruksion 3 rruget	5730333.6	5730334	0		0
Rruga Qyrkan	16024146	16024146	0		0
Sigurim Jete	350000	350000	0		0
Sherbim Interneti	176,700		176,700		176,700
Sherbime Postare	107,429	107429	0		0
Rikonstruksion banesa	6,460,896		6,460,896		6,460,896
Rikonstruksion rruge				43,533,953	43,533,953
Sherbim Interneti				176,700	176,700
Sherbim Interneti				176,700	176,700
Asfalt rruga lushallijve				5,000,000	5,000,000
mbikqyrje				60,000	60,000
mbikqyrje				9,600	9,600
KOLAUDIM				4,000	4,000
mbikqyrje rr.lican				117,600	117,600
PROJEKT				3,411,972	3,411,972
Karburant				1,613,220	1,613,220
Sherbim Interneti				176,700	176,700
Sherbim Interneti				176,700	176,700
Sherbim Interneti				176,700	176,700
Sherbim Interneti				176,700	176,700
Sherbim Interneti				176,700	176,700
Totali	145,097,127	78526300	66,569,767	54,987,245	121,557,012
Detyrime t FSHZH	36,236,536		36,236,536		36,236,536
Detyrime ne total	181333663		102,806,303	54,987,245	157,793,548

Burimi: Bashkia Cërrrik

Aneksin nr. 2.2/6 Struktura e Drejtorisë të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022.

Nr.	Emri Mbiemri	Funksioni sipas Struktures	Lloji I shkolles	Larte ose I mesem	Urdheri I emerimit NR.date
1	E.D.	Përgjegjës Sektori Tatim Taksave	Finance - Kontabilitet	I Larte	Nr.63/2, Data 20.05.2016/ Nr.1301/2 prot
2	A.D	Specialist i taksave per biznesin NJA Cërrik	Administrim Biznesi	I Larte	Date 24.05.2016 , Nr. 1324/2 Prot
3	M.H	Specialist i taksave per Familjaret NJA Cërrik	Pune Sociale	I larte	Nr.322 date 30.08.2022 Nr. 2487 Prot
4	S.O	Specialist terreni per vjeljen e te ardhurave (bisnes e familjare) ne NJA Cërrik	Ekonomik	I Larte	Nr. 39/1, date 01.04.2016/ Nr. 850/2 Prot
5	A.F	Specialist terreni per vjeljen e te ardhurave (bisnes e familjare) ne NJA Cërrik	Administrim Biznesi	I Larte	
6	A.M	Specialist i taksave per biznesin NJA Gostime	Biologji-Kimi	I Larte	Nr 68, date 27.03.2017/ Nr. 1168/1 Prot
7	F.B	Specialist i taksave per Familjaret NJA Gostime	Administrim Biznesi	I Larte	Nr.325 Date 10.10.2017 , Nr 4238 prot
8	E.M	Specialist terreni per vjeljen e te ardhurave (bisnes e familjare) ne NJA Gostime	Finance - Kontabilitet	I Larte	Nr.74/1, date 13.06.2016/ Nr. 1497/2 Prot
9	M.K	Specialist i taksave per biznesin e familjaret NJA Klos	Finance - Kontabilitet	I Larte	Date 05.06.2016, Nr. 1407/1 Prot
10	A.S	Specialist i taksave per biznesin e familjaret NJA Mollas	Matematik - Fizike	I Larte	Nr. 141, date 28.04.2017/ Nr. 2015 Prot
11	A.GJ.	Specialist terreni per vjeljen e te ardhurave (bisnes e familjare) ne NJA Mollas	Histori - Gjeografi	I Larte	Nr. 103, date 18.05.2020/ Nr. 1269 Prot
12	E.D	Specialist i taksave per biznesin e familjaret NJA Shales	Drejtesi	I Larte	Nr. 509 date 17.11.2022 , Nr.3303 Prot
13	A.Xh	Specialist terreni per vjeljen e te ardhurave (bisnes e familjare) ne NJA Shales	Drejtesi	I Larte	Nr.946 date 23.03.2022 Nr.89 prot
14	K.B	Përgjegjës Sektori I te ardhurave nga pronat me qira, transporti , tregjet e te tjera tatime	Kontabilitet dhe Auditim	I Larte	Nr. 324, date 10.10.2017/ Nr. 4237 Prot
15	T.C	Agjent Terreni per pronat me qera, tregjeve, transportit e te tjera tatime NJA Cërrik	Gjimnaz I Pergjithshem	I mesem	Nr. 58/2 date 15.05.2016/ Nr.1255/2 Prot
16	E.Q	Agjent terrenii per pronat me qera tregjeve transportit e te tjera tatime NJA Cërrik	Shkolla e mesme Profesionale Ekonomike	I mesem	
17	S.M	Agjent Terreni per pronat me qera, tregjeve, transportit e te tjera tatime NJA Gostime	Gjuh dhe Letersi	Larte	Nr. 127/1 date 12.10.2016 / Nr. 2480/1 Prot
18	A.M	Agjent Terreni per pronat me qera, tregjeve, transportit e te tjera tatime NJA Mollas	Gjimnaz I Pergjithshem	I mesem	
19	M.B	Agjent Terreni per pronat me qera, tregjeve, transportit e te tjera tatime NJA Shales	Gjimnazi I Pergjithshem		
20	A.SH	Kujdestar tregu Cërrik	Gjimnazi I Pergjithshem	I mesem	Nr.107/1 Date 04.04.2018/ Nr. 1131 prot

Burimi: Bashkia Cërrik

Aneksi nr. 2.2/7 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2022

Nr	Emertimi I te Ardhurave Tatimore	Viti 2021	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2022	Viti 2022
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	%
A	b	4	5	7	8	9
A	Te ardhura nga Taksa Lokale	61,010	57,779	95,610	60,101	63%
I	Tatim I thjeshtuar mbi fitimin	910	758	915	313	34%
II	Taksa mbi pasurinë e paluajteshme	33,500	39,517	66,645	32,870	49%
1	Taksa mbi Ndërtesat	16,000	20,698	20,500	17,324	85%
2	Taksa mbi token bujqësore	16,000	13,083	14,000	10,465	75%
3	Takse Trualli	1,500	5,736	32,145	5,081	16%
III.	Taksa vendore per sherbim hotelier	10	-	10	26	260%
IV.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	8,800	4,750	9,000	4,428	49%
V	Taksa e tabelës	500	511	500	223	45%

VI	Taks Reklame	600	-	650	100	15%
VII	Taksa te perkoshme	150	104	150	53	35%
1	Rregjistrimi	10		10		
2	Pulles	140	104	140	53	38%
VIII	TE ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	16,540	12,139	17,740	22,088	125%
1	Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	11,500	12,083	12,500	12,943	104%
2	Taksa e rentës minerare	30	56	30	40	133%
3	Taks mbi te ardhurat personale	5,000		5,200	9,097	175%
4	Te tjera taksa kombetare	10		10	8	80%
B	Të ardhura nga tarifat Vendore	34,270	31,151	36,687	32,743	89%
I	Tarifa nga menaxhimi I mbetjeve	16,100	17,665	16,700	16,433	98%
II	Tarif per ndricimin publik	2,110	1,721	2,500	1,595	64%
III.	Tarif per Gjelberimin	1,440	1,536	1,750	1,436	82%
IV.	Tarifa per sherbimet Administrative te bashkise	12,800	8,248	13,600	10,034	74%
1	Tarifa sherbimi administrative	60		80	97	121%
2	Tarifa per dhenien e licencave lejeve Autorizimeve	1,500	1,696	1,500	1,040	69%
3	Tarifa te kontrollit e zhvillimit teritorit			4,800	400	8%
4	Tarifa e licensimit te te transportit	1,100	1,008	1,100	958	87%
5	Tarifa parkimi	1,100	1,224	1,200	1,392	116%
6	Tarif per sherbimet zjarrfikese		29	300	145	48%
7	Tarifa per zenien e fasadave e hapësira publike	3,560	2,782	3,800	2,397	63%
8	Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj		70			
9	Tarifa vendore Urbanistika	4,700	1,372	820	3,508	428%
10	Tarife për shërbime te tjera administrative(me v.k.b)	780	67		97	
11	Te tjera jo taitmore(arsimi)	20				
V	TARIFA TE INSTITUCIONEVE SPORTIVE E KULTURORE	370	13	150	-	
1	Tarifa per Bileta sporti		13	150	-	
2	Tarifa te tjera Transporti urban	130				
3	Tarifa per kopshet cerdhet	240				
VI	Tarifa te sherbimit te Uitjes e Kullimit	-	1,968	1,600	1,954	122%
VII	Tarifa te perkoshme	1,450	-	387	1,291	334%
C	Të ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qera	44,196	11,437	10,423	9,596	92%
1	Qera nga Ndërtesat	250	1,501	1,220	668	55%
2	Qera toke bujqesore	4,500	4,151	8,324	6,009	72%
3	Qera trualli	20				
4	Te tjera te ardhura nga pronsia	1,650	2,746	279	346	124%
5	Te tjera gjoba dhe kamatvonesa	666	3,039	600	2,573	429%
6	Te ardhura nga detyrime te pambledhura nga viti i kaluar	32,110				
7	Të ardhura të tjera	5,000				
VIII	Totali i te ardhurav te veta (A+B+C+D+E)	139,476	100,367	142,720	102,440	72%

Burimi: Bashkia Cërrik.

Aneks nr. 2.2/8 detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifat vendore të ndara sipas Njësieve administrative si vijon:

Njesite	Detyrimi 31.12.2021		Paguar viti 2021		Mbetje viti 2021		Detyrimi viti 2022		Detyrimi 31.12.2022	
	Nr.Fam.	Detyrimi	Nr.Fam.	Detyrimi	Nr.Fam.	Detyrimi	Nr.Fam.	Detyrimi	Nr.Fam.	Detyrimi
Administrative										
Njesia Shales	437	4,022,099	120	923,440	317	3,098,659	568	2,857,682	600	5,956,341
Njesia Cërrik	577	5,008,487	149	947,369	428	4,061,118	817	2,740,801	822	6,801,930
Njesia Mollas	462	3,968,439	238	1,692,890	224	2,275,549	355	1,776,969	356	4,028,344
Njesia Gostime	828	5,098,341	296	1,669,960	532	3,428,381	1059	4,896,744	1128	8,465,825
Njesia Klos	438	4,687,598	87	561,765	351	4,125,833	518	2,420,059	535	6,545,892
TOTALI	2742	22,784,964	890	5,795,424	1852	16,989,540	3317	14,692,255	3441	31,798,332

Burimi: Bashkia Cërrik

Aneksi nr. 2.2/9 Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre

Nr.	Subjekt	Nipt	Lishenca 5 vite	Afati	Afati	Detyrimi 5 Vjecar sipas VKM	Detyrimi për Autorizim	Pagesat e kryera	Diferenca e autorizim it dhe VKM
				Fillim	Mbarim				
1	G. C. shpk, M.	K.....T	25.11.2019-25.11.2024	25.11.2021	25.11.2022	1,000,000	200,000	600,000	400,000

2	G. C. shpk	K....T	28.12.2018-18.12.2023	18.12.2021	18.12.2022	1,000,000	200,000	800,000	200,000
3	K. shpk	J....P	03.02.2022-03.02.2027	03.02.2022	03.02.2027	1,000,000	1,000,000	1,000,000	-
4	"G.O."shpk, Gostime	L....N	16.12.2020-16.12.2025	16.12.2021	16.12.2022	1,000,000	200,000	400,000	600,000
5	"G.O"shpk, Kamunah	L....N	11.12.2020-11.12.2025	11.12.2021	11.12.2022	1,000,000	200,000	400,000	600,000
6	"F." shpk	L....T	18.06.2015-18.06.2020 (OK)	18.06.2020	18.06.2020	1,000,000	-	-	1,000,000
7	"D.O." shpk	L.....O	22.09.19-22-09-2024	22.09.2021	22.09.2022	1,000,000	200,000	600,000	400,000
8	SH.O.shpk, P.12.22	L.....G	21.11.2020-.,Pezulluar Dhjetor 2022	21.11.2022	21.11.2022	1,000,000	200,000	400,000	-
9	X.O. shpk	L.....G	16.09.2019-16.09.2024	16.09.2021	16.09.2022	1,000,000	200,000	600,000	400,000
10	"L.O" shpk	L....U	06.03.2022-06.03.2027	06.03.2022	06.03.2024	1,000,000	400,000	400,000	600,000
11	D.2020 shpk	M.....S	06.08.2020-06.08.2025	06.08.2021	06.08.2022	1,000,000	200,000	400,000	600,000
12	S.2000 sh.p.k	K....P	12.03.2019-12.03.2024	12.03.2019	12.03.2024	1,000,000	1,000,000	1,000,000	-
13	I. shpk	M....P	12.12.2020-12.12.2025	12.12.2020	12.12.2022	1,000,000	400,000	400,000	600,000
14	A-E P.	L.....C	12.11.2018-12.11.2023	12.11.2018	12.11.2024	1,000,000	1,000,000	1,000,000	-
15	H.B pike Gazi, Fundore	L.....G	23.09.2021-23.09.2026	23.09.2021	23.09.2023	100,000	40,000	40,000	60,000
						14,100,000	5,440,000	8,040,000	5,460,000

Burimi: Bashkia Cërrik

Aneksi nr. 2.2/10 Kontratat e lidhura nga qirat e aseteve

Nr.D	SUBJEKTI (shoqeria..)	Kontrata e Lidhur		VLERA e KONTRATËS në lekë	Çelje 2022	Pagesa	Mbetja
		Datë	Kohëzgjatja				
1	21.01.2019		10-vjet(me te drejt përsëritje)	20,020	20,020	20,020	-
2	"E-I 07" Ad.M.SH	21.01.2019	10-vjet(me te drejt përsëritje)	8,008	8,008	20,020	-
			9-vjet(me te drejt përsëritje)	27,002	27,002	8,008	-
3	B.C	08.05.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	54,030	54,030		54,030
4	A.SH1	08.05.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	15,015	15,015	15,015	-
5	S.V	08.05.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	50,050	50,050	50,050	-
6	XH.S(KONTRATE E ANULLUAR	08.05.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	5,005	-		-
7	E.B	18.06.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	15,015	15,015	15,000	-
8	Y.GJ	18.06.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	17,002	17,002	17,000	1,020
9	S.B	18.06.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	5,005	5,005	5,005	-
10	F.V	18.06.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	30,030	30,030	30,030	-
11	A.SH	18.06.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	10,010	10,010	10,010	-
12	A.SH	18.06.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	30,030	30,030	30,030	-
13	S.V	18.06.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	85,009	85,009	85,009	-
14	"H."sh.p.k	01.07.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	180,000	180,000	180,000	-

15	"B."shpk Ad.F.D	01.06.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	120,120	120,120	135,122	-
		01.06.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	15,002	15,002		
16	A.K	01.06.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	15,015	15,015	15,015	-
17	Q.K	01.06.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	15,015	15,015	15,015	-
18	I.H	01.06.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	4,004	4,004	4,005	-
19	D.SH	01.06.2019	9-vjet(me te drejt përsëritje)	30,030	30,030	30,030	-
20	"F. C."shpk	10.01.2018	10-vjet(me te drejt përsëritje)	75,451	75,451	75,451	-
		10.01.2018	10-vjet(me te drejt përsëritje)	667,370	667,370	667,370	-
21	SH.H	21.09.2020	10-vjet(me te drejt përsëritje)	9,000	9,000	9,000	-
22	A.H	21.09.2020	10-vjet(me te drejt përsëritje)	6,000	6,000	6,000	-
23	P.GJ	21.09.2020	10-vjet(me te drejt përsëritje)	15,000	15,000	15,000	-
24	V.XH "B N F"	21.09.2020	10-vjet(me te drejt përsëritje)	50,000	50,000	50,000	-
25	D.T	21.09.2020	10-vjet(me te drejt përsëritje)	30,000	30,000	30,000	-
26	A. A	21.09.2020	10-vjet(me te drejt përsëritje)	15,000	15,000	15,000	-
27	D.K	21.09.2020	10-vjet(me te drejt përsëritje)	15,000	15,000		
28	D.T	21.09.2020	10-vjet(me te drejt përsëritje)	15,000	15,000	15,000	-
29	G.GJ	23.09.2020	10-vjet(me te drejt përsëritje)	150,000	150,000	150,000	-
30	H.K	22.12.2020	10-vjet(me te drejt përsëritje)	65,000	65,000	65,000	-
31	K.B	22.12.2020	10-vjet(me te drejt përsëritje)	90,000	90,000	90,000	-
32	F.G.S	14.12.2020	10-vjet(me te drejt përsëritje)	20,000	20,000	20,000	-
33	A.P	21.12.2020		4,000	4,000	4,000	-
34	F.S	22.12.2020	9-vjet(me te drejt përsëritje)	10,000	10,000	10,000	-
35	D.L	22.12.2020	9-vjet(me te drejt përsëritje)	15,000	15,000	15,000	-
36	I. Sh,p,k-	30.12.2020	9-vjet(me te drejt përsëritje)	150,000	150,000	150,000	-
37	D. 2005 SH.P.K-M S	04.02.2021	9-vjet(me te drejt përsëritje)	250,000	-		
38	A.H	04.02.2021	9-vjet(me te drejt përsëritje)	12,000	12,000	12,000	-
39	A.SH	07.05.2021	9-vjet(me te drejt përsëritje)	10,000	10,000	10,000	-
40	B N,F sh.p.k(Adm. V XH)	06.05.2021	9-vjet(me te drejt përsëritje)	297,000	297,000	297,000	-

41	M.K	07.05.2021	9-vjet(me te drejt përsëritje)	70,000	70,000	70,000	-
42	A.XH	01.08.2021	9-vjet(me te drejt përsëritje)	35,000	35,000	35,000	-
43	D.A	01.08.2021	9-vjet(me te drejt përsëritje)	18,000	18,000	18,000	-
44	A.A	01.08.2021	9-vjet(me te drejt përsëritje)	12,000	12,000	12,000	-
45	E.A	01.08.2021	9-vjet(me te drejt përsëritje)	7,000	7,000	7,000	-
46	D.M	01.08.2021	9-vjet(me te drejt përsëritje)	10,000	10,000	10,000	-
47	M.M	01.08.2021	9-vjet(me te drejt përsëritje)	10,000	10,000	10,000	-
48	S.H	31.01.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	60,000			
49	Q.M	31.01.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	40,000	40,000	40,000	-
50	A.D	15.03.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	30,000	30,000	30,000	-
51	E.D	15.03.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	130,000	130,000	130,000	-
52	A.SH	15..03.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	4,000	4,000	4,000	-
53	F. L.A	10.06.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	6,800	6,800	3,400	-
54	F. L. A	10.06.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	2,000	2,000	1,000	-
55	E. M. B.	10.06.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	200,000	200,000	100,000	-
56	P. S.	10.06.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	6,500	6,500	3,250	-
57	F. K. A.	10.06.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	30,000	30,000	15,000	-
58	P. Q. C.	10.06.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	17,000	17,000	8,500	-
59	J. F. Q.	23.08.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	10,000	10,000	10,000	-
60	E.D	23.08.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	20,000	20,000	8,330	-
61	A.SH	23.08.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	20,000	20,000		
62	SH.M	23.08.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	5,000	5,000	1,666	-
63	K.LL	26.10.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	7,000	7,000	1,170	-
64	SH.LL	26.10.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	3,000	3,000	750	-
65	F.C	26.10.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	10,000	10,000	1,000	-
66	O.Z	22.12.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	9,500	500	500	-
67	F. B	22.12.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	12,000	500	500	-

68	F. B	22.12.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	2,000	500		
69	I.XH.	26.10.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	30,000	50,000	5,000	-
70	H.M	22.12.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	30,000	-		
71	A.D	22.12.2022	9-vjet(me te drejt përsëritje)	12,000	500		
				3,580,038	3,221,533	2,916,271	55,050

Burimi: Bashkia Cërrik

Aneksi nr. 2.3/1 Pronat të cilat janë regjistruar gjatë periudhës 2017-2019 pranë ASHK

Nr	Emertimi i Pasurisë	Zona kadastral	Nr Pasurise	Indeksi I harte	Nr. rregjis	Siperfaqia sipas V.K.M.		Data e aplikimit Nr. Dt.	Vertetim ose certifikate Hipoteke	Siperfaqia sipas Faktit	
						Truall	Ndert			Truall	Ndert
1	Kinemaja/qytetit(me +)	1389	1/157			583	472	20/09/2017		583	472
2	Njesia Shales/Shkollë	2449	A-269			6460	560	09/10/2017		6460	560
3	Qender Shendetesore	2449	163/16			2685	305	09/10/2017		2685	305
4	Shkollë	3856	67/30			1350	320	09/10/2017		1350	320
5	Shkollë	3862	359/3			1250	319	09/10/2017		1250	319
6	Tregu i vjeter	2281	1/161			5034.6		14/11/2017		5034.6	
7	Tregu i ri	1389	3/63			787		14/11/2017		787	
8	Varrezat publike qytetit		26			16000		06/12/2017		15022	
9	Zjarfiksjia dhe sheshi	2441	12/120	truall		7743		16/01/2018		7743	
10	Truall	2441	12/122			451		16/01/2018		451	
11	Truall	2441	12/124			413		16/01/2018		413	
12	Ruge vendore	2441	12/125	Ruge		1003.4		16/01/2018		1003.4	
13	Truall	2441	12/126			860.54		16/01/2018		860.54	
14	Truall	2441	12/129			521.07		16/01/2018		521.07	
15	Kopeshti i vjeter	1389	1/125			200	200	15/02/2018		200	200
16	Shesh ansor i fushes	1389	3/89			2780		07/03/2018		2780	
17	Fushe sporti	1389	3/90			9304		07/03/2018		9304	
18	Ndertese ne ndikim te fushes sportit	1389	3/91				212	07/03/2018			212
19	Terren sportiv	1389	12/123			7224		07/03/2018		7224	
20	Ambulanca vjeter Lagja nr 2	1389	4/68			323	256	16/05/2018		323	256
21	Qender shendesore Gostim	1820	177/16			875	295	20/06/2018		875	295
22	Shtermen	3422	A			400	310	20/06/2018		400	310
23	Malasej	2559	A			125	46	20/06/2018		125	46
24	Ndryshim emertimi nga komune Njesi	1530	300/5	kullot		182500		20/02/2019		182500	
25		1452	183/23	zallishte		246226		20/02/2019		246226	
26	Saktesim sip Ambulanca Vjeter	1389	4/68					08/02/2019			
27	Shtepia pionierit	1389	4/73			514	396	27/03/2019		514	396
28	Zyre/Bordi Kullimi	2559	6/18			70	66.4	07/04/2019		70	66.4
29	Truall midis ndertesave	2559	6/17			209		07/04/2019		209	
30	Ekonomi/Pyjore/Kullosore	3856	A-(100a)			196800		16/04/2019		196800	
31	Shkolla e nates	1389	5/81			414	340	08/05/2019		414	340

Burimi: Bashkia Cërrik

Pronat të cilat janë regjistruar gjatë periudhës 2020-2022 pranë ASHK.

Nr	Emertimi i Pasurisë	Zona kadastral	Nr Pasurise	Indeksi I harte	Nr. rregjis	Siperfaqia sipas V.K.M.		Data e aplikimit Nr. Dt.	Vertetim ose certifikate Hipoteke	Siperfaqia sipas Faktit	
						Truall	Ndert			Truall	Ndert
1	NTI	1389	3/105,		1164	280	240	16/6/2020		280	240
2	NTI	1389	3/103		1163	585	479	16/6/2020		585	479
3	Saktesim kufiri	2559	6/17,6/18					9/11/2020			
4	Ekonomi pyjore kodiEL6700001	3294	220/7.220/50			49.15		17/12/2020		49.15	
5	Shkolla 9 vj Shtermen	3422	46/1		8	3154	652	24/2/2022		3154	652
6	Obori shkolles Shtermen	3422	46/2		9	800		24/2/2022		800	
7	Ambulanca re lagjanr 2	1389		CE-A-1	1206	433	318	24/02/2022		433	318

Burimi: Bashkia Cërrik

Aneksi nr. 1.5/1 i Leje të ndërtimit për ndërtim për vitin 2020-2022

Nr	Periudha/ Viti	Kategoria e aplikimit	Vendimi Leje ndërtimi	Sipërfaqe totale ndërtimi	Preventivi Sipas subjektit	TNI më %	Kosto mesatare e ndërtimit për m2 sipas EKB	Preventivi sipas EKBN	Vlera e TNI- së e llogaritur nga Bashkia	Vlera qe duhej te paguej sipas EKBN	Vlera e TNI-së e likujduar në Lekë
1	2020	Leje ndërtimi me sipërfaqe deri në 250 m2	Vendim Nr.197 datë 24.03.2020	24.4	452,603	3%	32,331	788,876	13,578	23,666	13,578
2	2020	Leje ndërtimi per rikonstruksion pa ndryshim funksioni	Vendimi Nr. 202 date 14.04.2020	100	4,346,387	3%	32,331	3,233,100	130,392	96,993	130,392
3	2020	Leje ndërtimi per rikonstruksion pa ndryshim funksioni	Vendimi Nr. 204 date 08.05.2020	120	2,558,289	3%	32,331	3,879,720	76,749	116,392	76,749
4	2020	Leje ndërtimi per ndërtim te ri deri ne 250 m2	Vendimi 207 date 08.05.2020	171	5,096,978	3%	32,331	5,528,601	165,858	165,858	165,858
5	2020	Leje ndërtimi per ndërtim te ri me sipërfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 208 date 18.05.2020	92.4	3,431,684	3%	32,331	2,987,384	102,950	89,622	102,950
6	2020	Leje ndërtimi per shtese ne ndërtim ekzistues, me sipërfaqe me te madhe se 250 m2	Vendimi Nr. 211 date 08.06.2020	530	10,285,069	3%	32,331	17,135,430	339,476	514,063	339,476
7	2020	Leje ndërtimi per rikonstruksion pa ndryshim funksioni	Vendimi Nr. 213 date 05.06.2020	77.6	499,923	3%	32,331	2,508,886	14,998	75,267	14,998
8	2020	Leje ndërtimi per ndërtim te ri me sipërfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 214 date 04.06.2020	164	7,499,914	0%	-	-	-	-	-
10	2020	Leje ndërtimi per ndërtim te ri me sipërfaqe deri ne 250 m2	Vendim Nr.224 datë 24.07.2020	100.6	2,990,258	3%	32,331	3,252,499	99,445	97,575	99,445
11	2020	Leje ndërtimi per ndërtim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250 m2	Vendimi Nr. 225 date 04.08.2020	756.23	27,839,221	3%	32,331	24,449,672	835,177	733,490	835,177
12	2020	Leje ndërtimi per rikonstruksion pa ndryshim funksioni	Vendimi 227 date 14.09.2020	125.4	2,122,186	3%	32,331	4,054,307	63,696	121,629	63,696
14	2020	Leje ndërtimi per ndërtim te ri me te madhe se 250 m2	Vendimi Nr. 243 date 14.12.2020	365.76	10,248,144	3%	32,331	11,825,387	354,762	354,762	354,762
15	2020	Leje per ndryshim funksioni	Vendimi Nr. 246 date 29.12.2020	76.4	871,664	3%	32,331	2,470,088	26,150	74,103	26,150
16	2020	Leje ndërtimi per ndërtim te ri deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 239 date 20.11.2020	Sip. Prones qe zhvillohet 1850 m2 sip. Ndert. 14 m2	14,997,853	3%	32,331	#VALUE!	-	#VALUE!	-
17	2020	Leje ndërtimi per rikonstruksion me ndryshim funksioni	Vendimi Nr. 240 date 20.11.2020	484	13,634,256	0%	32,331	15,648,204	-	-	-
18	2020	Leje ndërtimi per ndërtim te rime sipërfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 245 date 23.12.2020	110	3,743,415	3%	32,331	3,556,410	121,103	106,692	121,103
19	2021	Leje ndërtimi per ndërtim te ri per sipërfaqe me te madhe se 250 m2	Vendimi Nr. 256 date 02.03.2021	1384.5	34,013,875	2%	32,331	44,762,270	680,278	895,245	680,278
20	2021	Leje ndërtimi per ndërtim te ri me sipërfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 255 date 19.02.2021	26.03	765,442	1%	32,331	841,576	7,654	8,416	7,654
21	2021	Leje ndërtimi per rikonstruksion pa ndryshim funksioni	Vendimi Nr. 257 date 18.03.2021	69	1,751,537	1%	32,331	2,230,839	17,515	22,308	17,515

22	2021	Leje ndertimi per ndertim te ri me siperfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 258 date 19.03.2021	79	2,728,651	1%	32,331	2,554,149	27,287	25,541	27,887
23	2021	Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues ne siperfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 264 date 18.05.2021	137	3,696,517	1%	32,331	4,429,347	36,965	44,293	36,965
24	2021	Leje ndertimi per rikonstruksion pa ndryshim funksioni	Vendimi Nr. 263 date 17.05.2021	92.5	2,045,298	1%	32,331	2,990,618	20,453	29,906	20,453
25	2021	Leje ndertimi per rikonstruksion pa ndryshim funksioni	Vendimi Nr. 267 date 08.06.2021	298.39	3,641,003	2%	32,331	9,647,247	72,820	192,945	72,820
26	2021	Leje ndertimi per rikonstruksion pa ndryshim funksioni	Vendim Nr. 269 date 17.06.2021	291.73	3,198,526	2%	32,331	9,431,923	63,971	188,638	63,971
27	2021	Leje ndertimi per ndertim te ri me siperfaqe deri ne 250 m2	Vendim Nr. 268 date 11.06.2021	110	3,611,974	1%	32,331	3,556,410	44,920	35,564	44,920
28	2021	Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues ne siperfaqe deri ne 250 m2	Vendim Nr. 272 date 01.07.2021	100.9	2,373,160	1%	32,331	3,262,198	23,732	32,622	23,732
29	2021	Leje ndertimi per rikonstruksion pa ndryshim funksioni	Vendimi Nr. 271 date 01.07.2021	35.63	1,732,753	2%	32,331	1,151,954	34,655	23,039	34,655
30	2021	Leje ndertimi per ndertim te ri me siperfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 275 date 19.07.2021	56	2,484,790	1%	32,331	1,810,536	24,848	18,105	24,848
31	2021	Leje ndertimi per ndertim te ri me siperfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 291 date 01.11.2021	256	5,783,508	2%	32,331	8,276,736	115,670	165,535	165,535
32	2021	Leje ndertimi per ndertim te ri me siperfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 292 date 01.11.2021	81	3,321,996	1%	32,331	2,618,811	33,220	26,188	39,700
33	2021	Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues ne siperfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 300 date 28.12.2021	32.12	936,920	1%	32,331	1,038,472	42,716	10,385	42,716
34	2021	Leje per ndertim te ri me siperfaqe me te madhe se 250 m2	Vendimi Nr. 299 date 24.12.2021	798	15,060,485	2%	32,331	25,800,138	301,210	516,003	396,970
35	2021	Leje ndertimi per ndertim te ri me siperfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 301 date 26.01.2022	110.5	3,644,073	2%	32,331	3,572,576	72,881	71,452	86,141
37	2022	Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues me siperfaqe me te madhe se 250 m2	Vendimi Nr. 311 date 18.03.2022	300	19,640,592	2%	32,331	9,699,300	392,812	193,986	404,812
39	2022	Leje ndertimi per ndertim te ri me siperfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 305 date 07.03.2022	160	5,824,547	2%	32,331	5,172,960	116,491	103,459	133,291
40	2022	Leje ndertimi per ndertim te ri me siperfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 1317 date 19.04.2022	208.4	7,352,008	1%	32,331	6,737,780	73,520	67,378	95,402
41	2022	Leje ndertimi per ndertim te ri me siperfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 1328 date 20.04.2022	138.19	4,970,231	1%	32,331	4,467,821	49,702	44,678	64,287
42	2022	Leje ndertim per ndertim te ri me siperfaqe me te madhe se 250 m2	Vendimi Nr. 1309/3 date 09.06.2022	390.25	17,144,018	2%	32,331	12,617,173	342,880	252,343	401,418
43	2022	Leje ndertimi per ndertim te ri me siperfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 1895/2 date 07.07.2022	234	6,749,455	2%	32,331	7,565,454	135,790	151,309	167,290
44	2022	Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues me siperfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 1986/3 date 30.08.2022	248.74	7,668,421	1%	32,331	8,042,013	80,420	80,420	86,639
45	2022	Leje ndertimi per ndertim te ri me siperfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 2399/3 date 19.09.2022	102.5	3,898,903	1%	32,331	3,313,928	38,989	33,139	41,552

46	2022	Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues me sipërfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 2400/3 date 23.09.2022	49	1,588,247	2%	32,331	1,584,219	31,765	31,684	33,235
47	2022	Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues me sipërfaqe me te madhe se 250 m2	Vendimi Nr. 2401/3 date 19.09.2022	485.14	56,000,026	0%	32,331	15,685,061	-	-	-
48	2022	Leje ndertimi per rikonstruksion me ndryshim funksioni	Vendimi Nr. 2456/3 date 23.09.2022	93.08	746,160	2%	32,331	3,009,369	14,923	60,187	14,923
49	2022	Leje ndertimi per ndertim te ri me sipërfaqe deri ne 250 m2	Vendimii Nr. 2806/5 date 26.010.2022	84.07	3,536,430	1%	32,331	2,718,067	35,364	27,181	44,192
50	2022	Leje ndertimi, rikonstruksioni dhe riparimi te nderteses se demtuar me shtim apo ndryshim vellimi	Vendimi Nr. 2963/5 date 01.11.2022	129	4,252,606	1%	32,331	4,170,699	42,526	41,707	45,751
51	2022	Leje ndertimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250 m2	Vendimi Nr. 3024/7 date 05.01.2023	800	63,546,299	2%	32,331	25,864,800	1,270,925	517,296	1,294,925

Burimi: DPZHT Bashkia Cërrik

Aneksi nr. 2.5/2 i Leje ndërtimi me sipërfaqe deri në 250 m2, për vitin 2020-2022 për të cilat u konstatuan diferenca midis EKBN dhe preventivit.

Nr	Kategoria e aplikimit	Vendimi Leje ndërtimi	Sipërfaqe totale ndërtimi	Preventivi Sipas subjektit	TNI më %	Kosto mesatare e ndertimit për m2 sipas EKB	Preventivi sipas EKBN	Vlera e TNI-së e llogaritur nga Bashkia	Vlera qe duhej te paguej sipas EKBN	Vlera e TNI-së e likujduar në Lekë	Diferenca midis EKBN dhe Preventivit
1	Leje ndërtimi me sipërfaqe deri në 250 m2	Vendim Nr.197 datë 24.03.2020	24.4	452,603	3%	32,331	788,876	13,578	23,666	13,578	10,088
2	Leje ndertimi per rikonstruksion pa ndryshim funksioni	Vendimi Nr. 204 date 08.05.2020	120	2,558,289	3%	32,331	3,879,720	76,749	116,392	76,749	39,643
3	Leje ndertimi per ndertim te ri deri ne 250 m2	Vendimi 207 date 08.05.2020	171	5,096,978	3%	32,331	5,528,601	165,858	165,858	165,858	0
4	Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues, me sipërfaqe me te madhe se 250 m2	Vendimi Nr. 211 date 08.06.2020	530	10,285,069	3%	32,331	17,135,430	339,476	514,063	339,476	174,587
5	Leje ndertimi per rikonstruksion pa ndryshim funksioni	Vendimi Nr. 213 date 05.06.2020	77.6	499,923	3%	32,331	2,508,886	14,998	75,267	14,998	60,269
6	Leje ndertimi per rikonstruksion pa ndryshim funksioni	Vendimi 227 date 14.09.2020	125.4	2,122,186	3%	32,331	4,054,307	63,696	121,629	63,696	57,933
7	Leje ndertimi per ndertim te ri per sipërfaqe me te madhe se 250 m2	Vendimi Nr. 256 date 02.03.2021	1384.5	34,013,875	2%	32,331	44,762,270	680,278	895,245	680,278	214,967
8	Leje ndertimi per ndertim te ri me sipërfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 255 date 19.02.2021	26.03	765,442	1%	32,331	841,576	7,654	8,416	7,654	762
9	Leje ndertimi per rikonstruksion pa ndryshim funksioni	Vendimi Nr. 257 date 18.03.2021	69	1,751,537	1%	32,331	2,230,839	17,515	22,308	17,515	4,793
10	Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues ne sipërfaqe deri ne 250 m2	Vendimi Nr. 264 date 18.05.2021	137	3,696,517	1%	32,331	4,429,347	36,965	44,293	36,965	7,328
11	Leje ndertimi per rikonstruksion pa ndryshim funksioni	Vendimi Nr. 263 date 17.05.2021	92.5	2,045,298	1%	32,331	2,990,618	20,453	29,906	20,453	9,453

12	Leje ndertimi per rikonstrukcion pa ndryshim funksioni	Vendimi Nr. 267 date 08.06.2021	298.39	3,641,003	2%	32,331	9,647,247	72,820	192,945	72,820	120,125
13	Leje ndertimi per rikonstrukcion pa ndryshim funksioni	Vendim Nr. 269 date 17.06.2021	291.73	3,198,526	2%	32,331	9,431,923	63,971	188,638	63,971	124,667
14	Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues ne siperfaqe deri ne 250 m2	Vendim Nr. 272 date 01.07.2021	100.9	2,373,160	1%	32,331	3,262,198	23,732	32,622	23,732	8,890
15	Leje per ndertim te ri me siperfaqe me te madhe se 250 m2	Vendimi Nr. 299 date 24.12.2021	798	15,060,485	2%	32,331	25,800,138	301,210	516,003	396,970	119,033
16	Leje ndertimi per rikonstrukcion me ndryshim funksioni	Vendimi Nr. 2456/3 date 23.09.2022	93.08	746,160	2%	32,331	3,009,369	14,923	60,187	14,923	45,264
							140,301,344	1,913,876	3,007,439	2,009,636	997,803

Burimi: DPZHT Bashkia Cërrik

Aneksi nr. 1.6/1 i gjobave të vendosura nga Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Cërrik për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022 dhe arkëtimi tyre.

Nr.	Subjekti	Vendimi		Arsyeja/Shkaku i gjobës	Vlera e gjobës	Situata aktuale e gjobës				Totali
		Seria Nr	Data			Likuiduar	Proces gjyqësor	Pa likuiduar	Kamatëvonesa	
01	S.SH	0001	28.08.2017	Xoglaturë në vazhdimësi, kollona betoni 3m l, 21.5m gja dhe 9m gje=193m	500.000 lekë	JO	JO	PO	-	500.000 lekë
02	T.H	0002	19.12.2017	Cati fallco e ndërtuar mbi soletë.	70.000 lekë	JO	JO	PO	-	70.000 lekë
										Viti 2017 total 570.000 lekë.
03	P.SH	0003	16.07.2018	Ngritje me profile hekuri cati e pashfrytezueshme.	10.000 lekë	JO	JO	PO	-	10.000 lekë
04	K.H	0004	30.10.2018	Shtesë kati dytë pa leje.	300.000 lekë	JO	JO	PO	-	300.000 lekë
										Viti 2018 total 310.000 lekë.
05	XH.SH	0005	10.01.2019	Mbulesë betoni e llojit soletë në objektin ekzistues.	300.000 lekë	JO	JO	PO	-	300.000 lekë

06	B.D	0006	08.03.2019	Bazë betoni 100m dhe ngritje kollonash lartesi 3m.	500.000 lekë	JO	JO	PO	-	500.000 lekë
07	N.H	0007	11.04.2019	Mbulese objekti kati dyte me solete dhe cati e pashfrytezueshme.	300.000 lekë	JO	JO	PO	-	300.000 lekë
08	R.M	0008	07.05.2019	Rikonstruksion i objektit me mure dhe cati.	300.000 lekë	JO	JO	PO	-	300.000 lekë
09	E.H	0009	12.06.2022	Themele betoni, xoglature me sipërfaqe 90m.	500.000 lekë	JO	JO	PO	-	500.000 lekë
10	C.GJ	0010	05.07.2019	Kioske metalike me profile te cmontueshme.	500.000 lekë	JO	JO	PO	-	500.000 lekë
11	L.H	0011	05.08.2019	Solete betoni mbi objektin ekzistues 1 kat.	300.000 lekë	JO	JO	PO	-	300.000 lekë
12	J.A	0012	09.08.2019	Cati e pashfrytezueshme mbi objektin ekzistues 1kat.	300.000 lekë	JO	JO	PO	-	300.000 lekë
										Viti 2019 total 3.000.000 lekë
13	H.Z	0013	29.04.2020	Rindertim objekti nga themeli 1 kat.	500.000 lekë	JO	JO	PO	-	500.000 lekë
14	R.P	0014	16.06.2020	Ndertim catie e pashfrytezueshme mbi objektin ekzistues 1 kat.	500.000 lekë	JO	500.000 lekë	PO	-	500.000 lekë
15	G.D	0015	19.06.2020	Rindertim objekti 1 kat nga themeli.	500.000 lekë	JO	500.000 lekë	PO	-	500.000 lekë
										Viti 2020 total 1.500.000 lekë.
16	H.B	0016	01.09.2021	Rethim i objektit me mur tulle.	300.000 lekë	JO	Larguar/ Në ndjekje të procedurave.	PO	-	300.000 lekë
17	M.M	0017	03.09.2021	Rindërtim objekti nga themeli dy kate.	500.000 lekë	JO	500.000 lekë	PO	-	500.000 lekë

18	F.M	0018	08.09.2021	Ndërtimi në zhvillim i konstruksionit metalik.	300.000 lekë	JO	300.000 lekë	PO	-	300.000 lekë
19	Q.SH	0019	21.09.2021	Mbulesë betoni e llojit soletë në objektin ekzistues duke krijuar shtesë në vëllim dhe sipërfaqe.	300.000 lekë	JO	300.000 lekë	PO	-	300.000 lekë
20	R.H	0020	20.10.2021	Shtesë objekti në pjesën ballore.	300.000 lekë	JO	300.000 lekë	PO	-	300.000 lekë
21	B.C	0021	28.10.2021	Ndërtim pa leje, 1 kat.	500.000 lekë	JO	500.000 lekë	PO	-	500.000 lekë
22	M.M	0022	29.10.2021	Shtesë kati dytë.	500.000 lekë	JO	500.000 lekë	PO	-	500.000 lekë
23	B.F	0023	22.11.2021	Shtesë kati dytë.	500.000 lekë	JO	Në ndjekje të procedurave.	PO	-	500.000 lekë
24	E.SH	0024	22.11.2021	Ndarja e mureve me mur tulle, në katin e poshtëm të objektit ekzistues.	300.000 lekë	JO	300.000 lekë	PO	-	300.000 lekë
										Viti 2021 3.500.000 lekë
25	A.S	0025	07.02.2022	Ndërtim pa leje, dy objekte në zhvillim, (5m me 4m dhe 3m l, 23m me 7m dhe 6.5m l).	500.000 lekë	JO	Në ndjekje të procedurave.	PO	-	500.000 lekë
26	H.D	0026	02.03.2022	Ngritja e katit perdhe pa leje.	500.000 lekë	JO	500.000 lekë	PO	-	500.000 lekë
27	J.GJ	0027	11.05.2022	Punime ndërtimore në objektin e llojit magazine.	300.000 lekë	JO	300.000 lekë	PO	-	300.000 lekë
28	H. M	0028	11.05.2022	Ndërtimi i katit të dytë+cati, sistem kapotë.	500.000 lekë	JO	Në ndjekje të procedurave.	PO	-	500.000 lekë
29	M.D	0029	18.05.2022	Riparim i murit rrethues dhe ndertimin nga fillimi në verilindje.	300.000 lekë	JO	300.000 lekë	PO	-	300.000 lekë
30	N.P	0030	06.06.2022	Nërtimi i katit të nëndheshëm.	500.000 lekë	JO	Në ndjekje të procedurave.	PO	-	500.000 lekë
31	P.M	0031	23.06.2022	Rikonstruksion i godines ekzistuese, soletë+kollona.	300.000 lekë	JO	Në ndjekje të procedurave.	PO	-	300.000 lekë

32	L.G	0032	20.07.2022	Rikonstruksion i objektit ekzistues nga fillimi.	500.000 lekë	JO	500.000 lekë	PO	-	500.000 lekë
33	XH.M	0033	25.08.2022	Ndertimi soletes mbi objektin ekzistues.	300.000 lekë	JO	300.000 lekë	PO	-	300.000 lekë
34	A.B	0034	26.08.2022	Ndertimi murit rrethues pa leje.	150.000 lekë	JO	Ska marrë njoftim/ Në ndjekje te procedurave.	PO	-	150.000 lekë
35	S.G	0035	27.10.2022	Shtese kati dytë, rikonstruksion i katit të parë.	650.000 lekë	JO	650.000 lekë	PO	-	650.000 lekë
36	F.B	0036	12.12.2022	Shtesë anësore në katin e dytë.	300.000 lekë	JO	300.000 lekë	PO	-	300.000 lekë
										Viti 2022 total 4.800.000 lekë

Burimi: IMTV bashkia Cërrik

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

